

Melihate Zeqiri

Dafina Roka

Meleqe Kursoni

Nafije Grajeçevci

LIBËR PËR MËSUESIN

GJUHË SHQIPE 9

Për klasën e nëntë të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2022



Lejohet për botim teksti shkollor për klasën e nëntë, me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, nr. 01B/286, të datës 28.06.2022.

BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI
Recensentë të MASHTI-t: Prof: Sejdi Gashi, Vesel Islami, Gyltene Selimi
Korrektorë letrarë: Brunilda MENO, Arlon LIKO
Paraqitja grafike dhe kopertina: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-45-4

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, qershor 2022
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohej çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: cel: +355 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355 069 20 267 73; 069 40 106 88;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

Hyrja	5
Shpërndarja e orëve mësimore.....	7
Plani vjetor	9
Plani dymujor.....	13
Aspekte të përgjithshme të planit të orës mësimore	20

Hyrje

Lënda e *Gjuhës shqipe* bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë synon zhvillimin gjuhësor e letrar, që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që të përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës. Mësimi i gjuhës shqipe zhvillon te nxënësit të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, nxënësit zhvillojnë botën emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhën e kulturën kombëtare dhe ato botërore. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën dhe kureshtjen e nxënësve për t’u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinalë e krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura, që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte, në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë. Arritjet gjuhësore të nxënësve janë përcaktuese, jo vetëm për lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, por edhe për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë e të shkruajnë mirë, ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit bazë.

Korniza Kurrikulare përcakton si qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kyçe nga nxënësit. Ndërtimi dhe zhvillimi i këtyre kompetencave kyçe janë të domosdoshëm për një individ, me qëllim që të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Çdo fushë të nxëni dhe lënde synon që ta pajisë nxënësin me këto kompetenca. Këtë “mision”, lënda e realizon nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave të saj. Bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës së *Gjuhës shqipe*, pesë kompetencat e saj janë:

- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme
- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar
- Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale
- Përdorimi i drejtë i gjuhës.

Punë të mbarë!

SHPËRNDARJA E ORËVE MËSIMORE SIPAS KOMPETENCAVE PËR KLASËN IX
 PJESA E PARË: BASHKËBISEDIM, LEXOIMË DHE SHKRUAJMË - **100 ORË** = **66,70%**
 PJESA E DYTË: NJOHURI PËR GJUHËN – **50 ORË** = **33,30%**

PJESA E PARË: BASHKËBISEDOJMË, LE XOJMË DHE SHKRUAJMË	Njohuri të reja	Përpunim njohurish gjithsej	Përpunim njohurish të shpërndara					Orë gjithsej
			Lektyra	Projekt	Bashkëbisedim jashtë klase (vizita)	Përpunim i kompetencës	Testim (lexim) Ese (shkruajmë)	
KOMPETENCA: LEXOJMË	38 orë	9 orë	4 orë			2 orë	3 orë	47 orë
KOMPETENCA: SHKRUAJMË	15 orë	20 orë		4 orë		10 orë	6 orë	35 orë
KOMPETENCA: BASHKËBISEDOJMË	10 orë	8 orë			2 orë	6 orë		18 orë
	63 orë	37 orë						100 orë
PJESA E DYTË: NJOHURI PËR GJUHËN								
KOMPETENCA: DREJTSHKRIMI	10 orë	2 orë				1 orë	1 orë	12 orë
KOMPETENCA: LEKSIKOLOGJI	7 orë	2 orë			1 orë	1 orë		9 orë
KOMPETENCA: MORFOLOGJI	12 orë	5 orë				4 orë	1 orë	17 orë
KOMPETENCA: SINTAKSA	6 orë	6 orë		2 orë		3 orë	1 orë	12 orë
	35 orë	15 orë						50 orë

PLANI VJETOR

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi

Shkalla: 4

Klasa: IX

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE

Lëndët e Fushës kurrikulare	PERIUDHA I (83 orë)			PERIUDHA II (54 orë)			PERIUDHA III (48 orë)		Kontributi në rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës
	Shtator- Tetor (35 orë)	Nëntor (18 orë)	Dhjetor (17 orë)	Janar (10 orë)	Shkurt (15 orë)	Mars (20 orë)	Prill-Maj (27 orë)	Qershor (8 orë)	

Gjithsej, 185 orë në vit								
1. Njohja me nxënësit dhe planin mësimor Rrëfime popullore 2. Rrëfime nga e kaluara 3. Rozafati 4. Fjalë grosh 5. Epi i Gilgameshit 6. Fabula 7. Mençuria popullore 8. Përpunim njohurish 9. Ese Drejtshkrim 10. Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit 11. Përdorimi i drejtë i ligjëratës së drejtë 12. Përdorimi i drejtë i ligjëratës së zhdrejtë 13. Drejtshkrimi i fjalëve ku takohen dy zanore	Tekste fantastike 36. Tre vëllezërit dhe e Bukura e Dheut 37/38. Harri Potter mund trashëgimtarin e Gjarpërblertit 39. Krahësimi i heronjve të përrallës me heronjtë e filmave fantastikë Leksikologji 40. Leksiku i gjuhës shqipe dhe pasuria e tij 41. Dialektet e gjuhës shqipe 42. Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj	Leksikologji 54. Stilet e gjuhës 55. Mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat dhe stilet e ndryshme në gjuhën shqipe 56. Përpunim njohurish nga leksikologjia Tekste poetike 57. Vargje kushtuar mallit 58. Malli për të pambërrirshmen 59. Ejani o kujtime! 60. Lamtumirë! 61. Në rrugën <i>Gjenerali Vaj</i> s	Klasa e fjalëve 71. Drejtshkrimi i emrave që kanë dy trajta shumësi 72. Lakimi i përmrave 73. Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit 74. Përdorimi i apostrofit para trajtave të shkurtra 75. Folja 76. Mënyrat dhe kohët e foljes	81/82/ Përpunim njohurish/ Folja 83. Test/ gjuhësi Teksti poetik 84/85. Martesa e Halilit 86. Gjuha shqipe 87. Këndo ose vdis pa klithmë 89. Lexim 90/91. artistik i poezive 92. Përpunim njohurish 93. Ese 94. Test/ Letërsi	Drama 96/97 Trashëgimi a 98/99. Makbeth 100/101. Cili është ndryshimi midis tragjedisë dhe shfaqjes së saj në teatër? 102. Shekspiri në teatër dhe Shekspiri në film 103. Përpunim njohurish Teksti jo letrar <i>Tekste rrëfyese</i> 104. Yllka Domi ose poezia e këputur përgjysmë	Sintaksa 116/117. Kallëzuesi 118/119. Llojet e kallëzuesit 120. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje 121. Fjalitë e përbëra me nënrenditje 122. Përpunim njohurish 123. Fjalitë e përbëra me nënrenditje 124. Përpunim njohurish 125. Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur 126. Përpunim njohurish nga sintaksa	143/144. Projekt/ Sintaksë 145. Vizitë bibliotekës së qytetit 146. Lektyra shkollore 147. Test/ Letërsi 148. Ese 149/150. Përfundimi i vitit/ rikujtim / rishikim i njohurive	Komunikues efektiv: I/1.2.3.4.5.6.7.8 Mendimtarë kreativ: II/1.2.3.4.5.6.7.8 Nxënësi i suksesshëm: III/1.2.3.4.5.6.7.8 Kontribues produktiv: IV/1.2.3.4.5.6.7.8 Individi shëndoshë: V/1.3.5.6.7.8.9. Qytetar i përgjegjshëm: VI/1.2.3.4.5.6.7.8.9.

14. Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupet: <i>ye, ua, ue</i> .	43. Huazimet/ Shmangia e tyre	62. Bashkëbisedo jmië /shkrualjmë poezi	95. Përforcim / Letërsi	105. Ese për Yllka Domin	127. Test/Sintaksa <i>Tekste udhëzuese</i>	Komunikues efektiv: I/1.2.3.4.5.6.7.8
15. Drejtshkrimi i fjalëve të huazuara nga gjuhët e huaja	44. Gjuthësi: përpunim njohurish Tekstet fantastike 45./46. Udhëtimi për në qendër të Tokës	63. Lexim artistik Klasa e fjalëve 64. Klasat e fjalëve 65. Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme 66. Lakimi i emrave 67/68. Përpunim njohurish/ Gjuthësi 69/70. Projekt/Letërsi	77. Përpunim njohurish 78. Forma veprorë dhe joveprorë e foljeve 79. Pjesorja dhe format e tjera të pashtjelhuara të foljes 80. Foljet gjysmëndihm ëse	106. Udhëtimi në Paris 107. Homeri i Shqipërisë 108. Tung, babë! 109. Gjuha amtare, detyrim mbarëkom bëtar 110. Shkrualjmë/ Një gjuhë një komb <i>Tekste informuese paraqitëse</i> 111. Bibliotekat më të bukura në botë 112. Shkrualjmë/	128. Këshilla për të shmangur shqetësimin e panevojshëm përgjatë pasigurisë globale 129. Bashkëbisedoj më/ Si të shmangim shqetësimet gjatë pasigurive globale 130. Dieta e jetëgjatësisë <i>Tekste argumentuese</i> 131. Fjalimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut	Mendimtarë kreativ: II/1.2.3.4.5.6.7.8 Nxënës i suksesshëm: III/1.2.3.4.5.6.7.8 Kontribues produktiv: IV/1.2.3.4.5.6.7.8 Individ i shëndoshë: V/1.3.5.6.7.8. 10 Qytetar i përgjegjshëm: VI/1.2.3.4.5.6.7.8
16. Drejtshkrimi i nyjës së përparme të emrave (i, e, të, së)	47. Udhëtimi i gjatë i Geri Hopit	68. Shndërrimi i doktor Xhekilit				
17. Drejtshkrimi i nyjës së përparme të mbiemrave dhe të përremrave pronorë	48. Maska e Murtajës së Kuqe	69. Përpunim njohurish 51/52. Lektyra shkollorë Leksikologji				
18. Drejtshkrimi i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura	53. Regjistrat e gjuhës					
19. Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras						

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsia

20. Shkrimi i fjalëve me vizë lidhëse në mes	113. Veshjet popullore 114/115. Projekt/Letërsi	132. Zbulimi i Hektorit 133. Shkruajmë ese argumentuese Tekste përshkruese 134. Parku i Gërmisë 135. Ese 136. Banesa tiranase 137. Shkruajmë ese përshkruese 138. Përpunim njohurish 139. Test/Letërsi 140. Lektyra shkollore 141. Ushtrime/Shkruajmë 142. Vizitë	Komunikues efektiv: I/1.2.3.4.5.6.7.8 Mendimtarë kreativ: II/1.2.3.4.5.6.7.8 Nxënës i suksesshëm: III/1.2.3.4.5.6.7.8 Kontribuues produktiv: IV/1.2.3.4.5.6.7.8 Individ i shëndoshë: V/1.3.5.6.7.8. 10 Qytetar i përgjegjshëm: VI/1.2.3.4.5.6.7.8
21. Përpunim njohurish			
22. Test/ Gjydhësi/Drejtshtkrimi			
Tekste realiste			
23. Lodra me akull			
24. Fshati mbi shtatë kodrina			
25/26. Djali me pizhame me vija			
27. Të mjerët			
28. Gjerdani			
29. Krahason romanin me tregimin			
30. Në stuhi			
31. Vdekja e nëpunësit			
32/33. Krastakraus			
34. Përpunim njohurish			
35. Test/ Letërsi			

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

PLANI DYMUJOR: SHTATOR-TETOR

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi
Klasa: IX; Shkalla IV

Lënda mësimore: Gjuhë shqipe (4 orë në javë)

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës:

- I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8
- II. Mendimtar kreativ 1, 2, 4, 5, 7, 8
- III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8
- IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8
- V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9
- VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 3, 4, 5, 6, 7, 9

Rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare të shkallës, që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës:

I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT

Të dëgjuarit dhe të folurit• Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura e për situata komplekse shoqërore. Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit• Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletrare. Pasuron fjalorin. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. • Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. • Identifikon dhe analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. si dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

Të shkruarit• Zhvillon forma të veçanta të shkrimit: ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore dhe drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punime të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në media. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe joletrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

• Komunikon mirë. • Merr pjesë në diskutim. • Bashkëpunon. • Kërkon dhe jep ndihmë. • Respekton mendimin e të tjerëve. • Kushton vëmendje. • Motivohet për zhvillimin e shkathëtsive. • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. • Respekton parimet e të tjerëve. • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

• Komunikon mirë. • Merr pjesë në diskutim. • Bashkëpunon. • Kërkon dhe jep ndihmë. • Respekton mendimin e të tjerëve. • Kushtron vëmendje. • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. • Respekton parimet e të tjerëve. • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur. • Përdor imagjinatën dhe kreativitetin. • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

• Të komunikuarit. • Të dëgjuarit. • Të folurit. • Të shkruarit. • Të lexuarit. • Të kuptuarit. • Përdorimi i teknologjisë informative. • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS • Komunikim verbal dhe joverbal. • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elementë të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përalla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njofim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Teksti letrar Rrëfime popullore	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja. Dallon heroin e përrallës nga ai i një film fantastik (p.sh.: krahason heroin e përrallës “E bukura e dheut”, me heronj nga “Zoti i unazave”). Krahason llojet epike me ato lirike.	1. Njohja me nxënësit dhe planin mësimor Rrëfime popullore 2. Rrëfime nga e kaluara 3. Rozafati 4. Fjalë grosh 5. Epi i Gilgameshit 6. Fabula 7. Mençuria popullore 8. Përpunim njohurish 9. Ese Drejtshkrim 10. Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit 11. Përdorimi i drejtë i ligjëratës së drejtë 12. Përdorimi i drejtë i ligjëratës	35- orë	1) Prezantim Diskutime 2) Stuhi mendimesh Diamanti Rrjeti i diskutimit 3) Stuhi mendimesh Të nxënit në këmbime Pesëvargësh 4) Shqyrtim i përbashkët; Punë e pavarur; Punë në dyshe. 5) Kllaster; Pesëvargëshi. 6) Kllaster Lapsat në mes; Pesëvargësh. 7) Shqyrtimi i njohurive paraprake; Mësimdhënia e ndërsjellë;	Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit Vlerësim i të shprehurit me gojë Vlerësim i vazhdueshëm	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi. Edukatë qytetare; Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi	Teksti shkollor Burime nga interneti Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të

	dhe stilistike.	së zhdrejtë 13. Drejtshkrimi i fjalëve ku takohen dy zanore 14. Drejtshkrimi i fjalëve që kanë grupet ye, ua, ue. 15. Drejtshkrimi i fjalëve të huazuara nga gjuhët e huaja 16. Drejtshkrimi i njëjës së përparme të emrave (i, e, të, së) 17. Drejtshkrimi i njëjës së përparme të mbiemrave dhe të përremrave pronorë 18. Drejtshkrimi i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura 19. Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras 20. Shkrimi i fjalëve me vizë lidhëse në mes 21. Përpunim njohurish 22. Test/ Gjuhësi/ Drejtshkrimi Tekste realiste 23. Lodra me akull 24. Fshati mbi shtatë kodrina 25/26. Djali me		Shqyrtimi i përbashkët. 8) Prezantim digjital Lexim artistik; Rrjeti i diskutimit. 9) Stuhi mendimesh; Lapsat në mes; Marrëdhënia pyetje/përgjigje. 10) Stuhi mendimesh Marrëdhënia e ndërsjellë + lojë gjuhësore; Rrjeti i diskutimit. 11) Kubimi 12) Parashikim me tema paraprakë; Marrëdhënia pyetje/përgjigje; Ditari dy pjesësh. 13) Përshkrim vizual Diamanti; Marrëdhënia pyetje/përgjigje. 14) Kubimi 15) Vështrim Mësimdhënia e ndërsjellë; Rrjeti i diskutimit. 16) Vështrim Mësimdhënia e ndërsjellë; Rrjeti i diskutimit. 17/18) Stuhi mendimesh; DRTA	Vlerësim për të nxënëit (formativ) Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënëit (formativ) Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.
Analizon strukturën e konfliktit të një veprë.						
Dallon drejtime të ndryshme (romantike, moderniste etj., në vepra periudhash të ndryshme letrare).						
Debaton për ide dhe siguron të dhëna për krahasimin e veprave me tema universale.						
Heton lidhjet e historisë dhe fiksionit, tekstit dhe kontekstit.						
Dallon karakteret tragjike nga ato komike, reale nga ato fantastike, përallore nga ato fantastike-shkencore.						
Shkruan ese të ndryshme për tekste						

	letrare e joletrare. Zbaton njohuritë e fituara në drejtshkrim dhe drejtshqiptim. Përdor forma të ndryshme të shkrimit letrar dhe joletrar, duke kuptuar rolin e standardit dhe të folurit dialektor e lokal për letërsinë.	pizhame me vija 27. Të mjerët 28. Gjerdani 29. Krahason romanin me tregimin 30. Në stuh 31. Vdekja e nëpunësit 32/33. Krastakraus 34. Përpunim njohurish 35. Test/ Letërsi		Diskutimi. 19) Vështrim Tabela e konceptit; Informata kthyes. 20) Kubimi 21) Stuhi mendimesh Të nxën në këmbime; Rrjeti i diskutimit. 25/26) Shqyrtim i përbashkët; Punë e drejtuar; Punë në çifte. 27/28) Prezantim digjital DRTA Puno në dyshe/ shkëmbe mendime; Diskutim. 29) Kllaster Marrëdhënia pyetje-përgjigje; Tabela e konceptit. 30) Mësimdhënia e ndërsjellë; Pema e mendimeve; Lojë gjuhësore. 31/32) Shqyrtim i njohurive; Diagrami i Venit; Punë në grupe.	Vlerësim diagnostikues Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim për të nxën të (formativ) Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxën të (formativ) Vlerësim i Vazhdueshëm	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore, Shoqëria dhe mjedisi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi	Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale
--	---	---	--	--	--	--	--

shesë të përgatitura nga mësuesi/ja.	
Vlerësim për të nxënësit (formativ) Vlerësim për të nxënësit (formativ)	34) Imagjinata e drejtuar; Lexim artistik; Mendo/puno në dyshe /tregoju të tjerëve. 35) Kubimi

Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shpesh të përgatitura nga mësuesi/ja.						

MODEL PLANI DYMUJOR: NËNTOR-DHJETOR

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi; **Lënda mësimore:** Gjuhë shqipe dhe letërsi (4 orë në javë);

Klasa: IX; **Shkalla** IV

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

- I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8**
- II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8**
- III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8**
- IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8**
- V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9**
- VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9**

Rezultatet e të nxënit të fushës së kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT

• Të dëgjuarit dhe të folurit

- Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore.
- Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.

• Të lexuarit

- Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe jolettrare. Pasuron fjalorin. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
- Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.
- Analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

Të shkruarit

- Zhvillon forma të veçanta të shkrimit: ese, (auto)biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
- Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në media. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe jolettrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

- Komunikon mirë.
- Merr pjesë në diskutim.
- Bashkëpunon.
- Kërkon dhe jep ndihmë.

- Respekton mendimin e të tjerëve.
- Kushton vëmendje.
- Motivohet për zhvillimin e shkathtësive.
- Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve.
- Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe.
- Respekton parimet e të tjerëve.
- Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin.
- Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme
- Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

- Të komunikuarit.
- Të dëgjuarit.
- Të folurit.
- Të shkruarit.
- Të lexuarit.
- Të kuptuarit.
- Përdorimi i teknologjisë informative.
- Zgjidhja e problemeve.
- Aftësitë e të menduarit.
- Përpunimi i informacionit.
- Të menduarit krijues.

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

- Komunikim verbal dhe joverbal.
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst.
- Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.
- Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare.
- Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman.
- Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim.
- Strofë, varg, rimë.
- Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitete.
- Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim.
- Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë.
- Llojet e fjalive sipas intonacionit.
- Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta.
- Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit.
- Parafjalë, lidhëz.
- Shenjat e pikësimit.
- Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Tekste fantastike Rrëfime popullore	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja. Dallon heroin e përrallës nga ai i një filmi fantastik; (p.sh. krahason heroin e përrallës “E bukura e dheut” me heronj nga “Zoti i unazave” etj.).	Tekste fantastike 36. “Tre vëllezërit dhe e bukura e dheut” 37. & 38. “Harri Poter mund trashëgimtarin e Gjarpërblerit” 39. Krahasonimi i heronjve të përrallës me heronjtë e filmave fantastikë	35- orë	36. Stuhi mendimesh DRTA Puno në dyshe 37. & 38. Stuhi mendimesh DRTA Shkëmbe mendime	Vlerësim për të nxënit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.	Teksti shkollor
Teksti letrar/	Krahason llojet epike me ato lirike.	Leksikologji 40. Leksiku i gjuhës shqipe dhe pasuria e tij		39. Stuhi mendimesh Ditari dypjesësh Tabela T 40. Stuhi mendimesh Diskutim Punë në grupe	Vlerësim i vazhdueshëm	Shkenat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi.	Burime nga interneti
Tekste realiste Njohuri për gjuhën/ Drejtshkrimi Leksikologjia	Analizon zhvillimin historik të gjuhës dhe argumenton dokumentimin e vonë të shqipes. Dallon gjuhën standarde nga dialektet dhe zbaton normën gjuhësore në të folur e në të shkruar.	41. Dialektet e gjuhës shqipe 42. Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj 43. Huazimet/ Shmangia e tyre 44. Gjuhësi: përpunim njohurish		41. Stuhi mendimesh Diagrami I Venit 42. Krijë në dyshe Diskutim 43. Stuhi mendimesh Punë e pavarur 44. Stuhi mendimesh Lapsat në mes Marrëdhënia pyetje-përgjigje 45. 46. 47. Stuhi	Vlerësimi i të nxënit Vlerësim i të shprehurit me gojë	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.	Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesja.
Morfologjia Klasa e fjalëve	Zbaton njohuritë e fituara në drejtshkrim dhe drejtshqiptim. Përdor forma të ndryshme të shkrimit letrar dhe joletrar, duke kuptuar rolin e standardit dhe të folurit dialektor e lokal për letërsinë. Dallon tipare të tregimit	Tekstet fantastike 45. & 46. “Udhëtimi për në qendër të Tokës” 47. “Udhëtimi i gjatë i Geri Hopit”			Vlerësim për të nxënit (formativ)	Shkenat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi	

të shkurtër nga tipare të romanit, duke u përqendruar në efektet narrative dhe stilistike. Analizon strukturën e konfliktit të një vepre. Dallon drejtime të ndryshme (romantike, moderniste etj., në vepra periudhash të ndryshme letrare). Debaton për ide dhe siguron të dhëna për krahasimin e veprave me tema universal. Heton lidhjet e historisë dhe fiksionit, tekstit dhe kontekstit. Dallon karakteret tragjike, nga ato komike, reale nga ato fantastike, përrallore nga ato fantastike-shkencore. Shkruan ese të ndryshme për tekste letrare e joletrare. Zbaton njohuritë e fituara në drejtshkrim dhe drejtshqiptim; Përdor forma të ndryshme të shkrimit letrar dhe joletrar, duke kuptuar rolin e standardit dhe të folurit dialektor e lokal për letërsinë.	48. “Shndërrimi i doktor Xhekillit” 49. “Maska e murtajës së kuqe” 50. Përpunim njohurish 51./52. Lektyra shkollore Leksikologji 53. Regjistrat e gjuhës 54. Stilet e gjuhës 55. Mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat dhe stilet e ndryshme në gjuhën shqipe 56. Përpunim njohurish nga leksikologjia Tekste poetike 57. Vargje kushtuar mallit 58. Malli për të pambërrirjtshmen 59. Ejani o kujtime! 60. Lamtumirë! 61. Në rrugën e Gjeneralit Vajës 62. Bashkëbisedojmë / shkruajmë poezi 63. Lexim artistik Klasa e fjalëve 64. Klasat e fjalëve 65. Fjalët e	mendimesh Ditari dypjesësh Tabela T 48. Lojë Minileksion Punë në dyshe 49. Stuhi mendimesh Lexim i drejtuar diskutim 50. 51. 52. Rrjeti i diskutimit Vështrim Mësimdhënia e ndërsjellë 53. Stuhi mendimesh Ditari dypjesësh Rrjeti i diskutimit 54. Pyetje-Përgjigje Ditarët e të nxënit Shkëmbje mendime 55. RAFT 56. Stuhi mendimesh Të nxënit në këmbime Rrjeti i diskutimit 57. Shkrim 5’ Pyetje-përgjigje Citat-koment 58. Stuhi mendimesh Pyetje-përgjigje Diagrami i Vënit 59. Kllaster	Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim diagnostikues Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim për të nxënit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shitesë të përgatitura nga mësuesja Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shitesë të përgatitura nga mësuesja
--	---	---	---	--

MODEL PLANI DYMUJOR: JANAR-SHKURT

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi; Lënda mësimore: Gjuhë shqipe dhe Letërsi (4 orë në javë);

Klasa: IX; Shkalla IV

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8

II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8

III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8

IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8

V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9

VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

a

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT

Të dëgjuarit dhe të folurit

- Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore.
- Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit

- Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletrare. Pasuron fjalorin. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
- Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.
- Analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

Të shkruarit

- Zhvillon forma të veçanta të shkrimit: ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
- Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në medie. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe joletrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

- Komunikon mirë.
- Merr pjesë në diskutim.
- Bashkëpunon.
- Kërkon dhe jep ndihmë.
- Respekton mendimin e të tjerëve.
- Kushton vëmendje.
- Motivohet për zhvillimin e shkathtësive.
- Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve.
- Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe.
- Respekton parimet e të tjerëve.
- Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin.
- Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme
- Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

- Të komunikuarit.
- Të dëgjuarit.
- Të folurit.
- Të shkruarit.
- Të lexuarit.
- Të kuptuarit.
- Përdorimi i teknologjisë informative.
- Zgjidhja e problemeve.
- Aftësitë e të menduarit.
- Përpunimi i informacionit.
- Të menduarit krijues.

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

- Komunikim verbal dhe joverbal.
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst.
- Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.
- Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare.
- Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman.
- Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim.
- Strofë, varg, rimë.
- Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet.
- Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim.
- Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë.
- Llojet e fjalive sipas intonacionit.
- Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta.
- Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit.
- Parafjalë, lidhëz.
- Shenjat e pikësimit.
- Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Klasat e fjalëve	Praktikon trajtat e emrave në rasën, numrin dhe gjininë përkatëse.	Klasa e fjalëve	25- orë	71) Brainstorming Punë e drejtuar Diskutime	Vlerësim për të nxënit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.	Teksti shkollor
Drejtshkrimi	Dallon dhe përdor në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore, sipas ligjërimeve dhe stileve funksionale.	71. Drejtshkrimi i emrave që kanë dy trajta shumësi		72. & 73. Stuhi mendimesh Punë në grupe Punë individuale	Vlerësim i vazhdueshëm	Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi.	Burime nga interneti
Teksti poetik	Dallon format e shijelluara nga ato të pashtjelluara të foljeve.	72. Lakimi i përemrave vektorë		74. Punë në dyshe Mësimdhënia e ndërsjellë	Vlerësim diagnostikues		
Teksti letrar	Dallon vlerat modale dhe kohore të foljeve përbrenda ligjërimit.	73. Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vektor		75. & 76. Stuhi mendimesh INSERT	Vlerësimi i të nxënit	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.	Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesja.
Njohuri për gjuhën	Dallon foljet, i ndan ato në tri zgjedhime, gjashtë mënyra, gjen temën, mbaresën e foljeve, dallon format e pashtjelluara.	74. Përdorimi i apostrofit para trajtave të shkurtra		Rrjeti i diskutimit	Vlerësim i të shprehurit me gojë		
	Dallon heroin e përrallës nga ai i një film fantastik; (p.sh. krahason heroin e përrallës “E bukura e dheut” me heronj nga “Zoti i unazave” etj.).	75. Folia		77. Shqyrtimi i njohurive paraprake Mësimdhënia e ndërsjellë	Vlerësim i vazhdueshëm	Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi	
	Krahason llojet epike me ato lirike.	76. Mënyrat dhe kohët e foljes		Shqyrtimi i përbashkët	Vlerësim për të nxënit (formativ)		
	Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	77. Përpunim njohurish		78. Harta e mendjes Të nxënit në bashkëpunim Lojë gjuhësore 79. & 80. Pema e mendimit Diskutim Punë në grupe			

Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si poezi, prozë, tekst dramatik, artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik. Analizon strukturën e konfliktit të një veprë. Dallon drejtime të ndryshme (romantike, moderniste etj., në vepra periudhash të ndryshme letrare). Debaton për ide dhe siguron të dhëna për krahasimin e veprave me tema universale. Heton lidhjet e historisë dhe fiksionit, tekstit dhe kontekstit. Dallon karakteret tragjike, nga ato komike, reale nga ato fantastike, përrallore nga ato fantastike-shkencore. Shkruan ese të ndryshme për tekste letrare e joletrare.	80. Foljet gjysmëndihmëse 81. & 82. Përpunim njohurish/ Folja 83. Test/ gjuhësi Teksti poetik 84. & 85. Martesa e Halilit 86. Gjuha shqipe 87. Këndo ose vdis pa klithmë 89. Lexim artistik i poezive 90. & 91. “Sharlota” 92. Përpunim njohurish 93. Ese 94. Test/ Letërsi 95. Përf forcim/ Letërsi	81. & 82. Marrëdhënia e ndërsjellë + lojë gjuhësore Rrjeti i diskutimit 83. Marrëdhënia pyetje-përgjigje 84. & 85. Kllaster Secili mësion një pesëvargëshi 86. Kllaster Citat/koment pesëvargëshi 87. Stuhi mendimesh Citat/koment Ese 5’ 89. Vështrim Mësimdhënia e ndërsjellë Rrjeti i diskutimit 90. & 91. Stuhi mendimesh Karrigia e autorit Analizë teksti 92. Vështrim Tabela e konceptit Informata kthyesë 93. Ese 94. Marrëdhënia pyetje-përgjigje 95. Shqyrtim i përbashkët Puno në dyshe/ shkëmbe mendime	Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënëit (formativ) Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënëit (formativ) Vlerësim diagnostikues	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.	Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesja Teksti i nxënësit; materiale nga interneti
---	---	---	--	---	--

MODEL PLANI DYMUJOR: MARS-PRILL

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi; Lënda mësimore: Gjuhë shqipe dhe letërsi (4 orë në javë)

Klasa: IX; Shkalla IV

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

- I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8**
- II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8**
- III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8**
- IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 8**
- V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9**
- VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9**

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT

• Të dëgjuarit dhe të folurit

- Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore.
- Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.

• Të lexuarit

- Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletrare. Pasuron fjalorin. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin.
- Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.
- Analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

Të shkruarit

- Zhvillon forma të veçanta të shkrimit: ese, (auto)biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.
- Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në media. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe joletrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

- Komunikon mirë.
- Merr pjesë në diskutim.
- Bashkëpunon.
- Kërkon dhe jep ndihmë.
- Respekton mendimin e të tjerëve.
- Kushton vëmendje.
- Motivohet për zhvillimin e shkathtësive.
- Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve.
- Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe.
- Respekton parimet e të tjerëve.
- Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin.
- Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme
- Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

- Të komunikuarit.
- Të dëgjuarit.
- Të folurit.
- Të shkruarit.
- Të lexuarit.
- Të kuptuarit.
- Përdorimi i teknologjisë informative.
- Zgjidhja e problemeve.
- Aftësitë e të menduarit.
- Përpunimi i informacionit.
- Të menduarit krijues.

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS

- Komunikim verbal dhe joverbal.
- Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst.
- Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri.
- Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare.
- Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman.
- Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim.
- Strofë, varg, rimë.
- Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitet.
- Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim.
- Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë.
- Llojet e fjalive sipas intonacionit.
- Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta.
- Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit.
- Parafjalë, lidhëz.
- Shenjat e pikësimit.
- Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Teksti letrar	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja.	Drama 96. & 97. Trashëgimia 98. & 99. Makbeth 100. & 101. Cili është ndryshimi midis tragjedisë dhe shfaqjes së saj në teatër? 102. Shekspiri në teatër dhe Shekspiri në film 103. Përpunim njohurish Teksti joletrar Tekste rrëfyese 104. Yllka Domi ose poezia e këputur përgjysmë 105. Ese për Yllka Domin 106. Udhëtimi në Paris 107. Homeri i Shqipërisë 108. “Tung babë” 109. Gjuha amtare, detyrim mbarëkombëtar	32- orë	96. 97. 98. 99. Stuhi mendimesh Pyetje-përgjigje Rrjeti i diskutimit 100. & 101. Organizimi grafik Pyetje përgjigje Rrjeti i diskutimit 102. Stuhi mendimesh Lexim Rrjeti i diskutimit 103. Kllaster Secili mëson një Pesëvargëshi 104. Stuhi mendimesh Lapsat në mes pesëvargëshi 105. Ese përshkruese 106. Gushëkuqi rrethor Të nxënit në këmbime Diagrami i Venit 107. Stuhi mendimesh Citat/koment 3-2-1 108. Stuhi mendimesh Di-dua të di-mësova Ese 5’ 109. Stuhi mendimesh INSERT Karikatori i pistoletës 110. Kllaster Lapsat në mes Pesëvargësh 111. Përkthim vizual/ Diamanti 110/Diagrami i Venit 112. Stuhi mendimesh	Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim diagnostikues Vlerësimi i të nxënit Vlerësimi i të shprehurit me gojë Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi. Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore;	Teksti shkollor Burime nga interneti Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesja. Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesja
Teksti joletrar Tekste rrëfyese	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja. Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik, artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik. Analizon strukturën e konfliktit të një veprë.	Teksti joletrar Tekste rrëfyese 104. Yllka Domi ose poezia e këputur përgjysmë 105. Ese për Yllka Domin 106. Udhëtimi në Paris 107. Homeri i Shqipërisë 108. “Tung babë” 109. Gjuha amtare, detyrim mbarëkombëtar	32- orë	96. 97. 98. 99. Stuhi mendimesh Pyetje-përgjigje Rrjeti i diskutimit 100. & 101. Organizimi grafik Pyetje përgjigje Rrjeti i diskutimit 102. Stuhi mendimesh Lexim Rrjeti i diskutimit 103. Kllaster Secili mëson një Pesëvargëshi 104. Stuhi mendimesh Lapsat në mes pesëvargëshi 105. Ese përshkruese 106. Gushëkuqi rrethor Të nxënit në këmbime Diagrami i Venit 107. Stuhi mendimesh Citat/koment 3-2-1 108. Stuhi mendimesh Di-dua të di-mësova Ese 5’ 109. Stuhi mendimesh INSERT Karikatori i pistoletës 110. Kllaster Lapsat në mes Pesëvargësh 111. Përkthim vizual/ Diamanti 110/Diagrami i Venit 112. Stuhi mendimesh	Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim diagnostikues Vlerësimi i të nxënit Vlerësimi i të shprehurit me gojë Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi. Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore;	Teksti shkollor Burime nga interneti Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesja
Tekste informuese paraqitëse	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja. Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik, artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik. Analizon strukturën e konfliktit të një veprë.	Teksti joletrar Tekste rrëfyese 104. Yllka Domi ose poezia e këputur përgjysmë 105. Ese për Yllka Domin 106. Udhëtimi në Paris 107. Homeri i Shqipërisë 108. “Tung babë” 109. Gjuha amtare, detyrim mbarëkombëtar	32- orë	96. 97. 98. 99. Stuhi mendimesh Pyetje-përgjigje Rrjeti i diskutimit 100. & 101. Organizimi grafik Pyetje përgjigje Rrjeti i diskutimit 102. Stuhi mendimesh Lexim Rrjeti i diskutimit 103. Kllaster Secili mëson një Pesëvargëshi 104. Stuhi mendimesh Lapsat në mes pesëvargëshi 105. Ese përshkruese 106. Gushëkuqi rrethor Të nxënit në këmbime Diagrami i Venit 107. Stuhi mendimesh Citat/koment 3-2-1 108. Stuhi mendimesh Di-dua të di-mësova Ese 5’ 109. Stuhi mendimesh INSERT Karikatori i pistoletës 110. Kllaster Lapsat në mes Pesëvargësh 111. Përkthim vizual/ Diamanti 110/Diagrami i Venit 112. Stuhi mendimesh	Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim diagnostikues Vlerësimi i të nxënit Vlerësimi i të shprehurit me gojë Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi. Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore;	Teksti shkollor Burime nga interneti Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesja
Njohuri për gjuhën/ Sintaksa	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja. Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik, artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik. Analizon strukturën e konfliktit të një veprë.	Teksti joletrar Tekste rrëfyese 104. Yllka Domi ose poezia e këputur përgjysmë 105. Ese për Yllka Domin 106. Udhëtimi në Paris 107. Homeri i Shqipërisë 108. “Tung babë” 109. Gjuha amtare, detyrim mbarëkombëtar	32- orë	96. 97. 98. 99. Stuhi mendimesh Pyetje-përgjigje Rrjeti i diskutimit 100. & 101. Organizimi grafik Pyetje përgjigje Rrjeti i diskutimit 102. Stuhi mendimesh Lexim Rrjeti i diskutimit 103. Kllaster Secili mëson një Pesëvargëshi 104. Stuhi mendimesh Lapsat në mes pesëvargëshi 105. Ese përshkruese 106. Gushëkuqi rrethor Të nxënit në këmbime Diagrami i Venit 107. Stuhi mendimesh Citat/koment 3-2-1 108. Stuhi mendimesh Di-dua të di-mësova Ese 5’ 109. Stuhi mendimesh INSERT Karikatori i pistoletës 110. Kllaster Lapsat në mes Pesëvargësh 111. Përkthim vizual/ Diamanti 110/Diagrami i Venit 112. Stuhi mendimesh	Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim diagnostikues Vlerësimi i të nxënit Vlerësimi i të shprehurit me gojë Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi. Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore;	Teksti shkollor Burime nga interneti Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shtesë të përgatitura nga mësuesja

Shkruan ese të ndryshme për tekste letrare e joletrare. Zbaton njohuritë e fituara në drejtshkrim dhe drejtshqiptim. Përdor forma të ndryshme të shkrimit letrar dhe joletrar, duke kuptuar rolin e standardit dhe të folurit dialektor e lokal për letërsinë. Dallon nivele të ndryshme të artikullimit gjuhësor, nga zhvillimi i fjalisë së thjeshtë në fjali të përbërë dhe paragraf. Dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje. Shkruan paragrafë me fjali të bashkërenditura dhe të nënrenditura.	110. Shkruajmë/Një gjuhë-një komb <i>Tekste informuese paraqitëse</i> 111. Bibliotekat më të bukura në botë 112. Shkruajmë/ 113. Veshjet popullore 114. & 115. Projekti/ Letërsi Sintaksa 116. & 117. Kallëzuesi 118. & 119. Llojet e kallëzuesit foljor dhe emëror 120. Fjalitë e përbëra me bashkërenditje 121. Fjalitë e përbëra me nënrenditje 122. Përpunim njohurish 123. Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethimore 124. Përpunim njohurish 125. Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore 126. Përpunim njohurish nga sintaksa 127. Test/Sintaksa	Shkruajmë 113. Ruaje fjalën e fundit për mua Tabela T 114. & 115. Prezantim digjital Lexim artistik Rrjeti i diskutimit 116.117.118.119. Punë Në grupe Diskutim Punë në dyshe 120. Diskutim Punë e pavarur 121. Pyetja sjell pyetjen/Kllaster diskutim 122. Marrëdhënia pyetje-përgjigje Ditari dypjesësh 123. Punë në grupe/ Diskutim Punë në çift 124. Marrëdhënia pyetje-përgjigje Ditari dypjesësh 125. Stuhi mendimesh Kllaster Punë individuale 126. Pena e mendimeve Informata kthyesë 127. Marrëdhënia pyetje-përgjigje Punë e pavarur	Vlerësim diagnostikues Vlerësim për të nxënësit (formativ) Vlerësim diagnostikues Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim për të nxënësit (formativ) Vlerësim i punëve me shkrim Vlerësim për të nxënësit (formativ) Vlerësim i Vazhdueshëm	Shoqëria dhe mjedisi Edukatë qytetare; Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi Edukatë qytetare; Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi Edukatë qytetare; Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; Shoqëria dhe mjedisi	Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shpesh të përgatitura nga mësuesja Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shpesh të përgatitura nga mësuesja
---	---	---	---	--	---

MODEL PLANI DYMUJOR: MAJ-QERSHOR

Fusha e kurrikulës: Gjuhët dhe komunikimi

Lënda mësimore: Gjuhë shqipe dhe letërsi (4 orë në javë)

Klasa: IX

Shkall: IV

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:

- I. Komunikues efektiv 1,2,3,4,5,6,7,8**
- II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 7,8**
- III. Nxënës i suksesshëm 1,2,3,4,5,6,7,8,**
- IV. Kontribuues produktiv 1,2,3,4,5,6,8**
- V. Individ i shëndoshë 1,2,3,4,5,6,7,8,9**
- VI. Qytetar i përgjegjshëm 1,2,3,4,5,6,7,9**

Rezultatet e të nxënit të fushës së kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave:

I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT

Të dëgjuarit dhe të folurit• Komunikon për të kuptuar ngjarjen, qëllimin dhe idetë për tema të caktuara përmes bisedave, monologëve, dialogëve etj. Bisedon me moshatarët dhe me të rriturit për tema të panjohura dhe për situata komplekse shoqërore. Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme.

Të lexuarit• Kupton dhe analizon tema të ndryshme letrare dhe joletrare. Pasuron fjalorin. Lexon dhe identifikon karakteristikat strukturore të tekstit, si: heroin, subjektin, idenë, detajin, figurën, rrëfimin, përshkrimin. • Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. • Identifikon dhe analizon vepra letrare duke identifikuar llojin, gjininë, temën, motivin, idenë, figurat, simbolet etj. dhe argumenton strukturën e ndërtimit të tyre.

Të shkruarit Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. • Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Shkruan për përvoja relevante që lidhen me kulturën dhe historinë e vendit. Përdor rregullat e shfaqjeve, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet të ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.) për paraqitje në medie. Përdor teknologjinë për shkrimin e krijimeve letrare dhe joletrare të ndryshme (programe softuerike, pajisje të regjistrimit), për të krijuar një video ose animacion.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET

- Komunikon mirë. • Merr pjesë në diskutim. • Bashkëpunon. • Kërkon dhe jep ndihmë. • Respekton mendimin e të tjerëve. • Kushton vëmendje. • Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. • Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. • Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. • Respekton parimet e të tjerëve. • Tregon vetëbesimin për punë të pavarur.
- Përdor imagjinatën dhe kreativitetin. • Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme • Kritikon duke u mbështetur mbi argumente.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË

- Të komunikuarit. • Të dëgjuarit. • Të folurit. • Të shkruarit. • Të lexuarit. • Të kuptuarit. • Përdorimi i teknologjisë informative. • Zgjidhja e problemeve • Aftësitë e të menduarit • Përpunimi i informacionit • Të menduarit krijues.

IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS • Komunikim verbal dhe joverbal. • Tingull, rrokje, diftong, fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf, tekst. • Shqiptim, intonacion, theks, ritëm, rrjedhshmëri. • Elemente të strukturës dhe formës teksteve letrare dhe joletrare. • Poezi, përralla, tregime, fabula, gjëgjëza, novelë, këngë popullore, legjenda, mite, roman. • Brendi, personazh, mjedis, temë, qëllim. • Strofë, varg, rimë. • Onomatope, personifikim, krahasim, hiperbolë, epitete. • Ditar, urim, kartolinë, letër, plan i thjeshtë, udhëzim, porosi, enciklopedi për fëmijë, atlas, njoftim. • Titull, kapitull, ilustrim, harta, tabelë. • Llojet e fjalive sipas intonacionit. • Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. • Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. • Parafjalë, lidhëz. • Shenjat e pikësimit. • Sinonime, antonime, fjalë të urta, shprehje frazeologjike.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha e nevojshme (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Tekste Udhëzuese	Ndërlidh njësitë paraprake me njësitë e reja. Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e jo letrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	Tekste udhëzuese 128. Këshilla për të shmangur shqetësimin e panevojshëm përgjatë pasigurisë globale 129. Bashkëbisedojmë/ Si të shmangim shqetësimet gjatë pasigurive globale 130. Dieta e jetëgjatësisë Tekste argumentuese 131. Fjalimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut 132. Zbulimi i Hektorit 133. Shkruajmë ese argumentuese Tekste	23- orë	128.129.130. Stuhi mendimesh Ditari dypjesësh Tabela T 131. Stuhi mendimesh Grupet e ekspertëve Pyetje/përgjigje 132. Stuhi mendimesh Ruaje fjalën e fundit për mua Top tre 133. Përvijim i të menduarit Lexim i koduar Punë me shkrim 134. Parashikimi me tema paraprak	Vlerësim për të nxënit (formativ) Vlerësim i vazhdueshëm Vlerësim diagnostikues Vlerësimi i të nxënit Vlerësim i të shprehurit me gojë Vlerësim i Vazhdueshëm Vlerësim për të nxënit (formativ)	Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; shoqëria dhe mjedisi. Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi. Shkencat shoqërore; shoqëria dhe	Teksti shkollor Burime nga interneti Teksti i nxënësit; materiale nga interneti; materiale shitesë të përgatitura nga mësuesja.
Tekste Argumentuese	Debaton për ide dhe siguron të dhëna për krahasimin e veprave me tema universal;						
Tekste Përshkruuese	Shkruan ese të ndryshme për tekste letrare e joletrare;						
Projekt	Zbaton njohuritë e fituara në drejtshkrim						

[illegible]

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Rrëfime popullore		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: Krahason mitin me përrallën, legjendën me fabulën.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):			
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):			
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit			
II. VLERAT DHE QËNDRIMET			
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË			
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Rrëfime nga e kaluara			
Fjalët kyçe: miti, Pandora, kutia, Epimeteu, Prometeu, Zeusi, e keqja, njerëzit			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore			
Nxënësi/ja:			
• kupton rëndësinë e miteve dhe vlerën e miteve;			
• njeh diskursin e përrallës;			
• dallon personazhet e legjendës dhe fabulës.			
Kriteret e suksesit:			
• Komento çfarë pasojash pati për njerëzimin mendjelehtësia e Epimeteut dhe kurioziteti i tepruar i Pandorës.			
• shpjegon bashkëbisedimin mes peshkatarit dhe të shoqes;			
• analizon fjalët e Skënderbeut dhe kupton rëndësinë e veprimit të tij.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
Pema e mendimeve, metoda e bashkëbisedimit, puna në grupe, lexim i drejtuar, diskutim i drejtuar.			
Pjesa hyrëse			
Mësuesi/ja në fillim të orës së mësimi përmes metodës së bashkëbisedimit shtron pyetjen: Si e kuptoni fjalën “mit”?			
Përmes përgjigjeve të ndryshme që mund të japin nxënësit, angazhon një nxënës të nivelit të lartë që përgjigjet t’i shkruajë në tabelë.			
Në vazhdim nxënësit njoftohen me pjesët që kanë për lexim:			
1. Kutia e Pandorës			
2. Peshkaqeni dhe e bukura e dheut - përrallë			
3. Legjenda e shpatës së Skënderbeut - legjendë			
4. Prit. Të ik unë, hyr ti - fabula			
38			

Ndërtimi i njohurive të reja: Puna në grupe, lexim i drejtuar, diskutim i drejtuar

Pjesa kryesore

Për të realizuar këtë etapë të orës mësimore klasën e ndajmë në grupe pune duke iu caktuar detyra për të punuar me fragmentet e dhëna. Nëpërmjet punës me grupe ekspertësh ndajmë klasën në katër grupe duke iu caktuar detyra specifike secilit grup.

Grupi i parë – Detyrat

Lexoni tekstin “Miti i krijimit të popullit pellazg” dhe diskutoni në grup lidhur me kërkesat:

- Cila ishte arsyeja e armiqësisë mes Prometeut dhe Zeusit?
- Cili ishte qëllimi që Zeusi krijoi të Pandorën dhe ai dha atë Epimeteut?
- Cila ishte dhurata e martesës që Zeusi i dha Pandorës?
- Pandora ishte shumë kureshtare. A mendoni se kjo ishte e rastësishme?
- Çfarë roli luajti shpresa, e fundit që doli nga kutia e Pandorës, në jetën e njerëzve?

Grupi i dytë – Detyrat

Lexoni tekstin “Peshkaqeni dhe e bukura e dheut” dhe pasi të diskutoni me grupin, shkruani përgjigjet në fletore.

- Fjalët e peshkut që zuri peshkatari “Mos më trazo mua, se s’jam fati yt” e shtyjnë atë ta lëshojë. Si iu shpërblye peshkatari ky veprim?
- Personazheve u duhet të përballen me një shtrigë që mban peng të bukurën e dheut:
 - Çfarë i bëri shtriga vëllait të parë?
 - A arriti t’i bënte të njëjtën gjë vëllait të dytë?
 - Në çfarë mënyre mund të zhbëhej magjia e shtrigës?

Grupi i tretë – Detyra

Lexoni tekstin “Legjenda e shpatës së Skënderbeut”. Diskutoni dhe shkruani përgjigjet.

- Kujt ia dhuroi shpatën Skënderbeu?
- Çfarë kërkonte të shprehte me këtë veprim ai?
- Cilat veprime të jashtëzakonshme thuhej se mund të kryente Skënderbeu?

Grupi i katërt – Detyra

Lexoni fabulën “Prit. Të ik unë, hyr ti”. Diskutoni në grup dhe shkruani përgjigjet në fletore.

- Në fabulë thuhet: “pak nga pak, filloi të shtrihej e të zgjerohej duke e shtyrë gjarprin, gjithë edhe më andej”. A mund ta zëvendësoni tërë këtë fjali me një fjalë të vetme? Cila mund të jetë ajo?
- Në rastin e fabulës që ju lexuat nuk është shprehur mesazhi. Gjeni mesazhin ose mesazhet që përcjell ajo?

Pjesa përfundimtare

Diskutim me nxënësit

Në të katërta krijimet flitet për veprime dhe dialog mes personazheve. Diskutim rreth këtyre veprimeve, në secilin prej teksteve.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni në internet të dhëna për figurën e Pandorës.

Lexoni edhe përrallën “E Bukura e Dheut”.

Gjeni edhe ndonjë legjendë tjetër për Skënderbeun dhe diskutoni në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit/et duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Rrëfime popullore			Rezultati i të nxënit të temës: Dallon rrëfimin fantastik nga rrëfimi real.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):				
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):				
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit				
II. VLERAT DHE QËNDRIMET				
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË				
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Rozafati				
Fjalët kyçe: kështjella, e lashtë, Rozafati, Buna, ilire, plaku i urtë, labeatët, adrianët, Trieshte, Valdanuzi				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:				
Nxënësi/ja:				
- njuh dhe identifikon dialogët në legjendë; - dallon veprimet dhe rëndësinë e unitetit në mes të vëllezërve; - kupton veprimin fisnik të nuses së vogël.				
Kriteret e suksesit:				
- shpjegon bisedën mes tre vëllezërve dhe plakut të urtë; - komenton besën e dhënë nga vëllai i vogël; - analizon tekstin dhe kupton pse sakrifikohet nusja e vogël.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela, libri “Tregime të moçme shqiptare”, shkruar nga Kuteli.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.				
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Teknika e pyetjeve – 10 minuta, DLTA – 25 minuta, teknika e pyetjeve – 3-2-1.				
Pjesa hyrëse				
Mësimdhënësi/ja u drejton nxënësve pyetje në lidhje me tematikën që do të trajtohet në tekstin që kanë për lexim dhe pyetjet mund të jenë si më poshtë:				

1. A janë shqiptarët autoktonë në trojet e veta?
2. Keni dëgjuar për flijimin, që në kohët e hershme ishte një traditë shumë e njohur?
3. Besa është një ndër tiparet që populli ynë e ka pasur të shenjtë. Si mendoni, po në ditët e sotme, a ka të njëjtën rëndësi besa, apo vlera e saj është zbehur?

Ndërtimi i njohurive të reja:

Pjesa kryesore – DLTA – 25 minuta

Teksti ndahet në paragrafë dhe lexohet pjesë-pjesë. Pas çdo pjese parashtrihen pyetjet që mund të kenë nxënësit ose që do të drejtojnë mësimdhënësi/ja, dhe jepen përgjigjet përkatëse.

Paragrafi 1:

1. Kur është ndërtuar kështjella e Rozafatit?
2. Çfarë ka ndodhur gjatë shekujve me muret e kështjellës?

Paragrafi 2:

1. Sipas gojdhënës, kush merrej me ndërtimin e kështjellës?
2. Çfarë këshille u jep plaku i urtë vëllezërve, që muri të mos shembej?

Paragrafi 3:

1. Përse nuk e çojnë ushqimin dy nuset e mëdha?
2. Çfarë porositë lë nusja e vogël para se ta muroshtin?

Paragrafi 4:

1. Ku janë në kështjellë gjurmët e murosjes?
2. Gjeni në tekst fjalitë që tregojnë se shqiptarët janë autoktonë.

Paragrafi 5:

1. Në tekst thuhet: "... gurtë janë edhe sot të lagur e të myshkët". Çfarë tregon kjo për dashurinë e nënës?
2. Plaku i urtë është një figurë që e gjejmë shpesh në përralla e legjenda. A është vetëm simbol i përvojës jetësore apo diç më shumë?

Pjesa përfundimtare: (3-2-1)

Në fazën e fundit, mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të reflektojnë rreth temës së trajtuar duke treguar:

- 3 – tri gjëra të rëndësishme që duhen mbajtur mend;
- 2 – dy veti që lidhin flijimin dhe sakrificën individuale me të mirën kolektive;
- 1 – një gjë interesante që mësuat sot.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Diskutoni me prindërit rreth traditës së murimit, e cila praktikohet kur ndërtohet një shtëpi e re. Çfarë vendoset në themele dhe përse? Shkruani një tekst të shkurtër rreth këtyre ritualeve. Gjeni legjenda ose gojdhëna nga folklori, të cilat trajtojnë motivin e besës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Rrëfime popullore			Rezultati i të nxënit të temës: Njeh dhe dallon rëndësinë e fjalës së thënë dhe rëndësinë e veprimeve në kohën e duhur.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Fjalë e grosh				
Fjalët kyçe: grosh, plakut i urtë, votër, rrogëtar, konak, log, Robi i Zotit.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja: • kupton rëndësinë e marrjes së vendimit në kohën e duhur; • dallon tiparet e plakut të urtë; • komenton momentin kur djali kthehet nga kurbeti në shtëpi. Kriteret e suksesit: • komenton veprimin e djalit kur merr vendimin për të vepruar; • shpjegon fjalët e plakut të urtë; • analizon bashkëbisedimin mes nënës dhe djalit.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shënjes), tabela.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi, TIK.				
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:				
Nxënësit janë vënë në dijeni një orë më përpara për këtë temë, me qëllim që të kenë mundësi të bëhen pjesë aktive me materiale të ndryshme. Të gjithë nxënësit kanë përpara tekstin.				

Pjesa hyrëse – Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë fjalën “Përralla” dhe nxënësit japin idetë e tyre lidhur me temën. **Përralla:**

- Tregim fantastik
- Tekst ku e pamundura bëhet e mundur.
- I pranishëm numri tre.
- Mbizotëron e mrekullueshmja.

Ndërtimi i njohurive të reja

Pjesa kryesore – Lexim me ndalesa, punë në grupe, pyetje-përgjigje

Nxënësit lexojnë tekstin nga ... *Njeni s’kishte te shpia...* deri te ... *Bujti atë natë te ai konak...* dhe iu përgjigjen pyetjeve të ushtrimeve 4 dhe 5, të dhëna në tekst. Në vazhdim, mësimdhënësi/ja cakton për lexim pjesën e dytë prej ... *Bujti atë natë te ai konak...* deri te ... *Aty gjen plakën...* dhe nxënësit iu përgjigjen pyetjeve të ushtrimit 1 dhe 7. Pastaj nxënësit lexojnë edhe fragmentin përfundimtar që fillon nga ... *Aty gjen plakën...* deri në përfundim. Iu përgjigjen pyetjeve të ushtrimeve 2 dhe 3, të dhëna në tekst.

Pjesa përfundimtare – Punë e pavarur

Formulo me një fjali mesazhin që përcjell pjesa e leximit. Shpjego mënyrën e rrëfimit të ngjarjes.

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësimi i nxënësve me gojë. Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish.

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni dhe sillni në klasë përralla të tjera, të cilat i vlerësoni për mesazhet e rëndësishme që përcjellin.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Rrëfime popullore		Rezultati i të nxënësve të temës: Rrit nivelin e komunikimit me diskursset orale, letrare dhe joletrare.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Koment – Epi i Gilgameshit
Fjalët kyçe: letërsi indoevropiane, letërsi fantastike, epos, Epi i Gilgameshit, i pavdekshëm, hero – mbret, shkrim kuneiform, pllaka argjile, Enkiduji, Humbaba
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore: Nxënësi/ja: - dallon diskursin fantastik; temën e pavdekësisë, hyjnore, njerëzore e shtazore të Gilgameshi; - fiton aftësi për të kuptuar fragmentin e dhënë; - përdor njohuritë gjuhësore për të vlerësuar gjuhën e tekstit letrar. Kriteret e suksesit: - lexon dhe komenton këngën e Gilgameshit të dhënë në tekst; - shkruan në fletore vetitë mbinjerëzore të Enkidujit; - analizon fragmentin ku flitet për luftën kundër Humbabës.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela, foto të ndryshme, laptop dhe projektor.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi, TIK.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:
Metodologjia dhe veprimtari të nxënësve: Pema e mendimeve - metoda e bashkëbisedimit, një pyetje - shumë përgjigje, harta e koncepteve, lexim i drejtuar, puna në grupe, Kllaster. Pjesa hyrëse Në fillim të orës së mësimin, nëpërmes metodës së bashkëbisedimit, ndërtojmë disa prej vlerave që mbart “Epi i Gilgameshit”, si pjesa themel e letërsisë indoevropiane. Në vazhdim, mes leximit shprehës njihemi me pjesën e dhënë në tekst, të shkëputur nga “Epi i Gilgameshit”. Pjesa kryesore Për të realizuar këtë etapë të orës së mësimin, klasën e ndajmë në tri grupe pune, duke iu caktuar nxënësve detyra të diferencuara për të punuar me fragmentin e dhënë. Më pas, grupet nisin nga puna.

Grupi i parë – Detyrat

- Gjeni në tekst vargjet ku tregohet miqësia dhe përkujdesja e madhe që ka Gilgameshi ndaj Enkidujit. Për ç'anë të karakterit të tij flasin këto veprime?
- Analizoni fjalët e hyjneshës Irninë. "Kthehuni prapa! Veprën tuaj e kryet, n'Uruk t'filloni, se ju pret qyteti!" A mendoni se ajo ishte dakord me veprimin e Gilgameshit?

Grupi i dytë – Detyrat

- Në këtë epos shkrihen dhe bashkëjetojnë tri botë. Bashkoni me shigjetë cilës botë i përket secili prej personazheve (mund të kenë më shumë se një shigjetë ndërlidhëse).

Gilgameshi**Enkiduji****njerëzit****Humbaba****hyjnitë****Shamashi****kafshët****Irnina**

- Analizoni mënyrën se si u drejtohen heronjtë tanë perëndive. Cilat janë arsyet që i shtyjnë heronjtë tanë të komunikojnë me hyjnitë?

Grupi i tretë – Detyrat

- Në epose, ëndrrat janë një element i përdorur shpesh, me funksion paralajmërues. Gjeni dy ëndrrat dhe analizojini ato duke shpjeguar edhe funksionin e tyre.
- Irnina i ndalon Gilgameshin dhe Enkidujin të shkojnë në majë të malit. Cila është arsyeja?

Pjesa përfundimtare

Për të realizuar këtë etapë të orës së mësimin, ftojme nxënësit të bëhen pjesë e diskutimit të drejtuar mbi çështjen e mëposhtme:

- Në ç'raport qëndron rrëfimi i personazhit kryesor me rrëfimin e vetë autorit?

Mes punës së pavarur dhe diagramit të Venit, nxënësit realizojnë punët e tyre dhe më pas orientohen në diskutim.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Duke u nisur nga karakteristikat e Gilgameshit, trimëria dhe guximi, gjeni figura të ngjashme në eposet që njihni.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Fabula			Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon diskursin e fabulës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):				
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):				
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit				
II. VLERAT DHE QËNDRIMET				
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË				
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Cjapi dhe dhelpra				
Fjalët kyçe: fabula, cjapi, dhelpra, i mençuri, i pasuri, i varfëri.				
Rezultatet e të nxënit për orën mësimore				
Nxënësi/ja:				
- njih diskursin e fabulës; - fiton aftësi për të kuptuar dhe zbërthyer rëndësinë e së vërtetës; - dallon diversitetin shoqëror.				
Kriteret e suksesit				
- dallon dinakërinë e dhelprës; - komenton dhe përshkruan fjalët e personazhit të pasur dhe të varfër; - analizon dallimet e individit në shoqëri.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:				
Pjesa hyrëse – Metoda e bashkëbisedimit, pyetje – përgjigje.				
Në fillim të orës mësimdhënësi/ja përmes metodës së bashkëbisedimit inkurajon nxënësit që të tregojnë dhe interpretojnë si e kuptojnë ata termin fabul. Në vazhdim nxënësit njihen me tekstin e fabulës “Cjapi dhe dhelpra” dhe “E vërteta”.				
Pjesa kryesore – Puna me grupe				
Nëpërmjet punës me grupe ekspertësh, mësimdhënësi/ja ndan klasën në tri grupe duke iu caktuar detyrat e veçanta secilit grup.				
Grupi i parë				
Nxënësit lexojnë fabulën “Cjapi dhe dhelpra” dhe punojnë ushtrimin Kuptojmë tekstin -1 dhe 2.				

Grupi i dytë

Nxënësit lexojnë fabulën “Cjapi dhe dhelpira” dhe “E vërteta” dhe shkruajnë në fletore përgjigjet e pyetjeve të rubrikës Analizojmë tekstin – 3 dhe 4.

Grupi i tretë

Pasi nxënësit kanë lexuar tekstin iu përgjigjen pyetjeve të rubrika Reflektojmë rreth tekstit -9,10.

Pjesa përfundimtare – Diskutim i drejtuar

Për realizimin e kësaj etape të orës mësimore ftojmë nxënësit të bëhen pjesë e diskutimit të drejtuar mbi çështjen e mëposhtme;

- **A keni qenë ndonjëherë të përdorur? Si do të ndiheshit po të ishit?**

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quket e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni edhe fabula të tjera, ku personazhet nuk janë kafshë dhe diskutoni për mesazhin e tyre. Tregoni dhe ju një rast, kur nuk keni treguar diçka të vërtetë dhe nuk ju kanë besuar. Pse mendoni se nuk ju besuan?

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit/et duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Anekdota		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist;	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Mençuria popullore			
Fjalët kyçe: anekdota, shqiponja, dhelpira, mal, shtazët e egra, nepërka, bretkosa.			

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore

Nxënësi/ja:

- dallon diskursin që përdoret në anekdota;
- analizon strukturën e anekdotës;
- identifikon karakteristikat e anekdotës.

Kriteret e suksesit:

- flet për dialogun mes babës dhe të birit;
- shpjegon rëndësinë e fjalëve pozitive të plakut të urtë;
- analizon dialogun mes nepërkës dhe bretkosave.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela, foto të ndryshme, laptop, projektorë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:


Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:

Pjesa hyrëse: Stuhi mendimesh

Në këtë fazë, Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Mençuria popullore” dhe udhëzon nxënësit të tregojnë njohuritë e tyre për krijimet e vjetra popullore. Nxënësit tregojnë njohuritë e tyre dhe Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë mendimet e tyre. Pastaj shpjegon pjesën para mësimin, për krijimet e vjetra popullore dhe për pjesët që do të mësojnë.

Pjesa kryesore: Ndërtimi i njohurive të reja - Diamanti 4

Në këtë fazë, Mësimdhënësi/ja shpjegon njësinë mësimore dhe udhëzon nxënësit të lexojnë dhe të mbushin kolonat me kuptimin e secilës pjesë që lexojnë. Udhëzohen të ndalen edhe te mesazhet që përcjellin anekdotat.



Pas përfundimit të detyrës, në secilin grup prezantojnë punimet e tyre me një nxënës përfaqësues.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje-Diagrami i Venit

Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre detyrat e ndara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: Kuptojmë tekstin – detyrat: 1, 2, 3.

Grupi i dytë: Analizojmë tekstin – detyrat: 5.

Grupi i tretë: Interpretojmë tekstin – detyrat: 6, 7, 8.

Grupi i katërt: Gjuha e tekstit – detyrat: 9.

Mësimdhënësi/ja ndihmon nxënësit nëse është e nevojshme. Pastaj të gjithë reflektojmë rreth tekstit detyrat 10, 11.



Pjesa përfundimtare: Pas reflektimit, nxënësit udhëzohen për Diagramin e Venit.

Unë kujtova se po thue;
A e pe shqiponjën?

Pse s'pom vetni
Për rrafsh?

Nëse se kanë kimen
E njëjtë mos u frikësoni

Nepërka dhe bretkosat



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Tregoni ndonjë rast nga jeta juaj kur dikush tjetër ju ka nxitur të bëheni pjesë e një grindjeje, por në fund nuk ju ka ndihmuar.

Në dy prej anekdotave të mësipërme, mençuria e “pleqve” vlerësohet shumë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit/et duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshtkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Të lirohet jo të pushkatohet! <i>Kjo fjali mund të sjellë dykuptimshmëri në rast se do të vendoset presja gabim.</i> Të lirohet, jo të pushkatohet! Të lirohet jo, të pushkatohet! Diskutojmë së bashku. Zbaton njohuritë e fituara në drejtshkrim dhe drejtshqiptim.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIMET – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit			
Fjalët kyçe: shenja pikësimi, brenda fjalisë, në fund të fjalisë, pikë, presje, dypikëshi, pikëçuditja, pikëpyetja etj.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon shenjat e pikësimit që përdoren brenda fjalisë; - dallon shenjat e pikësimit që përdoren në fund të fjalisë; - ndërton një tekst duke përdorur shenjat e pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”, webfaqe, fjalor, foto të dokumenteve, shkumësa me ngjyra.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
- Zhvillon drejtshkrimin.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Stuhi mendimi, INSERT, Shkrim i lirë*


Hapi I. Situata e të nxënit

Organizo mendimet! Organizimi i orës së mësimt: Stuhi mendimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:

Çfarë shenjash pikësimi njihni ju?

Organizo mendimet!



Diskutohet së bashku me nxënësit funksioni i shenjave të pikësimit.

Ndërtimi i njohurive të reja: *INSERT*

Udhëzohen nxënësit të plotësojnë në fletoren e klasës, tabelën INSERT.

<i>V (informacioni që dihet)</i>	<i>+ (informacioni që shtohet)</i>	<i>— (informacioni që dihet gabim)</i>	<i>? (informacioni që ka nevojë për sqarim nga mësuesi)</i>

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Puno në dyshe*

Nxënësit të ndarë në dyshe, do të punojnë ushtrimet e dhëna në tekst.

Ushtrimi 1 Vendosni thonjëzat në fjalitë e mëposhtme.

Agimi tha: “Kjo ngjarje nuk do të përsëritet më në të ardhmen”.

Ndeshja më interesante e këtij sezoni, do të zhvillohet në stadiumin “Qemal Stafa”.

Gazeta “Ekonomia” nuk është për publikun e gjerë, por për një publik të specializuar.

Ne jemi nxënës të klasës së nëntë, në shkollën “Fan Noli”.

Ushtrimi 2 Vendosni dy pikat atje ku duhen.

Skënderbeu u përgjigj: “Lëreni të shkojë...”.

Unë vazhdoj t’i qëndroj mendimit: “Për të pasur një implementim të suksesshëm, ne duhet të kemi edhe një ofertë ekonomike intriguese”.

Ai tha: “Ky libër më pëlqen shumë”.

Kjo substancë gjendet në shumë produkte ushqimore, si: qumësht, mish, misër, arra, etj.

Fshatari pyeti: “Kur niset treni?”

Ushtrimi 3 Vendosni shenjat e pikësimit në dialogun e mëposhtëm.

- Ç’duan që vijnë në dasmat tona? - pyeti njëri nga djemtë e rinj.
- Shët, se është turp!
- Çfarë turpi? - pyeti një tjetër. - Guxojnë edhe të ngrihen në valle!
- Nuk mund t’i dëbonim. Kështu është zakoni i të parëve
- Ç’zakon?! Po për Nicën e shkretë, ç’thotë zakoni i të parëve?
- Shët, se mos dëgjojnë...
- Mos ki frikë, - u hodh një tjetër. - Edhe sikur të dinin shqip, nuk do të kuptonin asgjë nga brenga e saj.

Ushtrimi 4 Vendosni në tabelën e mëposhtme shenjat e pikësimit që përdorët në ushtrimin 2.

Shenja pikësimi që përdoren brenda fjalisë	Shenja pikësimi që përdoren në fund të fjalisë
Dy pikat,	Pika,
Thonjëzat	Pikëpyetja, Pikëçuditja
	Trepikëshi

Ushtrimi 5 Vendosni shenjat e pikësimit në tekstin e mëposhtëm.

Njerëzit që dilnin nga shfaqja kaluan nga trotuari duke kënduar me zë të ulët ose sa u hante fyti
 O engjëll i bukur, Luçia ime
 Atëherë Leoni, për t’u treguar si njohës arti, zuri të fliste për muzikën
 Ai kishte parë Tamburinën Rubinin Persianin Grisin pra në krahasim me ta Lagardi, me
 gjithë zërin buçitës që kishte s’ ishte gjë fare
 Sidoqoftë ia preu fjalën Sharli, që e kafshonte çikë e nga një çikë akulloren e tij thonë
 që në aktin e fundit është me të vërtetë i mahnitshëm
 Më vjen keq që ika para mbarimit se mua filloi të më pëlqente shfaqja
 S’ka gjë e mori fjalën sekretari së shpejti ka për të dhënë një shfaqje tjetër
 Mirëpo Sharli iu përgjigj se do të iknin që të nesërmen

Ushtrimi 6 Gjeni ku janë përdorur gabim shenjat e pikësimit. Shkruajini si duhet ato.

Harabeli nuk është shpend migrues.

Studentët kanë një skuadër me emrin e vet, Studenti.

Skënderbeu tha: “Mos i besoni armikut! Besoni vetëm te shpata dhe mendja juaj!”

Gazeta “Flamuri i Arbrit” është botuar nga De Rada.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për dallimin e shenjave të pikësimit brenda dhe në fund të fjalisë etj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 7 Shkrim i shpejtë

Shkruani një tekst të shkurtër, në të cilin të përdorni shenjat e pikësimit që përdoren brenda fjalisë, si dhe shenjat e pikësimit që përdoren në fund të saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshtkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: - Përdorimi i drejtë i gjuhës – Drejtshkrim. - Dallon dhe përdor drejt në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore, sipas ligjërimeve dhe stileve funksionale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në media. II. VLERAT DHE QËNDRIMET - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Përdorimi i drejtë i ligjëratës së drejtë			
Fjalët kyçe: dialog, ligjëratë e drejtë, pjesa lajmuese, pjesa përmendëse, shenja pikësimi.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon në dialog (replikë) ligjëratën e drejtë; - dallon pjesën lajmuese dhe pjesën përmendëse në ligjëratën e drejtë; - përdor drejt shenjat e pikësimit në ligjëratën e drejtë, kur pjesa lajmuese ndodhet në fillim, në mes dhe në fund; - krijon fjali me ligjëratë të drejtë; - kthen dialogun në ligjëratë të drejtë dhe argumenton përdorimin e shenjave të pikësimit.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, fisha me ushtrime, fletore, shkumës me ngjyra.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Zhvillon komunikimin. - Shoqëria dhe mjedisi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: <i>Punë në dyshe, Diskutim, Punë e pavarur, Punë në grupe, Shkrim i lirë</i>
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>punë në dyshe</i> Orientohen nxënësit të lexojnë në dyshe dialogun e paraqitur në tekst në faqen 196. Nxënësit do të nënvizojnë fjalët që thonë personazhet, do të dallojnë llojet e fjalive dhe do të qarkojnë shenjat e pikësimit. Dëgjohen mendimet e nxënësve, duke i paraqitur ato të përmbledhura në tabelë. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>diskutim</i> Dy nga fjalitë e dialogut rishkruhen në tabelë, por si ligjëratë të drejtë, duke përdorur shenjat e duhura të pikësimit. (<i>Sqarohen nxënësit që çdo replikë e dialogut është një ligjëratë e drejtë.</i>) <i>Me sy të picërruar Ylli më tha: “Mirë e ke bërë. Gjithçka që të shikon syri këtu në plazh, ti e ke hedhur bukur në letër. Vetëm njerëz nuk paske fare te vizatimi yt! Pa njerëzit, deti dhe rëra duken të shkretë. Hë, keq e kam?! Ç’thua?”</i> <i>“Për këtë, - iu përgjigja unë, - po e vrisja mendjen e s’po e gjeja dot”</i> <i>Nxënësit diskutojnë në lidhje me fjalitë.</i> Jepet përkufizimi për ligjëratën e drejtë dhe dy pjesët e saj: pjesa lajmuese dhe pjesa përmendëse. Shenjat e pikësimit që përdoren në të tria rastet, kur pjesa lajmuese ndodhet në: fillim, mes dhe në fund. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Do të punohen nga nxënësit ushtrimet e faqes 197. Ushtrimi 1 (<i>punë e pavarur</i>) Nxënësit do të nënvizojnë në tekst shenjat e pikësimit, do të shpjegojnë përdorimin e tyre dhe do të dallojnë pjesën lajmuese. <i>Kur ishin duke u shpërndarë, xha Trifoni tha: “Ne babagjyshërve na është bërë zakon, para se të flemë, t’u tregojmë nipërve ndonjë përrallë”.</i> <i>“Skënderbeu ka goditur dhe ka shkatërruar karvanët e venedikasve, që po na sillnin furnizimet”, - tha kryeveqilharxhi</i> <i>“Populli shqiptar, - deklaroi Ismail Qemali, - na zgjodhi dhe na dërgoi ne në këtë mbledhje, që të këshillohemi për shpëtimin e atdheut”.</i> <i>“Miq të mi, - u përgjigj Isa Boletini, edhe ai më këmbë e me burrn, - unë nuk ndahem nga populli”.</i> <i>“Ishim të rrethuar, - tha ai, - Na duhej të çanim pa bërë zhurmë”.</i> <i>“Bredhi i bardhë nuk rritet në pyllin tonë, - tha përgjegjësi, - rritet në vendet e larta malore”.</i> Ushtrimi 2 (<i>punë në grupe</i>) Klasa ndahet në tri grupe. Secili grup rishkruan nga dy fjali të ushtrimit 1, duke vendosur pjesën lajmuese në dy pozicione të tjera. Tre nxënës punojnë në tabelë. <i>“Ne babagjyshërve na është bërë zakon, para se të flemë, t’u tregojmë nipërve ndonjë përrallë”, - tha xha Trifoni kur u shpërndamë,</i> <i>“Ne, - tha xha Trifoni, kur u shpërndamë, - na është bërë zakon t’u tregojmë nipërve ndonjë përrallë”.</i> <i>Kryeveqilharxhi tha: “Skënderbeu ka goditur dhe ka shkatërruar karvanët e venedikasve, që po na sillnin furnizimet”.</i>

“Skënderbeu,- tha kryeveqilharxhi, - ka goditur dhe ka shkatërruar karvanët e venedikasve, që po na sillnin furnizimet”.

Ismail Qemali deklaroi: “Populli shqiptar na zgjodhi dhe na dërgoi në këtë mbledhje që të këshillohemi për shpëtimin e atdheut”.

“Populli shqiptar, - deklaroi Ismail Qemali, - na zgjodhi dhe na dërgoi në këtë mbledhje, që të këshillohemi për shpëtimin e atdheut”.

Isa Boletini në këmbë dhe me burrnin u përgjigj: “Miq të mi, unë nuk ndahem nga populli”.

“Miq të mi, unë nuk ndahem nga populli”, - u përgjigj në këmbë dhe me burrnin Isa Boletini.

Ai tha: “Ishim të rrethuar. Na duhej të çanim pa bërë zhurmë”.

“Ishim të rrethuar, - tha ai. – Na duhej të çanim pa bërë zhurmë”.

Ushtimi 3 (*shkrim i lirë*).

Paraqiten në tabelë disa nga fjalitë e krijuara nga nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi: do të bazohet në pjesëmarrjen e nxënësve gjatë orës, veprimet në situatë, saktësinë në dallimin e dialogut, ligjëratës së drejtë, shenjat e pikësimit në të dhe pjesët përbërëse, kthimin e dialogut në ligjëratë të drejtë dhe qortimin që u bëjnë gabimeve të shokëve. Komunikohen vlerësimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtimi 4, faqe 197 (sipas kërkesës).

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm...

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përdor drejtë gjuhën - drejtshkrimin; - dallon dhe përdor drejt në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore në përshtatje me ligjërimet dhe stilet funksionale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT - Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, autobiografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.			

Zhvillon shkrimin kreativ për vetën dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për vetën, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Përdorimi i drejtë i ligjëratës së zhdrejtë
Fjalët kyçe: ligjëratë e drejtë, ligjëratë e zhdrejtë, ndryshime, shenja pikësimi.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon ndryshimet që pëson ligjëratat e drejtë kur kalon në ligjëratë të zhdrejtë; - liston të gjitha llojet e ndryshimeve; - përdor drejt shenjat e pikësimit gjatë kalimit të ligjëratës së drejtë në ligjëratë të zhdrejtë dhe anasjelltas; - përshkruan një situatë nga jeta e përditshme duke përdorur: ligjëratë të drejtë, të zhdrejtë dhe dialog.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, fisha me ushtrime, fletore, shkumës me ngjyra.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Zhvillon komunikimin. Shoqëria dhe mjedisi.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:
<i>Diskutim; Punë në dyshe; Punë e pavarur; Punë në grupe; Shkrim i lirë</i>
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Diskutim Paraqitet në tabelë një ligjëratë e drejtë dhe një ligjëratë e zhdrejtë. “Kadareja është shkrimtari im i preferuar”, - tha ajo. Ajo tha se Kadareja ishte shkrimtari i saj i preferuar. Nxënësit do të nënvizojnë ndryshimet që pëson ligjëratat e drejtë kur kalon në ligjëratë të zhdrejtë. Listohen në tabelë këto ndryshime. <i>Rikujtohet se ç’është ligjëratat e zhdrejtë.</i>
Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në dyshe Udhëzohen nxënësit që të lexojnë në dyshe shembujt e paraqitur në tekst, në faqet 198-199. Nxënësit mbajnë shënime në lidhje me ndryshimet që pëson ligjëratat e drejtë kur kalon në ligjëratë të zhdrejtë. Mendimet e nxënësve, përmes punës në dyshe, paraqiten në tabelë.

Listohen ndryshimet:

- Nuk përdoret dypikëshi dhe thonjëzat, por shtohen lidhëzat.
- Foljet dhe përemrat vetorë e pronorë, nga veta e dytë, kthehen në vetën e tretë.
- Ndryshon koha e foljeve.
- Ndryshojnë përemrat dhe ndajfoljet.
- Fjalitë pyetëse, nxitëse dhe dëshirore shoqërohen nga foljet: pyes, urdhëroj, uroj.
- Në fjalitë pyetëse, nuk përdoret pikëpyetja (pyetja e zhdrejtë)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur (në grupe), Shkrim i lirë. Ndahet klasa në tri grupe.

Grupi 1: Ushtrimi 1

Nxënësit kthejnë ligjëratën e drejtë në të zhdrejtë. Shpjegohen ndryshimet në çdo rast.

Abdyl Frashëri ka thënë se duhet të bashkohemi në një besë të gjithë shqiptarët.

Skënderbeu tha që të lajmëronin fitoren dhe të ndiznin zjarret që t'i bëhej dritë popullit.

Populli ka thënë: “Më mirë një vezë sot, se një pulë mot”.

Edlira pyeti se ku do të shkonin.

Nisur nga detyra e hapit të dytë, nxënësit dallojnë ndryshimet që ka pësuar fjalia.

Grupi 2

Katër fjalitë e para të ushtrimit 2. Ligjëratat e zhdrejtë kthehet në ligjëratë të drejtë.

Artani, më në fund më premtoi: “Do të të gjej edhe ty një libër si timin”.

Vajza iu afrua kalimtarit të rastit dhe pyeti: “Nga duhet të kaloj për të mbërritur te stacioni i autobusëve?”

Unë i thashë: “Dua të njoh nxënësit dhe punët e tyre”.

Ejona tha: “Ky libër më pëlqen shumë”.

Grupi 3. Fjalitë 5-8 të ushtrimit 2.

Besmira tha: “Edhe sikur një mijë pengesa të më dalin përpara, unë do t'i kapërcej me guxim”.

Mësuesi u kërkoi nxënësve: “Nxirrni përqindjen e normës së interesit, bazuar në të dhënat e ushtrimit”.

Përfaqësuesi i agjencisë së udhëtimit tha: “Mos lëvizni nga vendi, derisa të mbërrijnë ekskursionistët e tjerë!”

Babai i rikujtoi djalit: “Që kur je kthyer nga emigracioni, ke ndryshuar shumë”.

Tre nxënës do të punojnë në tabelë. Dëgjohen dhe vlerësohen përgjigjet e nxënësve, duke mbledhur 2-3 fletore nga çdo grup.

Ushtrimi 3 (shkrim i lirë)

Në varësi të kohës, detyra mund të vazhdohet në shtëpi.

Vlerësimi i nxënësve:

Do të të bazohet nisur nga pjesëmarrja gjatë orës së mësimit, saktësia në dhënien e përgjigjeve, qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes gjatë orës së mësimit.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Përshkruani një situatë të jetës së përditshme duke përdorur ligjëratat të drejta, ligjëratat të zhdrejta dhe një dialog me 4-5 replika.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm...

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: - Përdorimi i drejtë i gjuhës – Drejtshkrim - Dallon tingujt dhe ndryshimet fonetike të tingujve (p.sh.: rotacizmi, metateza, asimilimi, apofonia, afereza, sinkopa, apokopa etj.)	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët.			
Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në media.			
II. VLERAT DHE QËNDRIMET - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin.			
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: -Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues.			
IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve ku takohen dyzanore			
Fjalët kyçe: zanore, ie, je, oo, zanore të njëjta, rregulla, përdorim i drejtë i gjuhës.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: • shkruan dhe shqipton saktë fjalët në të cilat takohen zanoret: ie, oo, aa; • formon fjalë të prejardhura që kanë në përbërjen e tyre këto zanore; • ndërton fjali me fjalë që kanë në përbërjen e tyre këto zanore.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, libri “Shqipja standarde”, fisha me fjalë, tabelë, shkumës me ngjyra.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
- Shoqëria dhe mjedisi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Minikonkurs, Diskutim, Punë në dyshe, Punë e pavarur*

Organizimi i orës së mësimimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Minikonkurs*

Zhvillohet një minikonkurs me tre nxënës sipas rreshtave. Në secilën tavolinë janë përmbysur fisha me fjalët: diell, e djellë, ndiej, nxierr, alkol, avijon, ndieva, përkthyer, kaisi, aksion, miljon, portier, trajner, medalie, parandjenja, e ndieshme, edukues, i vazhdueshëm, arsyje, ngjyjej, i anshëm, (**secili nxënës/e ka 7 fisha**). Nxënësit do të shkruajnë në tabelë trajtën e saktë të fjalës, duke korrigjuar gabimet.

Fjalët e sakta: diell, e diel, ndiej, nxjerr, alkool, avion, ndjeva, përkthyer, kajsi, aksion, medalje, parandjenja, e ndjeshme, edukues, i vazhdueshëm, arsye, ngjyjej, i anshëm.

Fiton nxënësi/ja që punon më shpejt dhe saktë.

Ndërtimi i njohurive të reja: *diskutim, punë në grupe dyshe.*

Në fjalët e paraqitura në tabelë, nxënësit do të nënvizojnë grupet e zanoreve.

Hapet teksti në faqen 200 dhe nxënësit shqyrtojnë rastet e drejtshkrimit të fjalëve me grupet e zanoreve. Fillimisht punohet në dyshe dhe më pas, nxënës të ndryshëm paraqesin në tabelë grupe fjalësh dhe rregullin përkatës për çdo rast. Përdoren shkumësa me ngjyra të ndryshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Ushtrimi 1. Nxënësit do të vendosin në vend të pikave, shkronjën që mungon.

Eksper...encë, jo...bjektiv, var...ant, kalc...um, eku...valent, z...oteknik, arter...e, port...er, amb...ent, jo...rganik, përz...er, koalici...on, eku...libër, aks...omë, i pa...rmatosur, ak...arium.

Për fjalët: eksperiencë, ekuivalent, ambient, jepet gjegjësjë në gjuhën shqipe (përvojë, i/e njëjtë, mjedis).

Ushtrimi 2. Nxënësit do të dallojnë fjalët nga të cilat janë formuar fjalët e prejardhura.

arsye, thyej, muaj, hua, pyes, qiell, diell, mëso, harro, shkrue (geg), moho, arsye

Kërkesë shtesë: Të formohen fjalë të tjera të prejardhura, nga tri për çdo fjalë.

Arsye-i arsyetoj, i arsyetueshëm, i paarsyetueshëm

Thyej-thyesë, i thyeshëm, thyeshmëri

Muaj-mujor, hua-huazoj, i huazuar, i pahuazuar

Pyes-i pyetur, i papyetur, pyetësor

Qiell-qiellësi, joqiellor

Diell-diellishtë, diellzim, diellzohet

Mëso-mëso, mësuar, i mësuar, i pamësuar

Harro-harrim, harresë, mosharrim

Shkrue-shkruaj, shkrim, shkrimtar, i shkruar, i pashkruar

Moho-mohim, mohues, i mohuar, i pamohuar

Arsye-arsyetoj, i arsyetuar, i paarsyetuar, i arsyetueshëm

Ushtrimi 3. Nxënësit formojnë mbiemra të prejardhur nga foljet dhe formojnë fjali me to.

Shkruaj-i shkruar, dëgjoj-i dëgjuar, pëlqej-i pëlqyer, bluaj-i bluar, përpunoj-i përpunuar, ndiej-i ndier

Dëgjohen dhe vlerësohen përgjigjet e nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përgjigjet që kanë dhënë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Gjeni në fragmentin intervistë me gjuhëtarin Et'hem Lika, fjalë që kanë grupet e zanoreve të mësuara.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshtkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: - Përdorimi i drejtë i gjuhës – Drejtshtkrim. - Dallon tingujt dhe ndryshimet fonetike të tingujve (p.sh.: rotacizmi, metateza, asimilimi, apofonia, afereza, sinkopa, apokopa etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshtkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në media. II. VLERAT DHE QËNDRIMET - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për vetën, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: -Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Drejtshtkrimi i fjalëve që kanë grupet ye, ua, ue			
Fjalët kyçe: grupe zanoresh, ye, ua, ue, raste përdorimi, drejtshtkrim, drejtshtqiptim...			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • shqipton dhe shkruan saktë fjalët që kanë grupet e zanoreve ye, ua, ue; • përdor drejt këto zanore në fjalët e prejardhura; • i përdor saktë këto fjalë në përshkrime të ndryshme.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, libri “Gjuha standarde”, fletore, shkumës me ngjyra.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Shoqëria dhe mjedisi.

- Artet.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS

GJATË ORËS MËSIMORE: *Stuhi mendimi, Punë e pavarur, Shpjegim, Punë në dyshe, Shkrim i lirë.*

Organizimi i orës së mësimimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Stuhi mendimi.*

Shkruhet në tabelë tema e re mësimore dhe nxiten nxënësit që të shkruajnë sa më shumë fjalë me këto grupe zanoresh.

Paraqiten në tabelë disa fjalë.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e pavarur*

Nxënësit udhëzohen që të hapin tekstin në faqen 21. Lexohet në heshtje informacioni i dhënë.

Shkruhen në tabelë grupet: **ye, ua, ue** dhe tre nxënës do të shkruajnë në tabelë fjalë me këto zanore.

Nxënësit e tjerë do të formulojnë rregullin përkatës. Përfshihen sa më shumë nxënës në këtë veprimtari.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë në dyshe.* Në grupe dyshe, plotësohen ushtrimet në vijim.

1. Nxënësit do të plotësojnë në libër ushtrimin 1. Do të këmbëjnë librat me njëri-tjetrin. Vlerësojnë punën e realizuar nga shoku/shoqja.

Grupi ye	Grupi ua	Grupi ue
lyej, i lyer, i palyer, thyej, pyes, fyej, i thyer, thyesë, fyell, dyer, skërfyell, përthyer, i mbërthyer, i përlyer, i fyer...	muaj, luaj, duar, hua, ftua, i ftuar, i paafruar, i afruar, i dëgjuar, i mësuar, mbuluar, i ngujuar, bluaj, shkruaj...	dëgjueshëm, i lexueshëm, i pranueshëm, duel, tunel, mësues, i gabueshëm, i pagabueshëm...

2. Një nxënës punon në tabelë, kurse klasa punon në fletore.

thyerja gërryerja mësues lakues

ftua përrua dragua grua

langua ndërrues kërkues pastrues

dyshues fyerja fyell arsyë

Kërkesë shtesë. Formoni fjalë të prejardhura nga fjalët: thyej, dyshues, fyej, arsyë dhe më pas krijoni nga një fjali me to.

Thyej - thyesë, i thyer, i pathyer, thyesi (shkelës kufiri)

dyshues - i dyshuar, i padyshuar, dyshimor (që përmban dyshim), dyshimtar, dyshimtas

fyej - fyese, i fyer, i pafyer

arsyë - arsyetoj, arsyetim, mosarsyetim, i arsyeshëm, i paarsyeshëm, arsyetues, arsyetuar

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi: Nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen dhe motivohen vlerësimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Ushtrimi 3. Përshkruani peizazhin e fotografisë, duke përdorur sa më shumë fjalë, në të cilat takohen dy zanore. <i>*Mund të shfrytëzohen pjesë leximi nga teksti, në të cilat nxënësit do të veçojnë fjalët që kanë këto grupe zanore.</i>
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: - Përdorimi i drejtë i gjuhës. - Dallon dhe përdor drejt në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore, sipas ligjërimeve dhe stileve funksionale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathhtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: -Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: -Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Drejtshkrimi i fjalëve të huazuara nga fjalët e huaja.
Fjalët kyçe: fjalë të huaja, bashkëtingëlloret d/,t/l/,c/,ll, drejtshqiptim, drejtshkrim...
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - shqipton si duhet fjalët e huaja që kanë bashkëtingëlloret: /d/,/t/,/l/,/ll/,/c/; - shkruan saktë fjalët e huaja që kanë këto bashkëtingëllore; - formon fjalë të prejardhura që kanë këto bashkëtingëllore dhe formon fjali me to.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, libri “Shqipja standarde”, shkumës me ngjyra, fletore, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Shoqëria dhe mjedisi. - Artet.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: <i>Bisedë, Diskutim, Punë në dyshe, Punë e pavarur.</i>
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>bisedë</i> Zhvillohet një bisedë të lirë me nxënësit në lidhje me fjalët e huaja që përdoren në gjuhën shqipe. Sqarohen nxënësit që këto fjalë shqiptohen dhe shkruhen sipas disa rregullave të caktuara. Këto fjalë i përkasin kryesisht terminologjisë shkencore. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>diskutim</i> Prezantohet në tabelë titulli i mësimi. Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin në faqen 202. Nxënësit do të lexojnë në heshtje informacionin e dhënë dhe më pas paraqiten fjalët me burim nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja.
Këto fjalë shkruhen me d, t dhe jo me dh, th: dekagram, diplomaci, diplomë, etnografi, aritmetikë, maratonë, termik... Shkruhen me d, t edhe emrat e përveçëm: Afërdita, Demokriti, Leonida, Maratona, Tesalia, Trakia...
Shkruhen me l dhe jo me ll, fjalët nga greqishtja e vjetër: ambulancë, atlas, balonë, diplomaci, kolos, lustër, tablo, etj. Sqarohet që fjala atlas (pëlhurë e mëndafshhtë, me shkëlqim nga njëra anë) shkruhet me ll. (sqarohet që fjala atlas, pëlhurë e mëndafshhtë, me shkëlqim nga njëra anë, shkruhet me ll)
Emrat e përveçëm latinë dhe grekë: Apolonia, Atlantik, Peloponezi, Platoni... (përfshihen fjalët: apostull, bllok, dishepull, konsull, llogari...)
Fjalët nga latinishtja e greqishtja, që kanë bashkëtingëlloren c që ndiqet nga zanorja i, e: certifikatë, ciklamin, deficit, konciz, recension, central, cerebral... (përfshihen: biçikletë, çiklizëm, motoçikletë...)

Fjalët me burim nga latinishtja shkruhen me **I**: golf, kloun, klub...
Përdoren me **II**: basketboll, hendboll, penallti, futboll

Shkruhen me **I** fjalët e burimit sllav: bolshevik, kolkhoz, polak...
Shkruhen me **II** fjalët: bjellorus, sllav, sllovak, Bjellorusi...

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi I: (*Punë në dyshe*). Nxënësit mbyllin librin dhe shkruajnë në fletore nga 10 fjalë të burimit latin e grek.

Nxënësit kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Ushtrimi 2. Nxënësit lexojnë me vëmendje fjalët me burim nga anglishtja dhe gjuhët sllave. Ato fjalë që nxënësit i kanë shqiptuar, apo i kanë shkruar deri tani gabim, do t'i rishkruajnë në fletore.

Hapi II: Ushtrimi 3 (*punë e pavarur*) Një nxënës punon në tabelë.

Nënvizohen fjalët e shkruara gabim dhe shkruhen saktë në fletore.

dialog, diplomë, diplomaci, olimpiadë, pedagogji, antologji, arithmetikë-aritmetikë, pathollog-patolog, patos, Herodoti, Thesalia-Tesalia, Maratona, Hietra, Iliada, dhjak, idhull, dheshpot, Theodor, Kleanth, ballonë-balonë, dialloj-dialloj, llotari-lotari, lluks-luks, tablo-tablo, sandalle-sandale, Apollonia-Apolonia.

Fjala: **despot** - sundimtar me pushtet absolut; **dheshpot** - titull fetar në kishën ortodokse, ndërmjet priftit dhe mitropolitit

Kërkesë shtesë. Me fjalët e qortuara, formoni fjalë të prejardhura dhe krijoni fjali me to. (emrat e përgjithshëm)

Diplomë - i diplomuar, i padiplomuar, dialloj-dialogues, jodiallojes

Aritmetikë - aritmetikore (veprime) luks-luksoz

Patolog-patologji, patologjik

(Jo nga të gjitha fjalët formohen fjalë të prejardhura.)

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi: Nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës mësimore, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen vlerësimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi nr.4, sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: - Përdorimi i drejtë i gjuhës. - Dallon dhe përdor drejt në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore, sipas ligjërimeve dhe stileve funksionale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Drejtshkrimi i nyjës së përparme të emrave (i, e, të, së)			
Fjalët kyçe: nyjë i, e, të, së, rasë gjinore, dhanore, rrjedhore, përdorim i drejtë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - njeh rastet e përdorimit të nyjës i, e, të, së te emrat; - përdor drejt nyjën i, e, të, së te emrat në gjinore, dhanore, a rrjedhore; - argumenton përdorimin e nyjës i, e, të, së te emrat			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, libri “Shqipja standarde”, fletore, shkumës me ngjyra, tabelë, tabakë letre			

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
- Shoqëria dhe mjedisi.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE:** *Punë në dyshe, Shpjegim, Diskutim, Punë e pavarur*

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit/es: *Punë në dyshe, shpjegim*

Prezantohet në tabelë tema e mësimit dhe shkruhen disa fjali që kanë emra të njyshëm. Oborri i shkollës gumëzhin nga zërat e nxënësve.

- *Punimet e portofolit të nxënësve janë të bukura.*
- *Krijimet e një nxënësi të klasës sonë janë të realizuara.*
- *Arritjet e një nxënëseje të shkollës sonë në matematikë janë të shkëlqyera.*
- *Mbjelljet e stinës së pranverës u realizuan në kohë.*
- *Motivet e veshjeve të krahinës së Vlorës, të Mallakastrës, të Tepelenës, kanë ngjashmëri.*
- *Studimi i rrjedhës së poshtme të lumit Vjosa paraqet interes.*
- *Ministria e Arsimit dhe e Kulturës organizoi një veprimtari festive me nxënësit e dalluar.*
- *Rezultatet e provimeve të së motrës i mori vesh të nesërmen.*
- *Dajës së Valbonës i erdhi një letër nga një grup nxënësish të shkollës sonë.*

Përbri tyre vendosen rregullat përkatëse dhe nxënësit, në dyshe sipas bankave, do të shoqërojnë rregullin me rastin përkatës. Vendoset nga një numër bri fjalive.

Ndërtimi i njohurive të reja: *diskutim*

Prezantohen përgjigjet e nxënësve. Diskutohet në lidhje me to dhe shpjegohen rastet, të cilat janë të paqarta për nxënësit, duke sjellë edhe shembuj të tjerë të ngjashëm.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Ushtrimi 1

*Ndiquet e njëjta procedurë e ndjekur gjatë situatës së të nxënësit. Nxënësit do t'u vendosin rregullave të paraqitura në libër nga një numër dhe më pas, këtij numri do t'i përkojë edhe grupi i fjalëve të ushtrimit 1.

Ushtrimi 2 dhe 3. Vendoset nyja e përparme në vend të pikave. Një nxënës do të punojë në tabelë, kurse klasa do ta ndjekë punën në fletore. Pas vendosjes së nyjës, nxënësit do të thonë edhe rregullin përkatës.

recitimi i nxënësës së talentuar

sipas një fjale të urtë të popullit tonë

ushtrimet e lëndës së Matematikës, të Fizikës, të Kimisë, të Informatikës

punimet e një nxënëseje të talentuar

vlerësimi i këngës së bukur të fëmijëve

Ushtrimi 4.

gomat e makinës së re

..i fjalës së rëndë nga ajo e ngrohtë

ardhja e ditëlindjes së të birit

dritaret e një shtëpie të vogël

përpara forcës së të ardhmes

fletorja e në nxënëseje të klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi: Vlerësohet pjesëmarrja gjatë orës, veprimet në situatë, saktësia në dhënien e përgjigjeve, qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**Vendosni nyjat e përparme dhe shpjegoni përdorimin e tyre.**

cilësia e verës... Përmetit, përmirësimi i cilësisë... verës... Përmetit, në rendin e ditës... konferencës, vajzës së tij... dashur, vajtimi i... shkretës dhe... mjerës nënë, historia e luftës... popullit shqiptar, stina e pranverës... këtij viti, fjala e nderit... shqiptarit, kujtimet e... kaluarës, frytet e fitores... ..resë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin e vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshtkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: - Përdorimi i drejtë i gjuhës. - Dallon dhe përdor drejt në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore, sipas ligjërimeve dhe stileve funksionale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshtkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në media. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: -- Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Drejtshkrimi i nyjës së përparme të mbiemrave dhe të përremrave pronorë	
Fjalët kyçe: nyjë e përparme, i, e, të, së, rregulla, përdorim i drejtë...	
Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:	
Nxënësi/ja: - përdor drejt nyjën e përparme te mbiemrat dhe përremrat pronorë; - formulon rregullin përkatës, nisur nga shembulli, - argumenton përdorimin e nyjës së përparme te mbiemrat dhe përremrat pronorë.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, libri “Shqipja standarde”, fletore, shkumës me ngjyra, tabelë, tabakë letre	
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:	
- Shoqëria dhe mjedisi.	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Punë në dyshe, Shpjegim, Diskutim, Punë e pavarur	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Punë në dyshe. Prezantohet në tabelë titulli i mësimi. Shkruhen disa grupe fjalësh që kanë në përbërjen e tyre mbiemra dhe përremra pronorë. Në anën tjetër të tabelës, vendosen rregulla të përdorimit të nyjës te mbiemrat dhe përremrat pronorë. Nxënësit, në dyshe sipas bankave, do të shoqërojnë grupin e fjalëve me rregullin përkatës. Rregullat duhen paraqitur sa më të qartë për nxënësit. Mund të paraqiten në këtë formë:	
oborri i një shkolle <u>të</u> madhe	Rregulli → nyja të , emri para është i gjinisë femërore, trajta e pashquar)
vlerësimi i një detyre më <u>të</u> plotë	Rregulli → nyja të , mbiemri në shkallën krahasore ndodhet pas një emri në numrin njëjës
nxënësi i më <u>së</u> mirës klasë	Rregulli → nyja së , mbiemri ka dalë para emrit
fjalët e <u>së</u> bukurës vajzë	Rregulli → nyja së , emri para është i gjinisë femërore
Shembujt, nxënësve mund t’u jepen të shpërndarë, në mënyrë që ta gjejnë vetë rregullin. Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim, diskutim Diskutohen së bashku me nxënësit rastet dhe shpjegohen paqartësitë që ata mund të kenë. Jepen edhe shembuj të tjerë nga vetë nxënësit, ose mësuesja. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur. Ushtrimi 1, 2 dhe 3. Është e njëjta procedurë e ndjekur gjatë situatës së të nxënës. Nxënësit do t’u vendosin rregullave të paraqitura në libër, nga një numër dhe më pas, këtij numri do t’i përkojë edhe grupi i fjalëve të ushtrimit 1. Ushtrimi 2 dhe 3. Vendoset nyja e përparme në vend të pikave. Një nxënës do të punojë në tabelë, kurse nxënësit e tjerë, do ta ndjekin punën në fletore. Pas vendosjes së nyjës, nxënësit do të thonë edhe rregullin përkatës. Ndërtimi i një shkolle më <u>të</u> bukur se e para.	

Çmimi i parë iu dha nxënëses më të dalluar të shkollës.
 Ndërtimi i më së bukurës shkollë.
 Çmimi i parë iu dha më të dalluarës nxënëse të shkollës.
 Kujtimi i motrës së saj të dashur e të paharruar.
 Ndhimesa e një nxënëseje të dalluar.
 Vlerësimi i më së bukurës këngë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi: Vlerësohet pjesëmarrja gjatë orës, veprimet në situatë, saktësia në dhënien e përgjigjeve, qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 4, sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin e vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përdor drejt gjuhën; - dallon dhe përdor drejt në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore sipas ligjërimeve dhe stileve funksionale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për mjedisin.			

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Drejtshkrimi i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura
Fjalët kyçe: drejtshkrim, pjesëza, parafjalë, trajta foljore\
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - shkruan saktë fjalët e huaja që kanë pjesëzat apo parafjalët; - formon fjalë me pjesëzat apo parafjalët që përdoren para trajtave foljore.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, shkumës me ngjyra, fletore, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe”.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, artet.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: <i>Bisedë, Diskutim, Punë në dyshe, Punë e pavarur.</i>
Organizimi i orës së mësimin Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>bisedë</i> Zhvillohet një bisedë e lirë me nxënësit në lidhje me pjesëzat dhe parafjalët e përsëritura që përdoren në gjuhën shqipe. Sqarohen nxënësit që këto fjalë shqiptohen dhe shkruhen sipas disa rregullave të caktuara. Këto fjalë i përkasin kryesisht terminologjisë shkencore. Ndërtimi i njohurive të reja: <i>diskutim</i> Prezantohet në tabelë titulli i mësimin. Udhëzohen nxënësit që të hapin tekstin në faqen 196. Nxënësit do të lexojnë në heshtje informacionin e dhënë dhe më pas paraqitet drejtshkrimi i pjesëzave dhe parafjalëve që përdoren para trajtave foljore, para emrave a përemrave shkruhen zakonisht të plotë. Trajtat foljore që formohen me pjesëzat <i>do të:</i> <i>Djali do të shkruante e do të përsëriste të gjitha rregullat drejtshkrimore.</i> Pjesëza <i>të</i> që vihet përpara mënyrës lidhore ose pjesoreve të foljeve shkruhet rregullisht në të gjitha rastet e përsëritjes së trajtave foljore përkatëse, bashkë me parafjalët që mund të ketë përpara (<i>për</i> ose <i>me</i>): Mësuesi udhëzonte nxënësit për të studiuar, për të kuptuar dhe për të zbatuar të rejat e shkencës. Ai mori masa urgjente me të arritur e me të parë gjendjen e spitaleve. Pjesëza <i>duke</i> e përcjellores shkruhet në të gjitha rastet e përsëritjes së kësaj trajte foljore. Në raste mohimi, bashkë me të përsëritet edhe pjesëza <i>mos</i>: Nxënësit argëtoheshin duke kërcyer, duke kënduar, duke brohoritur e duke duartrokitur.

Pjesëza *pa* përpara pjesores shkruhet rregullisht në të gjitha rastet e përsëritjes së kësaj trajte foljore: *Pa e parë e pa e takuar nuk e besoj. Pa lexuar e pa shkruar nuk mësohet asgjë.*

Parafjalët *në, te (tek), me, nga, prej* përsëriten para gjymtyrëve homogjene sa herë bashkërenditen dy a më shumë emra a përemra me të cilët ato lidhen.
në vjeshtë, në verë, në dimër, në pranverë; te popujt, te fiset, te pellazgët, te shqiptarët; I pëlqen vendi i tij në pranverë, në verë, në vjeshtë dhe në dimër, pra në të katra stinët e vitit. Shkoi te Sara, te Beni, te Jona, që të pyeste për mësimet e nesërme. Andi i kishte të rrallë shokët nga rregullsia, nga mençuria dhe nga serioziteti në punë.

Këto parafjalë mund të mos përsëriten për arsye të caktuara kuptimore a stilistike: *nga, me.*

- U nisën të gjithë nxënësit nga Vlora, Durrësi, Lushnja, Fieri.
- Mësimdhënia kërkon nga mësuesit e pedagogët, përkushtim, seriozitet e profesionalizëm.
- Nga vajzat e djemtë u thanë shumë fjalë të bukura.
- Me libra e fletore në duar ata përshëndesnin që larg.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura:

Hapi I: (*Punë në dyshe*). Nxënësit mbyllin librin dhe shkruajnë në fletore nga 10 fjali për drejtshkrimin e pjesëzave dhe të parafjalëve të përsëritura.

Nxënësit kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

Hapi II: (*punë e pavarur*)

Ushtrimi 1.

Lexoni tekstin dhe gjeni raste të përdorimit të parafjalëve dhe pjesëzave. Shpjegoni përdorimin e tyre sipas rregullave të mësipërme.

Edhe këtu një pritje e paparashikuar. Vetë koordinatoja e aktivitetit dhe disa familje amerikane, që do të bëheshin mikpritësit e fëmijëve tanë në ditët e qëndrimit tonë atje, kishin dalë për të na uruar mirëseardhjen. Shpejt e shpejt, në stilin krejt origjinal e praktik amerikan, ata i ndanë dhe i morën nëpër makinat e tyre fëmijët, duke na uruar në të njëjtën kohë natën e mirë mua dhe dy trajnerëve. Një ditë më parë skuadrat pjesëmarrëse në turne i kishin zhvilluar ndeshjet e radhës dhe prisnin ndeshjet e ditës së dytë. Vonesa jonë e kushtëzuar nga aeroporti i Ljubljanës do të na “ndëshkonte”, pasi do të zhvillonim dy ndeshje brenda ditës, madje brenda 4 orëve.

Ushtrimi 2.

Në tekstin e mëposhtëm plotësoni parafjalët dhe pjesëzat që mungojnë.

Këto fjalë qenë të papritura. Ne e dinim dashurinë e vogëlushes _____ lulet. Ballkoni ynë qe kthyer _____ një lulishte: tulipanë, karafila, lulekine, bar italian, begonja, luleshpate, fikuse, zymbyla etj. Unë isha _____ rregulluar edhe një dërrasë si raft, ku mami _____ bashku me Inxhin _____ renditnin një sërë tjetër _____ saks. Vogëlushja u gëzohej luleve. Rrinte _____ orë të tëra aty _____ ballkon. I njomte çdo mëngjes, u gërmonte dheun saksive, hiqte gjethet e thata, lidhte lehtë e _____ kujdes pas hekurave ndonjë kërcell të lëvarur. Dhe lulet rriteshin të shëndetshme, gjelbëronin e lulëzonin _____ lloj-lloj ngjyrash të ndezura. Inxhi ndiqte çdo ditë _____ kureshtje lulëzimin e tyre. Dhe, herë pas here, kumtonte duke i ndritur sytë: “Mami, luleshqiponja ka lëshuar një gjethë të re!”, “gonxhja e karafilin të kuq ka hapur!”

“Nënëgjyshe, fikusi është _____ çelur një lule të vockël, të bardhë! Sa e bukur që është! Eja ta shohësh!”. Dhe ne nxitonim ta shikonim. Më tepër se lulja, na gëzonte fytyra e vogëlushes, që vetëtinte _____ lumturia.
Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi: Nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen vlerësimet.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Ushtrimi nr. 3, sipas kërkesës.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/a bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përdor drejt gjuhën dhe drejtshkrimin; - dallon dhe përdor drejt në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore sipas ligjërimeve dhe stileve funksionale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues.			

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras

Fjalët kyçe: fjalë që shkruhen njësh, fjalë që shkruhen ndaras, fjalë të përbëra, të përngjitura, togfjalësha, parim semantik, parim morfologjik.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- dallon rastet e shkrimit të fjalëve njësh dhe ndaras të fjalëve;
- shkruan drejt fjalët që përdoren njësh dhe ndaras.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkumës me ngjyra, libri “Shqipja standarde”, fisha me fjalë, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
- Shoqëria dhe mjedisi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Minikonkurs, Shpjegim, Punë e pavarur*

Organizimi i orës së mësimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Minikonkurs*

Zhvillohet një minikonkurs në klasë me tre nxënës, të cilët shprehin dëshirën që të bëhen pjesë e tij.

Nxënësit, përfaqësues të tri grupeve, do të tërheqin fisha me fjalë të fshehura dhe do të shkruajnë në tabelë këto fjalë, duke i korrigjuar ose jo.

1. dy vjeçar (dyvjeçar), nëndrejtor, veri perëndim (veriperëndim), vendburim, shurdh-memec (shurdhmemec)

2. farë e fis (farefis), një qind (njëqind), kush-do (kushdo), gjithsecili, tjetërkush

3. me qënë se (meqenëse), pothuajse, barblete (bar blete) bojë ari, përsëgjalli (për së gjalli)

Pranohen të gjitha përgjigjet e nxënësve. Qortimi i gabimeve dhe shpallja e fituesit, do të bëhen në vazhdimin e orës së mësimit.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Shpjegim.*

Prezantohet tema e mësimit. Sqarohen nxënësit se shkrimi i fjalëve njësh dhe ndaras, mbështetet në parimin semantik (kuptimi leksikor i fjalëve) dhe në parimin morfologjik

Shkruhen bashkë ato fjalë që nga ana leksikore shënojnë një koncept të vetëm dhe nga ana gramatikore sillen si një fjalë e vetme, kurse ndaras, ato fjalë që shënojnë koncepte të ndryshme dhe nga ana gramatikore janë pjesë e një togfjalëshi.

Tërhiqet vëmendja e nxënësve tek informacioni i paraqitur në tekst dhe diskutohen me nxënësit të gjitha rastet e shkrimit të fjalëve njësh dhe ndaras.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur*

Ushtrimi 1. Një nxënës punon në tabelë. Të tjerët punojnë në fletoren e tyre.

besëlidhje, besëmirë, besëprerë, besëplotë, besëqen

bojarrë, bojargjend, bojëmjaltë,

duarbosh, duartatë, duarflori, duarkryq, duarlidhur, duarmpirë,

ballëbardhë, ballëçelik, ballëdalë, ballëflori, ballëfshehur

bashkëbisedim, bashkëbanor, bashkëpunim, bashkëbanim

kryeqytet, kryeagronom, kryearkëtar, kryeartikull, kryeartë, kryebosh ndihmës drejtor, ndihmësmjek, ndihmësministër, ndihmësgjyqtar parabolë, paraburgim, paracaktim, paradhomë pikëbashkim, pikëçuditje, pikëderdhje, pikëgrumbullim udhëdalje, udhëheq, udhëheqës, udhëçelës (ai që çan përpara me guxim, për të zbuluar të renë) gjysmëbosh, gjysmëdrejtëz, gjysmëfinale, gjysmëdjathtë vendbanim, vendarritje, vendburim, vendnumërim Ushtrimi 2. Nxënësit qarkojnë trajtat e sakta të fjalëve. (përgjigjet e sakta) Mirë se vjen, i parakohshëm, bojëbizele, juglindje, letërnjoftim, bashkatdhetar, vendqëndrim, bashkëjetesë, rrugëdalje, jokalistare, kryeredaktor, katër mijë.
Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi: Nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen dhe motivohen vlerësimet.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Ushtrimi 3. Kërkesë shtesë. Formoni nga një fjali me fjalët e përngjitura dhe shprehjet.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - përdor drejt gjuhën dhe drejtshkrimin; - dallon dhe përdor drejt në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore sipas ligjërimeve dhe stileve funksionale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie.			

II. VLERAT DHE QËNDRIMET - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathhtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shkrimi i fjalëve me vizë lidhëse në mes

Fjalët kyçe: fjalë që shkruhen me vizë në mes, rregull përkatës, drejtshkrim.

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- rendit fjalë që shkruhen me vizë në mes;
- dallon rastet e përdorimit të fjalëve që shkruhen me vizë në mes;
- shkruan saktë të gjitha fjalët që kanë vizë në mes.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkurtes me ngjyra, libri “Shqipja standarde”.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

-

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Konkurs, Diskutim, Punë në grupe, Punë e pavarur*

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Konkurs, diskutim*

Shkruhet tema e mësimi në tabelë dhe udhëzohen nxënësit që të paraqesin në fletore sa më shumë fjalë që shkruhen me vizë në mes. Nxënësi që mbaron i pari, ngre dorën dhe klasa lë punën. Lexohen fjalët e shkruara nga nxënësi i parë, paraqiten në tabelë dhe numërohen. Fiton nxënësi që ka numrin më të madh të fjalëve të shkruara saktë.

Për fjalët e paraqitura në tabelë, nxënësit përcaktojnë klasën e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë në grupe*

Sqarohen nxënësit se fjalët e shkruara me vizë në mes, janë ato njësi që shënojnë një koncept të vetëm, por që nga pikëpamja gramatikore, janë në rrugën e njëfjalëzimit (bashkimi në një fjalë të vetme).

Klasa ndahet në tri grupe, secilit grup i jepet për të studiuar pesë nga rastet e shkrimit të fjalëve me vizë në mes. Nxënësit do të shkruajnë në njërën anë të fletores fjalët dhe në anën tjetër, rregullin përkatës. Përdoren ngjyra të ndryshme.

Një nxënës, përfaqësues i çdo grupi, prezanton punën e realizuar në fletore. Mund të përfshihen edhe nga dy nxënës për çdo grup, nisur nga numri i nxënësve në klasë.

Gjatë prezantimit të rasteve të shkrimit të fjalëve me vizë në mes, sqarohen pasaktësitë dhe paqartësitë që mund të kenë nxënësit. Shpjegohen rastet përjashtuese.

Vlerësohen dhe përgëzohen nxënësit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë e pavarur.*

Ushtrimi 1. Nxënësit do të punojnë në fletore, kurse një nxënës punon në tabelë. Mblidhen disa fletore për t'u vlerësuar.

Përgjigjet: 110-vjetori i Mësonjëtores, 50-vjetori i lindjes së xhaxhait, shkolla 9-vjeçare, ngjarjet e 1997, shekulli i XXI, 16-ta është katër herë më e madhe se katra.

Ushtrimi 2

Para dy vjetësh mora pjesë në një konferencë rinore në Lisbonë. Ishte konferenca e 12-të ndërkombëtare. Udhëtimi me avion Tiranë-Lisbonë ishte mjaft i këndshëm, pasi qëndruam mbi 5 orë në Vjenë të Austrisë. Nga aeroporti në Vjenë shkua me tren-ekspres. Në një konferencë, u njoha me disa anglosaksonë dhe frankogjermanë. Erdhën përfaqësues nga OKB-ja dhe ekspertë të Unicef-it. Ditën e 2-të konferencës, unë kisha ditëlindjen. Ishte hera e parë që do ta festoja larg familjes e farestit tim. Kur ora po i afrohej 12-ës, unë numëroja tik-takun e saj. Sapo akrepat mbuluan njëri-tjetrin, i pari më telefonoi babi. Edhe gjyshen 85-vjeçare nuk e kishte zënë gjumi. U emocionova shumë dhe nuk e përmbajta dot veten. Hera-herës u përlota. Më uruan dhe shumë bashkëmoshatarë.

Dy prej tyre ishin nga La Valeta, ndërsa dy të tjerë nga San-Salvadori. Mos më pyesni sa vjeç isha. Ju jeni një grup-moshë me mua. Ne atëherë ishim nxënës në klasën e 9-të.

Në varësi të kohës, detyra mund të vazhdohet në shtëpi.

Detyrë shtëpie (alternativë)

Shkruani si duhet fjalët që formohen nga bashkimi i temave.

korean+jugor proces+verbal

fletë+hyrje një+mijë

lule+mos+më+prek lule+mëllagë

indo+evropian vajtje+ardhje

bujqësor+industrial qen+ujk

vaj+recini projekt+plan

teknik+shkencor makinë+shkrimi...

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit nisur nga pjesëmarrja gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen vlerësimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Detyrë shtëpie (alternativë)

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: I V	Klasa: IX
Tema: Tregimi epistolar			Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):				
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):				
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit				
II. VLERAT DHE QËNDRIMET				
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË				
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Lodra me akull				
Fjalët kyçe: dimër, liqen, akull, borë, fëmijë, lodra, ngjarje.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore				
Nxënësi/ja:				
- identifikon prozën epistolare nëpërmjet elementeve strukturore të tregimit; - dallon fjalët dialektore për t'i kthyer në standarde; - dallon në tekst figurën letrare të onomatopesë; - diskuton mbi rëndësinë jetësore dhe të pazëvendësueshme të disa gjërave në jetën tonë.				
Kriteret e suksesit:				
- flet për mënyrën të shkruarit të ditarit; - shkruan fjalët dialektore dhe i zëvendëson me gjuhën standarde; - njeh dialogët mes personazheve kryesore Yllit dhe Sokolit.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela, libri “Të fala nga fshati”.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë fizike, shoqëria dhe mjedisi.				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim; skeda e autorit; lexim zinxhir; ditar dypjesësh; punë dyshe;				
Organizimi i orës së mësim:				
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: diskutim.				
Nxënësve u shtrohen pyetjet: Cilat janë lojërat që luani në dimër? A paraqet rrezikshmëri ndonjë prej tyre?				

Ndërtimi i njohurive të reja:

Hapi i parë: (Skeda e autorit). Në bazë të njohurive që kanë dhe të atyre që do të marrin, nxënësit ndërtojnë skedën e autorit.

Autori: Sterio Spase (1914-1989)

Botimet: Tregime, romane, studime pedagogjike, tekste shkollore

Veprat: Kuror rinie, Nusja pa duvak, Pse?, Afërdita, Kryengritësit

Libri: Të fala nga fshati

Titulli i tregimit: Lodra në akull

Lloji letrar: Proza epistolare

Karakteristikat: Shkrimi në formën e letrës, ditarit, artikujve, postës elektronike.

Hapi i dytë: (Lexim zinxhir) Lexohet pjesa dhe shpjegohen fjalët që nxënësit i kanë të panjohura.

Hapi i tretë: (ditar dypjesësh). Punohen ushtrimet 1, 2, 3.

1. Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

Atë ditë të ftohtë dimri, liqeni kishte ngrirë. A

ndodhte shpesh ngrirja e liqenit në dimër?

Jo, nuk ndodhte shpesh.

Çfarë bënë fëmijët në liqenin e ngrirë?

Filluan të rrëshqisnin mbi liqen.

A ishte argëtuese një gjë e tillë?

Po, ishte argëtuese.

Cila ishte ngjarja që i tronditi fëmijët në liqenin e ngrirë?

Rënia e viçit të Gjergjit në liqen dhe ngrirja brenda tij.

Çfarë kuptojmë nga kjo pjesë? Cili është mesazhi i saj?

Lojërat janë argëtuese për fëmijët, por nuk duhet të rrezikojmë gjatë tyre.

Teksti është ndërtuar në formën e letrës. Çfarë i shton rrëfimit të ngjarjes përdorimi i kësaj forme?

Rrëfimi bëhet më i besueshëm, autori afrohet me lexuesin.

Ku dhe kur zhvillohen ngjarjet për të cilat rrëfëhet në këtë tekst?

Në liqen, në dimër.

Hapi i katërt: (punë individuale). Punohen ushtrimet 4 dhe 5.

4. Ngrirja e liqenit përjetohet me entuziazëm dhe frikë nga fëmijët. Gjeni në tekst ndodhitë që shkaktojnë ankth te personazhi.

...dëgjua një “kërc” të rënduar, pastaj një “bëllduf” e po n’atë çast ulërima fëmijësh... ishte çarë akulli në një vënd dhe njëra këmbë, Vasos i qe futur brënda.

... na trembën se po çahesh akulli i tërë e se do të mbyteshim.

Dhe frikën më të madhe na e futi viçi i vogël i Gjergjit ... dha një vrap në thellësi...viçi ra brenda n’ujë!

5. Gjeni në tekst përshkrimet e ndjesive të fëmijëve ditën e parë dhe ditën e dytë.

- Dita e parë: më rrihte zemra; sa bukur që ishte; me mendje të ngritur

- Dita e dytë: ia patëm frikën; na erdhi shumë keq; i kemi zili ata zogj...

Hapi i pestë: (diskutim). Punohen ushtrimet 6, 7, 8, 9, 11, 13, 14

6. Çfarë shtohet më shumë në ditën e dytë, kënaqësia apo ankthi?

Shtohet ankthi. Pse? Sepse kuptuan rrezikshmërinë e lojës së tyre.

7. Pse autori ka zgjedhur të rrëfejë një ngjarje të tillë?

- Lojëra të tilla, vërtet janë tërheqëse, por paraqesin dhe rrezikshmëri.

8. Si i kuptoni fjalët e Yllit: “Vetëm tani e kuptojmë se ç’marrëzi kemi bërë duke rrëshqitur aq fellë dje e pardje. Paskemi shpëtuar si për çudi.”

Fëmijët u ndërgjegjësuat për rrezikun pas asaj që i ndodhi viçit të Gjergjit.

A përbëjnë ato mesazhin e pjesës? Po ju, a tregoheni gjithmonë të kujdesshëm kur luani?

9. Si e interpretoni shprehjen e mëposhtme?

“Ne i kemi zili këta zogj, se na duket sikur vozitin si lundra akulli mbi liqen!”

Dëshira e fëmijëve ishte e madhe për të rrëshqitur mbi liqen dhe rreziku po aq i madh, ndaj i kishin zili zogjtë që e kishin këtë mundësi si pjesë e përditshmërisë së tyre. / Dëshira për të qenë “të lirë” si zogjtë.

11. Çfarë tregon përdorimi i fjalëve dialektore në tekst?

Autori ka përdorur regjistrin e shkujdesur gjuhësor, pra është i lirshëm, përdor gjuhën e gjallë.

13. Nisur nga fjalja: “Ne na erdhi shumë keq për Gjergjin që humbi viçin, të vetmin viç që kishin!”, diskutoni për kujdesin që tregojmë ndaj gjërave, rëndësia e të cilave është jetësore dhe e pazëvendësueshme për ne.

14. Fëmijët dhe nënat e tyre, kanë qëndrime të ndryshme ndaj lojës në akullin e liqenit. Po ju, a keni ndonjë qëndrim të ndryshëm nga ai i prindërve tuaj? Për çfarë? Hapi i gjashtë: (punë në dyshe).

Ushtrimi 10. Nënvizoni në tekst fjalët e shkruara në dialekt. Shkruajini ato në gjuhën standarde, sipas shembullit të dhënë.

Fjalët në dialekt Fjalët në gjuhën standarde

Pyesnja - Pyesja

Shihnja - shihja

Aqë - Aq

Qërtonin - qortonin

Makar - fundja

Këthyem - kthyem

Çarkth - çark

Hapnë - hapën

Fellë - thellë

Hapi i shtatë: 12. Gjeneri në tekst onomatopetë dhe shkruajini ato më poshtë.

Onomatopeja: (Nga greq. onoma – emër, poeme – bëj – krijoj). Është figurë e përsëritjes që ka bazë imitimin e zhurmave të zërave të natyrës dhe të qenieve të gjalla.

Fërshh; kërc; bëllduf; kërc-trak

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruani një tekst përshkrues në të cilin përdorni sa më shumë onomatope.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit/et duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti letrar			Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: identifikon elementet bazike të strukturës së novelës.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Fshati mbi shtatë kodrina				
Fjalët kyçe: fshati, male, lufta, pranvera, vera, rigoni, plepi, dielli, satelit, orbitë.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja: - njih tiparet e kompozicionit të novelës; - dallon relievin e maleve shqiptare, rëndësinë e tyre përgjatë historisë; - kupton përshkrimin e rrëfimitarit në tekst. Kriteret e suksesit: - lexon tekstin dhe kupton ndërtimin e tij; - kupton rëndësinë që kanë pasur malet shqiptare në luftëra të ndryshme; - analizon tekstin dhe komenton mënyrën e rrëfimit. Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela, novela “Fshati mbi shtatë kodrina”				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Histori, gjeografi, arte.				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:				
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Stuhi mendimi; kllaster; pyetje-përgjigje; diskutim Organizimi i orës së mësimi: Pjesa hyrëse – stuhi mendimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: stuhi mendimi Nxënësve u shtrohet pyetja: Novelat janë krijime artistike në prozë. Ku dallojnë ato me romanin? Përgjigjet e nxënësve i shkruajmë në tabelë.				

Pjesa kryesore**Ndërtimi i njohurive të reja: kllaster, lexim zinxhir.**

Mësimdhënësi/ja cakton një nxënës të lexoj rubrikën, biografinë e poetit Kasëm Trebeshina. Titujt e veprave shkruhen në tabelë.

Hapi I: Njëpërmjet kllasterit, nxënësit nxjerrin tiparet e tregimit.

- ngjarjet zhvillohen brenda një kohe të shkurtër
- lloj i shkurtër i prozës
- ka një personazh kryesor
- nuk jepen hollësi për psikologjinë e personazheve
- pasqyrohen anë të rëndësishme të realitetit
- përmes tregimit ndiqet dinamika e jetës, aktualiteti dhe tema e ditës.

Tregimi

Hapi i II: Lexohet pjesa e leximit “Fshati mbi shtatë kodrina” nga dy-tre nxënës.

Nxënësit punojnë rubrikën: Kuptojmë tekstin: 1 dhe Analizojmë tekstin: 2, 3,4

Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të punojnë ushtrimin – Interpretojmë tekstin; 5,6,7 dhe Gjuha e tekstit; 8,9,10.

Pjesa përfundimtare

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: marrëdhënie pyetje përgjigje, diskutim.

Reflektim rreth tekstit – Komentoni frazën: E dimë që ka vende më të bukura, më të mëdha në botë, po e dimë se ka diej edhe më të mëdhenj se dielli ynë në hapësirat e pakufishme të gjithësisë.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruani një ese përshkruese për vendlindjen tuaj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit/et duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV
Tema: Tekste realiste		Klasa: IX	
		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare dhe jolettrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):			
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):			
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit			
II. VLERAT DHE QËNDRIMET			
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË			
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Djali me pizhame me vija (ora e parë)			
Fjalët kyçe: pizhame me vija, ushtarë, gardh, Poloni, Gjermani.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:			
Nxënësi/ja:			
• gjykon fatin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore; • dallon fabulën, përmbajtjen dhe subjektin e fragmentit; • u përgjigjet pyetjeve për të kuptuarit e tekstit.			
Kriteret e suksesit:			
• shikon sekuencën filmike në projektor; • lexon tregimin e dhënë në tekst; • analizon personazhet e tekstit dhe diskuton për veçoritë e tyre.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela, libri “Djali me pizhame me vija” dhe filmi “Djali me pizhame me vija”.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Histori, Të drejtat e njeriut			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Bisedë; lexim zinxhir; diskutim; pyetje-përgjigje			
Organizimi i orës së mësimi:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: bisedë			
Shohim në videoprojektor një sekuencë nga filmi: “Djali me pizhame me vija”			

Nxënësve u shtrohet pyetja: “Ç’ dini për fatin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore”?

Ndërtimi i njohurive të reja: lexim zinxhir, diskutim.

Prezantohet tema dhe lexohet pjesa nga nxënësit.

Lexohet dhe diskutohet informacioni në tekst rreth fabulës, përmbajtjes dhe subjektit të një veprë letrare.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pyetje-përgjigje

Ushtimi 1. Lexoni pjesën dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme.

- Duke u nisur nga informacionet që marrim në tekst, për ç’lloj kampi mendoni se flitet? *Kamp nazist (përqendrimi; burgimi).*

- Si visheshin njerëzit brenda gardhit të kampit? *Në kamp të gjithë visheshin njësoj, me të njëjtat pizhame e kapele me vija.*

- Po në shtëpinë e Brunos? *Të gjithë ata që endeshin nëpër shtëpi (përveç mamit, Gretelit dhe atij vetë) vishnin uniforma me cilësi të ndryshme dhe dekorata, kapele ose helmata, mbanin shirita kuqezi të ndritshëm.*

- Kush ishte pjesëtari i vetëm i familjes që e kalonte gardhin me tela? *Babai*

- Kush tjetër, nga ata që njihje Brunoja, kishte të drejtë të kalonte në të dyja anët e gardhit?

Ushtarët

- Ç’po bënte Brunoja, kur dalloj djaloshin e vogël brenda gardhit? *Po eksploronte*

- A kishte ndonjë shenjë dalluese në rrobat e djalit? *Në krahë kishte një shirit me një yll*

- Çfarë i bëri përshtypje Brunos të Shmueli? *Brunoja mund të bënte be që s’i kishin zënë sytë kurrë më parë ndonjë djalë më të dobët dhe më të pikëlluar se ai.*

- Pse autori e përshkruan me detaje të hollësishme fytyrën e djalit? *Për të treguar se pafajësia e këtij fëmije është shndërruar nga dhembja dhe vuajtja në kamp. Imazhi fizik vjen i shpërfytyruar në nivele të larta.*

- Çfarë kërkon të vërë në dukje autori? *Brenda kampit nuk bënin dallim as fëmijët.*

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shikoni të plotë filmin “Djali me pizhame me vija” dhe shkruani një ese rreth tij.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekstet letrare			Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):				
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):				
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit				
II. VLERAT DHE QËNDRIMET				
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË				
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Djali me pizhame me vija (ora 2)				
Fjalët kyçe: Gardhi me gjemba, mungesa e lirisë, ndjenja, të ndryshëm, të ngjashëm;				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore:				
Nxënësi/ja:				
- krahason tipare të fizikut dhe karakterit të djalit polak dhe atij gjerman; - interpretin simbolikën e gardhit që ndan fëmijët dhe realitetin e secilit; - analizon mungesën e lirisë së individit, nisur nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.				
Kriteret e suksesit:				
- dallon personazhin polak nga ai gjerman; - kupton ndarjen që paraqet gardhi; - komenton rëndësinë e lirisë së njeriut.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela, Libri “Djali me pizhame me vija”, Filmi “Djali me pizhame me vija”				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Histori, Të drejtat e njeriut;				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:				
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Diskutim, tabela e krahasimit, punë individuale, punë dyshe, kllaster				
Organizimi i orës së mësim:				
Hapi i parë: Lexohen dy-tri përshtypje të nxënësve rreth filmit “Djali me pizhame me vija”				
Hapi i dytë: diskutim. Punohen ushtrimet 2 dhe 3.				
2. Ne tekst, vihet ne dukje se emri Shmuel është emër shumë i përhapur, një duzine, ndërsa ai i Brunos i përveçëm, i vetmi. Në kuptim të figurshëm, ç’ kërkon te na tregojë rrefimtari me këtë? Kjo gjë përfaqëson filozofi në e pushtimit gjerman, mbizotërimin e racës së pastër ariane. Emri i veçantë, tregon në mënyrë simbolike, atë çka kërkonin të tregonin gjermanët: veçantinë e racës së tyre.				
3. Mes dy djemve të se njëjtës moshë që jetojnë kaq pranë njeri-tjetrit, qëndron një gardh. Gjeni në tekst sa herë përmendet fjala “gardh” (5 herë) dhe shpjegoni çfarë simbolizon ai, duke iu përgjigjur pyetjeve:				

Nxënëset punojnë me fjalorin e gjuhës shqipe.

-Përse nevojitet gardhi me gjemba? gardh - kuptimi i parë i kësaj fjale është ndarje fizike, territoriale kuptimi i figurshëm - ndryshim/ndarje botëkuptimi, formimi, ideologjie.

- Si e përfuturojnë Brunoja dhe Shmueli telin që i ndan? Teli me gjemba nuk ekziston për fëmijët. Naiviteti, brishtësia dhe pafajësia e fëmijëve nuk mund të jetë pjesë e ideologjisë së të rriturve.

- A janë ata plotësisht të ndërgjegjshëm për të? Jo, nuk janë plotësisht të ndërgjegjshëm për telin (ndryshimin) mes tyre.

Hapi i tretë: Ushtrimi 4 (tabela e krahasimit) Duke u nisur nga informacionet e marra nga teksti dhe nga fotografi që shoqërojnë atë, bëni krahasimin mes Brunos e Shmuelit.

a. Krahasojmë portretet fizike.

Shmueli e ka lëkuren e fytyrës pothuajse ngjyre gri...

Brunoja e ka lëkurën e fytyrës të bardhë e të pastër

b. Krahasojmë familjet, edukimin.

Prindërit e Brunos janë gjermane dhe babai i tij është ushtarak me uniforme...

Prindërit e Shmuelit janë polakë, nëna e tij ka qenë mësuese dhe babai orëndreqës.

c. Krahasojmë rrethanat në të cilat kanë lindur dhe jetojnë.

Brunoja jetonte në Berlin, por u largua prej andej kur babai i tij u bë komandant i kampit...

Shmueli jetonte në Poloni, por u largua prej andej kur i internuan në kamp

d. Krahasojmë gjendjet e tyre shpirtërore.

Brunoja ishte i pakënaqur që ishte detyruar të largohej, i vetmuar...

Shmueli ishte i trishtuar që ishte i detyruar të jetonte në kamp

Hapi i katërt: Ushtrimi 5 (diskutim). Si i kuptoni fjalitë: “Ku qëndronte ndryshimi? - pyeste veten.

– Dhe, kush e vendosi se kush duhet të vishte pizhame me vija dhe kush duhet të vishte uniforme?”

Ku qëndron dilema e djalit?

Dilema e djalit lidhet me pabarazinë mes njerëzve. Ai arrin të kuptojë, se njerëzit brenda gardhit ndryshojnë me ata matanë gardhit nga veshja, por nuk kupton ndryshimin brenda racës njerëzore.

(Pa marrë parasysh ndasitë racore, apo politike që fëmijët me naivitetin dhe pafajësinë e tyre, nuk mund t'i kuptojnë, ai e sheh të ngjashëm me veten djalin brenda gardhit).

Hapi i pestë: Ushtrimi 6 dhe 7 (punë individuale)

6. Përshkruani përjetimin emocional të Brunos gjatë takimit me Shmuelin.

Bruno tronditet si pasojë e reflektimit të ndryshimeve që sheh mes vetes dhe djalit me pizhame.

7. Në paragrafi në parë përdoren fjalët antonime të ndryshëm/njësoj. Shpjegoni përdorimin e tyre për njerëzit në të dyja anët e gardhit. Nxënësit-et punojnë me fjalorin e gjuhës shqipe.

Njerëzit brenda gardhit dukeshin të gjithë njësoj dhe ata matanë gardhit të ndryshëm. E gjithë kjo tablo s'është gjë tjetër, vetëm se kontrasti i jetës mes dy grupimeve.

Hapi i gjashtë: Ushtrimi 8 (punë dyshe). Gjeni në tekst epitetet me të cilat përshkruhet gjendja e Shmuelit, në çastin kur takohet me Brunon.

Fytyrë e çuditshme; sy të pikëlluar; lëkurë gri; grije të paparë

Hapi i shtatë: 9 - Si mendoni, çfarë ndjenjash shkakton mungesa e lirisë tek individit? (**killaster**)

Nënshtrim, paragjykim, pabarazi, mungesë lirie.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Reflektoni rreth shprehjes – Të ndryshëm apo të ngjashëm – ushtrimi 10


Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti letrar			Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e jo letrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Të mjerët				
Fjalët kyçe: Zhan Valzhani, Kozeta, Tenardijet, Parisi, Murgeshat, Kuvendi				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - njih tiparet e personazhit Kozeta; - analizon gjendjen në të cilën ndodhen personazhet kryesore, Zhan Valzhani dhe Kozeta; - dallon gjendjen emocionale të Kozetës. Kriteret e suksesit: - shkruan në fletore portretin moral të Kozetës; - komenton marrëdhënien prind–vajzë; - analizon bashkëbisedimin mes Kozetës dhe Zhan Valzhanit.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela, foto të ndryshme, laptop, projektor, libri “Kozeta”.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:Edukatë qytetare, histori, gjeografi.				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Pjesa hyrëse: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësimgdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Të mjerët” dhe nxënësve u shtron pyetjen – Sa është e rëndësishme të edukosh një fëmijë? Nxënësit tregojnë njohuritë e tyre dhe Mësimgdhënësi/ja shkruan në tabelë mendimet e tyre. Pastaj shpjegon biografinë e Viktor Hygo.				

Pjesa kryesore: Ndërtimi i njohurive të reja - Diamanti 4

Në këtë fazë, Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të shikojnë një sekuençë filmike nga filmi “Të mjerët” dhe të mbushin kolonat me kuptimin e secilës pjesë që shikojnë. Udhëzohen të ndalen edhe te mesazhet që përcjell filmi.



Pas përfundimit të detyrës, në secilin grup prezantojnë punimet e tyre me një nxënës përfaqësues.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje-Diagrami i Venit
Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre detyrat e ndara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: - Kuptojmë tekstin – detyrat: 1 (b, ç).

Grupi i dytë: - Analizojmë tekstin – detyrat: 2, 3, 4, 5.

Grupi i tretë: - Interpretojmë tekstin – detyrat: 9, 10, 11.



Grupi i katër: - Gjuha e tekstit – detyrat: 6, 7, 8.

Mësimdhënësi/ja ndihmon nxënësit nëse është e nevojshme. Pastaj të gjithë reflektojmë rreth tekstit. detyrat -12,13.

Pjesa përfundimtare: Pas reflektimit, nxënësit udhëzohen për Diagramin e Venit.

Zhan Valzhan – Tenardije

Kuvendi – shtëpia



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).


Detyrat dhe puna e pavarur

Nga mëson më shumë njeriu; nga modeli i prindërve, nga shkolla nga përjetimi i vështirësive në jetë? Diskutoni në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit/et duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti letrar (tregimi)			Rezultati i të nxënit të temës: Kupton mesazhin që mbart tregimi dhe e lidh me situata jetësore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):				
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):				
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit				
II. VLERAT DHE QËNDRIMET				
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË				
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Gjerdani				
Fjalët kyçe: Matilda, zoti Lauze, Ministria e Arsimit, zonja Forestje, ballo, fustani, gjerdani.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore				
Nxënësi/ja:				
- dallon tiparet e çiftit Luazel; - analizon gjendjen ekonomike dhe shoqërore në të cilën ndodhen personazhet e tregimit; - dallon gjendjen emocionale në të cilën ndodhet Matilda.				
Kriteret e suksesit:				
- Shkruan disa elemente karakteristike të çiftit Luazel. - Komenton situatën e Matildës kur kupton se i ka humbur gjerdani. - Analizon takimin e rastësishëm të Matildës dhe Zhanës.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela,				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:				
Pjesa hyrëse: Lexim i drejtuar				
Në këtë fazë, mësimmhënësi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore «Gjerdani» dhe informon ata për shkrimtarin e shquar Gi de Mopasan. Në vazhdim, cakton një nxënës që të lexojë biografinë e autorit. Një nxënës tjetër shkruan në tabelë veprat e autorit Gi de Mopasan.				
Pjesa kryesore: Ndërtimi i njohurive të reja - Diamanti 4				
Në këtë fazë, mësimmhënësi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë tregimin “Gjerdani”, në tekstet e tyre dhe të plotësojnë rubrikat me kuptimin e fragmenteve. Në vazhdim, nxënësit listojnë edhe fjalët që nuk kanë kuptuar në tekst.				



Pas përfundimit të detyrës, në secilin grup, një nxënës prezanton punimet e grupit përkatës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre detyrat e ndara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: - Kuptojmë tekstin – detyrat: 1.


Grupi i dytë: - Analizojmë tekstin – detyrat: 2, 3, 4, 5.

Grupi i tretë: - Interpretojmë tekstin – detyrat: 7, 8.

Grupi i katër: - Gjuha e tekstit – detyrat: 9, 10, 11, 12.

Mësimdhënësi/ja ndihmon nxënësit nëse është e nevojshme. Pastaj të gjithë reflektojmë rreth tekstit detyrat - 13, 14.

Pjesa përfundimtare: Pas reflektimit, nxënësit udhëzohen për Diagramin e Venit.



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).


Detyrat dhe puna e pavarur

Duke u nisur nga ajo që ka dhënë shkrimtari, si mendoni se do të shkojë fati i Matildës dhe bashkëshortit të saj?

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti letrar			Rezultati i të nxënit të temës: Dallon (krahason) romanin me tregimin.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):				
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4 ,5, 6, 7, 8.				
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):				
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit				
II. VLERAT DHE QËNDRIMET				
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË				
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Krahason romanin me tregimin				
Fjalët kyçe: romani, novela, tregimi, prozë, “Të mjerët”, “Gjerdani”.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore				
Nxënësi/ja:				
- dallon tiparet kryesore të romanit; - njuh kompozicionin e tregimit; - dallon përshkrimin e personazheve të romanit nga përshkrimi i personazheve të tregimit.				
Kriteret e suksesit:				
- Shkruan karakteristikat e romanit “Të mjerët”. - Komenton ndërtimin e tregimit “Gjerdani”. - Analizon të përbashkëtat dhe dallimet e dy teksteve letrare: “Të mjerët” dhe “Gjerdani”.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:				
Pjesa hyrëse: Stuhi mendimi				
Në këtë fazë, mësindhënësi/ja përmes bashkëbisedimit reflekton njësitë “Të mjerët” dhe “Gjerdani”, pastaj shtron pyetjen: Si e kuptoni dallimin mes romanit dhe novelës? Në vazhdim, cakton një nxënës që të shkruajë në tabelë të gjitha përgjigjet.				
Pjesa kryesore: Ndërtimi i njohurive të reja - Diamanti 4				
Në këtë fazë, mësindhënësi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë tekstin “Karakteristikat e poetikës së tregimit dhe romanit” në librin e tyre dhe të plotësojnë rubrikat me elementet karakteristike të fragmenteve.				



Pas përfundimit të detyrës, secili grup prezanton punimet e tij me një nxënës përfaqësues.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje - Diagrami i Venit

Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre, detyrat e ndara nga mësimdhënësi/ja.

Grupi i parë – Karakteristikat e përgjithshme të tregimit dhe të romanit.


Grupi i dytë – Tiparet e romanit, duke i dalluar konkretisht te romani “Të mjerët”.

Grupi i tretë – Radhitni tiparet e tregimit, duke i vënë re konkretisht te tregimi i Mopasanit “Gjerdan”.

Mësimdhënësi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme. Pastaj, të gjithë reflektojmë rreth tekstit.

Pjesa përfundimtare: Pas reflektimit, nxënësit udhëzohen për plotësimin e Diagramit të Venit.

Romani - tregimi - “Të mjerët” - “Gjerdani”



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).


Detyrat dhe puna e pavarur

Ndaluni të përshkrimi i personazheve që ndodhen te romani “Të mjerët” dhe te tregimi “Gjerdani”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti letrar		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: identifikon trishtimin në të cilin është zhytur personazhi.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Në stuhi			
Fjalët kyçe: trishtim, stuhi, plogështi, gotë, qelq, kravatë, anije, Titanik			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon tiparet kryesore të tregimit; - njuh mënyrën e bashkëbisedimit të personazheve të Pashkut; - kupton stilin modern të tregimit të Pashkut. Kriteret e suksesit: - shkruan onomatopetë që përdor A. Pashku në tregim; - komenton dialogun e personazhit kryesor të tregimit; - analizon elementet tradicionale ndërthur që Pashku në tregimin modern “Në stuhi”.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela,			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Pjesa hyrëse: Stuhi mendimi Në këtë fazë, Mësimdhënësi/ja përmes bashkëbisedimit reflekton nga ora e kaluar dhe shtron pyetjen: A jeni ndier ndonjëherë të pafuqishëm përballë ndonjë situatë? Në vazhdim, cakton një nxënës që të shkruajë në tabelë të gjitha përgjigjet që kanë dhënë nxënësit dhe diskutojnë bashkërisht rreth tyre. Pjesa kryesore: Ndërtimi i njohurive të reja - Diamanti 4 Në këtë fazë, Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë në librat e tyre biografinë e autorit Anton Pashku dhe veprat e autorit i shkruajnë në tabelë. Në vazhdim udhëzon nxënësit të lexojnë në tekst tregimin “Në stuhi” dhe pastaj të diskutojnë dhe plotësojnë rubrikat me elementet karakteristike të tregimit.			



Pas përfundimit të detyrës, secili grup prezanton punimin e vet me një nxënës përfaqësues.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje-Diagrami i Venit

Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre detyrat e ndara nga mësimdhënësi/ja.

Grupi i parë – Kuptojmë tekstin: 1, 2, 3.

Grupi i dytë – Analizojmë tekstin: 4, 5, 6, 7.

Grupi i tretë – Gjuha e tekstit: 8, 9.

Grupi i katërt – Interpretojmë tekstin: 10, 11, 12.



Grupi i pestë – Reflektojmë rreth tekstit: 13, 14.

Mësimdhënësi/ja ndihmon nxënësit nëse është e nevojshme. Pastaj të gjithë reflektojmë rreth tekstit.

Pjesa përfundimtare: Pas reflektimit, nxënësit udhëzohen për Diagramin e Venit.

Onomatope - Krahësim

Standarde - Dialektore



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).


Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni dhe komentoni në klasë për ndonjë tregim tjetër të Pashkut, që ka motive popullore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti letrar		Rezultati i të nxënit të temës: Njih rëndësinë e veprimeve të arsyeshme dhe përgatitet për situata jetësore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Vdekja e nëpunësit			
Fjalët kyçe: Teatri i Operas, portier, teshtimë, falje, Shkëlqesia e tij, funksionarët, vartësinë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon dialogët dhe monologët në tregim; - njih personazhet tregimit të Çehovit; - kupton rëndësinë e vlerave njerëzore. Kriteret e suksesit: - shkruan në fletore bisedën e Çervjakovit dhe Brizalovit; - komenton tiparet kryesore të Çervjakovit dhe Brizalovit. - analizon momentin tragjik të vdekjes së Çervjakovit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Pjesa hyrëse: Stuhi mendimi, bashkëbisedim Në këtë fazë, mësimgdhënësi/ja përmes bashkëbisedimit shpjegon biografinë e shkrimtarit Anton Çehov dhe vlerën e veprave të tij në letërsi. Veprat e autorit i shkruan në tabelë. Në vazhdim shtron pyetjen: A jeni ndier ndonjëherë në faj për ndonjë veprim të paqëllimshëm tuajin? Nëse po, argumentoni mendimin tuaj. Argumentet e tyre, nxënësit i shkruajnë në tabelë. Pjesa kryesore: Ndërtimi i njohurive të reja - Diamanti 4 Në këtë fazë, mësimgdhënësi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë në librat e tyre tregimin “Vdekja e nëpunësit”, të autorit Anton Çehov dhe mbajnë shënime. Në vazhdim plotësojnë rubrikat me elementet kryesore të tregimit.			



Pas përfundimit të detyrës, secili grup prezanton punimet e tij me një nxënës përfaqësues.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje-Diagrami i Venit

Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre detyrat e ndara nga mësimdhënësi/ja.

Grupi i parë – Kuptojmë tekstin: 1, 2, 3.

Grupi i dytë – Analizojmë tekstin: 4, 5, 6, 7.

Grupi i tretë – Interpretojmë tekstin: 8, 9, 10.

Grupi i katërt – Gjuha e tekstit: 11, 12, 13, 14.



Grupi i pestë – Reflektojmë tekstin: 15, 16.

Mësimdhënësi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme. Pastaj të gjithë reflektojmë rreth tekstit.

Pjesa përfundimtare: Pas reflektimit, nxënësit udhëzohen për Diagramin e Venit.

Çervjakovi – Brizalovi

Përlulje - Respekt



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Luani në role këtë pjesë, duke u përpjekur të transmetoni botën e brendshme të personazheve të saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti letrar		Rezultati i të nxënit Nxënësi/ja: - dallon dhe krahason rëndësinë e luftëtarëve besnik me tradhtinë e luftëtarit të pabesë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. Shkathtësitë e komunikimit - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. Vlerat dhe qëndrimet III. Aftësitë dhe shkathtësitë IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Krastakraus			
Fjalët kyçe: Fusha e Oranikut, arenë, Koloseu, beteja e Torviolit, tradhtari, ushtar, luftë, shigjeta, hark lavdie, Judë, i pabesë, liri.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon emrat e vendeve ku zhvillohen luftimet mes ushtarëve shqiptarë dhe turq; - njeh ndjenjën e krenarisë historike dhe kombëtare gjatë shekujve; - dallon virtytin e luftëtarit historik dhe vesin e personazhit tradhtar.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Mësimdhënësi/ja mund t’u drejtohet nxënësve: Ju si shoqe dhe shokë keni një periudhë të gjatë kohore së bashku, dhe natyrisht njiheni mirë, dhe në situata të mira, ndoshta edhe të këqija, ju keni qenë bashkë. Gjithsesi, secili prej jush ka patur nevojë për njëri-tjetrin, për ndihëm dhe këshillën e njëri-tjetrit. Në vazhdim, mësimdhënësi/ja shtron pyetjen: Ju kujtohet ndonjë ngjarje, e cila mund t’ju ketë lënë mbresë për sjelljen apo qëndrimin për të cilin ndoshta pastaj jeni ndier keq dhe menjëherë mund ta keni ndryshuar? Reflektoni në dyshe nëse keni për të treguar ndonjë ngjarje të veçantë që ju ka ndodhur dhe që mund t’ju ketë bërë të ndryshoni mendimin apo edhe të pendoheni për sjelljen apo qëndrimin tuaj. A do të kishit dëshirë ta ndanit me shokët/shoqet e klasës dhe ta prezantoni?			

Nxënësit do të reflektojnë në dyshe dhe do të prezantojnë ngjarjet apo ndodhitë të cilat mund t'i kenë përjetuar dhe pastaj të jenë penduar për sjelljen e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Për të realizuar me sukses këtë njësi mësimore, mësimdhënësi/ja duhet ta organizojë mësimdhënien në dy orë mësimi. Për orën e parë përdor teknikën DRTA- të lexuarit e drejtuar për të vazhduar më pastaj në orën e dytë me teknikën Marrëdhënia pyetje-përgjigje.

Mësimdhënësi/ja shkruan në dërrasë të zezë titullin e njësisë mësimore “Krastakraus” dhe fillon të shpjegojë se kjo pjesë është shkëputur nga romani “Krastakraus” të shkrimtarit shqiptar Bilal Xhaferri. Pasi nxënësit marrin informacionin rreth krijimtarisë letrare të shkrimtarit, mësimdhënësi/ja ndan klasën në 3 grupe. Secilit grup i caktohet pjesa që do të lexojnë. Pas leximit grupet do të kenë detyrë të përgjigjen në pyetjet të ndërtuara në mënyrë grafike më parë nga mësuesi/ja (mësuesit mund të përgatisin më parë fleta të bardha ku do të kenë formuluar pyetjet dhe tabelën.

Vende reale?	Personazhe historike?	Ngjarje historike?

Grupi I – do të lexojë dhe reflektojë për pjesën e parë që fillon nga fillimi deri te “– I dukej si një shenjë oguri dhe sikur gjatë këtyre dymbëdhjetë vjetëve luftërash të pandërprera, atdheu kalonte gjithnjë nën një ylber shigjetash, nën atë hark lavdie....”

Grupi II – do të vazhdojë leximin nga: “Ky kujtim i largët, i mbuluar nga tymi dhe pluhuri i Berati, tani këtu në fushën e Oranikut atij iu duk përsëri një shenjë oguri.” deri te - “... Tradhtia! Ah sikur të mund ta shtypja me dhëmbët e mi kokën e këtij gjarpri!” ...

Grupi III – fillon nga - “... Strezi kish urdhër t’i mbante të tijat jashtë përleshjes.”, deri në fund.

Pas përfundimit të leximit të pjesës, nxënësit do të paraqesin para shokëve/shoqeve mendimet dhe idetë e tyre.

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit mund të shpjegojë dhe zbërthejë fjalët e panjohura për të cilat nxënësit mund të mos kenë njohuri.

Pjesa përfundimtare:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Puno në dyshe/Shkëmbe mendime

Mësuesi/ja drejton vëmendjen e klasës drejt diskutimit pro dhe kundër rreth çështjes.

Tradhtia është një akt, i cili mund të sjellë përfitime vetjake, por dëmton interesat e shoqërisë a të kombit. Diskutoni rreth kësaj çështjeje dhe listoni në tabelë elementet kryesore.

Shqiptarët	Tradhtia	Turqit

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Përshkruani me disa fjali një personazh historik.

Gjeni dy romane të tjera, që përshkruajnë ngjarje të periudhës së Skënderbeut.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit: Nxënësi/ja: dallon dhe krahason personazhin fantastik në përrallë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Njësia mësimore: Tre vëllezërit dhe e bukura e dheut			
Fjalët kyçe: tre vëllezërit, e Bukura e Dheut, plaka, mbreti, kordha, kuçedra, lufta, nëna.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon veprimet pozitive të personazheve; - njuh mënyrën e rrëfimit të përrallës; - dallon virtytet e tri personazheve (tre djemve). Kriteret e suksesit: - komenton mënyrën se si bëhen bashkë tre djemtë e rinj: Kordha, Ylli, Deti; - shpjegon dhe diskuton dialogun e tre djemve me mbretin, me plakën dhe Të bukurën e dheut; - analizon portretin moral të Kordhës, Yllit dhe Detit që në ditë të vështira i gjenden pranë njëri-tjetrit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Pjesa hyrëse: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Mësimdhënësi/ja mund t’u drejtohet nxënësve: Ju si shoqe dhe shokë keni një periudhë të gjatë kohore së bashku, dhe natyrisht njiheni mirë; në situata të mira dhe ndoshta edhe të këqija, ju keni qenë bashkë. Gjithsesi secili prej jush ka patur nevojë për njëri-tjetrin, për ndihmën dhe këshillën e njëri-tjetrit. Në vazhdim, Mësimdhënësi/ja shtron pyetjen: Ju kujtohet ndonjë ngjarje, e cila mund t’ju ketë lënë mbresë për sjelljen apo qëndrimin për të cilin ndoshta pastaj jeni ndier keq dhe menjëherë mund ta keni ndryshuar? Reflektoni në dyshe nëse keni për të treguar ndonjë ngjarje të veçantë që ju ka ndodhur dhe që mund t’ju ketë bërë të ndryshoni mendimin apo edhe të pendoheni për sjelljen apo qëndrimin tuaj. A do të kishit dëshirë ta ndanit me shokët/shoqet e klasës dhe ta prezantoni?			

Nxënësit do të reflektojnë në dyshe dhe do të prezantojnë ngjarjet apo ndodhitë të cilat mund t'i kenë përjetuar dhe pastaj të jenë penduar për sjelljen e tyre.

Pjesa kryesore:

Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Për të realizuar me sukses këtë njësi mësimore, mësimdhënësi/ja duhet ta organizojë mësimdhënien në dy orë mësimi. Për orën e parë përdor teknikën DRTA- të lexuarit e drejtuar për të vazhduar më pastaj në orën e dytë me teknikën marrëdhënia pyetje-përgjigje.

Mësimdhënësi/ja shkruan në dërrasë të zezë titullin e njësisë mësimore “Tre vëllezërit dhe e bukura e dheut” dhe fillon të shpjegojë rëndësinë që kanë përrallat në letërsinë shqipe, por edhe te vetë ne. Pasi nxënësit marrin informacionin rreth krijimtarisë letrare të përrallës, mësimdhënësi/ja ndan klasën në 3 grupe. Secilit grup i caktohet pjesa që do të lexojnë. Pas leximit, grupet do të kenë detyrë të përgjigjen në pyetjet të ndërtuara në mënyrë grafike më parë nga mësuesi/ja (Mësuesit/et mund të përgatisin më parë fleta të bardha ku do të kenë formuluar pyetjet dhe tabelën:

Cilat janë tri elemente që i bëjnë vëllezërit të pamposhtur?	Cilat janë veprimet e Kordhës që e frikësuan kuçedrën?	Ku e kishte fuqinë Kordha?

Grupi I – do të lexojë dhe reflektojë për pjesën e parë që fillon nga fillimi deri te – “...I rrëfyon edhe këta të tyret, e u pushtuan të tre, e u puthën si tre vëllezër të vërtetë, dhe lidhën besë që si do t'u ngjanjë puna, të vdesin bashkë.”

Grupi II – do të vazhdojë leximin nga: “Kështu pra, muarrën të tre e duke ecur, vajtën pranë një qyteti ku kishte edhe mbret, i cili ato ditë kishte çarë një hendek...” deri te “Vajti pak më tej, e gjeti kuçedrën me gjashtë këlysh mb'udhë, e cila iu derth ta hajë...”

Grupi III – fillon nga “Duke pritur më tej, iu duk atij pallati I së bukurës së dheut e tek ecte udhën për në pallat, gjeti një krua mb'udhë edhe qëndroi pakëz te kroi...” deri në fund.

Pas përfundimit të leximit të pjesës, nxënësit do të paraqesin para shokëve/qeve mendimet dhe idetë e tyre. Mësuesi/ja së bashku me nxënësit mund të shpjegojë dhe zbërthejë fjalët e panjohura për të cilat nxënësit mund të mos kenë njohuri.

Pjesa përfundimtare:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Puno në dyshe/Shkëmbe mendime

Mësuesi/ja drejton vëmendjen e klasës drejt diskutimit pro dhe kundër rreth çështjes.

Në përrallat shqiptare rëndom dominon edhe personazhi femër. Shkruani veçoritë dalluese të tri personazheve femra në tabelën e mëposhtme.

Nëna	Plaka	E bukura e dheut

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Në përrallë përmenden disa numra që janë tipikë për krijimet popullore, veçanërisht numri tre. A dini përralla tjera, në të cilat ky numër ndeshet më shpesh?

Cili është mesazhi më i rëndësishëm që përcjell kjo përrallë?

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit: Nxënësit: shohin një sekuençë filmike të Harri Poterit, pjesën ku Harri Potter mund trashëgimtarin e Gjarpërblertit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Njësia mësimore: Harri Potter mund trashëgimtarin e Gjarpërblertit			
Fjalët kyçe: Foksi, kapela që flet, shkopi magjik, shkolla “Hogwarts”, gjakpërzier, jetim, shpatë argjendi, shtatore, gjarpri i stërmadh,			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon personazhin pozitiv nga ai negativ; - njuh situatën e ndeshjes së personazheve në një luftë të pabarabartë për jetë a vdekje; - dallon fuqitë mbinatyrore në raste kur ndihma e tyre është në të mirën e individit. Kriteret e suksesit: - komenton mënyrën si komunikojnë Harri dhe Ridlli; - shpjegon dhe diskuton format dhe mjetet që përdor Harri për vetëmbrojtje nga gjarpri gjigant; - analizon mënyrën se si vinë në ndihmë të Harri Poterit, Kapelja që flet dhe Feniksi i Urtimorit në momente kur po e sulmonte për vdekje Basilisku.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”,Fleta të bardha, marker, tabela. Projektori, laptop.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore: Pjesa hyrëse: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Rrahje mendimesh Mësimdhënësi/ja mund t’u drejtohet nxënësve dhe i udhëzon të shohin pjesën filmike të Harri Potter. Në vazhdim në pika të shkurtra shpjegon biografinë e autores së librit “Harri Potter” Xhoan K. Rouling dhe informon nxënësit për suksesin e padiskutueshëm që kanë në botë seria e librave të saj. Shkruan në tabelë serinë e librave “Harri Potter”. Mësuesi/ja shtron pyetjen: Pasi shikuat pjesën e filmit, a keni vërejtur përdorimin e mjeteve magjike që u përdorën gjatë përleshjes? Nëse po, cilat janë ato? Një nxënës i shkruan në tabelë emrat e mjeteve magjike.			

Pjesa kryesore:

Ndërtimi i njohurive të reja: DRTA/Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Për të realizuar me sukses këtë njësi mësimore, mësimdhënësi/ja duhet ta organizojë mësimdhënien në dy orë mësimi. Për orën e parë përdor teknikën DRTA-të lexuarit e drejtuar për të vazhduar më pastaj në orën e dytë me teknikën marrëdhënia pyetje-përgjigje.

Mësimdhënësi/ja shkruan në dërrasë të zezë titullin e njësisë mësimore “Harri Poter mund trashëgimtarin e Gjarpërblertit” dhe fillon të shpjegojë se kjo pjesë është shkëputur nga romani “Harri Poter dhe dhoma e të fshehtave” të shkrimtares Angleze Xhoan K. Rouling. Pasi nxënësit marrin informacionin rreth krijimtarisë letrare të shkrimtares, mësimdhënësi/ja ndan klasën në 3 grupe. Secilit grup i caktohet pjesa që do të lexojnë. Pas leximit, grupet do të kenë detyrë të përgjigjen në pyetjet të ndërtuara në mënyrë grafike më parë nga mësuesi/ja (Mësuesit/et mund të përgatisin më parë fleta të bardha ku do të kenë formuluar pyetjet dhe tabelën).

A janë takuar edhe herë të tjera Ridlli dhe Harri?	Identifikoni elementet që i japin romanit karakter fantastik?	Cilat teknika përdor shkrimtarja për të krijuar situatë të tensionuar?

Grupi I – do të lexojë dhe reflektojë për pjesën e parë që fillon nga fillimi deri te: “E dinte ç’po ndodhte, e merrte me mend, gati – gati i dukej se e shihte gjarprin e stërmadh duke u zhdredhur nga goja e Gjarpërblertit.”

Grupi II – do të vazhdojë leximin nga: “Harri u pengua.” deri te: “...E mbërtheu dhëmbin që po i përhapte helmin në trup dhe e shkuli nga krahu.”

Grupi III – fillon nga: “Por ishte vonë, e dinte. – Foksi, ti je?” deri në fund.

Pas përfundimit të leximit të pjesës, nxënësit do të paraqesin para shokëve/qeve mendimet dhe idetë e tyre.

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit mund të shpjegojë dhe zbërthejë fjalët e panjohura për të cilat nxënësit mund të mos kenë njohuri.

Pjesa përfundimtare:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Puno në dyshe/Shkëmbe mendime

Mësuesi/ja drejton vëmendjen e klasës drejt diskutimit pro dhe kundër rreth çështjes.

Kanë kaluar shumë vite dhe Ridlli vazhdon ta urrejë Harri Poterin. Si mendoni, me kalimin e viteve, zbehen apo forcohen ndjenjat?

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Përshkruani me disa fjali një personazh historik.

Gjeni dy romane të tjera, që përshkruajnë ngjarje të periudhës së Skënderbeut.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme të përrallës, personazhe fantastike dhe filma fantastik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Krahasoni i heronjëve të përrallës me heronjtë e filmave fantastikë			
Fjalët kyçe: Krahasonim, heronjë, përralla, fantastike, film, letërsi gojore, zhanre,			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - Dallon dhe krahason personazhet e përrallave me personazhet e filmave fantastik - Njeh kupton dallimin mes dy grupeve të personazheve. - Identifikon vjetërsinë e përrallave dhe krahason faktin kur është zhvilluar filmi. Kriteret e suksesit: - Komenton dhe diskuton rreth protagonistit Kordha dhe protagonistit Harri Poter. - Shkruan personazhet që janë në përralla dhe personazhet në filma fantastikë (zana, princesha, dragonjë, njëbrireshi dhe kalorësit me forca të jashtëzakonshme, magjistarët) - Analizon faktin se përrallat janë ndërtime të vjetra gojore, ndërsa filmat fantastik janë krijime me të reja			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Në këtë fazë mësuesi-ja pyet nxënësit: Kur shikoni filma fantastik, personazhet e tyre me kë ju ngjasojnë? Veprimet e tyre a mund të realizohen edhe në jetën e përditshme apo vetëm në përralla? Nxënësit-et përgjigjen në pyetje dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi-ja. Pastaj shpjegon pjesën para leximit.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim- Ditari dypjesësh- Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë mësuesi-ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Krahasimi i heronjëve të përrallës me heronjtë e filmave fantastik” pastaj, lexon pjesën e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend me zë dhe gjatë leximit të ndajnë krahasimet e pëlqyera për ti komentuar. Pas leximit udhëzohen ti shkruajnë në fletore krahasimet e zgjedhura dhe ti komentojnë. Pastaj, disa nxënës i lexojnë këshillat e zgjedhura dhe komentojnë zgjedhjen e tyre. P.sh.:

Krahasimet e pëlqyera	Komentimi
*	*
*	*

Pastaj udhëzohen nga mësuesi-ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.

Grupi i parë – Rubrika: Përgjigjuni pyetjeve, detyra 1

Grupi i dytë – Rubrika: Përgjigjuni pyetjeve, detyra 2

Grupi i tretë – Rubrika: Përgjigjuni pyetjeve, detyra, 3

Grupi i katër – Rubrika: Përgjigjuni pyetjeve, detyra, 4

Mësuesi-ja ndihmon nxënësit/et nëse kanë nevojë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela T

Në këtë fazë udhëzohen të shprehin mendimet e tyre për temën dhe të komentojnë mendimet e tyre si mendimet pozitive po ashtu, edhe negative.

Si mendoni, a janë të vlefshme për këdo krahasimet e këtij teksti? Argumentoni mendimin tuaj.

Përgjigje pozitive	Tema (Pyetja)	Përgjigje negative

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shikoni filmin e plotë “Harri Potter” dhe personazhet e filmit, krahasoni personazhet e përrallaës “Tre vëllezërit dhe e bukura dheut”. Krahasimet e gjetura listoni në fletore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: - Analizon aspektin stilistik të shqipes; sekuenca, stili, diskurset, gjuha kritike dhe ajo kreative. - Dallon vlerën emocionale të fjalëve si leksik dhe stil.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIMET - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE:			
Njësia mësimore: Leksiku i gjuhës shqipe dhe pasuria e tij			
Fjalët kyçe: leksik, rrugë pasurimi, shtresë vetjake, shtresë e huazuar, leksik aktiv, leksik pasiv, gjuhë standarde, familje fjalësh, huazim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: - njeh rrugët e pasurimit të leksikut në gjuhën shqipe;			

- dallon shtresën vetjake dhe shtresën e huazuar të leksikut;
- shqyrton leksikun sipas mënyrës së përdorimit;
- përcakton fjalë të leksikut aktiv dhe leksikut pasiv;
- kthen një tekst të dhënë në gjuhën standarde;
- shpjegon kuptimet e fjalëve;
- ndërton familjen e fjalëve, duke pasuruar leksikun vetjak.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkumës me ngjyra, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Pema e gjuhëve.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Shoqëria dhe mjedisi,
- TIK-u.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Stuhi mendimi, Diskutim, Punë e drejtuar, Punë në grupe*

Organizimi i orës së mësimi.

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Stuhi mendimi*

Shkruhen në tabelë pyetjet. Ç'quajmë leksik të një gjuhe? Cilat janë rrugët e pasurimit të leksikut? Ku bën pjesë gjuha shqipe?

Nxënësit, nisur nga njohuritë që kanë, prezantojnë përgjigjet, të cilat paraqiten të përmbledhura në tabelë.

Ndërtimi i njohurive të reja: *diskutim*

Shkruhet tema e mësimi në tabelë dhe udhëzohen nxënësit që të lexojnë materialin në krye të faqes. Diskutohen çështjet e paraqitura në tekst.

1. Shtresa vetjake e leksikut (fjalët e fondit autokton)

2. Shtresa e huazuar e leksikut (marrja e fjalëve dhe e shprehjeve nga një gjuhë tjetër)

Rrugët e huazimit: pushtimet e ndryshme, afërsia gjeografike, marrëdhëniet kulturore, politike, ekonomike, emigrimi

3. Rrugët e përfitimit të fjalëve të reja (fjalëformimi, huazimi)

4. Shqyrtimi i leksikut sipas mënyrës së përdorimit (masës së përdorimit, marrëdhëniet me normën letrare)

Nxiten nxënësit që të shoqërojnë mendimet me shembuj nga teksti.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e drejtuar, punë në grupe.*

Hapi III. (punë e drejtuar) 1. Nxënësit do të përpiqen që ta rishkruajnë tekstin e dhënë në gjuhën standarde.

Ata që presin barin me drapinj dhe kosa të shkurtra, posare për livadhe me gur në bjeshkën e Cukalit, janë njerëz të heshtun (heshtur) dhe vetëm në dukje të qetë: dhimba (dhimbja) u bren kocat (kockat) natën e i kap si pika në mëngjes në muskuj e gjymtyrë, kur sjellin së pari (për herë të parë) rreptas hekurin në bar. Në parzmin (kraharorin) e leshtë, u fshehet (fshihet) frika e gjarpnit (gjarprit), që pret tue njehë (të njohë) në ritëm afrimin e krismës së drapnit (draprit) në tërfojë (tërfil). Mbledhësit e barit flejnjë (flenë) në vapën e ditës mbështetë (mbështetur) për (në) trungun e ahut nën hije e shohin andrra (ëndrra) syçelë. Ma (Më) i riu i zgjoi njëherë e u tregoi atë që kishte gjetë (gjetur), diçka të gdhendun, (gdhendur) gungë e madhe ngjyrë ashti, (ngjyrëvjollcë) rrashtën (samarin, zhguallin) e breshkës e mbi atë gjarpnin (gjarprin) dredha-dredha, gjithçka të bamun (bërë) gurë! Mirë, - thanë ata, - na e dimë qëmoti se nëma (mallkimi) i/e Orëve ndërron në shkamb (shkëmb) çdo gja (gjë) edhe bariun me tufë përpara, po puna ashtë: si erdhi breshka deri këtu, kaq nalt (lart)?

(Martin Camaj, “Dranja”)

Ndihmohen nxënësit aty ku kanë vështirësi.

Hapi II (*Punë në grupe*) Klasa ndahet në tri grupe.

Grupi 1. Ushtrimi 1. Familja e fjalëve

emër	emëroj, emëruar, i emëruar, i paemëruar -emërim, mosemërim, emërtim, mosemërtim, emërues, joemërues, emëror, emërmadh, emërshuar, emërharruar
çel	çelur, i çelur, i paçelur, çelës,
shteg	shtegtoj, shtegtuar, shtegës, shtegti, shtegtim, shtegtar, i shtegtuar, i pashtegtuar, shtegtues

Grupi 2. Ushtrimi 2 (me ndihmën e fjalorit):

internet: sistemi i rrjeteve kompjuterike të ndërlidhura që përdor TPC/IT (Suita e Protokollit të Internetit);

celular: 1. aparat i vogël telefonik që mbahet me vete, aparat komunikimi për telefoninë e lëvizshme, i lidhur me rrjetin telefonik të tokës, nëpërmjet stacioneve të ndryshme të komunikimit;

tastiera: 1. mjet për futjen e të dhënave në kompjuter, bën pjesë në njësinë e pjesëve hyrëse të kompjuterit;

2. tastiera muzikore, tërësia e tasteve të pianos, fizarmonikës;

3. tërësia e tasteve në një makinë shkrimi, ose radio me tastierë;

dekoder: një pajisje elektronike që konverton sinjale nga një formë në tjetrën (si për shkyçjen e një transmetimi televiziv);

korruption: mitmarje (në shqip), sistem i bazuar te ryshfeti, dhënia e dhuratave për qëllime të caktuara, përfitim i pamërituar i diçkaje, duke shkelur ligjin;

integrim: 1. përfshihem diku, bëhem pjesë e një strukture (në shqip)

2. bashkoj ose shkrij në një njësi të vetme pjesët apo anët e diçkaje në një të tërë.

Grupi III. Nxënësit do të hartojnë një listë fjalësh që përdorin çdo ditë dhe që mendojnë se janë të huazuara.

Prezantimi i përgjigjeve të ushtrimeve, përmes një përfaqësuesi. Nxënësit e tjerë mund të plotësojnë, ose qortojnë gabimet e shokëve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit nisur nga pjesëmarrja e tyre gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen vlerësimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 4, sipas kërkesës në fletore. Ushtrimi 5, në fletë formati.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: tregon pozitën e shqipes si gjuhë indo-evropiane brenda trungut gjenealogjik gjuhësor; dallon gjuhën standarde nga dialektet dhe zbaton normën gjuhësore në të folur e në të shkruar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për mjedisin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Dialektet e gjuhës shqipe			
Fjalët kyçe: dialekt, variant gjuhësor, krahinë, gegërisht, toskërisht, e folme.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon dialektet e gjuhës në tekste të ndryshme; - përdor dialektet e gjuhës për qëllime të ndryshme; - përdor dialektet e duhura në një situatë të caktuar; - gjen elementet përbërëse të dialekteve të dhënë; - dallon të përbashkëtat e të veçantat mes dialekteve; - argumenton mbi rëndësinë e përdorimit të dialekteve.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
- gjeografi, histori, art figurativ, edukim qytetar.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Stuhi mendimesh, diagrami i Venit, informacione shtesë.


Organizimi i orës së mësimin

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

- Mësimdhënësi/ja paraqet hartën para nxënësve, kërkohet të gjejnë pjesën veriore dhe pjesën jugore të trojeve shqiptare. Nxënësit/et shprehin mendimet me njohuritë që kanë, disa prej tyre e sqarojnë duke treguar përmes hartës se ku gjenden këto dy pjesë dhe lumin Shkumbin, i cili ndan dialektet e shqipes: gegërishten dhe toskërishten. Pastaj veçojmë disa krahina dhe të folmet e tyre.
- Dialekti është një variant i gjuhës që përdoret nga folës të një treve të kufizuar ose nga folës të një shtrese shoqërore të veçantë. Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore: gegërishten dhe toskërishten.

Ndërtimi i njohurive të reja: Diagrami i Venit

- Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësi/et të lexojnë informacionin për dialektet e shqipes në libër, pastaj komentojnë njohuritë e reja.
- Kërkohet të lexojnë tekstet e mëposhtme dhe përcaktoni se cili prej tyre i përket dialektit të Veriut dhe cili dialektit të Jugut. Gjeni ndryshimet ndërmjet tyre.
- Dialekti gegë përdoret në të djathtë të rrjedhës të lumit Shkumbin. Pra, deri në Vermosh brenda kufijve të Shqipërisë, në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore dhe në pjesën jugperëndimore të Malit të Zi.
- Dialekti toskë përdoret në të majtë të lumit Shkumbin. Pra, deri në Konispol brenda kufijve të Shqipërisë, dhe në të folmet çame në Greqi deri në gjirin e Prevezës.
- Nxënësit/et në diagramin e Venit paraqesin të veçantat dhe të përbashkëtat e dialekteve të shqipes.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Informacione shtesë

- **Ushtrimi numër 1**, mësimdhënësi/ja punon bashkë me nxënësit/et, si: Plotësoni diagramin e Venit për të gjetur të përbashkëtat dhe dallimet mes të folmeve dialektore dhe dialektit. Diskutohet me klasën.

- **Ushtrimi numër 2**, punohet individualisht pastaj në çifte këmbëjnë punimet, vlerësojnë punën e bërë, komentohen në grupe, prezantohen në tabelë dhe shkruhen shembujt sipas kërkesës, përgjigjen nxënësit e klasës për ushtrimet 1,2 qortojnë gabimet me ndihmën e mësimehdhënsit/ës. Jepet forma e drejt e përdorimit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim motivues me fjalë e shprehje gjatë orës. Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimi të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive. Gjithashtu, nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 3, Mblidhni fjalë dialektore të zonës suaj (duke pyetur të afërmit dhe të moshuarit) dhe përbri secilës prej tyre shënoni shpjegimin në gjuhë standarde.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: “Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë të mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim, jo vetëm me paanësi, por dhe të sillemi ashtu. Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthimet e shtypit. Ashtu qoftë!” Faik Konica “Gjuha shqipe është një gjuhë e fuqishme dhe e bukur që duhet të jetë krenaria e folësve të saj dhe një mjet i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të vjetër shqiptar”. Holger Pedersen - tregon pozitën e shqipes si gjuhë indo-evropiane brenda trungut gjenealogjik gjuhësor; - dallon gjuhën standarde nga dialektet dhe zbaton normën gjuhësore në të folur e në të shkruar.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik			

III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Gjuha standarde, roli dhe rëndësia e përdorimit të saj
Fjalët kyçe: gjuha standarde, gjuha letrare, dialekte.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - diskuton rreth historikut të gjuhës standarde; - analizon rëndësinë e përdorimit të gjuhës standarde.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit. Emil Lafe “Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare”. Mahir Domi, “Konferenca e ortografisë”. – “Nëndori”, Tiranë, 1954, nr. 1, http://www.radiokosovaelire.com/emil-lafe-percarja-e-gjuhes-po-vjen-prej-nje-grupi-njerezish-nga-kosova
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - histori, gjeografi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Lëviz / ndalo / krijo dyshe, Diskutim, Puno në dyshe
Hapi I. Organizimi i orës së mësimi <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:</i> Lëviz / ndalo / krijo dyshe Nxënësit do të përdorin këtë teknikë në fazën e parë të procesit mësimor. Ata do të dëgjojnë mendimet e njëri-tjetrit rreth gjuhës standarde, duke veçuar momentet më të kryesore të rrugës drejt standardizimit. Më pas, mendimet e tyre do të shkruhen në tabelë. Mësuesi shpjegon informacionin më poshtë:

Themelet e gjuhës standarde u hodhën në periudhën e Rilindjes Kombëtare. Në këtë kontekst, ngjarja më e rëndësishme ishte Kongresi i Manastirit (nëntor 1908), në të cilën u njësua alfabeti i gjuhës shqipe.

Kongresi i Manastirit i finalizoi këto përpjekje duke krijuar një alfabet, i cili është alfabeti që përdorim edhe sot. Krijimi i këtij alfabeti, do të ndiqet kronologjikisht nga disa ngjarje të rëndësishme, vendimtare për procesin e konsolidimit të standardizimit të shqipes, siç janë: Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës (1916-1917), Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968) dhe Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972).

Në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, nisi një punë e organizuar dhe sistematike për standardizimin e gjuhës shqipe. Kështu, në vitet 1948-1950, 1953-1954, 1956, u hartuan njëri pas tjetrit, disa udhëzues drejtshkrimorë që e ngritën gjithnjë e më lart kulturën gjuhësore.

Pas një pune të vijueshme shumëvjeçare, u mbledh më 24 nëntor 1972 Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Pas viteve '90, u organizuan dy konferenca ndërkombëtare ("Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot" dhe "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot"), në të cilat u diskutuan disa nga problematikat drejtshkrimore të ditëve të sotme.

Ndërtimi i njohurive të reja: diskutim

Emërtimi *gjuhë letrare* sot, po përdoret gjithnjë e më rrallë. Në vend të tij, po përdoret termi *gjuhë standarde*, e cila është modeli i përdorimit të një gjuhe. Ajo mishëron zbatimin e përpiktë të tërësisë së normave e rregullave fonetike, leksikore, gramatikore të gjuhës shqipe, që janë të detyrueshme për çdo folës të saj.

Ku përdoret gjuha standarde?



Nxënësit i ilustrojnë me shembuj mendimet e tyre

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe

Udhëzohen nxënësit të punojnë në dyshe ushtrimet e dhëna.

Ushtrimi 1 Gjeni kuptimin e fjalëve *bankina*, *karrexhata*, *korsi* në shqipen standarde.

Bankina - pjesë e rrugës e përfshirë ndërmjet kufirit të karrexhatës dhe elementit gjatësor më të afërm, trotuarit, trafikndarësit, argjinaturës, buzës së brendshme të kanalit, ose buzës së sipërme të skarpatës;

Karrexhata - pjesë e rrugës e projektuar për lëvizjen e mjeteve;

korsi - pjesë gjatësore e rrugës e kufizuar në mënyrë të përshtatshme për lejimin e kalimit të një rreshti të vetëm mjedesh.

Ushtrimi 2 Në një portal, lajmi vjen kështu:

“Punonjësit naftëtarë të Ballshit shpërthejnë dyert e Uzinës dhe kërkojnë të drejtat e tyre. Naftëtarët kanë thënë se uzina është e tyre dhe nuk ka vend këtu administratori i ri.

Ky është momenti kur naftëtarët janë konfrontuar fizikisht me administratorin e kompanisë Bylis Energy, të cilin e kanë marrë në mbrojtje forcat e sigurisë. Pas largimit të administratorit, naftëtarët kanë marshuar drejt reparteve duke u kërkuar 150 kolegeve që kanë nisur punë, që të bashkohen protestes së tyre të drejte që kërkon 1-Fillimin e punës me kontrata të rregullta, 2-Marrjen e 15 pagave të prapambetura dhe sigurimet shoqërore, 3- Zbatimin e statusit të naftëtarit

Burimi: <https://www.facebook.com/neoalb1/>

Kthejeni tekstin në shqipen standarde?

Punonjësit naftëtarë të Ballshit, shpërthejnë dyert e Uzinës dhe kërkojnë të drejtat e tyre. Naftëtarët kanë thënë se uzina është e tyre dhe nuk ka vend këtu administratori i ri.

Ky është çasti kur naftëtarët janë përballur fizikisht me administratorin e kompanisë “Bylis Energy”, të cilin e kanë marrë në mbrojtje forcat e sigurisë. Pas largimit të administratorit, naftëtarët kanë marshuar drejt reparteve duke u kërkuar 150 kolegëve që kanë nisur punë, që t’u bashkohen protestës së tyre të drejtë, e cila kërkon:

1. fillimin e punës me kontrata të rregullta;
2. marrjen e 15 pagave të prapambetura dhe sigurimet shoqërore;
3. zbatimin e statusit të naftëtarit.

Ushtrimi 3 Komentoni shprehjen:

Thënia	Komenti im
Në të vërtetë, ngulitja e normave të shkruarit drejt është një proces që përbëhet nga disa hallka, ku zotërimi i rregullave përbën hallkën fillestare. Hallka të tjera që duhet të pasojnë, janë formimi i shkathtësive dhe i shprehive të shkruarit pa gabime. Vetëm kur njohuritë për normën gjuhësore kthehen në shprehje, mund të thuhet se kemi arritur të shkruajmë dhe të flasim si duhet. (R. Memushaj, Shqipja standarde, 50)	

4. Në intervistën e gjuhëtarit Et’hem Lika, ngrihen disa probleme, të cilat janë me të vërtetë shqetësuese për të ruajtur të paprekur shqipen standarde:

1) Problem janë fjalët e huaja, që kanë hyrë prej shekujsh në leksikun e shqipes dhe janë bërë tashmë një trup me fjalët shqipe, por më problem janë fjalët e huaja, të cilat e kanë gjegjësen shqipe, por që shumica e njerëzve, as që marrin mundimin t’i zëvendësojnë ato gjatë bisedave apo dhe në të shkruar.

2) Mendimi se shqipja standarde nuk është e detyrueshme, na çon në përfundimin, që në shkollat tona, duhet të bëhet një punë e madhe për zbatimin e detyrueshëm të shqipes standarde të folur e të shkruar. Mësuesit, politikanët, punonjësit e administratës shtetërore, gazetarët nuk duhet të flasin e të shkruajnë në dialekt!

3) Gjuha standarde, mësohej vetëm në shkollën 9-vjeçare deri para dy vjetësh e këtij mbyllesj cikli. Tashmë në AMU (Arsimi i Mesëm i Lartë), është futur si lëndë më vete dhe jo e integruar me lëndën e Letërsisë, lënda “Gjuha shqipe”.

Do të ishte shumë mirë që cikli për të mësuar gjuhën standarde, të shtrihej dhe në Arsimin e Lartë, pavarësisht degës që studiohet (inxhinieri, mjekësi, farmaci, ekonomik, fizioterapi, arkitekturë etj.). Vlen të përmendet, që në testimet që zhvillohen për kualifikimin e mësuesve 5/10/20 vjeçar dhe testimet për licencim të Profesioneve të Rregulluara, janë vendosur pyetje nga “Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe”.

Informacion shtesë për mësuesin:

Në tetor 1980, Komisioni i Përhershëm për Pasurimin dhe Pastrimin e Mëtejshëm të Gjuhës Letrare Shqipe (1979-1990), ngriti grupin e punës për zëvendësimin e fjalëve të huaja dhe miratoi detyrat e tij.

Grupi skedoi propozimet e bëra për zëvendësimin e fjalëve të huaja, që nga Komisioni i gjuhësisë i Institutit Shqiptar për Studime e Arte (1944) e në vijim, i krahasoi me “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe i përpunoi në formë artikujsh, që nisën të botohen në revistën “Gjuha jonë” nga numri 2/1981 në rubrikën e posaçme e “Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj”.

Me lëndën e kësaj rubrike, më 1998 u botua vëllimi “Për pastërtinë e gjuhës shqipe. Fjalor”, që përmban rreth 620 artikuj zëra (çerdhe fjalësh), ku janë trajtuar mbi 1440 fjalë.

Komisioni u vuri detyrë shkollës dhe institucioneve botuese, që të përkrahin dhe të përhapin përdorimin e fjalëve shqipe në vend të fjalëve të huaja.

4) Mbledhja e fjalëve dhe shprehjeve popullore.

Për t’i shërbyer detyrës së pasurimit dhe pastërtisë së gjuhës, si dhe dokumentimit të leksikut popullor në tërësi, filloi më 1981, aksioni kombëtar për mbledhjen e fjalëve dhe shprehjeve popullore. Aksioni u përgatit dhe u ndoq në vijimësi nga Ministria e Arsimit dhe Instituti i Gjuhësisë, i cili hartoi një udhëzues të posaçëm metodiko-shkencor dhe mbajti lidhje me seksionet e arsimit dhe me kabinetet pedagogjike në të gjitha rrethet.

Nëpërmjet këtij aksioni në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë u grumbullua një lëndë shumë e pasur: “Fjalë e kuptime të panjohura më parë dhe shprehje frazeologjike”. Në revistat “Gjuha jonë” dhe “Studime filologjike”, nisi të botohet rregullisht rubrika “Fjalë dhe shprehje popullore”. Aksioni shërbeu edhe si një nxitje e re për të gjallëruar traditën e mëparshme në këtë fushë. Një varg fjalorësh të botuar kohët e fundit, me fjalë e shprehje nga krahinat kanë marrë shkas edhe nga ky aksion.

5) Shqipërimi, njësimi dhe përpunimi i mëtejshëm i terminologjisë tekniko-shkencore.

Kësaj fushe, Komisioni i ka kushtuar vëmendje të veçantë vijimisht. Në periudhën e pasluftës në Shqipëri arsimit i mesëm u bë masiv, u ngrit arsimit i lartë, u organizua kërkimi shkencor dhe vendi hyri në rrugën e industrializimit. Në këto rrethana, mund të thuhet që terminologjia, u bë fusha kryesore e pasurimit të fjalorit të shqipes me fjalë e kuptime të reja. Në përpunimin dhe shqipërimin e terminologjisë, krahas terminologjeve, bashkëpunuan gjuhëtarët më në zë.

Më 1984, Komisioni mori në shqyrtim studimin për shqipërimin, njësimin dhe pasurimin e terminologjisë ushtarake. Me një organizim të mirë dhe punë këmbëngulëse, në këtë fushë, u shënuan arritje të mira, duke u botuar një seri fjalorësh për armë e shërbime të veçanta, si dhe fjalorë të përgjithshëm termash ushtarakë.

6) Gjuha në shtyp dhe në radiotelevizion.

Shtypi dhe radiotelevizioni kanë ndikim të madh për ngritjen e kulturës gjuhësore dhe përhapjen e normës letrare.

Në vitin 1982, Komisioni mori në shqyrtim studimin “Mbi gjendjen dhe punën për përmirësimin e mëtejshëm të gjuhës në shtyp dhe radiotelevizion”, të përgatitur nga një grup pune. Për shtypin e shkruar, studimi vinte në dukje të metat kryesore në zbatimin e drejtshkrimit dhe të normës gramatikore, përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme, përdorimin e gabuar të disa fjalëve, të meta të ndryshme stilistike e në ndërtimin e fjalive. Për radiotelevizionin, në studim vërehej se folësit jo rrallë nuk i përmbahen tekstit të shkruar, por pasqyrojnë veçori dialektore, ose shqiptime joletrare. Organet e shtypit dhe radiotelevizioni u porositën të merrnin masat përkatëse për mënjanimin e të metave.

Gjuha e shtypit dhe e radiotelevizionit, u mor në shqyrtim përsëri nga Komisioni më 1988.

7) Gjuha e shkruar dhe e folur në arsimin e lartë.

Më 1986, Komisioni mori në shqyrtim studimin “Ligjërimi i shkruar dhe i folur në veprimtarinë e Universitetit të Tiranës”. Në këtë studim, paraqitej gjendja e zbatimit të normës letrare dhe e kulturës gjuhësore në përgjithësi në testet dhe botimet e Universitetit, më tej, gjendja e përpunimit dhe e shqipërimit të terminologjisë në lëndët mësimore, gjendja e ligjërimit të folur në procesin e mësimdhënies.

8) Gjuha e teksteve shkollore.

Më 1987, Komisioni mori në shqyrtim një studim për gjuhën e teksteve të shkollës 8-vjeçare (klasat I-IV). Për këtë studim ishin shqyrtuar mbi 2000 faqe tekste. Shkolla 8-vjeçare, dhe veçanërisht arsimit fillor, luajnë një rol të rëndësishëm për t’i aftësuar nxënësit që të fitojnë shprehitë e zbatimit të normës letrare. Gjuha e teksteve përbën modelin gjuhësor që ndikon drejtpërdrejt në formimin gjuhësor të tyre. Në studim, vërehet se në përgjithësi tekstet e vëzhguara janë një shembull i mirë për thjeshtësinë dhe për pastërtinë e gjuhës, është punuar me pikësnyime të caktuara për të mënjeluar fjalët e huaja të panevojshme dhe për të përhapur fjalën shqipe.

9) Gjuha e skenës dhe e ekranit.

Nisur nga ndikimi i gjuhës së folur në veprimtaritë artistike për kulturën gjuhësore në përgjithësi, Komisioni në dhjetor 1982, mori në shqyrtim studimin “Për gjendjen e gjuhës në skenë dhe në ekran” dhe shtroi detyra për përmirësimin e mëtejshëm të saj.

10) Gjuha e administratës shtetërore.

Komisioni mori në shqyrtim që në vitin 1982 zbatimin e normës letrare në veprimtarinë e administratës shtetërore, sidomos në pushtetin vendor dhe në institucione e ndërmarrje ekonomike. U caktuan detyra për kualifikimin gjuhësor të sekretareve, daktilografisteve, arkivisteve nëpërmjet kurseve.

11) Kualifikimi shkencor i redaktorëve dhe korrektorëve letrarë.

Me porosi të Komisionit pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, u organizua më 1982, një kurs për kualifikimin e redaktorëve e të korrektorëve letrarë, sipas një programi të posaçëm të drejtuar nga mësues të gjuhës.

Burimi: Emil Lafe, Gjuha Shqipe, Pasurimi i gjuhës shqipe.

Mahir Domi, “Konferenca e ortografisë” – Nëndori, Tiranë, 1954, nr. 1, f. 142-144.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për punën hulumtuese, për kthimin e teksteve në shqipen standarde etj.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Gjeni në median vizive, 5 gabime të shqipes standarde.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: - Dallon vlerën emocionale të fjalëve si leksik dhe stil. - Pasuron fjalorin përmes krijimit të fjalëve të reja dhe futjes në përdorim të fjalëve dialektore me vlera domethënëse e shprehëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Interpretim, Punë në dyshe (Të nxënit me këmbime), Shpjegim i lidhur me diskutimin, Punë e pavarur, Koment.			
Njësia mësimore: Huazimet. Shmangia e tyre			
Fjalët kyçe: huazim: leksikor, fjalëformues, sintaksor, fjalë e huaj, gjegjëse shqip.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon fjalët e huaja në një tekst të dhënë; - njeh dukurinë e huazimit leksikor;			

- njeh huazime nga gjuhë të ndryshme, që janë bërë pjesë e leksikut të gjuhës shqipe;
- dallon huazimet në fjalëformim dhe huazimet në sintaksë;
- ndërgjegjësohet për të ruajtur pastërtinë e gjuhës shqipe;
- dallon dhe zëvendëson fjalën e huaj me gjegjësen në gjuhën shqipe në tekste të ndryshme.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkumës me ngjyra, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Pema e gjuhëve.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Shoqëria dhe mjedisi,
- TIK-u.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Interpretim, Punë në dyshe (Të nxënës me këmbime), Shpjegim i lidhur me diskutimin, Punë e pavarur, Koment.*

Organizimi i orës së mësimi.

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit:

Hapi I. Nxënësit recitojnë poezi të njohura për gjuhën shqipe (Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Ismail Kadare).

Hapi II. Orientohen nxënësit te fjalitë e paraqitura në krye të faqes 225. Udhëzohen, që në dyshe, të nënvizojnë ato fjalë, të cilat ata i nuk i kuptojnë. Lexohen fjalët e gjetura nga nxënësit dhe paraqiten në tabelë.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Shpjegim i lidhur me diskutimin*

Bëhet e njohur tema mësimore dhe përcaktohen në tabelë çështjet që do të trajtohen:

- Dukuria e huazimit leksikor
- Huazime nga gjuhë të ndryshme
- Huazime në fjalëformim
- Huazime në sintaksë
- Shmangia e huazimeve

Nxënësit do të lexojnë në heshtje informacionin e paraqitur në tekst.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur.*

Ushtrimi 1 (punohet në libër)

Fjalë e huaj	Fjalë shqip
Agresiv	I egër
Ingredient	Përbërës
Obligim	Detyrim
Dominoj	Mbizotëroj
Performancë	Paraqitje
Merkato	Treg
Kortezi	Delikatesë, mirësjellje
Ilegal	I paligjshëm, joligjor
Kreativ	Krijues

Ushtrimi 2. Një nxënës/e punon në tabelë, kurse klasa në fletore. Mblidhen disa fletore për t'u vlerësuar. Fjalë të ndërtuara me:

- parashtesë shqipe + fjalë të huaj: rikuperim, jolegal, pakontestueshëm
- parashtesë e huaj + fjalë e huaj: destabilitet, disavantazh, dispozicion

fjalë shqipe + fjalë e huaj: bashkekzistencë, kundërofensivë,

fjalë e huaj + fjalë e huaj: *low cost, play off, facebook*

Vihet për diskutim në klasë termi “huazim”. Nxënësit paraqesin mendimet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen dhe motivohen vlerësimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 5, sipas kërkesës në fletore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: njuh mënyrën e të rrëfyerit të teksteve fantastike, zhvillon imagjinatën dhe të menduarit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Udhëtim për në qendër të Tokës			
Fjalët kyçe: shpella, deti, botanist, kocka kafshësh, kërpudha, shkëmbinj titanikë, ujëvara, planet, Uran, Neptun.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: • zotëron gjuhën dhe zhvillon imagjinatën; • njuh mënyrën e dialogëve në tekst; • dallon bukurinë e natyrës të përshkruar në tekst dhe kupton rëndësinë e universit.			
Kriteret e suksesit: • komenton bisedën e Akselit dhe xhaxhait të tij; • diskuton rreth zbulimeve dhe asaj çka sheh në natyrë Akseli; • analizon rëndësinë e udhëtimit të Akselit dhe qetësinë që ndien ai pas këtij udhëtimi.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh

Në këtë fazë mësuesi/ja pyet nxënësit: A keni udhëtuar në vende, të cilat ju kanë bërë përshtypje? Nëse po, listoni disa nga karakteristikat e atyre udhëtimeve.

Nxënësit/et përgjigjen në pyetje dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi-ja.

Pastaj shpjegon pjesën para leximit.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim - Ditari dypjesësh - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Udhëtim për në qendër të Tokës” të autorit Zhyl Vern. Pastaj, lexon pjesën e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend me zë dhe gjatë leximit të ndajnë këshillat e pëlqyera për t’i komentuar. Pas leximit udhëzohen t’i shkruajnë në fletore të gjitha elementet që e mahnitin Akselin dhe pjesët e zgjedhura dhe t’i komentojnë. Pastaj, disa nxënës i lexojnë elementet e mahnitshme dhe i komentojnë zgjedhjen e tyre. P.sh.:

Elementet e mahnitshme që sheh Akseli	Komentimi
*	*
*	*

Pastaj udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3, 4, 5

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 6, 7, 8

Grupi i katër - Interpretojmë tekstin, detyrat 9, 10

Grupi i pestë - Reflektojmë rreth tekstit, detyrat 11, 12

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et, nëse kanë nevojë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela T

Në këtë fazë udhëzohen të shprehin mendimet e tyre për temën dhe të komentojnë mendimet e tyre si mendimet pozitive, po ashtu edhe negative.

Si mendoni, a janë të vlefshme udhëtimet në vende të ndryshme? A mësojmë prej udhëtimeve? Argumentoni mendimin tuaj.

Përgjigje pozitive	Tema (Pyetja)	Përgjigje negative

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur
Përshkruani një udhëtim drejt vendit ku ëndërroni të shkoni, si dhe personat me të cilët do të donit ta ndërmerrnit këtë udhëtim.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekste fantastike		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të urrejtjes, zemërimit dhe luftënxitjes, por kupton mënyrat se si mund të eliminohen këto elemente negative, me mirësi dhe pozitivitet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Udhëtimi i gjatë i Geri Hopit			
Fjalët kyçe: verrotë, fiderbë, djali i Shëronjëses, sëmundje, barna, armiqësi, tatuazhe, pajtim, falje, luftëtarë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - njih dhe kupton konfliktin e grupeve në tekst; - dallon vështirësinë e situatës jetësore të personazheve; - identifikon mençurinë e dy të rinjve dhe veprimet pozitive që ndërmarrin ata.			
Kriteret e suksesit: - komenton armiqësinë që kishin dy popujt Verrotë dhe Fiderbët; - shkruan qëllimin e udhëtimit të Geri Hopit; - analizon mënyrën e bashkimit të Geri Hopit me Anila Obradetin dhe pajtimin e dy popujve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh

Në këtë fazë mësuesi/ja pyet nxënësit: A ju ka ndodhur që për arsye të ndryshme të keni pasur hasmëri apo urrejtje dhe e keni pasur të vështirë t'i tejkaloni barrierat?

Nxënësit përgjigjen në pyetje dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi/ja.

Pastaj shpjegon pjesën para leximit.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim - Ditari dypjesësh - Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Udhëtimi i Geri Hopit” të autores Roberta Rizzo pastaj, lexon pjesën e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend me zë dhe gjatë leximit të ndajnë këshillat e pëlqyera për t'i komentuar. Pas leximit, udhëzohen t'i shkruajnë në fletore fjalitë që shprehin mesazh. Pastaj, disa nxënës i lexojnë mesazhet e zgjedhura dhe komentojnë zgjedhjen e tyre. P.sh.:

Mesazhi	Komentimi
*	*
*	*

Pastaj udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.

Grupi i parë – Kuptojmë tekstin, detyrat: 1

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat: 2, 3, 4, 5

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat: 7, 8

Grupi i katër – Interpretojmë tekstin: 9, 10, 11

Grupi i katër – Reflektojmë rreth tekstit, detyrat: 12, 13

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse kanë nevojë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela T

Në këtë fazë udhëzohen të shprehin mendimet e tyre për temën dhe të komentojnë mendimet e tyre si mendimet pozitive po ashtu, edhe negative.

Si mendoni, a janë të vlefshme për këdo mesazhet që përcjell teksti? Argumentoni mendimin tuaj.

Përgjigje pozitive

Tema (Pyetja)

Përgjigje negative

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruani një ese me temë: “Natyra ka mrekulli, burime dhe energji për të gjithë, mjafton ta respektojmë atë.”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti letrar		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shndërrimi i doktor Xhekillit			
Fjalët kyçe: Dr. Xhekilli, laborator, shndërrim, zbulim, shkencor,bar, Eduard Haidi.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon personazhin real dhe atë imagjinar; - njuh mënyrën e rrëfimit si formë e veçantë e romanit; - dallon virtytin nga vesi, të mirën nga e keqja. Kriteret e suksesit: - Komenton veprimet e Dr. Xhekillit për t’u shndërruar në Eduard Haidi. - Shpjegon dhe komenton bashkëbisedimet që Dr. Xhekilli i bënë me veten e tij (Eduard Haidi) - Analizon tiparet e personazhit Dr. Xhekilli dhe Eduard Haidit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lojë, bisedë e kombinuar me argumentim, shkrim i lirë, pyetje-përgjigje, minileksion, punë me tekstin, shënime paraprake, diskutim i lirë, punë në dyshe. Pjesa hyrëse (Lojë me sy mbyllur. Ngrihet një nxënës në tabelë dhe i mbyllin sytë. Ai duhet të gjejë emrin e një nxënësi tjetër sipas përshkrimit të tipareve dhe karakterit).			

Në fillim të orës, mësuesi/ja njofton nxënësit për organizimin e lojës dhe i njeh ata me mënyrën se si do të luhet.

Ngrihet një nxënës në tabelë dhe i mbyllet sytë. Nga klasa ngrihet një nxënës tjetër dhe përshkruan nga pamja e jashtme njërin nga shokët e tjerë. Nxënësi me sytë e mbyllur duhet ta njohë dhe ta gjej emrin e tij. Luhet kështu për disa nxënës.

Nëpërfundim të lojës, nxënësit diskutojnë duke radhitur arsyet e gjetjes, apo tëmos gjetjes së shokëve/shoqeve që u përshkruan.

U kërkohet nxënësve që në formën e një shkrimi të lirë të përshkruajnë veten sipas tabelës:

Unë

Isha

Jam

Pamja fizike

Bota e brendshme

Nxënësit punojnë për të përshkruar veten dhe lexohen disa punime duke diskutuar edhe mes shokësh për vërtetësinë e përshkrimit.

Mësuesi/ja drejton pyetje për nxënësit, në formën e rikujtimit të njohurive dhe lidhjes me temën e re:

- Çfarë lloj teksti është kur përshkruajmë shokun apo veten? *(tekst përshkruues)*
- Cilat janë format e përbëra të rrëfimit në prozë? *(romani, novela, tregimi)*
- Cilat janë veçoritë e tekstit përshkruues? *(përshkruan pamjen dhe karakteristikat e personave, kafshëve, vendeve, etj.)*
- Nga dallon teksti përshkruues nga ai rrëfimtari? *(sepse të tekstit rrëfimtari, tregohen/rrëfëhen ngjarje që lidhen me një, apo disa personazhe)*

Pjesa kryesore: minileksion, punë me tekstin, shënime paraprake.

Mësuesi/ja sqaron: Personazhet e trilluara - Janëpersonazhe, të cilat autori i përshkruan si personazhe në jetën reale.

Me anë të imagjinatës, këto personazhe përshkruhen si krijesa fantastike, por qëpërfaqësojnë ide dhe ndjenja të ndryshme. Personazhi i trilluar, lë mbresa dhe është tërheqës për pamjen dhe tiparet e tij të veçanta. Një personazh i tillë, është edhe Doktor Xhekilli.

Kjo pjesë është shkëputur nga romani “Çështja e çuditshme e Dr. Xhekillit dhe e Z. Haid”. Këtu rrëfëhet për një eksperiment që Dr. Xhekilli realizon në trupin e tij. Ai merr një substancë, të cilën e kishte krijuar vetë. Kur e pi, ai pëson një shndërrim të çuditshëm, kthehet në një njeri krejt të ndryshëm, në Z. Haid.

Thuhet se ideja për shkrimin e këtij teksti, autorit i ka ardhur nga një ëndërr e tmerrshme.

Punohet me tekstin duke e lexuar me kujdes. Nxënësve u lihen disa minuta për t’iu rikthyer tekstit dhe të rilexojnë nënvizimet që kanë bërë gjatë leximit të parë të tekstit, mbi fjalët dhe veprimet e doktor Xhekill.

Lexohen shënimet mbi veprimet dhe pamjen e doktor Xhekill, mbi shndërrimin e tij dhe ritregohet shkurtimisht teksti në formën e punës zinxhir.

(Eduard Haidi ishte shumë më i vogël, më i dobët dhe më i ri se Henri... e keqja ishte shkruar gjerësisht dhe qartë në fytyrën e tjetrit. Përveç kësaj, kishte lënë mbi atë trup një gjurmë shformimi dhe kalbësire)

(Por tundimi për një zbulim aq të veçantë e të thellë, më në fund i mposhti këshillat e maturisë)

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim i lirë, punë në dyshe.

Punohet me ushtrimet e tekstit mbi të kuptuarit e pjesës. Diskutohen me radhë ushtrimet.

Ushtrimi 1

- Cili është vendi ku zhvillohen ngjarjet dhe pse është zgjedhur pikërisht ky vend? *(në laborator)*

- A ishte e rrezikshme ajo që bëri Dr. Xhekilli? *(po, sepse nuk e dinte çfarë e priste dhe nëse mund të kthehej përsëri në gjendjen e mëparshme)*

- Cilat janë personazhet e kësaj pjese? *(Dr. Xhekilli)*

- Kush është Eduard Haidi? Ç' lidhje ka Z. Haid me Dr. Xhekillin? *(sepse është Dr. Xhekilli pas shndërrimit).*

- Pse i duhet Dr. Xhekillit pasqyra në laborator? *(që të shihte shndërrimin)*

- Si ka qenë jeta e Dr. Xhekillit deri në momentin e eksperimentit? *(E virtytshme)*

Çfarë synonte eksperimenti i dytë i bërë nga Dr. Xhekilli? *(nëse mund të kthehej ashtu siç ishte në fillim, në veten e tij me karakterin e Henri Xhekillit)*

Ushtrimi 2. *(në ndryshime të pamjes së jashtme dhe të botës së brendshme)*

Ushtrimi 3. Shndërrimi që ndodh është rruga drejt: *(së keqes).*

A ka kthim pas shndërrimit, në drejtim të anasjellë? - *Po*

Ushtrimi 4. Në këtë pjesë, rrëfimtari: *(është vetë pjesëmarrës në ngjarje).*

Çfarë vlere i shton tekstit kjo mënyrë të rrëfyeri? - *(E bën ngjarjen të duket më e vërtetë).*

Ushtrimi 5. Gjeneri ndryshimet mes Doktor Xhekillit dhe Zotit Haid - *(Eduard Haidi ishte shumë më i vogël, më i dobët dhe më i ri se Henri; shkëlqente e mira mbi fizionominë e njërit, e keqja ishte shkruar gjerësisht dhe qartë në fytyrën e tjetrit)*

Ushtrimi 6. Punohet në grupe dyshe duke rikujtuar njohuritë për tekstet me mister.

a- *pirja e një lëngu, ilaçi, kërcitje të kockave, shndërrim fizik e shpirtëror.*

b- *laboratori, mëngjes i errët, korridoret.*

c- *Doktor Xhekill, një njeri i moralshëm, por që shndërrohet në një njeri të keq, në Eduard Haidin.*

Ushtrimi 7. Vargonjtë e detyrimeve = *ana morale*

Ushtrimi 8. *(Rrëfimi nis me folje për të treguar intensitetin e veprimeve që po përjeton autori)*

Pjesa përfundimtare

Diskutim i lirë: *Komente rreth personazhit real dhe fantastik.*

Komente rreth njohjes së vetes

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Përshkruani situatën imagjinare, në të cilën ju mund të silleni dhe veproni sikur të mos kishit asnjë kufizim apo detyrim.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekstet e misterit			Rezultati i të nxënit të temës: Dallon (krahason) tiparet e rrëfimit fantastik nga ai realist.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Maska e Murtajës së Kuqe				
Fjalët kyçe: shkretot, epidemi, fatale, damkë, të fortifikuara , shije ekscentrike, kudhër, palaço, pehlivan, halucinacion, delirant, ebantë, qefin, konvulsion, blasfeme, solemn, impuls, burracakëri.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore				
Nxënësi/ja: - diskuton për kohën, vendin, ngjarjen, duke dhënë detaje nga teksti; - identifikon tiparet e tekstit të misterit; - analizon tiparet e personazheve; - zbërthen mesazhin e pjesës lidhur me realitetin e sotëm.				
Kriteret e suksesit: Debaton për personazhet, duke u ndalur në çdonjërin prej tyre. Analizon shprehjet e figurshme dhe mesazhin që përcjell pjesa. Krahason realitetin në kohë pandemie me ngjarjen e pjesës.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker (shjenjues), tabela.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.				
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Mësuesi/ja mund t’u drejtohet nxënësve me këtë pyetje: Si e kuptoni fjalën “mister”: si diçka reale, shumë e bukur, e mirë, që mund të na ndodhë, apo si diçka që ne e imagjinojmë, por nuk mund të ndodh në të vërtetë?				

Nxënësit do të japin mendimet e tyre. Mësuesi/ja apo një nxënës/e shënon në tabelë në formën e pemës së mendimeve sugjerimet dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i drejtuar

Ndahet pjesa në fragmente nga mësuesi/ja dhe lexohet me ndalesa nga nxënësit.

Ndalesa e parë: Lexohet fragmenti nga “Murtaja e kuqe kishte kohë...” deri te “...s’kalonte më shumë se gjysmë ore”.

Më pas, nxënësve u drejtohen pyetjet: (Ushtrimi 2)

- Me cilin lloj letrar ju ngjan fragmenti që sapo lexuat? *Ky fragment ngjason me përrallën.*

- Ç’elemente gjejmë në fillim të këtij fragmenti, që janë karakteristike edhe për përrallën? *Hyrja e paragrafit: “Murtaja e kuqe kishte kohë që shkretonte vendin”, ashtu si në përralla, ngjarjet kanë një të kaluar të hershme.*

Vendi dhe koha, të papërcaktuara, ashtu si në përrallë. Murtaja e Kuqe, sëmundje që del në formën e një personazhi.

- Cila është pritshmëria juaj për pjesën tjetër të tekstit?

Ndalesa e dytë: Lexohet fragmenti nga “Ama princ Prosperoja...” deri te “Jashtë ishte Murtaja e Kuqe”.

Më pas, nxënësve u drejtohen pyetjet: (Ushtrimi 1) (Ushtrimi 4 / Ushtrimi 8)

- Çfarë e bën princin Prospero dhe pasuesit e tij të futen në një manastir? *Epidemia e Murtajës së kuqe.*

- Cilat ishin simptomat e shfaqjes së Murtajës së Kuqe? *Të zinin dhembje therëse, marramendje të befta e më pas, shpërthim gjaku nga pore, me shpërbërje të trupit. Njollat e përsququra mbi trup e në veçanti në fytyrën e viktimës, ishin shenjat kryesore të sëmundjes.*

- Sa miq mori princi në manastir? *Një mijë shokë të gjallë e gazmorë.*

- Si e kalonin kohën princi Prospero dhe oborrtarët e tjerë? *Me argëtime të ndryshme.*

- Pse princi mendon se aty është i sigurt? *Sepse manastiri ishte një ndërtim gjigant dhe madhështor. Një mur i fortë e i lartë e qarkonte. E ky mur, dyert i kishte të hekurta.*

- Si i kuptoni fjalitë e mëposhtme?

Me këto masa, oborrtarët mendonin të sfidonin epideminë. Bota jashtë le të bënte ç’të donte. Ndërkohë, ishte

budallallëk të dëshpëroheshe, ishte budallallëk të mendoje. Princi kishte menduar për çdolloj qejfi.

Në këto fjalë, del në pah indiferentizmi, egoizmi dhe papërgjegjshmëria e princit. Ai duhet të shqetësohej dhe kujdesej për të gjithë popullsinë, por në të vërtetë, ai tregoi se angazhimi i tij i vetëm ishte të shpëtonte veten dhe miqtë e tij.

- Gjeni në tekst shprehjen që tregon arrogancën e princit Prospero ndaj pjesës tjetër të popullsisë. *Bota jashtë, le të bënte ç’të donte.*

Ndalesa e tretë: Lexohet fragmenti nga “Andej nga fundi i muajit të pestë...” deri tek “Ëndrrat ngrinë aty ku i zuri”.

Më pas, nxënësve u drejtohen pyetjet: (Ushtrimi 1) (Ushtrimi 2)

- Kur e organizoi princ Prosperoja ballon me maska që përshkruhet në tekst? *Andej nga fundi i muajit të pestë a të gjashtë, qe kur hynë..*

- Ç’pamje kishte figura e maskuar që u shfaq papritmas në mes të ballos me maska? *Figura qe e gjatë dhe e hollë, e përçar nga koka te këmbët, me qefinin e të vdekurit. Maska që fshihte fytyrën, ishte aq e ngjashme me një fytyrë kufome dhe kishte pamjen e të vdekurit nga Murtaja e Kuqe.*

- Çfarë efekti shkaktonte sahati i ebantë te mysafirët e princit? *Kur sahati i ebantë bie, për një çast, gjithçka hesht, gjithçka rresht...*

- Në çfarë pjese të manastirit përballet princi me figurën e tmerrshme që ishte shfaqur në festë? Në fundin e apartamentit të kadifenjtë.

Ndalesa e katërt: Lexohet fragmenti nga “Dhe prandaj ndoshta ndodhi...” deri tek “... u kthye befas dhe përballoi ndjekësin”.

Dhe nxënësve u shtrohen pyetjet: (Ushtrimi 3 / Ushtrimi 5 / Ushtrimi 6)

- Rendit ngjyrat e dhomave sipas radhës: *blu; e purpurt; jeshile; portokalli; e bardhë; vjollcë; e kadifenjtë*

Gjej sa ngjyra janë gjithsej. 7 ngjyra.

- Si ishte gjendja emocionale e princit Prospero para se të futej në manastir (*ama princ Prosperoja mbetej i lumtur, sfidues dhe i mençur*) dhe gjatë pesë a gjashtë muajve brenda tij (*i sigurt*). Përshkruani ndryshimin emocional, kur në festë shfaqet prania e qenies së maskuar. (*U tmerrua, u nervozua, u turpërua.*)

- Tregimet e Posë karakterizohen nga përshkrime të frikshme dhe të mistershme. Gjeneri në tekst elementet që e bëjnë këtë prozë të klasifikohet si tregim misteri.

kuqëlimi dhe llahtaria e gjakut - elemente që krijojnë mister.

figurë e maskuar, kështjella e izoluar, halucinacione delirante, veshje e njollosur me gjak.

Ndalesa e pestë: Lexohet fragmenti në tekst nga: “U dëgjua një britmë e mprehtë...” deri në fund.

Më pas, nxënësit punojnë ushtrimet 7 dhe 9.

7. Lidhni me shigjetë simbolin me shpjegimin e tij.

Ora - ngjyrat e ylberit

Numri shtatë - vdekja

Murtaja e Kuqe - koha që ikën

Manastiri - mburoja

Oborrtarët - servilizëm

9. Princi Prospero vdes në fund si shumë të tjerë që ishin jashtë manastirit. Mesazhi që përcjell rrëfimtari me vdekjen e këtij njeriu të pasur dhe të fuqishëm është: Me para, nuk mund të blesh gjithçka. Diskutoni rreth mesazhit.

Ndërtimi i njohurive të reja: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

A ju pëlqejnë librat me mister? Çfarë efekti shkaktojnë ata te ju?

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Përshkruani krijesën e paftuar në manastir, duke ruajtur misterin me të cilin paraqitet në tekst. Shkruani një ese me temë: “Jeta vlen më shumë se gjithçka”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë, për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Anës liqenit. Nata po afrohet. Drita e ditës tretet ngadalë e mbi tjegullat e shtëpive, mbi dërrasat e rrugëve, mbi fletët e pemëve, mbi trupat e epëta të çupave që shkojnë, një ngjyrë manushaqe - një ngjyrë gushëpëllumbi, si thonë në ca malet tona, - shtrihet e i mbështjell. Mbasandaj, pak nga pak manushaqet shfletohen. Hijet bëhen më të dendura, më të zeza. Njëri mbas tjetrit, yjet shpojnë qiellin e pikëlojnë dritë. Nata u afrua. Nata erdhi. • analizon aspektin stilistik të shqipes; sekuenca, stili, diskurset, gjuha kritike dhe ajo kreative; • dallon vlerën emocionale të fjalëve si leksik dhe stil.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Regjistrat e gjuhës
Fjalët kyçe: regjistri i zakonshëm, regjistri i thjeshtë, regjistri i ngritur, tipare, komunikim i folur, komunikim i shkruar.
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon regjistrat e gjuhës në tekste të ndryshme; - përdor regjistrat e gjuhës për qëllime të ndryshme; - përdor regjistrin e duhur në një situatë të caktuar; - gjen elementet përbërëse të regjistrit të dhënë; - dallon të përbashkëta e të veçantat mes regjistrit të thjeshtë e të zakonshëm; - argumenton mbi rëndësinë e përdorimit të regjistrit të lartë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, “Anës liqenit”, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: - Shoqëria dhe mjedisi
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: <i>Diskutim, analizë rasti, pyetje-përgjigje, ditari tripjesësh, punë me tekstin, puno/shkëmbje, rrjeti i diskutimit.</i>
Organizimi i orës së mësimin Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim, analizë rasti, pyetje-përgjigje. Në fillin të orës bëhet kontrolli dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë. Diskutohen me radhë duke argumentuar mbi përgjigjet e dhëna. Lidhja me situatën: Mësuesi/ja citon tekstin e zgjedhur për situatën dhe u kërkon nxënësve të jenë të vëmendshëm, për të gjetur elementet e tekstit si: gjuha e zgjedhur dhe lloji i tekstit. Nxënësit duhet të gjejnë disa epitete, metafora. Gjithashtu, nxënësit duhet të theksojnë se gjuha është e zgjedhur për të krijuar imazhe dhe kënaqësi të lexuesit. Leksiku i përdorur nga autori, është i pasur.
Mësuesi/ja drejton pyetjet: 1- Po çfarë kuptojmë me leksik? 2- Sa fjalë përmban fjalori i gjuhës shqipe? 3- Çfarë ndodh me listën e fjalëve të një gjuhe? 4- Sa fjalë mund të përdorë një njeri gjatë jetës së përditshme? 5- Kur na nevojitet një numër më i madh fjalësh? Përgjigjet e nxënësve: 1- Me leksik kuptojmë tërësinë e fjalëve dhe të shprehjeve të një gjuhe. 2- Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006 përmban rreth 48.000 fjalë. 3- Lista e fjalëve dhe e shprehjeve të një gjuhe është gjithnjë e hapur, sepse ekziston gjithnjë mundësia, që për nevoja të komunikimit, të shtohen fjalë të reja. 4- Njeriut mund t’i shërbejë një sferë e vogël e leksikut (jo më shumë se 400-800 fjalë) për komunikimin e përditshëm. 5- Në rastet e dhënies dhe të marrjes së mesazheve më të ndërlikuara, leximi i teksteve të ndryshme, nevojitet një bagazh leksikor prej 4000-5000 fjalësh. Për shkrimtarët apo studiuesit e ndryshëm, ky numër është më i lartë. Ndërtimi i njohurive të reja: Ditari trepjesësh, punë me tekstin.

Teksti, që citohet nga mësuesi/ja, është një prozë poetike, ku autori përdor fjalët e zgjedhura, sintaksën e fjalisë dhe figuracionin e ngjeshur për të përcjellë imazhet dhe ndjesitë e tij. Sipas situatave të ndryshme të komunikimit, në secilën prej tyre përdorim me vetëdije regjistra të ndryshëm gjuhësorë. Përgjithësisht, këta regjistra mund të klasifikohen në tri grupe kryesore: regjistër i zakonshëm, i thjeshtë dhe i ngritur.

Mësuesi/ja ndërton në tabelë një ditar tre pjesësh, në të cilin sqarohen regjistrat e gjuhës, tiparet dalluese dhe shembuj të thjeshtë. Lexohet teksti dhe dallohen llojet e komunikimit: 1- i folur; 2- i shkruar.

Regjistri	Tipare dalluese	Shembuj
Regjistri i thjeshtë	Forma mbizotëruese është dialogu. Fjalitë të shkurtra dhe të paplota, mungojnë gjymtyrë të ndryshme, madje edhe kallëzuesi. Përdoren togje të gatshme, apo dialekt. Pasthirrmat si: <i>uau, bo-bo, që thua ti, po pra, ehu</i> , etj. Shprehja e habisë, çudisë, ironisë me anë të intonacionit, etj. Gjestet dhe mimika që shoqërojnë komunikimin.	Hajt shnet! Ehu dhe ti! Varja! Ç'ia fut kot! E mban në tako. Ka marrë superxhiro. U hahet muhabeti. Çun për së mbari.
Regjistri i zakonshëm	Shprehet në mënyrë të plotë funksioni komunikues i gjuhës. Forma kryesore e realizimit është dialogu. Folësit e ndërtojnë komunikimin pa përgatitje paraprake. Bëhet kujdes të respektohen normat e gjuhës letrare. Mbizotërojnë temat e jetës së përditshme. Parapëlqehen trajtat e thjeshta, fjalitë e paplota, togjet e gatshme për komunikim. Mbizotërimi i formave veprorë kundrejt atyre pësore.	Si kalon? T'u bëfsha kurban! Puna mirë? Gëzuar qofshi! Sa harxhove për pajisjet që ndërrove? Çfarë thuhet për reformën e re? Kujdes grykën e shishes! Mos i përplas buzët!
Regjistri i ngritur	Kemi të bëjmë me monolog, por nuk përjashtohen edhe format e ndryshme të dialogut. I kushtohet vëmendje e veçantë përpunimit të saj. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit. Ndërtimet emërore janë më të shpeshta se ato foljore. Përdoren gjerësisht lokucionet lidhëzore, etj. Për nga përmbajtja, i kushtohet vëmendje përpunimit të mendimit dhe shtjellimit të tij. U kushtohet vëmendje rregullave të logjikës formale.	Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, për periudhën 2014 - 2020. Këtu s'do jem, do jem larguar, në tokë i tretur si të tjerët. Në kafenenë e preferuar, nuk do më shohin më kamerierët.

Gjatë plotësimit të ditarit, jepen edhe shembuj të tjerë nga nxënësit.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Puno/shkëmbe, rrjeti i diskutimit.

Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe dyshe me njëri-tjetrin për të plotësuar ushtrimet e tekstit. Punohen me radhë ushtrimet dhe diskutohen zgjidhjet e tyre.

Ushtrimi 1. Në regjistrin e zakonshëm, dallojmë këto tipare:

Forma kryesore e realizimit të tij, është dialogu. - Saktë

Kërkon një përgatitje të gjatë paraprake. - Gabim

Nuk respektohen medoemos normat e gjuhës letrare. - Saktë

Për nga përmbajtja, mbizotërojnë tema nga shkencat ekzakto. - Gabim
Fjalitë janë zakonisht të paplota. – Saktë

Ushtrimi 2. Dalloni pohimin e saktë nga ai i gabuar.

Në regjistrin e thjeshtë, dallojmë këto tipare:

U kushtohet vëmendje e veçantë formës dhe përmbajtjes së ligjëritimit. - Gabim

Përdoret kryesisht në rrethana formale dhe mes të panjohurish. - Gabim

Nuk këshillohet që gjatë të folurit të përdoren gjeeste dhe mimikë, apo luhatje intonacioni në fjali. - Gabim

Gjejnë përdorim të dendur format dialektore. - Saktë

Ushtrimi 4. Përgjigjet: kardiologu, bëra provim në lëndën e kimisë, pije ilaçin.

Diskutohet mes nxënësve për përgjigjet e sakta.

Ora e mësimit, mbyllet me theksimin e rëndësisë së përdorimit të regjistrin të lartë dhe argumentimin e përdorimit të saktë të gjuhës shqipe.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim motivues me fjalë e shprehje gjatë orës. Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimin të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive. Gjithashtu, nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 3, sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Planeti ynë Toka është planeti i tretë i sistemi tonë diellor. Toka është rreth 4,57 miliardë vjet e vjetër dhe i vetmi planet në sistemin tonë diellor ku është zhvilluar jeta. Toka ka satelit natyror vetëm Hënë. Nxënësi/ja: • analizon aspektin stilistik të shqipes; sekuenca, stili, diskurset, gjuha kritike dhe ajo kreative; • dallon vlerën emocionale të fjalëve si leksik dhe stil.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie.

II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Stilet e gjuhës

Fjalët kyçe: regjistër gjuhësor, fusha, tipare, stili shkencor-teknik, stili juridiko-administrativ, stili politiko-shoqëror, stili i letërsisë artistike.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- dallon fushat në të cilat realizohet komunikimi;
- përcakton stilet e gjuhës së përdorur në tekste të ndryshme, letrare dhe joletrare;
- bën dallimet mes stileve të ndryshme të përdorur në tekste letrare dhe joletrare;
- nxjerr veçoritë e secilit stil.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale rreth planetit tonë të përgatitura nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, punë me tekstin, ditarët e të nxënit, punë në grupe, puno/shkëmbe.

Organizimi i orës së mësimimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Pyetje-përgjigje, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim.

Mësuesi/ja në fillim të orës kontrollon detyrat e shtëpisë ku nxënësi duhet të krijonte dy tekste me titull: “Ndihem qytetar i botës”, por që t’i përkisnin regjistrave të ndryshëm.

Lexohen disa detyra dhe diskutohet rreth tyre duke përsëritur njohuritë e mëparshme.

Nxënësve u drejtohen pyetje si:

- *Sipas situatave të ndryshme të komunikimit, sa regjistra gjuhësorë kemi?*
- *A mund të përmendni nga një veçori të secilit regjistër?*
- *“O malet e Shqipërisë dhe ju o lisat e gjatë”, cilin regjistër i përket?*

Nxënësit përgjigjen duke plotësuar njëri-tjetrin e duke plotësuar me shembuj nga regjistra të ndryshëm.

Përgjigje të mundshme për regjistrat dhe veçoritë:

Regjistri i thjeshtë - Përdoren togje të gatshme, apo dialekt.

Pasthirrmat si: uau, bo-bo, që thua ti, po pra, ehu, etj.

Shprehja e habisë, çudisë, ironisë, me anë të intonacionit etj.

Regjistri i zakonshëm - Bëhet kujdes të respektohen normat e gjuhës letrare.

Mbizotërojnë temat e jetës së përditshme.

Regjistri i ngritur - I kushtohet vëmendje e veçantë përpunimit të saj. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit.

“O malet e Shqipërisë dhe ju o lisat e gjatë” i përket regjistrit të ngritur.

Mësuesi/ja bën lidhjen me situatën duke sqaruar se komunikimi realizohet sipas fushave të caktuara.

Ligjërimi strukturohet dhe përshtatet në varësi të nevojave që mbulon e gjithë veprimtaria në një fushë të caktuar dhe kështu krijohen stilet përkatëse për secilën fushë.

Mësuesi/ja lexon informacionin rreth planetit tonë dhe pyet nxënësit se cilës fushë mendojnë ata se i përket.

Planeti ynë

Toka është planeti i tretë i sistemit tonë diellor. Toka është rreth 4,57 miliardë vjet e vjetër dhe i vetmi planet në sistemin tonë diellor ku është zhvilluar jeta. Toka ka vetëm një satelit natyror, Hënën. Toka peshon 6.000 miliard tonë dhe është afër 40.000 km rreth ekuatorit.

Forma elipsoide e tokës, është marrë nga dy polet e saj Veriu dhe Jugu, sepse forca e gravitetit që e kishte zbuluar shkencëtari Njuton, ushtrohet në të dy polet, pra forca gravitacionale e veriut, kundërvepron me forcën e gravitetit të jugut, ose anasjelltas. Për këtë arsye, Toka nuk ka formë plotësisht rrethore, por elipsoide. Rrethi i ekuatorit të Tokës është pak më i madh se 40.000 km. Rrezja ekuatoriale është 6.378 km, kurse ajo polare, 6.357 km.

Nxënësit japin përgjigje dhe argumentojnë shkurt mbi to.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë me tekstin, ditarët e të nxënësve.

Për të lehtësuar përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja shkruan në tabelë, fushat në të cilat realizohet komunikimi dhe stilin përkatës.

Fushat në të cilat realizohet komunikimi	Stilet përkatëse për secilën fushë
fusha e veprimtarisë shkencore e teknike	stili shkencor-teknik
fusha e veprimtarisë juridike e administrative	stili juridiko-administrativ
fusha e veprimtarisë politike e shoqërore	stili politiko-shoqëror
fusha e gjuhës dhe e krijimit artistik	stili i letërsisë artistike

Lexohet mësimi dhe nxënësit punojnë me tekstin. Jepen shembuj me tekste që përfshihen në atë stil. Shembuj:

- 1- *Stili shkencor-teknik: artikuj, botime, studime shkencore.*
- 2- *Stili juridiko-administrativ: Kushtetuta, ligje, dokumente zyrtare.*
- 3- *Stili politiko-shoqëror: gazeta, raporte, fjalime.*
- 4- *Stili i letërsisë artistike: veprat artistike si: “Kështjella”, “Tre Shokët”.*

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në grupe, puno/shkëmbe.

Te shembujt e dhënë në tekst, pas çdo stili ndalohet dhe diskutohet për tiparet dalluese dhe veçoritë e secilit stil. Nxënësit punojnë në grupe dyshe me ditarët e të nxënësve për të nxjerrë disa nga tiparet dalluese të stileve.

Stili	Tiparet
shkencor- teknik	Funksion informues. Informacioni është objektiv, me vërtetësi. Komunikimi është një monolog me karakter përgjithësues dhe abstrakt. Shmanget dykuptimësia dhe qëndrimet emocionale. Krijimi me vetëdije i një varianti të posaçëm, i ndryshëm nga rrjedha e zakonshme e gjuhës së përditshme. Teksti duhet të ketë organizim logjik, pa kundërthënie.
juridiko- administrativ	Funksion informues dhe parashkrues të këtij ligjërimi, jepen udhëzime. Gjithçka paraqitet në emër të ligjit dhe të shtetit. Ndjekje e një modeli të mirëmunduar dhe të paracaktuar në formë dhe përmbajtje. Gjuhë e drejtpërdrejtë, nuk lë rast për dykuptimësi, apo për paqartësi. Mbetet kryesisht një stil tradicional.
politiko- shoqëror	Gjuha e përdorur duhet të përmbushë funksionin informues dhe ndikues. Jo vetëm paraqiten të dhëna, mendime e qëndrime për një çështje të caktuar, por synohet të ndikohet mbi mendimet, qëndrimet dhe vlerësimet e lexuesve, ose të dëgjuesve. Jo gjithnjë informacioni është objektiv dhe në përputhje me realitetin. Qëndrimi subjektiv dhe të shprehurit emocional, janë pjesë e pandashme e këtij stili.
i letërsisë artistike	Gjuha e përdorur ka funksion estetik. Jo vetëm kumtohet diçka, por njëkohësisht, synohet të kultivohet dhe të edukohet shija estetike. Ligjërimi synon shkallën më të lartë të përpunimit artistik. Flitet për së paku dy rrafshet kuptimore, pra për mundësinë e interpretimit të shumëfishtë të një veprë letrare. Këtu fiton rol parësor, ana krijuese e autorit, organizimi individual i tekstit.

Ushtrimi 1. Nxënësit punojnë në qetësi për të nxjerrë të përbashkëtat dhe të veçantat mes teksteve të dhëna.

- E përbashkët: të katër tekstet flasin për familje.
- E veçanta: secili tekst e trajton familjen mbi bazën e qëllimit që ka teksti.
- Teksti 1 = stili shkencor-teknik
- Teksti 2 dhe 3 = Stili politiko-shoqëror
- Teksti 4 = Stili i letërsisë artistike

Ushtrimi 2. – Teksti i përket stilit shkencor-teknik.

- Jo nuk mund të shkruhet në stil tjetër, sepse është tekst me funksion informues. Informacioni është objektiv, me vërtetësi. Shmanget dykuptimësia dhe qëndrimet emocionale.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim motivues. Nxënësit do të vlerësohen me fjalë dhe shprehje për njohuritë dhe përgjigjet e dhëna rreth pyetjeve të zhvilluara mbi temën e mësimit. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësisht të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive. Gjithashtu, nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 3, sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Leksikologji		Rezultati i të nxënit të temës: Dispozitat Normative. NENI 85. Të drejta dhe detyra të nxënësve 1. Nxënësi ka të drejtë: a) të kryejë veprimtaritë e tij në institucionin arsimor në kushte të qeta dhe të sigurta për jetën dhe shëndetin; b) të trajtohet me respekt, me dinjitet, në mënyrë të kulturuar dhe të moralshme në institucionin arsimor, pa presione, pa padrejtësi, pa fyerje, pa diskriminime, pa dhunë. Nxënësi/ja: • analizon aspektin stilistik të shqipes; sekuenca, stili, diskurset, gjuha kritike dhe ajo kreative; • dallon vlerën emocionale të fjalëve si leksik dhe stil.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat dhe stilet e ndryshme në gjuhën shqipe.

Fjalët kyçe: leksikologji, komunikim, stile, regjistri, tipare, veçori.

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përcakton stilet e gjuhës së përdorur në tekste të ndryshme letrare dhe joletrare;
- bën dallimet mes stileve të ndryshme të përdorura në tekste letrare dhe joletrare;
- dallon tiparet dhe mjetet gjuhësore me të cilat shprehen stilet e ndryshme në gjuhën shqipe;
- dallon tiparet dhe mjetet gjuhësore me të cilat shprehen regjistrat e ndryshëm në gjuhën shqipe.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit “Gjuha shqipe 9”, materiale të gatshme të sjella nga mësuesi/ja.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës, arte

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Rrjeti i diskutimit, analizë rasti, termat kyçe, punë me tekstin, grupi i ekspertëve, teknika RAFT, puno/shkëmbe*

Organizimi i orës së mësimimit

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: *Rrjeti i diskutimit, analizë rasti.*

Mësimi fillon me kontrollin e detyrave të shtëpisë. Nxënësit me temën “Planeti ynë”, duhet të shkruanin katër paragrafë të ndryshëm sipas katër stileve gjuhësore.

Lexojmë disa nga detyrat dhe bëhen dallimet mes stileve të përdorura. Diskutohet me rrjetin e diskutimit pas çdo detyre për përdorimin e saktë të çdo stili duke vlerësuar njëri-tjetrin.

Mësuesi/ja prezanton përpara nxënësve Dispozitat Normative dhe lexon nenin 85 “Të drejta dhe detyra të nxënësve”.

U kërkohet nxënësve, që në këtë rast të dhënë, të dallojnë stilin e përdorur dhe veçoritë dalluese të tij.

Teksti i përket stilit juridiko-administrativ.

Tiparet dalluese të këtij stili janë:

- 1- funksion informues dhe parashkrues i këtij ligjërimit, jepen udhëzime;
- 2- gjithçka paraqitet në emër të ligjit dhe të shtetit;
- 3- ndjekje e një modeli të mirëmenduar dhe të paracaktuar në formë dhe përmbajtje;
- 4- gjuhë e drejtpërdrejtë, nuk lë rast për dykuptimësi apo për paqartësi.

Jepen nga mësuesi/ja dy raste të tjera.

1- Qielli është pjesë e atmosferës së hapësirës, e cila është e dukshme nga sipërfaqja e çdo objekti astronomik. Është e vështirë të përcaktohet për shumë arsye. Gjatë ditës, qielli në Tokë ka pamjen e një sipërfaqeje të lëmuar me ngjyrë blu të errët për shkak të shpërhapjes së dritës së diellit në ajër. Ngjyra blu e qiellit, i atribuohet faktit se molekulat e ujit kanë si tendencë të mëtojnë valë në anën e ulët të spektrit dritor, çka i përket dritës blu. (*Stili shkencor- teknik*).

2- Frika e fjalët mes qiellit gri nisen, bredhin udhëve të gjithësisë kuturu... (*Stili i letërsisë artistike*)

Ndërtimi i njohurive të reja: *Termtat kyçe, punë me tekstin, grupi i ekspertëve.*

Mësuesi/ja shënon në tabelë disa terma kyçe si: leksikologji, komunikim, stile, regjistri, tipare, veçori.

Nxënësit sqarojnë njohuritë që kanë për secilën fjalë kyçe.

Degë e gjuhësisë që studion leksikun e gjuhës.

Dhënia dhe marrja e mesazheve me anë të të folurit dhe të shkruarit.

Stilet e gjuhës: stili shkencor-teknik; stili juridiko-administrativ; stili politiko-shoqëror; stili i letërsisë artistike.

Tri lloje: regjistër i zakonshëm, i thjeshtë dhe i ngritur.

Për fjalën: tipare dhe veçori, mësuesi/ja i drejton nxënësit nga tema e re e mësimit. Nxënësit e klasës ndahen në grupe për të punuar me grupet e ekspertëve.

Secilit grup i jepet nga një tipar për t'u trajtuar me hollësi. Nxënësit punojnë me grupe për disa minuta dhe më pas nga një përfaqësues i grupit del në tabelë për të nxjerrë tiparet dhe veçoritë e gjetura nga ekspertët e grupit përfaqësues. Anëtarët e grupit në fund mund të plotësojnë shokun e tyre për të dhënë sa më qartë e saktë informacionin.

Ekspertët e stilit shkencor-teknik

- 1- Informacioni të jepet i formuluar sa më saktë, i ngjeshur dhe pa shmangie kuptimore, shumë përkufizime, formulime apo formula për dukuri abstrakte.
- 2- Fjalitë janë të zgjeruara me grupe fjalësh dhe pjesë fjalish që përgjithësisht janë në marrëdhënie nënrenditjeje mes tyre, mjete lidhëse më të ndërlikuara, si shprehjet lidhëzore.
- 3- Mbizotërojnë ndërtimet emërore përkundrejt atyre foljore.
- 4- Përdoren shumë folje të mënyrës dëftore, fjalë e shprehje, si: mund, ndoshta, përgjithësisht, etj.

Tiparet dhe mjetet shprehëse të stileve shkruhen në tabelë dhe në fund të ekspertëve bëhet një përmbledhje nga mësuesi/ja.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Teknika RAFT, puno/shkëmbe.*

Në formën e teknikës RAFT, u kërkohet nxënësve që të zgjedhin një profesion të preferuar dhe që kanë njohuri rreth tij. Mund të mbështeten te profesioni i prindërve. Nxënësit duhet të trajtojnë shkurt një temë që ka lidhje me atë profesion dhe të krijojnë një tekst të shkurtër.

Orientohen nxënësit duke u kujtuar profesione si: mësues, doktor, jurist, gazetar, shofer, mekanik etj. Për 10 minuta nxënësit punojnë të lirë për të krijuar tekstin. Lexohen disa nga punët e nxënësve duke ndaluar te tiparet gjuhësore të regjistrit të përdorur.

Punim ushtrimesh në grupe dyshe, ku të shkëmbehen përgjigjet me njëri-tjetrin.

Ushtrimi 1

Tematika e një teksti, përcakton llojin e shkrimit. - x

Ligjërimi sipas regjistrit të ngritur është më i segmentuar se ai në regjistrin e thjeshtë. - v

Ligjërimi sipas regjistrit të zakonshëm është gjithnjë në përputhje me normën letrare. - x

Një tekst pa gabime drejtshkrimore, përmbush kërkesat për tekstin e shkruar në një regjistër të ngritur. - x

Në çdo rast, folësi është i lirë të përzgjedhë regjistrin gjuhësor që parapëlqen. - x

Ushtrimi 2 - sipas kërkesës.

Ushtrimi 3 - teksti i përket stilit shkencor-teknik dhe nuk mund të rishkruhet në një stil tjetër, sepse është tekst informues.

Ushtrimi 4 - stili politiko-shoqëror.

Ndoshta është i pafat, sepse çdo fillim sezoni i duhet të rindërtojë skuadrat e tij fituese dhe shumë shpesh ia del, por në këtë sezon janë dëmtimet e shpeshta të lojtarëve, që po ia bëjnë jetën ferr, aq më shumë në përballjet e rëndësishme si ajo me Napolin, një javë më parë, apo akoma më shumë edhe në 90-minutëshin e shumëpritur nga të gjithë bardhezinjtë, si ky i mbrëmjes së sotme kundër Interit.

Ushtrimi 5 sipas kërkesës lexohen nga mësuesi/ja disa ligje nga kodi penal dhe civil.

Një rast: Neni 14

Faji. Askush nuk mund të dënohet për një veprim, ose mosveprim të parashikuar nga ligji si veprë penale, në qoftë se vepra nuk është kryer me faj. Quhet me faj, personi që e kryen veprën me dashje, ose me pakujdesi.

Ushtrimi 6 plotësohet në tekst nga nxënësit dhe diskutohen përgjigjet.

Komunikimi i folur	Komunikimi i shkruar
shoferi i makinës	drejtuesi i automjetit
doktori i zemrës	kardiologu
dhashë provim kiminë	bëra provim në lëndën e kimisë
pije hapen	pije ilaçin

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen me notë për përgjigjet e dhëna, saktësinë e plotësimin të ushtrimeve, për mënyrën e formulimit të përgjigjeve, saktësinë e njohurive. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë vetëvlerësim dhe vlerësim të njëri-tjetrit me fjalë e shprehje.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 7, sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësimin të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):			
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.			
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):			
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit			
II. VLERAT DHE QËNDRIMET			
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË			
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Vargje kushtuar mallit			
Fjalët kyçe: mall, atdhe, nëna, zemra.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore			
Nxënësi/ja:			
- rikujton poezitë për vendlindjen; - përshkruan vargjet e poezisë; - dallon poezitë me temë të njëjtë.			

Kriteret e suksesit:

- analizon figurat letrare në poezi;
- diskuton për gjendjen shpirtërore të poetëve p.sh.:

Ca pika shiu ranë mbi qelq,

Për ty unë befas ndjeva mall; I. Kadare.

- krijon/shkruan një poezi/ese me temë të njëjtë;
- reciton bukur poezinë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9 - Fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Shkrim i shkurtër

Në këtë fazë mësuesi/ja shpjegon pjesën para mësimi. Në letërsinë shqipe ka shumë vjersha, poezi, proza poetike, të cilat i janë kushtuar mallit si një dhimbje e thellë shpirtërore, në të gjitha format e shfaqjes së tij: malli për njerëzit e dashur, për vendlindjen, malli për atdheun.

Në letërsinë shqipe, malli trajtohet më shumë si temë universale (malli për jetën, dashurinë, rininë) dhe po aq si ndjesi personale për dikë që është larg fëmijës, bashkëshortit/es, apo edhe për dikë që nuk jeton më.

Pastaj nxënësit udhëzohen që të shkruajnë disa vargje kushtuar mallit.

Pas përfundimit të kohës disa nxënës i lexojnë vargjet e krijuara.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja së pari lexon poezitë e zgjedhura në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend (lexim artistik) me zë dhe pas leximit të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/ emocionet që leximi i poezive zgjoi tek ta. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre punuese detyrat nga teksti shkollor.

Grupi I: Kuptojmë tekstin, ushtrimi 1, 2, 3, 4.

Grupi II: Analizojmë poezinë, ushtrimi 5, 6

Grupi III: Interpretojmë tekstin, ushtrimi 7 dhe Gjuha e teksteve, ushtrimi, 8,9,10

Grupi IV: Reflektojmë rreth tekstit, ushtrimi 11,12

Mësuesi/ja ndihmon grupet nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ditari dy pjesësh/Citat-koment

Nxënësit janë të lirë të zgjedhin vargje nga poezia e pëlqyer dhe t'i komentojnë. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të gjejnë figurat letrare në poezinë e pëlqyer, ti nënvizojnë dhe të tregojnë përse i ka përdor autorit ato, çfarë ka arritur të zgjojë te lexuesit gjatë përdorimit të shprehjeve nostalgjike.

Vargjet/ Citati	Komenti
Po kur të jesh mërzhitur shumë, Në raft të librave kërkomë, Atje i fshehur do të jem unë Në ndonjë varg a ndonjë shkronjë.	(Komentimi i nxënësit/es)

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur
Krijoni një ese me temë “Malli për vendlindjen”, duke përshkruar ndjesitë që keni përjetuar kur keni qenë larg saj.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike);	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Malli për t’pambërritshmen			
Fjalët kyçe: Mall, ëndërr, fëmijë, realizim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Esad Mekuli; - krijon një poezi lirike me temë të njëjtë; - reciton bukur poezinë. Kriteret e suksesit: - Përshkruan një element dallues të poezisë lirike. - Analizon vargjet e krijuara për mallin. - Dallon poezitë me temë të njëjtë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9 - Fleta të bardha, marker (shënjues), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Shkrim i shkurtër

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon pjesën “Para leximit”, jetën dhe veprimtarinë e autorit Esad Mekuli. Ajo që i karakterizon në mënyrën më të veçantë njerëzit, është aftësia e tyre për të ëndërruar. Kur janë fëmijë, ëndrrat janë shumë të bukura dhe me shumë ngjyra; në rini janë më të vrullshme dhe më të guximshme; në moshën e pjekurisë, njeriu vazhdon të ëndërrojë, por më pak.

Në këtë moshë, njeriu sjell ndër mend dhe analizon ëndrrat më të bukura të jetës. Ai ndjen mall për fëmijërinë, rininë dhe veçanërisht për ëndrrat që kishte dikur, por që sot i duken të pamundura për t’u realizuar.

Pastaj mësuesi/ja shkruan në tabelë detyrën për një shkrim të shkurtër:

Përshkruani peizazhin që ju vjen në mendje më shpesh. Përse ky peizazh është kaq i veçantë për ju? Pas përfundimit të kohës, disa nxënës i lexojnë punimet e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja së pari lexon poezinë e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit që ta lexojnë me rend (lexim artistik) me zë dhe, pas leximit, të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/ emocionet që zgjoi tek ata leximi i poezisë. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre të punës detyrat nga teksti shkollor.

Grupi I : Kuptojmë tekstin, ushtrimet 1, 2.

Grupi II: Analizojmë poezinë, ushtrimet 3, 4.


Grupi III: Interpretojmë poezinë, ushtrimet 5,6.

Grupi IV: Gjuha e poezisë, ushtrimet 7, 8, 9 dhe “Reflektojmë rreth poezisë”, ushtrimi 10.

Mësuesi/ja ndihmon grupet e nxënësve, nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i Venit

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen të krahasojnë dhe të veçojnë në Diagramin e Venit poezinë e mësuar me poezinë e Lasgush Poradecit “Malli”.



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).


Detyrat dhe puna e pavarur

Krijoni një poezi me temën “Malli”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Proza poetike			Rezultati i të nxënit të temës: Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Ejani, o kujtime!				
Fjalët kyçe: shpuzë, m’arrin.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Mid’hat Frashërit; - krijon një prozë poetike me temë të njëjtë; - reciton bukur poezinë. Kriteret e suksesit: - përshekruan një element dallues të prozës poetike; - analizon vargjet e krijuara për kujtimet; - dallon poezitë me temë të njëjtë.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9 - Fleta të bardha, marker (shënjes), tabela.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.				
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kllaster Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë “Mid’hat Frashëri” dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë një kllaster me mendimet e tyre rreth këtij personaliteti. Për shembull:				



Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë së re mësimore “Ejani, o kujtime!”. Pastaj shpjegon për nxënësit pjesën para leximit dhe për autorin Mid’hat Frashëri.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia-Pyetje-përgjigje-Citat-Koment

Në këtë fazë, mësuesi/ja lexon së pari prozën poetike të zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit që ta lexojnë me rend (lexim artistik) me zë dhe, pas leximit, të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/ emocionet që zgjoi tek ata leximi i prozës poetike. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre të punës detyrat nga teksti shkollor.

Grupi I: Kuptojmë tekstin, ushtrimi 1.

Grupi II: Analizojmë tekstin, ushtrimet 2, 3, 4.

Grupi III: Interpretojmë tekstin, ushtrimet 5, 6.

Grupi IV: Gjuha e tekstit, ushtrimet 7, 8, 9 dhe Reflektojmë rreth tekstit, ushtrimi 11.

Mësuesi/ja ndihmon grupet e nxënësve, nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Në këtë fazë, nxënësit/et udhëzohen të shkruajnë një pesëvargësh për autorin.

Mid'hat Frashëri
i dashur i lumtur
shkruante botonte kritikonte
U zgjodh kryetar në Kongresin e Manastirit
Shqipëria

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni shkrimtarë të tierë shqiptarë dhe të huaj që kanë shkruar proza poetike.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: - Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike). - Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Lamtumirë!			
Fjalët kyçe: Konstelacione, Mali i Çikës.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Fatos Arapi; - krijon një shkrim të shkurtër me temë të njëjtë; - reciton bukur poezinë. Kriteret e suksesit: - Përshkruan një takim mallëngjyes. - Analizon poezinë “Lamtumirë”. - Krahason poezinë “Lamtumirë” me poezinë “Ejani, o kujtime!”.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9 - Fleta të bardha, marker (shënjeshtër), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Shkrim i shkurtër Në këtë fazë mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë mësimore në dërrasën e zezë “Lamtumirë” dhe udhëzon nxënësit të krijojnë një shkrim të shkurtër duke treguar një ngjarje personale ku lamtumira akoma është pjesë e nostalgjisë dhe e kujtimeve.			

Pas përfundimit të kohës disa nxënës i lexojnë punimet e tyre.
Pastaj mësuesi-ja shpjegon pjesën para mësimit dhe për autorin Fatos Arapi.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje - Citat-Koment

Në këtë fazë, mësuesi/ja së pari lexon poezinë e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend (lexim artistik) me zë dhe pas leximit të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/ emocionet që leximi i prozës poetike zgjoi tek ta. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre punuese detyrat nga teksti shkollor.

Grupi I: Kuptojmë poezinë, ushtrimi 1.

Grupi II: Analizojmë poezinë, ushtrimi 2, 3, 4.


Grupi III: Interpretojmë poezinë, ushtrimi 5,6.

Grupi IV: Gjuha e poezisë, ushtrimi 7 dhe Reflektojmë rreth poezisë, ushtrimi 8, 9.

Mësuesi/ja ndihmon grupet nëse është e nevojshme.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i Venit

Në këtë fazë nxënësit-et udhëzohen të punojnë në Diagram të Venit për poezinë “Lamtumirë” dhe poezinë “Ejani, o kujtime!” të autorit “Mid’hat Frashëri”.



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni shkrimtarë të tjerë të letërsisë shqipe që i kanë shkruar poezitë e tyre në varg të lirë. Lexoni në klasë, pjesë nga poezitë e tyre.

Ktheni poezinë në prozë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënit të temës: - Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike); - Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Në rrugën <i>Gjenerali Vajs</i>			
Fjalët kyçe:			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - rikujton jetën dhe veprimtarinë e autorit Rrahman Dedaj; - krijon një shkrim të shkurtër me temë të njëjtë; - reciton bukur poezinë. Kriteret e suksesit: - Përshkruan përjetimin e tij kur shikon një fëmijë duke pastruar xhamat e makinave në rrugë. - Analizon poezinë “Në rrugën <i>Gjenerali Vajs</i>”. - Vlerëson secilin profesion që ushtrohet nga të rriturit”.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9 - Fleta të bardha, marker (shënjeshtër), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh			
Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan dy pyetje në tabelë dhe pas leximit, nxënësit shprehin mendimet e tyre.			

Nëse do të krahasonit figurën e gjeneralit me atë të lustraxhiut, në çfarë përfundimi do të arrinit? Si mendoni, cilat kanë më shumë rëndësi në jetë, bëmat, fitoret apo vlerat? Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe diskutojnë së bashku. Pastaj, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore: “Në rrugën <i>Gjenerali Vajs</i>”.	
Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje-Citat-Koment Në këtë fazë, mësuesi/ja së pari lexon poezinë e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit që ta lexojnë me rend (lexim artistik), me zë dhe, pas leximit, të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/ emocionet që zgjon tek ata leximi i poezisë. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre të punës (të ndarë në katër grupe) detyrat nga teksti shkollor.	
Grupi I : Kuptojmë poezinë, ushtrimi 1. Grupi II: Analizojmë poezinë, ushtrimet 2, 3, 4. Grupi III: Interpretojmë poezinë, ushtrimet 5, 6, 7 Grupi IV: Gjuha e poezisë, ushtrimet 8, 9. Mësuesi/ja ndihmon grupet e nxënësve, nëse është e nevojshme.	
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ese e shkurtër Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen të shkruajnë një ese të shkurtër duke u bazuar te detyra në tekst. Shkruani një ese për gjërat që konsideroni më të rëndësishme në jetë dhe që ju bëjnë të lumtur.	
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).	
Detyrat dhe puna e pavarur	
Mësojeni përmendësh poezinë.	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	
Është zgjedhja e mësuesit/es.	

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënësve të temës: Nxënësi/ja: ndërton me gojë e me shkrim fjali e tekste sipas standardeve gjuhësore për nivelin e klasës së nëntë duke rimarrë rregulla e njohuri edhe nga klasat e mëparshme.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi,			

skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie.

II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klasat e fjalëve

Fjalët kyçe: fjalë të ndryshueshme, fjalë të pandryshueshme, klasa fjalësh, fjalë kuptimplota, fjalë jokuptimplota, fjalë thirrmore.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përcakton se ç'pjesë të ligjëratës u përkasin fjalët në një tekst të dhënë;
- dallon klasën e fjalëve të ndryshueshme dhe klasën e fjalëve të pandryshueshme;
- dallon fjalët e mëvetësishme dhe të pamëvetësishme;
- dallon fjalët kuptimplota, fjalët jokuptimplota dhe fjalët thirrmore;
- krijon një tekst duke përdorur fjalë të klasave të ndryshme.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkurtes me ngjyra, tabela.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Pema e mendimeve, punë në çifte, diagrami i Venit, punë në grupe.

Organizimi i orës së mësimimit


Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pema e mendimeve

Rikujtohen njohuritë paraprake të nxënësve që kanë për klasat e fjalëve. Çfarë dini për fjalën?, pjesët e fjalës dhe kuptimin e saj? Cilat janë pjesët e ligjëratës?

Plotësohet pema e mendimeve me informacionet që kanë në libër për klasat e fjalëve, si:

- Fjala është tërësi e pandashme e tingëllimit dhe e kuptimit, që emërton njerëz, kafshë, sende, dukuri natyre dhe pjesë përbërëse të këtyre kategorive etj.
- Fjalët që e ndryshojnë formën gjatë përdorimit të tyre në fjali, quhen fjalë të ndryshueshme:
 - *emri, mbiemri, folja, përemri, numërori*.
- Fjalët që nuk e ndryshojnë formën gjatë përdorimit në fjali, quhen fjalë të pandryshueshme:
 - *ndajfolja, lidhëza, parafjala, pjesëza, pasthirrma*.

Punohet me gjithë nxënësit.



Ligjërimi shprehet me fjalë, prandaj ato quhen edhe pjesë të ligjëratës.

Nxënësit/et në grupe diskutojnë pjesët e ligjëratës, si të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e konceptit - Punë në çifte

- Udhëzohen nxënësit të plotësojnë tabelën sipas kërkesës.

	Fjala	Emërore	Gjinore	Dhanore	Kallëzore	Rrjedhore
Emri lakohet	Libri					
Mbiemri lakohet	i mirë					
Përemri lakohet	Ata/ato					
Numërori lakohet	i shtatë					
Folja zgjedhohet	Mësoj	unë	ti	ai	ne	ju ata/ato

- Nxënësit/et punojnë në çifte duke plotësuar tabelën e dhënë.

- Diskutojnë në grupe se çfarë kuptojnë me pjesët e ligjëratës, komentojnë punën bashkërisht.


- Duke klasifikuar kategoritë gramatikore të pjesëve të ligjëratës, nxënësit gjejnë pesë pjesët e ligjëratës si të ndryshueshme, si: emri, mbiemri, përemri dhe numërori të cilat lakohen, dhe folja që zgjedhohet, pra ndryshojnë në ligjërim.

- Disa nxënës/e lexojnë fjalitë dhe japin përkatësitë: pjesë ligjërata - funksion.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i Venit

- Nxënësi/et njihet me informacionin që jepet në libër, klasat e fjalëve, funksionet e tyre në fjali. Mësimdhënësi/a jep në tabelë diagramin e Venit për të përcaktuar dallimet dhe ngjashmëritë midis pjesëve të ndryshueshme e të pandryshueshme.

1. Ndryshojnë formë gjatë ligjërimit.
2. Kryejnë funksione të ndryshme në fjali.
3. Janë fjalë emërtuese e treguese.



1. Ndahen në klasa në bazë të disa rregullave (sipas kuptimit, rolit, funksionit).
2. Mund të jenë fjalë të thjeshta ose jo të thjeshta.
3. Shërbejnë për të krijuar fjali e tekste.

1. Nuk ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali.
2. Nuk ndryshojnë sipas trajtës, numrit, rasës, mënyrave.
3. Janë fjalë shërbyese ose plotësojnë kuptime të fjalëve të tjera.

Plotësohet diagrami i Venit nga nxënësit në tabelë, përmirësohen gabimet duke dhënë formën e drejt.

Disa nxënës/e lexojnë fjalitë dhe japin përkatësitë: pjesë ligjërates- funksion.

Rikujtohen njohuritë për pjesët e ligjërates, si të ndryshueshmet dhe të pandryshueshme, jepen udhëzimet nga mësimdhënësi/a të plotësohet tabela:

Ndajfolje	Mirë, herët, jashtë, keq, pak...
Parafjalë	Në, mbi, nën, tek, nga...
Lidhëz	Dhe, ndonëse, prandaj...
Pjesëz	Nuk, mos, pa...
Pasthirmë	Oh, obobo, ah...

- Nxënësit plotësojnë tabelën, shqyrtojnë punë në grupe pastaj prezantojnë para klasës.
- Mund të mbështeten në fragmentin e paraqitur në libër.

Rrjeti i diskutimit – punë në grupe

Pasi nxënësit të përmbledhin pjesët e ligjërates, diskutohet për secilën, kalohet të pjesa e ushtrimeve, nga 1-4.

Ushtrimi numër 1 punohet individualisht, sipas kërkesës së dhënë në libër.

Ushtrimi numër 2, 3 punohen në çifte, sipas kërkesës.

Ushtrimi numër 4 punohet në grupe, sipas kërkesës.

Mësimdhënësi/a kontrollon punën e nxënësve duke korrigjuar gabimet.

Ushtrimet prezantohen para klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejtë të pjesëve të ligjërates në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Shkruani një tregim të shkurtër, në të cilin i gjeni pjesët e ligjërates duke i klasifikuar secilën.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën aktive të nxënësve, motivon duke komentuar punën e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare:	Lënda:	Shkalla e kurrikulës:	Klasa
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	IV	IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Ndërton me gojë e me shkrim fjali e tekste standardeve gjuhësore për nivelin e klasës së nëntë, duke rimarrë rregulla e njohuri edhe nga klasat e mëparshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: -Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme			
Fjalët kyçe: fjalë të ndryshueshme, fjalë të pandryshueshme, klasa fjalësh, fjalë kuptimplota, fjalë jokuptimplota, fjalë thirrmore.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: - përcakton se ç’pjesë të ligjëratës u përkasin fjalët në një tekst të dhënë; - dallon klasën e fjalëve të ndryshueshme dhe klasën e fjalëve të pandryshueshme; - dallon fjalët e mëvetësishme dhe të pamëvetësishme;			

-dallon fjalët kuptimplota, fjalët jokuptimplota dhe fjalët thirrmore;
-krijon një tekst duke përdorur fjalë të klasave të ndryshme.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkurtesa me ngjyra, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS

GJATË ORËS MËSIMORE: Të nxënit me këmbime (Punë në dyshe), Organizuesi grafik, Punë e pavarur, Punë në grupe

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Të nxënit me këmbime (punë në dyshe)

Hapi I.

Nxënësit gjejnë në dyshe klasën e fjalëve me shkronja të zeza në fillim të mësimi. Përgjigjet e nxënësve, paraqiten në tabelë.


Hapi II. Bëhet e njohur tema e re mësimore, duke e paraqitur në tabelë.

Listohen në tabelë pyetjet

- Mbi ç'kritere i grupojmë fjalët në klasa?
- Ç'quajmë fjalë të ndryshueshme?
- Ç'quajmë fjalë të pandryshueshme?
- Ç'janë fjalët e mëvetësishme dhe të pamëvetësishme?
- Çfarë shprehin fjalët kuptimplota, fjalët jokuptimplota dhe fjalët thirrmore?

Nxënësit lexojnë informacionin e paraqitur në tekst dhe u përgjigjen pyetjeve të renditura në tabelë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Organizuesi grafik



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur, punë në grupe

Hapi I: Ushtrimi 1. Plotësohet në tekst.

Hapi II: Punë në grupe.

Grupi 1: Ushtrimi 2.

Nxënësit do të nënvizojnë me një vijë fjalët e ndryshueshme dhe me dy vija, fjalët e pandryshueshme.

Fjalë të ndryshueshme: tringëllima, e ziles, vazhdonte, ndihej, nxënësit, derdhën, korridoreve, oborri, gumëzhiti, zgjua bletësh, djema, shkojmë, fusha, është, kohë, e bukur, mund, bëjmë, një, ndeshje, futboll, ky, që (përemër lidhor) bënte, këtë, thirrje, ishte, Altini, nxënësit, e klasës, së nëntë, disa, shokët, dëgjuan, e (trajtë e shkurtër përemër vetor), bjerë, shi, kemi, të pamundur, luajmë, shtoi, ai, ke, pranoi, Erli.

Fjalë të pandryshueshme: të (pjesëz e lidhore), ende, kur, u, si, nga, dhe, të, nga, e (lidhëz), jo, se, nesër, të, kështu që, do ta (e trajtë e shkurtër + pjesëz), nuk, keq.

Grupi 2: Ushtrimi 3.

Emra: tringëllima, e ziles, nxënësit, korridoreve, oborri, zgjua, bletësh, djema, fusha, ndeshje, futboll, thirrje, Altini, e klasës, shokët, shi, Erli.

Mbiemra: e bukur, futboll, së nëntë (mbiemër marrëdhënior), të pamundur

Folje: vazhdonte, ndihej, derdhën, gumëzhiti, shkojmë, është, mund, bjerë, bëjmë, bënte, ishte, dëgjuan, kemi, luajmë, shtoi, ke, pranoi

Përemra: ky, që, disa, këtë, ai

Numëror: një

Ndajfolje: ende, nesër, keq

Parafjalë: nga

Lidhëz: kur, e, se, kështu që, dhe

Pjesëz: të, u, si, jo, do të, nuk

Pasthirmë ---

Grupi 3: Ushtrimi 3.

a) Në derë trokitën disa vajza. (përemër i) pacaktuar

b) Një njeri i panjohur po udhëtonte me makinën tonë. (mbiemër)

c) Në breg përplaseshin dallgë deti. (emër)

ç) A doni pak ujë burimi? (pjesëz)

d) O burra, jemi vonë për provimin! (pasthirmë)

dh) Çfarë mendimi keni për këtë nxënëse? (përemër dëftor)

e) Çdo mëngjes shkonte në shkollë me autobus. (përemër i pacaktuar)

ë) Vëlla e motër u përqaftuan me mall. (lidhëz)

Grupi 4. Ushtrimi 5.

film i ri **dokumentar** (mbiemër), **dokumentarë** (emër), **rreth** të zi (emër), **rreth** saj (parafjalë), **buzë** detit (parafjalë), I dridhej **buza** (emër), **Më** kishin (përemër vetor, trajtë e shkurtër), S'foli **më** (pjesëz), tryezën **të shtruar** (mbiemër), të fliste **shtruar** (ndajfolje), ana e **majtë** (mbiemër), rruga **majtas** (ndajfolje)

Dëgjohen përgjigjet e ushtrimeve nga një përfaqësues i çdo grupi.

Vlerësimi i nxënësve: nisur nga pjesëmarrja e nxënësve gjatë orës, saktësia në dhënien e përgjigjeve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë. Komunikohen dhe motivohen vlerësimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 4, 6 sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare:	Lënda:	Shkalla e kurrikulës:	Klasa
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	IV	IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Praktikon trajtat e emrave në rasën, numrin dhe gjininë përkatëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIMET - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Lakimi i emrave (ora e parë)			
Fjalët kyçe: Kategoria gramatikore e rasës, funksioni në fjali, lakimi, mbaresa...			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:			
Nxënësi/ja: - përcakton saktë kategorinë gramatikore të rasës së emrave; - lakon emrat e gjinisë mashkullore, femërore dhe asnjansëse, në trajtën e shquar dhe të pashquar, numri njëjës dhe shumës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit; Gramatika 1, 2; tabela e lakimit të emrave.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE: *Stuhi mendimi, Punë e drejtuar, Punë individuale*

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Stuhi mendimi*

U kërkohet nxënësve të vënë re fjalën **ngjyrë** në tekstin e mëposhtëm:


Rreth nesh kudo ka **ngjyra**: te rrobat që veshim, te lulet, tek ylberi në qiell dhe tek ekrani i televizorit. E gjithë kjo larmi **ngjyrash** krijohet nga përzierja e vetëm tri **ngjyrave**: e kuqja, e kaltra dhe e gjelbra. Këto tri **ngjyra**, të quajtura **ngjyra** bazë, krijojnë edhe figurat që shihni në ekranin e televizorit.

- Cilës pyetje i përgjigjet emri **ngjyrë** në secilin rast? Në ç'rasë është përdorur ky emër? Në cilën trajtë janë përdorur format e këtij emri?
- Ç'kemi quajtur **rasë**? Po **lakim**?

Theksohet se për të gjetur lakimin e emrit, mbështetemi te *lloji i mbaresës* që merr ai **në rasën emërore, numri njëjës, trajta e shquar**.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e drejtuar*

Hapi I Duke shfrytëzuar përgjigjet e nxënësve, mësuesi jep në tabelë funksionet në të cilat përdoren emrat, sipas rasave me dhe pa parafjalë.




U kërkohet nxënësve të krijojnë fjali me emra me parafjalë, për te parë funksionet në të cilat ata mund të dalin.

Hapi II. Të njëjtat fjali të krijuara nga nxënësit shfrytëzohen për të sqaruar dhe kategorinë e trajtës: të pashquar dhe të shquar. Kihet parasysh se emri në trajtën e pashquar shoqërohet zakonisht në fjali me fjalët përcaktuese: një, për numrin njëjës dhe disa/ca, për numrin shumës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë individuale*

U kërkohet nxënësve të rikujtojnë edhe një herë rrugën që përdorin për të gjetur lakimin e emrit. Çohet me mend emri në rasën emërore, trajta e shquar, numri njëjës dhe në bazë të mbaresës përcaktojmë lakimin.



Drejtohen nxënësit në faqet 249-250 të tekstit, për të vërejtur tabelat e lakimit të emrave. Nxënësit punojnë individualisht në tekst ushtrimin 1.

	Emërore, e pashquar, njëjës	Rrjedhore, e pashquar, njëjës (prej) shëndeti	Gjinore, e shquar, njëjës i, e shëndetit	Kallëzore, e shquar, njëjës Shëndetin
Shëndet	Shëndet	(prej) barku	i, e barkut	Barkun
Bark	Bark	(prej) të ftohti	i, e të ftohtit	Të ftohtit
Të ftohtët	Të ftohtë	(prej) pacienteje	i, e pacientes	Pacienten
Pacientë	Pacientë	(prej) ambulance	i, e ambulancës	Ambulancën
Ambulancë	Ambulancë	(prej) antibiotiku	i, e antibiotikut	Antibiotikun
Antibiotik	Antibiotik	(prej) farmacie	i, e farmacisë	Farmacinë
Farmacit	Farmacit			

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësimi i nxënësve bëhet hap pas hapi, duke pasur parasysh pjesëmarrjen gjatë orës mësimore dhe përgjigjet e dhëna.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Lakoni sipas tabelës emrat: kutia, çelësi, të menduarit.

Rasat	Trajta e pashquar		Trajta e shquar	
	Numri njëjës	Numri shumës	Numri njëjës	Numri shumës
Emërore				
Gjinore				
Dhanore				
Kallëzore				
Rrjedhore				

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare:	Lënda:	Shkalla e kurrikulës:	Klasa
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	IV	IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Praktikon trajtat e emrave në rasën, numrin dhe gjininë përkatëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit.			

Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathhtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për vetën, për të tjerët dhe për ambientin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lakimi i emrave (ora e dytë)

Fjalët kyçe: Kategoria gramatikore e rasës, funksioni në fjali, lakimi, mbaresa, analizë morfologjike.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përcakton saktë kategorinë gramatikore të rasës së emrave;
- dallon llojin e lakimit të emrave nëpërmjet mbaresës;
- analizon emrat sipas kategorive gramatikore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit; Gramatika 1, 2; tabela e lakimit të emrave.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Diskutim, Punë e pavarur*

Organizimi i orës së mësimi

Hapi I. Ora mësimore nis me diskutimin e detyrës së shtëpisë. Bëhet lakimi i emrave në mënyrë zinxhir nga nxënësit.

Hapi II. Punohen ushtrimet 1-6 në faqen 251, me punë të pavarur dhe individuale.

Ushtrimi 2. Dalloni emrat, nënvizoni mbaresat e tyre dhe tregoni se në ç'rasë janë përdorur.

Çdo vit (kallëzore) shkruhen miliona libra (K). Disa kanë fjalë (K) dhe ilustrime. (K) Disa kanë vetëm fjalë, (K) të tjerë përmbajnë kryesisht figura (K) dhe shumë pak fjalë. (K) Ne lexojmë libra (K) për të marrë informacion, (K) por për shumë njerëz (K) leximi (E) i tyre është kënaqësi (E) e madhe. Një libër (E) kinez i titulluar “Rregulla (E) të arta” është libri (E) më i vjetër i shtypur. Ai libër (E) është bërë mbi 1100 vjet (K) më parë.

Ushtrimi 3. Emrat në kllapa vendosini në rasën e duhur dhe përcaktoni llojin e lakimit.

1. Çdo fëmijë ka të drejtë të ketë të gjitha kushtet (L.I) (kusht) e nevojshme për të jetuar.
2. Prindërit ose njerëzit (L. II) (njeri) që me ligj kujdesen për fëmijët (L. III) (fëmijë) kanë për detyrë t'u sigurojnë fëmijëve (L.III) (fëmijë) kushtet e nevojshme për të jetuar sa më mirë. Kjo bëhet sipas mundësive (L. III) (mundësi) që ata kanë.

3. Institucionet shtetërore duhet të bëjnë gjithçka që mundën për të ndihmuar *prindërit* (*L. I*) (prind) ose njerëzit e tjerë që me *ligj* (*L. I*) (ligj) kujdesen për fëmijën, që të zbatohet kjo e drejtë e *fëmijëve*. (*L. III*) (fëmijë). (Konventa mbi të drejtat e fëmijës, neni 27).

Ushtrimi 4 Ktheni në trajtë të shquar emrat që shërbejnë si bërthamë e grupeve emërore, sipas shembullit: në një shkollë të qytetit - në shkollën e qytetit.

një shok të tyre -- shokun e tyre

shtëpi moderne -- shtëpia moderne

në një vend të ngrohtë -- në vendin e ngrohtë

një libër i vjetër -- libri i vjetër

një vajzë e klasës -- vajza e klasës

mësime të vështira -- mësimet e vështira

ditë të ftohta -- ditët e ftohta

ngjyrë e lehtë -- ngjyra e lehtë

Ushtrimi 5. Ndërtoni tabelën e lakimit të emrit të **mësuarit** në të dyja trajtat, duke pasur si model lakimin e emrit të lexuarit. Formoni tri fjali me format e ndryshme të këtij emri.

Për të punuar këtë ushtrim, klasa ndahet në dy grupe. Gjysma e klasës punon tabelën në numrin njëjës dhe gjysma tjetër punon tabelën në numrin shumës (njësoj si emri të **lexuarit** në librin e nxënësit)

	Numri njëjës	
Rasat	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore		
Gjinore		
Dhanore		
Kallëzore		
Rrjedhore		

Ushtrimi 6 Gjeni emrat në tekstin e mëposhtëm dhe analizojeni sipas kategorive gramatikore.

Këto unë i dëgjoja dhe mendjen e kisha te kulla ogurzezë. Nuk duhej të largohesha nga fshati pa zbuluar vetë të vërtetën. Po nga duhej t'ia nisja? Më të afërmen dhe më besniken, kisha Gëzimen. Ajo më kishte thënë shumë herë se e kishte parë fantazmën me sytë e saj. Një mëngjes e pyeta: - Nga shokët dhe shoqet e tua të fshatit, cilët janë më të guximshëm? Ajo u mendua pakëz dhe më tha se vetëm një frikacak kishin: - Trimin. - Cilin Trim? - pyeta unë. Është një djalë që e ka emrin Trim. Ai e ka parë fantazmën dhe nuk kalon më kurrë nga gërmadhat e kullës ogurzezë. Thonë se i bëhet edhe në ëndërr fantazma.

Për shembull: mendjen - emër i përgjithshëm, gjinia femërore, numri njëjës, trajta e shquar, rasa kallëzore, lakimi i tretë, abstrakt.

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Sugjerim: Faqja 251 mund të fotokopjohet dhe të përdoret si fletë pune për nxënësit/es dhe të shfrytëzohet për dosjen e tij/saj.

Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit me shprehje mbështetëse dhe notë për të gjitha ushtrimet.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 7, sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: praktikon trajtat e emrave në rasën, numrin dhe vetën përkatëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit: Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis: Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale: Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare: Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIMET – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për mjedisin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Drejtshkrimi i emrave që kanë dy trajta shumësi			
Fjalët kyçe: Kategoria gramatikore e numrit: njëjës, shumës, mbaresa-prapashtesa trajtëformuese.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - përcakton kategorinë gramatikore të numrit të emrit; - dallon emrat që përdoren vetëm në shumës dhe vetëm në njëjës; - dallon emrat në numrin shumës dhe tregon mënyrat e formimit të shumësit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit; Gramatika 1, 2; tabela e shumësit të emrave.			

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE: *Diskutim për njohuritë paraprake (Brainstorming), Punë e drejtuar, Punë individuale, Diskutim*

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Diskutim për njohuritë paraprake (Brainstorming)*

Në një tabak të bardhë, apo dhe në tabelë, shkruhet fragmenti i mëposhtëm. U kërkohet nxënësve të dallojnë emrat dhe të përcaktojnë numrin e tyre.

Me kalimin e kohës, njëra nga pemët u tha nga pleqëria dhe nga druri i kalbur, doli një insekt. Ishte një krimb i bardhë i gjatë dhe grykës, pas fletëve të buta të bimëve. Ai u shumëzua aq shumë, sa vuri në rrezik jetën e bimëve të tjera. Atëherë, Mukoli, vuri dorezat dhe e përzuri me të gjithë pasardhësit e tij. Lejoi që të mbetej vetëm një krimb.

Kur emri është në numrin njëjës? Po në numrin shumës?

- A është ndonjë nga emrat që përdoren vetëm në numrin njëjës? (pleqëria, Mukoli) Po vetëm në numrin shumës? (dorezat)

U kërkohet nxënësve të kthejnë emrat e gjetur nga njëjësi në shumës dhe anasjelltas, me qëllim që të dallojnë mënyrën e formimit të numrit shumës, p.sh.:

(Një) kalim - (disa) kalim-e mbaresa/prapashtesa trajtëformuese **-e**

(një) kohë - (disa) kohë-ra - II- -II- -**ra**

(një) pemë - (disa) pemë njësoj si njëjësi, pa mjet trajtëformues

(një) rrezik - (disa) rreziq-e me ndërrim tingulli **k-q** dhe me mbaresë/prapashtesë trajtëformuese **-e**

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e drejtuar*

Drejtohen nxënësit në tekst në faqen 246, për t'u njohur me llojet e emrave që përdoren vetëm në numrin njëjës dhe vetëm në numrin shumës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë individuale, Diskutim.*

Punohen ushtrimet 1 - 5 në faqen 247. Për ushtrimet 1, 4, 5, klasa ndahet në dy grupe, duke i dhënë secilit grup për të punuar gjysmën e ushtrimit, por nxënësit punojnë individualisht.

Ushtrimi 1. *Dalloni emrat në numrin shumës, duke treguar mënyrën e formimit të shumësit.*

Këto ditë kam pasur takime me miq të rinj. Babai do të përpiqet për t'i zgjidhur ato probleme. Shfaqjet vazhduan të kishin sukses. Ngrihi dorën dhe vërtiti fletën. Asnjë fëmijë nuk duhet të thotë fjalë që lëndojnë të tjerët. Vajzat dhe djemtë duhet të vendosin nëse do të grupohen sipas projekteve që kanë zgjedhur. Ai mund t'i zbatonte projektet, nëse do të ndihmohej nga të gjithë. Ne pamë dy ndeshje të bukura këtë të diel. Në ato brigje vihej re një dukuri interesante. Dyshi i shumëzuar me dy jep katër.

Ushtrimi 2. *Vendosni në numrin shumës emrat e gjinisë mashkullore dhe nënvizoni prapashtesat që marrin.*

kapitull i ri - kapituj të rinj; ballkon me lule - ballkonë me lule; kufi me tela - kufij me tela; bishtalec i gjatë - bishtalecë të gjatë; mjeshtër sporti - mjeshtër sporti; brez i humbur - breza të humbur, mësues karriere - mësues karriere, planet i ri - planetë të reja, telefon shtëpie - telefona shtëpie, zinxhir ari - zinxhira ari, treg perimesh - tregje perimesh, vit i kaluar - vite të kaluara

Kujdes emrat e dygjinishëm!

Ushtrimi 3. *Qarkoni në vargjet e mëposhtme, emrat që përdoren vetëm në një numër dhe formoni fjali me ta.*

libër, projekt, fizikë, dije, frikë, aktrim, aktor, skenarist familje, lule, argjendet, fotografi, personazh, përrallë, shtojzovallet, mal, frutë, ushqim, gijë, blerje, sëmundje, fruth, gjilpërë, antibiotiku, syzet, sy, numër, okulist, vizitë, qytet, perëndim, bregdet, plazh, shqipja, dokument, studiues, kapitull.

Ushtrimi 4. Vendosni në numrin shumës emrat dhe tregoni se çfarë kategorie gramatikore e përbashkët i bashkon.

shkollë e re – shkolla të reja; fjalë e ëmbël – fjalë të ëmbla; natë vere – net vere; dardhë vjeshte – dardha vjeshte; borë e bardhë – borëra të bardha; derë hekuri – dyer hekuri; supë me perime – supëra me perime; letër falënderimi – letra falënderimi; shtëpi pushimi – shtëpi pushimi; ëndërr me sy hapur – ëndërra me sy hapur.

I bashkon kategoria gramatikore e trajtës. Të gjithë emrat janë në trajtën e pashquar, njëjës.

Ushtrimi 5. Gjeni emrat dhe përcaktoni gjininë dhe numrin e tyre, duke i vendosur në një tabelë.

Një sërë mendimesh të çuditshme u shfaqën në mendjen e saj. Pranë një pylli me pisha gjendet një fshat i madh. Dy prej nxënësve nuk u paraqitën në provim. Vendimi juaj është i rëndësishëm për mua. Një grumbull turistësh me aparate fotografike në duar zbritën nga autobusi. Bulevardi i madh “Dëshmorët e Kombit”, shkëlqente prej dritave shumëgjyreshe. Në afërsi të kësaj kalaje, kalon rruga “Egnatia”. Përreth nuk dëgjojmë asnjë zhurmë.

Emrat	Gjinia	Numri
mendimesh	femërore	shumës
mendjen	femërore	njëjës
pylli	mashkullore	njëjës
pisha	femërore	shumës
fshat	mashkullore	njëjës
nxënësve	mashkullore	shumës
provim	mashkullore	njëjës
vendimi	mashkullore	njëjës
grumbull	mashkullore	njëjës
turistësh	mashkullore	shumës
aparate	femërore	shumës
duar	femërore	shumës
autobusi	mashkullore	njëjës
bulevardi	mashkullore	njëjës
Dëshmorët	mashkullore	shumës
e Kombit	mashkullore	njëjës
dritave	femërore	shumës
afërsi	femërore	njëjës
kalaje	femërore	njëjës
rruga	femërore	njëjës
Egnatia	femërore	njëjës
zhurmë	femërore	njëjës

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve në të gjitha fazat e orës.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë, me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare:	Lënda:	Shkalla e kurrikulës:	Klasa
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	IV	IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Praktikon trajtat e përemrave vetorë në rasën, numrin dhe vetën përkatëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në media. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHËTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Lakimi i përemrave vetorë			
Fjalët kyçe: përemri vetor, përemri dëftor, kategoria gramatikore e rasës, lakohet, trajtë e shkurtër, trajtë e shkurtër e bashkuar, rasa dhanore, kallëzore.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - përcakton kategoritë gramatikore të përemrit vetor dhe dëftor; - lakon përemrin vetor dhe dëftor sipas rasave; - përdor si duhet në fjali, trajtën e shkurtër të bashkuar të përemrit vetor.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit; tabela e lakimit të përemrave vetorë dhe përemrave dëftorë: ky/kjo, këta/këto; ai/ajo, ata/ato; Gramatika 1.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:


- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE: *Kllaster; diskutim; punë në grup; punë individuale*

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Kllaster; diskutim*

U kërkohet nxënësve të plotësojnë kllasterin për veçoritë e përemrit vetor.




Me gojë, nxënësit rikujtojnë lakimin e përemrave vetorë. Tabela e lakimit të tyre paraqitet para klasës dhe u kërkohet nxënësve të vënë re trajtat e shkurtra të përemrit vetor në rasën dhanore dhe kallëzore.

Së bashku me nxënësit, ndërtohet tabela e formimit të trajtave të shkurtra të bashkuara, e cila paraqitet dhe në libër.

Theksohet: Trajta e shkurtër e bashkuar, formohet nga bashkimi i dy trajtave të shkurtra. E para është gjithmonë në rasën dhanore dhe e dyta gjithmonë në rasën kallëzore, veta e tretë, njëjës ose shumës.

Rikujtohen njohuritë për përemrin dëftor. Punohet njësoj si për përemrin vetor. Ndërtohet kllasteri.



Në tekst, nxënësit lexojnë tabelën e lakimit të përemrave dëftorë: ky/kjo, këta/këto, ai/ajo, ata/ato.

Ndërtimi i njohurive të reja: *punë në grup*

Punohet me shkrim ushtrimi 2 në faqen 267. Klasa ndahet në dy grupe.

Grupi 1 - lakon grupet emërore: libër i këtillë, ai hap i atillë.

Grupi 2 - shtëpi e tillë, kjo lule e këtillë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë individuale

Punohet individualisht në libër ushtrimi 3. Nxënësit vendosin trajtën e shkurtër që duhet 3.

Më erdhi t'i bërtisja, kaq shumë më mërzi.

E gjeta në mes të nxënësve të tjerë, duke folur për festivalin e djeshëm.

Me siguri do të vijë të të kërkojnë mendim për këtë çështje.

Ty të kishte rrëmbyer gazi dhe nuk vije re ç'bëhej përqark.

Ata i gëzofshin shtëpitë e reja!

Na thanë se e kishin parë kur kishte dalë te porta.

Shallin që sheh mbi tavolinë, e mora në qendrën tregtare afër shtëpisë sime.

Djemve të pallatit, u kam thënë disa herë të mos bëjnë zhurmë te kati i parë.

Diskutohet plotësimi i ushtrimit në klasë.

Vlerësimi i nxënësve: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm i nxënësve gjatë gjithë orës së mësimi, me notë dhe me shprehje nxitëse.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 4, sipas kërkesës. Shkruani saktë fjalitë e këtij ushtrimi.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/a vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: praktikon trajtat e përemrave vetorë në rasën, numrin dhe vetën përkatëse.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT - Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, autobiografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për vetën dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie.			

II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për vetën, për të tjerët dhe për ambientin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor

Fjalët kyçe: përemri vetor, përemri dëftor, kategoria gramatikore e rasës, lakohet, trajtë e shkurtër, trajtë e shkurtër e bashkuar, rasa dhanore, kallëzore.

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përcakton kategoritë gramatikore të përemrit vetor;
- lakon përemrin vetor sipas rasave;
- përdor si duhet në fjali, trajtën e shkurtër të bashkuar të përemrit vetor.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit; tabela e lakimit të përemrave vetorë dhe përemrave dëftorë: ky/kjo, këta/këto; ai/ajo, ata/ato; Gramatika 1.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:


- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Kllaster; Diskutim; Punë në grup; Punë individuale

Organizimi i orës së mësim

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Kllaster, Diskutim

U kërkohet nxënësve të plotësojnë Kllasterin për veçoritë e përemrit vetor.



Me gojë, nxënësit rikujtojnë trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrit vetor. Tabela e lakimit të tyre paraqitet para klasës dhe u kërkohet nxënësve të vënë re trajtat e shkurtra të përemrit vetor në rasën dhanore dhe kallëzore.

Së bashku me nxënësit, ndërtohet tabela e formimit të trajtave të shkurtra të bashkuara, e cila paraqitet dhe në libër.

Theksohet: Trajta e shkurtër e bashkuar, formohet nga bashkimi i dy trajtave të shkurtra. *E para është gjithmonë në rasën dhanore dhe e dyta gjithmonë në rasën kallëzore, veta e tretë, njëjës ose shumës.*

Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara të përemrave vetorë

dhanore + kallëzore (veta III njëjës)	Trajtat e shkurtra	Shembuj
më (mua) + e (atë) =	ma	Ma tregoi edhe mua librin e ri që kishte bërë.
të (ty) + e (atë) =	ta	Ta tregoi edhe ty librin e ri që kishte bërë.
i (atij, asaj) + e (atë) =	ia	Ia tregoi edhe atij librin e ri që kishte bërë.
na (neve) + e (atë) =	na e	Na e tregoi edhe neve librin e ri që kishte bërë.
ju (juve) + e (atë) =	jua	Jua tregoi edhe juve librin e ri që kishte bërë.
u (atyre) + e (atë) =	ua	Ua tregoi edhe atyre pikturën që kishte bërë.
dhanore + kallëzore (veta III shumës)	Trajtat e shkurtra	Shembuj
më (mua) + i (ata, ato) =	m'i	M'i tregoi edhe mua librat e rinj që kishte bërë.
të (ty) + i (ata, ato) =	t'i	T'i tregoi edhe ty librat e rinj që kishte bërë.
i (atij, asaj) + i (ata, ato) =	ia	Ia tregoi edhe atij (asaj) librat e rinj.
na (neve) + i (ata, ato) =	na i	Na i tregoi edhe neve librat e rinj që kishte bërë.
ju (juve) + i (ata, ato) =	jua	Jua tregoi edhe juve librat e rinj që kishte bërë.
u (atyre) + i (ata, ato) =	ua	Ua tregoi edhe atyre librat e rinj që kishte bërë.

Ndërtimi i njohurive të reja: *punë në grup;*

Punohen me shkrim ushtrimet në faqen 237. Klasa ndahet në katër grupe.

Grupi 1 - Në tekstin e mëposhtëm, vendosni në vendet bosh trajtat e shkurtra që mungojnë.

___ kishim rezervuar pushimet në internet gjashtë muaj më parë dhe nuk ___ kishim vrarë mendjen për asgjë. ___ kishim marrë qetë se çdo gjë ___ dukej në rregull. Kështu që nuk mund ___ imagjinoni befasinë tonë kur ___ u tha që ne nuk mund të fluturonim sepse djalit tonë ___ kishte skaduar pasaporta. ___ kujtua një shok dhe vrapuam tek ai me shpresën se do të ___ ndihmonte dhe do të ___ rregullonte punën e pasaportës.

Grupi 2 - Vendosni në vendet bosh përemrat dhe trajtat e shkurtra ose të bashkuara.

Unë besoj se ___ nuk ke ikur, sepse do të ___ kishe lajmëruar. ___ i duam prindërit tanë, prandaj dhe ___ respektojmë gjithmonë. ___ mori mendja që e keni takuar. ___ thirrën urgjent në shkollë. Për të festuar ditëlindjen e nënës sime ___ veshi një fustan që të gjithë ___ pëlqyen. ___ prezantoni edhe mua nxënësit e rinj! Kur më telefonoi Lina, ___ tregoi të vërtetën që e kishte mundur aq kohë.

Grupi 3 - Plotësoni vendet bosh me përemra vetorë ose trajta të shkurtra dhe të bashkuara.

Unë e besoj ___, përse ___ nuk më beson _____. ___ duam prindërit tanë edhe ___ duan _____. Për të festuar ditëlindjen e nënës _____ organizuam një festë që do të jetë surprizë për _____. ___ janë duke dëgjuar me vëmendje këngën që ___ këndoi. Gjithçka që _____ dija jua kam treguar, ndërsa _____ kanë nevojë për ndihmë prej _____.

Grupi 4 - Shkruani sipas modelit, nënvizoni trajtën e shkurtër.

Më thuaj të vërtetën. Thuama të vërtetën. Nëse të pëlqen medaljoni im e merr me vete sot dhe ma kthe (_____) pas një jave. E bleve akullloren, më jep (_____) edhe mua pak. Nëse do të niseshe shpejt i fol shoferit (_____. Më ktheni (_____) sa më parë te nëna ime. Ju thuaj (_____) atyre të mblidhen sa më parë. Çfarë ka ndodhur më thoni (_____) të vërtetën.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë individuale Punohet individualisht në libër ushtrimi 3. Nxënësit vendosin trajtën e shkurtër që duhet: <i>Më</i> erdhi t’i bërtisja, kaq shumë më mërziti. <i>E</i> gjeta në mes të nxënësve të tjerë, duke folur për festivalin e djeshëm. Me siguri do të vijnë të <i>të</i> kërkojnë mendim për këtë çështje. Ty <i>të</i> kishte rrëmbyer gazi dhe nuk vije re ç’bëhej për qark. Ata <i>i</i> gëzofshin shtëpitë e reja! <i>Na</i> thanë se e kishin parë kur kishte dalë te porta. Shallin që sheh mbi tavolinë, <i>e</i> mora në qendrën tregtare afër shtëpisë sime. Djemve të pallatit, <i>u</i> kam thënë disa herë të mos bëjnë zhurmë te kati i parë. Diskutohet plotësimi i ushtrimit në klasë.
Vlerësimi i nxënësve: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm i nxënësve gjatë gjithë orës së mësimit, me notë dhe me shprehje nxitëse.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Ushtrimi 5. Në pjesën me titull “Bojaxhiu finok”, nënvizoni përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra dhe të bashkuara. Përcaktoni numrin, rasën dhe si janë formuar.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë, me shkrim...

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Drejtshtkrimi		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon dhe përdor drejt në të folur dhe në të shkruar fjalën si njësi leksikore sipas ligjërimeve dhe stileve funksionale.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit: Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis: Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale: Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare: Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshtkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie.			

II. VLERAT DHE QËNDRIMET – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për mjedisin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përdorimi i apostrofit para trajtave të shkurtra

Fjalët kyçe: shenjë, presje, rënie, tingull, pjesëzës, përemër.

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- njeh rastet e përdorimit të apostrofit;
- përdor apostrofin në disa raste të shkrimit të trajtave të shkurtra dhe të bashkuara;
- argumenton përdorimin e trajtave të shkurtra të bashkuara *ma, ta*, që shkruhen pa apostrof: *ma dha fjalën*; *pa ma thënë*; *ta dha fjalën*, *ta kërkoi një nder etj.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti i nxënësit, libri “Shqipja standarde”, fletore, shkumës me ngjyra, tabelë, tabakë letre.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
- Shoqëria dhe mjedisi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Punë në dyshe, Shpjegim, Diskutim, Punë e pavarur*

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Punë në dyshe, shpjegim*

Mësimdhënësi/ja pyet nxënësit: Çfarë po shihni në fotografinë e paraqitur në libër?, faqe 11.

Nxënësit/et shprehin mendimet e tyre mbi fotografinë. Japin shembuj, si:

- *T’i hedh uthull sallatës?* (disa shembuj shënohen në tabelë)
- *t’i lexoj, për t’u lexuar, t’ju ftojme, t’ua sjell, t’u realizoftë etj.*
- *çfarë thua, çfarëdo, çdonjëri, çdokush etj.*

Ndërtimi i njohurive të reja: *diskutim/ mësimdhënia e ndërsjellë.*

Prezantohen përgjigjet e nxënësve. Diskutohet në lidhje me to dhe shpjegohen rastet, të cilat janë të paqarta për nxënësit, duke sjellë edhe shembuj të tjerë të ngjashëm.

Trajtat e shkurtra	Shembuj
më + i = m’i	<i>m’i dha; t’i dha; T’i shkruash shoces. T’i zbatosh rregullat. Do t’i kërkoka. Do t’i flas.</i>
më + u = m’u	<i>M’u tha e vërteta... etj.</i>
më + ia = m’ia të + ia = t’ia	<i>Të m’ia thuash të gjitha. T’ia kërkosh librin. Të mos m’ia prishi qejfin... etj.</i>
të + iu = t’iu	<i>Për t’iu përgjigjur nënës... Me t’iu afruar shtëpisë... etj.</i>
të + jua = t’jua	<i>Dua t’jua them hapur: Do t’jua kisha thënë më parë. Do t’jua di për nder... etj.</i>
më + ua = m’ua	<i>Mos m’ua prishni festën. etj.</i>
të + u = t’u	<i>T’u themi të vërtetën. T’u japim një lajm të mirë.</i>

Trajtat e shkurtra të bashkuara *ma, ta* shkruhen pa apostrof: *ma* dha fjalën; pa *ma* thënë; *ta* dha fjalën, *ta* kërkoi një nder etj.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur

Ushtrimi 1

Shkruani si duhet trajtën e shkurtër.

do ti kërkoja; do ti flas; për ti pasur si dëshmi; me ti thënë një fjalë, ngrihet në këmbë; do tu kërkoj falje; tu marrësh nga një dhuratë; do tu kisha lajmëruar; do tu përgjigjem menjëherë; tja them hapur; do tja kisha thënë më parë; do tja lehtësojë shumë punën; të mia thuash të gjitha fjalët; do tia tregoj.

Ushtrimi 2

Qarkoni trajtën e saktë të trajtave të shkurtra.

Disa ditë më vonë, bashkë me dy shokë të tjerë, ai erdhi për (ta/t'a) kthyer vizitën. Përveç punës sime si mësues, më duhej (ta/t'a) mbaja dhe rrisja edhe si nënë atë fëmijë. Ai (s'i/si) dëgjoi këshillat e mjekut e lutjet e prindërve, prandaj s'(ju/iu) kthye shëndeti.

Ushtrimi 3

Në tekstin me titull “Zodiaku”, nënvizoni rastet e përdorimit të apostrofit në trajtat e shkurtra dhe tregoni rastin.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi: Vlerësohet pjesëmarrja gjatë orës, veprimet në situatë, saktësia në dhënien e përgjigjeve, qortimet që u bëjnë gabimeve të shokëve dhe zbatimi i rregullave të mirësjelljes në klasë.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 4. Shkruani një shkrim të shkurtër me temë “Fluturim në kozmos”, ku të përdorni deri në katër raste të përdorimit të trajtave të shkurtra dhe të bashkuara në të cilat përdoret apostrofi.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: • zbaton njohuritë e fituara në drejtshkrim dhe drejtshqiptim; • dallon format e shtjelluara nga ato të pashtjelluara të foljeve; • dallon vlerat modale dhe kohore të foljeve përbrenda ligjëritimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):

I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Folja

Fjalët kyçe: folje, kuptim, fjali, kohë, zgjedhimi, numër, vetë.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- zgjedhon saktë foljet në formën veprorë në të gjitha mënyrat;
- dallon në tekst foljet;
- identifikon mjetet me të cilat ndërtohet folja.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkumës me ngjyra, tabela.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Shoqëria dhe mjedisi

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Pema e mendimeve, INSERT, rrjeti i diskutimi, punë në çifte, diagrami i Venit, punë në grupe.

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Pema e mendimit

Mësimdhënësi/a fillon orën mësimore me një diskutim, duke iu rikujtuar nxënësve njohuritë paraprake të foljes, si:

- Ç'është folja?
- Çfarë tregon folja?
- Si e përshtatim foljen?
- Si përdoret folja në fjali?
- Sa zgjedhime ka folja?
- Cila janë zgjedhimet e foljes?

Mësimdhënësi/ja gjatë diskutimit me nxënës paraqet në tabelë pemën e mendimeve, ku shkruan Folja (*e rrumbullakon dhe në secilën shigjetë të rrumbullakuar shkruan mendimet e nxënësve - ndryshe quhet kllaster*) Mësimdhënësi/ja u shpjegon nxënësve si të organizojnë konceptet kryesore në pemën e mendimeve që tregon lidhjet midis temave.

P.sh. folja:

- është pjesë e ndryshueshme e ligjëratës;
- tregon veprim, të cilin e kryen kryefjala e fjalisë: *shkruaj, mbjell, kërcej...*
- tregon gjendje, në të cilën ndodhet kryefjala e fjalisë: *mendoj, mbetem, gëzohem...*
- përshtatet në numër dhe vetë me kryefjalën: *kjo ishte parë...*
- përdorimi i foljeve në fjali, si folje ndihmëse: *unë jam nisur që prej dy orësh...*
- zgjedhimet e foljes:
 - Zgjedhimi i parë: *lexoj, luaj, mësoj....*
 - Zgjedhimi i dytë: *flas, kap, mbjell...*
 - Zgjedhimi i tretë: *di, pi, rri...*

Ndërtimi i njohurive të reja: INSERT

Pastaj nxënësit udhëzohen që përmes metodës INSERT të paraqesin njohurit që kanë për foljen në tabelën e teknikës INSERT në dyshe pastaj diskutojnë në grup, përfaqësuesit e grupeve dalin e plotësojnë njërën nga rubrikat në tabelë...

✓	+	-	?
Folja tregon veprim, gjendje...	Folja është gjymtyra kryesore dhe më e rëndësishmja e fjalisë....	Foljet <i>kam</i> dhe <i>jam</i> quhen folje ndihmëse, kur përdoren për të ndërtuar format e kohëve të përbëra të foljes.	Foljet e parregullta përfshijnë ato folje, të cilat pësojnë ndryshime në rrënjën e tyre gjatë zgjedhimit: <i>jam</i> , <i>qeshë</i> , <i>qenë</i> ; <i>kam</i> , <i>pata</i> , <i>pasur</i> ; <i>shoh</i> , <i>pashë</i> , <i>parë</i> .

p.sh.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimi

Pasi nxënësit të përmbledhin foljen dhe disa nga veçoritë gramatikore të saj, që janë në tekstin mësimor, atëherë fillojnë diskutimin secili grup duke prezantuar punën e bërë dhe duke plotësuar njëri-tjetrit, kështu arrijmë të përmbledhim orën mësimore. Në fund prezantojnë modelin e pemës së mendimit dhe INSERT-it në projektor.

Punë me grupe

Ushtrimi 1 - Nënvizoni foljet.

Pak nga pak shqoi në errësirë një tufë rrezesh drite të dobëta e të kuqërremta. Atë e rrezatonte një libër i hapur, i cili qëndronte pezull mu në mes të sallës vezake. Libri rrinte pak pjerrtas, kështu që ajo ia dallonte titullin. Ai ishte i lidhur me një kapak prej mëndafshi në ngjyrën e bakrit dhe, njëlloj si te gjerdani që Perandoresha-fëmijë e mbante të varur në qafë, edhe në atë libër dukeshin dy gjarpërinj që kafshonin bishtin e njëri-tjetrit dhe formonin një figurë.

Ushtrimi 2 - Plotësoni tabelën me folje me kuptim të plotë leksikor dhe me folje ndihmëse.

Ushtrimi 3 - Plotësoni fragmentin e mëposhtëm me foljet që mungojnë.

Mënyra se si nxënësit i _____ detyrat e tyre _____ në vite. Në vitin 1900, fëmijët

_____ me shkumësa dhe pena. Sot fëmijët i _____ shumë kohë kompjuterit. Por ende në botë, mjete parësor i të shkruarit _____ lapsi.

Ushtrimi 4 - sipas kërkesës.

Ushtrimi 5 - Në foljet e ushtrimit të mësipërm, dalloni mbaresën nga tema e foljes. Më pas përcaktoni numrin, vetën, kohën.

Ushtrimi 6 - Shkruani foljen e duhur, duke përshtatur vetën dhe numrin me kryefjalën e fjalisë.

– Arbana i _____ një ninullë motrës së vogël. – Përpara postës _____ shumë njerëz në radhë. – Kushërinjtë e mi dje _____ një ekskursion mësimor.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejtë të foljes në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 7, Nënvizoni foljet dhe grupojini në një tabelë sipas zgjedhimeve që u përkasin.

Jeta është një mundësi, kape.

Jeta është bukuri, adhuroje.

Jeta është lumturi, shijoje.

Jeta është ëndërr, bëje realitet.

Jeta është sfidë, përballoje.

Jeta është detyrë, përmbushe.

Jeta është lojë, luaje.

Jeta është e çmuar, kujdesu për të.

Jeta është pasuri, vlerësoje.

Jeta është dashuri, jetoje.

Jeta është mister, zbuloje.

Jeta është premtim, mbaje.

Jeta është trishtim, kaloje.

Jeta është himn, këndoje.

Jeta është betejë, pranoje.

Jeta është aventurë, rrezikoje.

Jeta është jetë, mbroje.

Nënë Tereza

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore


Mësimdhënësi/ja vlerëson punën aktive të nxënësve, motivon duke komentuar punën e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - zbaton njohuritë e fituara në drejtshkrim dhe drejtshqiptim; - dallon format e shtjelluara nga ato të pashtjelluara të foljeve - dallon vlerat modale dhe kohore të foljeve përbrenda ligjëritimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit: Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit: Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis: Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale: Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare: Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			


ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore: Përdorimi i foljeve në fjali (ora e dytë)	
Fjalët kyçe: folje, kuptim, fjali, kohë, zgjedhimi, numër, vetë.	
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - zgjedhon saktë foljet në formën veprorë në të gjitha mënyrat; - dallon foljet në tekst; - identifikon mjetet me të cilat ndërtohet folja.	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkurtesa me ngjyra, tabela.	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shoqëria dhe mjedisi	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: <i>Stuhi mendimi-kllaster; punë individuale; diskutim.</i>	
Organizimi i orës së mësimi Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: <i>Stuhi mendimi-kllaster;</i> Pyeten nxënësit çfarë dinë për foljet dhe përgjigjet e tyre pasqyrohen në kllaster.	
Ç'dini për foljet? <pre> graph TD Folja[Folja] --> emërton[emërton] Folja --> ndahet[ndahet] Folja --> përshtatet[përshtatet në vetë me kryefjalën] emërton --> veprim[veprim] emërton --> gjendje[gjendje] veprim --> frymori[të një frymori a sendi] gjendje --> frymori ndahet --> sipas_vetes[sipas vetës që përdoren] sipas_vetes --> kuptim[me kuptim të plotë] sipas_vetes --> ndihmese[ndihmëse] sipas_vetes --> gjysmendihmese[gjysmëndihmëse] përshtatet --> veta[Veta numri koha mënyra diateza] </pre> * <i>vetore</i> → përdoret në të tria vetat * <i>njëvetore</i> → vetëm në vetën e tretë * <i>pavetore</i> → nuk marrin kryefjalë	
Sugjerim: <i>Ndarja sipas vetës, të shtohet pas shpjegimit nga mësuesi.</i> Ndërtimi i njohurive të reja: <i>Punë individuale</i>	

U kërkohet nxënësve, të dallojnë foljet te fragmenti dhe të përcaktojnë cilat janë me kuptim të plotë, ndihmës dhe gjysmëndihmës.

Kompjuterët janë aparate të ndërlikuara, që mund të përpunojnë sasi të mëdha informacioni brenda një kohe shumë të shkurtër. Përdorimi i kompjuterëve është bërë një mjet pune kaq i rëndësishëm, saqë sot, ata mësohen në shkollë. Ata mund të grumbullojnë të dhëna në sasi jashtëzakonisht të mëdha.



*Shpjegohen rastet kur foljet janë njëvetore dhe pavetore.



Hapi III. Punohen individualisht ushtrimet 1, 2, 3.

1. Gjeni cilat nga foljet që vijojnë janë pavetore dhe cilat njëvetore.

mësoj, kam, dal, vij, vetëtin, thuhet, nevojitet, hingëllin, gjelbëron, gurgullon, mbaroj, cicëron, bën ftohtë, gjëmon, bie shi, më vjen keq, lexohet, shkruaj, s'jetohet, dua, rri.

2. Dalloni foljet njëvetore, thoni se ç'tregojnë ato.

Drita u venit edhe më. Vajza ndezi llambën.

Mësuesi dukej pak i vlarë nga lodhja e rrugës, pinte ujë si pa dëshirë dhe heshtja e tij shprehte një nga ato mërzitë kur gjëja më e udhës është që mikun ta ftohet në gjumë.

Në verë frynte vazhdimisht një erë e lehtë nanuritëse, në vjeshtë era lodhej e shushurinte si fllad duke sjellë ca klithma të largëta zogjsh.

Do ta fajësonte veten, asgjë më të mençur s'mund të bënte.

Kur arritëm në fshat, ishte natë. Nëpër re voziste hëna e ngrënë.

3. Në vend të vizave, vendosni foljen e duhur. Gjeni foljet pavetore dhe përcaktoni se çfarë tregojnë ato.

(ka, të shëtitnin, kishte, rrihej, bën, duhet, frynte, mund, ndodh, s'jetohet)

Në pyllin pranë ka disa lloje kafshësh.


Kështu ndodh gjithnjë me shokun tim.

Nga jugu po vrenjte dhe frynte një erë e lehtë shiu.


Në dimër <i>s'jeto</i>het pa zjarr. Në rrugë <i>kishte</i> shumë njerëz. Të dielave pasdite e kishin zakon të <i>shëtitnin</i> te kodrat e liqenit për disa orë. Për një përshkrim të suksesshëm <i>duhet</i> bërë një vëzhgim i vëmendshëm. Ne <i>mund</i> ta përshkruajmë historinë edhe me gojë edhe me shkrim. Fëmijës nuk i <i>rrihej</i> në një vend dhe lëvizte në çdo cep të dhomës. Është mëngjes herët dhe bën ftohtë. Nuk <i>duhet</i> nxituar. Në përfundim, çdo ushtrim diskutohet.
Vlerësimi i nxënësve: Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejt të foljes në fjali.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Formoni fjali me foljet <i>lexoj, flas, zhvilloj, pres, laj, eci, hyj</i> , duke i përdorur në mënyra të ndryshme.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja vlerëson punën aktive të nxënësve, motivon duke komentuar punën e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon foljet, i ndan ato në tri zgjedhime, dallon foljet në gjashtë mënyra, gjen temën, mbaresën e foljeve, dallon format e pashtjelluara në ushtrimet e librit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit: Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis: Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale: Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare: Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për mjedisin.			

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Njësia mësimore: Mënyrat dhe kohët e foljes
Fjalët kyçe: folje, zgjedhim, kohë të thjeshta, të përbëra, format e shtjelluara, e pashtjelluara.
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: • kupton që folja mund ta shprehë veprimin në mënyra të ndryshme; • tregon kohën kur ka ndodhur veprimi në lidhje me çastin e ligjërit; • kupton që veprimi kryhet nga folja.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkurtes me ngjyra, tabela.
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin. Pasuron fjalorin me shprehje të reja.
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Mësimdhënie e ndërsjellë, Pema e mendimit, Shqyrtim i përbashkët.
Organizimi i orës së mësimit Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Mësimdhënie e ndërsjellë - Mësimdhënësi/ja fillon orën mësimore, duke diskutuar me nxënësit për njohurit paraprake të foljes, si: • Çfarë tregon folja? • Sa zgjedhime ka folja? • Cilat janë kohët bazë të foljes? • Cilat janë mënyrat e foljes? • - Nxënësit shprehin mendimet e tyre, mësimdhënësi/ja në mënyrë të ndërsjellë u shpjegon se: • folja mund ta shprehë veprimin në mënyra të ndryshme; • mënyra të foljes quajmë format e ndryshme që merr folja për të shprehur një veprim të sigurt, të mundshëm, të dëshirueshëm ose të papritur; • folja ka gjashtë mënyra: dëftore, lidhore, kushtore, habitore, dëshirore dhe urdhërore (shembuj); • folja ka tri kohë: kohën e shkuar, kohën e tashme dhe kohën e ardhme (shembuj). Ato tregojnë kohën kur ka ndodhur veprimi në lidhje me çastin e ligjërit; • koha e shkuar ka pesë nëndarje; koha e ardhme ka dy nëndarje: kohën e ardhme dhe kohën e ardhme të përparme (shembuj). • format e pashtjelluara të foljes nuk zgjedhohen (shembuj). Ndërtimi i njohurive të reja: Pema e mendimit Një nxënësi/e lexon me zë informacionin në libër, duke u ndalur të shembujt, të cilët i sqarojmë bashkërisht, si për format e shtjelluara e të pashtjelluara të foljes, kohët bazë, të thjeshta e të përbëra. Udhëzohen nxënësit/et që, përmes pemës së mendimeve të paraqesin njohurit që kanë për mënyrat dhe kohët e foljes. Punohet në grupe, diskutojnë bashkërisht, përfaqësuesit e grupeve dalin e plotësojnë njëren nga rubrikat në tabelë, si p.sh.:

Kohët bazë të foljes**Mënyrat e foljes dhe veprimi****Zgjedhimi i foljeve të rregullta****Formimi i formës joveprore**

Mësimdhënësi/ja vëzhgon punën e nxënësve, sqaron ku ka paqartësi, ndihmon nxënësit/et për të plotësuar pemën e mendimeve në mënyrë të drejtë. Një model mund të bëhet kështu:



Secili grup prezanton punën e bërë për mënyrat dhe kohët e foljes. Argumentojnë punën me shembuj konkretë. Dëgjohen nga klasa.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura. Shqyrtim i përbashkët

Gjeni foljet në fragmentin e mëposhtëm:

Hapni një llogari kursimi dhe vlerësoni përparësinë që ju sjell sigurimi i një depozite personale. Depozitimin e rregullt në llogarinë e kursimit vlerësojeni si një shpenzim të pashmangshëm, njëlloj si pagesën e faturës së energjisë elektrike.

- Nxënësit/et në grupe dyshe gjejnë foljet, analizojnë ato: kohë, vetë, numër.
- Si e shprehin mendimin foljet: hapni, vlerësoni, vlerësojeni? (urdhër, këshillë)
- Po folja sjell? (veprim i sigurt, dëftore)

Pastaj diskutojnë të gjithë nxënësit/et me mësimdhënësin/en, duke plotësuar njohuritë e nxënësve me konceptet për foljen: zgjedhim, mënyrë, folje ndihmëse kam, jam, tema e mbaresa e foljeve, format e shtjelluara e të pashtjelluara etj.

Vazhdohet me pjesën e ushtrimeve, nxënësit ndahen në pesë grupe, si:

Grupi I, numër 1. Nënvizoni foljet dhe vendosini në të gjitha mënyrat, në tabelë.

Grupi II, numër 2. Shkruani fjalinë e mëposhtme duke e përdorur foljen në të gjitha mënyrat e saj.

Grupi III, numër 3. Plotësoni vendet boshe me foljet që mungojnë dhe tregoni mënyrën e kohën e tyre.

Grupi IV, numër 4. Gjeni foljet dhe tregoni se në çfarë mënyre, kohe, vete dhe numri janë.

Grupi V, numër 5. Formoni fjali me foljet *lexoj, flas, zhvilloj, pres, laj, eci, hyj*, duke i përdorur në mënyra të ndryshme.

Punohen në grupe, komentohen. Mësimdhënësi/ja vëzhgon punën e tyre.

Ushtrimet prezantohen para klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejtë të mënyrave të foljes në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtroni për kohët e thjeshta dhe të përbëra të foljeve.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën aktive të nxënësve, motivon duke komentuar punën e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon llojet e fjalive njëkryegjymtyrëshe (foljore, vetore, pavetore, me vetë të pacaktuar, me vetë të përgjithësuar, emërore, përshkruese e treguese).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në media.			

II. VLERAT DHE QËNDRIMET - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathhtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: -Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Forma veprorë e foljeve

Fjalët kyçe: kategoria e diatezës, forma veprorë, mënyra dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore, urdhërore, veprimi i vërtetë, i mundshëm, i dëshirueshëm.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- zgjedh saktë foljet në formën veprorë në të gjitha mënyrat;
- dallon në tekst foljet e formës veprorë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit, tabela e zgjedhimit vepror të foljeve të të tria zgjedhimeve.


Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Harta e mendjes; Të nxënit në bashkëpunim; Lojë gjuhësore.

Organizimi i orës së mësimi


Hapi I. Nxënësit dinë se një nga kategoritë gramatikore të foljes është diateza dhe se ajo lidhet me formën e foljes. Shpjegohet për ta nëpërmjet kllasterit.



Hapi II. Drejtohen nxënësit në libër në faqen 280. Nëpërmjet bashkëpunimit të të gjithë aktorëve me njëri-tjetrin (nxënës-nxënës, mësues-nxënës) do të punohet për rikujtuar zgjedhimin e foljeve të të tria zgjedhimeve në formën veprorë.

a) Në ç'mënyrë mund ta paraqesë folësi veprimin e shprehur nga folja?

veprimi
i shprehur nga folja



i vërtetë _____ mënyra dëftore; mënyra habitore
i mundshëm _____ mënyra lidhore; mënyra kushtore
i dëshirueshëm _____ mënyra dëshirore; mënyra urdhërore

b) Sa kohë ka mënyra dëftore? Cilat janë?

Plotësohet tabela me format gramatikore të foljes *punoj* në mënyrën dëftore.

*Këtu shpjegohet edhe përdorimi i dy formave gramatikore të kohës së *ardhme të së shkuarës*: do të puno-ja; dhe kohës së *ardhme të përparme të së shkuarës*: do të kisha punuar.

c) Po mënyra habitore sa kohë ka? Si shprehet veprimi në mënyrën habitore? Lexohet tabela në libër.

d) Si shprehet veprimi në mënyrën lidhore? Sa kohë ka? Plotësohet tabela.

e) Kur është i mundshëm veprimi në mënyrën kushtore? Cilat janë kohët e kësaj mënyre? Lexohet tabela.

f) Po mënyra dëshirore dhe urdhërore, çfarë formash gramatikore kanë?

Tërhiqet vëmendja për mbaresat e veçanta në të tria zgjedhimet. Lexohen tabelat.

Hapi III. Për t'u çlodhur dhe argëtuar nxënësit, zhvillohet një lojë gjuhësore. Nxënësit, zinxhir njëri pas tjetrit, zgjedhojnë foljen *di* në formën veprorë në të gjitha mënyrat. Secili nga nxënësit thotë një vetë e kështu me radhë derisa përfundon zgjedhimi.

Vlerësimi i nxënësve: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 1, sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare:	Lënda:	Shkalla e kurrikulës:	Klasa
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	IV	IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon llojet e fjalive njëkryegjymtyrëshe (foljore, vetore, pavetore, me vetë të pacaktuar, me vetë të përgjithësuar, emërore, përshkruese e treguese).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit- Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit- Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë- Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis- Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale- Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare- Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: -Të komunikuarit. Të dëgjuarit. Të folurit. Të shkruarit. Të lexuarit. Të kuptuarit. Përdorimi i teknologjisë informative. Aftësitë e të menduarit. Të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Forma joveprore e foljeve			
Fjalët kyçe: forma joveprore, pjesëza “u”, mbaresa, folja ndihmëse.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - përdor saktë në fjali folje të formës joveprore; - dallon foljet e formës joveprore në tekst; - përcakton kategoritë gramatikore të foljeve në formë vepore dhe joveprore të përdorura në tekst.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, tabela e zgjedhimit jovepror të foljeve, Gramatika 1.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS

GJATË ORËS MËSIMORE: *Stuhi mendimi; Punë individuale; Diskutim.*

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Stuhi mendimi*

Nëpërmjet stuhisë së mendimit kontrollohen njohuritë e nxënësve për formën joveprorë.

- Ç'tregon veprimi i shprehur nga folja në formën joveprorë?
- Cilat janë mjetet me të cilat ndërtohet forma joveprorë e foljes?

Ndërtimi i njohurive të reja: *punë individuale;*

Punohen në tekst ushtrimet 1-6 të faqes 286 - 287.

3. Vini në vend të vizave foljet e formës joveprorë dhe përcaktoni se në ç'kohë dhe vetë janë ato.

Djali mallëngjehet gjithmonë kur sheh fotot e gjyshërve të tij.

Ne nuk e dinim se autobusi për në Vlorë niset në orën 7.00 të mëngjesit.

Arta me Verën po afroheshin drejt nesh me një tufë të madhe me lule.

Ndonëse ata janë kushërinj të parë, shihej me njëri-tjetrin vetëm një herë në vit.

Në shtëpinë tuaj, dritat shuhen shumë vonë.

Pasditë mamaja merret me punët e shtëpisë.

Gjatë fundjavës, në Durrës takohem shpesh me disa shoqe të kursit të baletit.

Anila përpiquej të mos mungonte asnjëherë në shkollë, që të mos mbetej prapa në mësim.

3. Kthejini foljet e ushtrimit të mësipërm në kohën e pakryer të mënyrës dëftore sipas shembullit të dhënë.

Djali mallëngjehet gjithmonë kur sheh fotot e gjyshërve të tij.

Djali mallëngjehej kur shihte fotot e gjyshërve të tij.

Ne nuk e dinim se autobusi për në Vlorë nisej në orën 7:00 të mëngjesit.

Arta me Verën po afroheshin drejt nesh me një tufë të madhe me lule.

Ndonëse ata janë kushërinj të parë, shiheshin me njëri-tjetrin vetëm një herë në vit.

Në shtëpinë tuaj dritat shuheshin shumë vonë.

Pasditë mamaja merrej me punët e shtëpisë.

Gjatë fundjavës, në Durrës takohej shpesh me disa shoqe të kursit të baletit.

Anila përpiquej të mos mungonte asnjëherë në shkollë, që të mos mbetej prapa në mësim.

4. Qarkoni fjalitë ku fjalëza u shërben si pjesëz për të formuar kohën e kryer të thjeshtë të formës joveprorë.

U dërgoi të gjithëve nga një kartolinë për festat.

Duhet t'u flasësh shoqeve e të mos bësh debate të kota me to.

U uroi mirëseardhjen të gjithëve dhe filloi t'i sqaronte për arsyet e takimit.

Pas pak, Drini u ngrit dhe u nis për në shtëpi, i kredhur në mendime për historinë që dëgjoi.

Agimi u ul në kompjuter për t'i shkruar një letër motrës së tij.

Ua përsëriti disa herë mësimin, por ata përsëri nuk e kuptuan.

Mos u hani kot me njëri-tjetrin.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *diskutim*

5. Nënvizoni foljet në mënyrën dëftore dhe tregoni se në ç'formë janë përdorur. Përcaktoni kohën dhe vetën e tyre.

Të gjitha ballinat e godinave ishin stolisur me flamuj të larmishëm e në ngjyra të ndezura.

Zilja për të hyrë në klasë po vononte, megjithëse nxënësit ishin rreshtuar të gjithë.

Po të mos i kishte prishur punë Arditi, tani do t'i ishin përmbushur të gjitha dëshirat.

Mësuesi filloi të shqetësohej, meqë nuk kishte mbërritur ende asnjëri nga nxënësit.

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi i nxënësve: Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 7, sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën e nxënësve në grupe, të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon foljet, i ndan ato në tri zgjedhime, dallon foljet në gjashtë mënyra, gjen temën, mbaresën e foljeve, dallon format e pashtjelluara në ushtrimet e librit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit: Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis: Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale: Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare: Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për vetën dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për mjedisin.			

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesorja dhe format e tjera të pashtjelluara të foljes

Fjalët kyçe: pjesorja, format, folje, zgjedhim, kohë të thjeshta, të përbëra, format e shtjelluara, e pashtjelluara.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- klasifikon fjalët sipas mënyrës së formimit;
- tregon si janë formuar fjalët jo të parme;
- dallon temat fjalëformuese të fjalëve;
- formon fjalë të reja me mënyra të ndryshme;
- dallon saktë përbërësit e fjalëve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkurtesa me ngjyra, tabela.


Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin. Pasuron fjalorin me shprehje të reja.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Pema e mendimit, Pyetje-përgjigje, Diskutim, Punë në dyshe, Punë në grupe.

Organizimi i orës së mësimi

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: pema e mendimit

Hapi I. Nisur nga njohuritë që zotërojnë, nxënësit plotësojnë Pemën e mendimit për format e pashtjelluara.



Nxënësit do të japin shembuj, nga dy fjalë për secilin grup.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe

Hapi I. Shkruhet tema në tabelë. Udhëzohen nxënësit që të lexojnë informacionin e paraqitur në tekst, në faqen 246-247 dhe t'u përgjigjen pyetjeve, të cilat do të listohen në tabelë. Klasa ndahet në tri grupe.

Grupi I.

1. Dalloni pjesoret sipas skemës së dhënë: pjesore – mbiemër.

- a) Karvanët ktheheshin ngarkuar plot e përplot. b) Jam shumë i ngarkuar me punë. c) Këpucët i kishte të lagura. d) Mos rri lagur, se ftohesh.
dh) Ishte njeri i mbyllur në vetvete.

2. Çfarë është përbërja (kompozimi)? Si formohen fjalët e reja? Sa lloje kompozitash kemi?

Grupi II.

Rishkruani fjalitë, duke i kthyer pjesoret në mbiemra dhe anasjellas.

Derën e gjeta të hapur. _____

Shtëpia ishte e larë dhe e pastruar. _____

Kjo poezi nuk është e përkthyer mirë. _____

Grupi III.

Dalloni format e pashtjelluara foljore dhe thoni llojin e tyre.

Kreshnikët e Jutbinës tuboheshin në bjeshkë të dielën, pa dalë dielli, për të kaluar së bashku disa orë nën hijen e pemëve, duke ngrënë e duke pirë e duke kujtuar bëmat e hershme. – Po ti, o Muj, a nuk ke për të rrëfyer ndonjë trimëri? – Habitem me ju, o burra, se mbetet gjithë ditën e lume duke shitur trimëri.

Grupi IV

Formoni katër fjali me formën përcjellore të foljeve të dhëna.

mendoj _____

_____ ngre _____

_____ afro _____

Grupi V

Rishkruani ato fjali në të cilat forma mohore e foljes mund të kthehet në formë foljore të shtjelluar. P.sh.:

Erdhi pa ftuar. Erdhi, ndonëse nuk ishte ftuar.

Doli pa përcjellë. _____

Qëndronte pa folur. _____

Pa u munduar, nuk fitohet asgjë. _____

Duhej të mbërrinin pa rënë nata. _____

Fliste pa na vështruar në sy. _____

Grupi VI

Rishkruani fjalitë duke e kthyer formën për të + pjesore në formë foljore të shtjelluar.

Njeriu bën gjithçka për të gjetur lumturinë. _____

Njeriu bën gjithçka që _____

Të notuarit ndihmon për të pasur një jetë më të shëndetshme. _____

Pat thënë se s’kishte për t’u kthyer më në atë vend. _____

Ankohej se kishte për të bërë shumë detyra. _____

Hapi II. Një nxënës, përfaqësues i çdo grupi, prezanton përgjigjet. Aktivizohen sa më shumë nxënës.

Plotësimi i Pemës së mendimit, të paraqitur në fillim të orës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë në dyshe, punë në grupe.*

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejt të mënyrave të foljes në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 7. Në pjesën me titull “Mandolina e braktisur”, nënvizoni pjesoren dhe format e pashtjelluara të foljeve. Emërtoni çdonjëren prej tyre.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën aktive të nxënësve, motivon duke komentuar punën e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Morfologji		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon foljet, i ndan ato në tri zgjedhime, dallon foljet në gjashtë mënyra, gjen temën, mbaresën e foljeve, dallon format e pashtjelluara në ushtrimet e librit. Përdor foljet modale/gjysmëndihmëse në kuptimin e duhur në tekst.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit: Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis: Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale: Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare: Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative.			

Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme.

Kritikon, duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për mjedisin.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Kategoritë gramatikore të emrit, mbiemrit, foljes, përemrit dhe numërorit. Parafjalë, lidhëz. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Foljet gjysmëndihmëse

Fjalët kyçe: folje gjysmëndihmëse, këpujore, struktura, përdorimi.

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- klasifikon fjalët sipas mënyrës së formimit;
- tregon si janë formuar fjalët jo të parme;
- dallon temat fjalëformuese të fjalëve;
- formon fjalë të reja me mënyra të ndryshme;
- dallon saktë përbërësit e fjalëve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti, fletore, shkumës me ngjyra, tabela.


Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Zhvillon komunikimin. Pasuron fjalorin me shprehje të reja.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Pema e mendimit, Pyetje-përgjigje, Diskutim, Punë në dyshe, Punë në grupe.

Organizimi i orës së mësimi

Pyeten nxënësit çfarë dinë për foljet dhe përgjigjet e tyre pasqyrohen në kllaster.

Ç'dini për foljet?



Kallëzuesi i thjeshtë shprehet me një folje ose shprehje foljore, e cila tregon mënyrë, kohë, vetë. Kallëzuesi i përbërë përbëhet nga dy pjesë, ku pjesa e parë është folje gjysmëndihmëse, që tregon një mënyrë veprimi, kurse pjesa e dytë është folje me kuptim të plotë leksikor.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe

Hapi I. Shkruhet tema në tabelë. Udhëzohen nxënësit që të lexojnë informacionin e paraqitur në tekst, në faqen 248-249 dhe t'u përgjigjen kërkesave, të cilat do të listohen në tabelë. Klasa ndahet në tri grupe.

Grupi I.

1. Lexoni fjalitë: Shiu filloi menjëherë. Ata mund të vijnë shumë shpejt. Miqtë tanë duhet të ndihmohen.

Foljet gjysmëndihmëse e zbehin kuptimin e tyre leksikor gjatë përdorimit si pjesë përbërëse e kallëzuesit. Folje gjysmëndihmëse mund të jenë foljet: jam, mund, duhet, do, nis, filloj, vazhdoj.

Grupi II.

Folja ndihmëse *jam* shërben për të vënë në lidhje pjesën emërore (emër, mbiemër, përemër) të kallëzuesit me kryefjalën, pra shërben si këpujë: – Është shumë i ndjeshëm, – plotësoi infermierja.

Grupi III.

Struktura e përdorimit të foljeve si gjysmëndihmëse.

Foljet *filloj*, *nis*, *zë*, *vazhdoj*, *mbaroj* tregojnë fillimin, vazhdimin dhe mbarimin e veprimit. Për të shprehur fillimin e veprimit, përdoren foljet *filloj*, *nis*, *zë* + folje themelore në lidhore. *Filloi të lëvizte ngadalë*. Për të shprehur vazhdimin e veprimit, përdoren foljet *vazhdoj*, *vijoj* + folje në lidhore. *Gjyshja vazhdoi ta shihte të nipin me mall*.

Hapi II. Një nxënës, përfaqësues i çdo grupi, prezanton përgjigjet. Aktivizohen sa më shumë nxënës. Plotësimi i Pemës së mendimit, të paraqitur në fillim të orës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë në dyshe, punë në grupe.

Hapi I. Ushtrimi 1. Në tekstin e mëposhtëm, dalloni foljet ndihmëse nga foljet gjysmëndihmëse.

a) Pylli vetëtin nga tisi i florinjte i rrezeve të diellit, që zënë e thyhen në shkëlqimin e gjetheve. Ketrat hidhen nga njëra degë te tjetra dhe mbajnë në duart e vockla boçe pishe të hapura. Aromat e luleve, të barit dhe të drurëve janë përzier së bashku dhe të krijojnë një ndjesi të çuditshme, si jashtëplanetare. Kjo gjendje të bën të ëndërrosh për gjëra të gëzuara.

b) Nga koha kur romakët mundën Teutën dhe zotëruan detin, shqiptarët u detyruan të mbështeteshin me shpatulla në male. Tani duhej luftuar për të tjera troje dhe me të tjera mjete.

Hapi II. Punë në grupe.

Grupi 1. Ushtrimi 2. Shkruani tri fjali në të cilat foljet *filloj*, *vazhdoj*, *mbaroj* t'i përdorni një herë si folje me kuptim të plotë leksikor, një herë si folje gjysmëndihmëse.

Grupi II. Ushtrimi 3. Shkruani dy fjali në të cilat të përdorni foljen *jam* një herë si pjesë e kallëzuesit emëror dhe një herë me kuptim të plotë leksikor.

Grupi III. Ushtrimi 4.

Shkruani pesë fjali në të cilat të përdorni foljet gjysmëndihmëse:

vazhdoj _____

mund _____

filloj _____

nis _____

do _____

Në përfundim, çdo ushtrim diskutohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për përdorimin e drejtë të mënyrave të foljes në fjali.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 5. Në tekstin me titull “Zbulimi i një të fshehte shekullore”, nënvizoni foljet gjysmëndihmëse.


Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja vlerëson punën aktive të nxënësve, motivon duke komentuar punën e tyre.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Rrëfime popullore		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon tekste të kulturës tradicionale nga tekste praktike (përralla, miti, këngët e kreshnikeve, ftesa, urime, falënderime).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Martesa e Halilit			
Fjalët kyçe: shoshojnë, sharroj, n’Kotorre t’reja, korit, fligishti, daji, Krajli , Jutbina, Muji dhe Halili, fiskajë, Tusha.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - përshkruan ngjarjen në tekst; - dallon njeriun me vlera në shoqëri; - zbulon mesazhin që përcjell ky tekst te ne.			
Kriteret e suksesit: - Rikujton krijimet e vjetra shqiptare. - Përshkruan një element dallues të poezisë epike. - Analizon vargjet dhe dallon figurën letrare të krahasimit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9 - Fleta të bardha, marker (shënjes), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:**Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kllaster**

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë “Poezia epike” dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë një kllaster me mendimet e tyre për temën. Për shembull:



Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë së re mësimore: “Martesa e Halilit”, dhe u shpjegon nxënësve pjesën “Para leximit” dhe për Eposin e Kreshnikëve.

Ndërtimi i njohurive të reja: - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje - Secili mëson një

Në këtë fazë, mësuesi/ja së pari lexon poezinë epike të zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend (lexim artistik) me zë dhe pas leximit të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/ emocionet që leximi i poezisë epike zgjoi tek ta. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre punuese detyrat nga teksti shkollor.

Grupi I: Kuptojmë poezinë, ushtrimet 1, 2

Grupi II: Analizojmë poezinë, ushtrimet 3, 4, 5, 6, 7

Grupi III: Interpretojmë poezinë, ushtrimet 8, 9

Grupi IV: Gjuha e poezisë, ushtrimet 10, 11, 12, 13 dhe “Reflektojmë rreth poezisë”, ushtrimi 14. Mësuesi/ja ndihmon grupet e nxënësve, nëse është e nevojshme.

Pastaj udhëzohen të lexojnë pjesën e njëjtë dhe të shkruajnë detyrën e udhëzuar nga mësuesi/ja.

Nxënësit punojnë në grupet e tyre të punës (tashmë të ndarë në tri grupe me numër të njëjtë nxënësish).

Grupi i parë: Diskutues - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe pas leximit të tregojnë ngjarjen para nxënësve tjerë. Një nxënës prezanton grupin (p.sh.: Nxënësit tregojnë pjesën në pika të shkurtra, sepse të gjithë e kanë lexuar.)

Grupi i dytë: Afinitet - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të mendojnë për detyrat jashtë shkollës, p.sh.: ku mundën të gjejnë material shtesë dhe cili është i nevojshëm. Grupi i dytë ka të drejtë të angazhojë nxënësit për detyrat e shtëpisë.

Grupi i tretë: Kritikët - Nxënësit udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të krijojnë mendime pozitive dhe negative, duke i përdorur komentet e tyre për të bindur nxënësit e tjerë për qëndrimin e tyre. Nxënësit mund të kritikojnë krijimet fantastike, që shpesh i gjejmë në traditën popullore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen të shkruajnë një pesëvargësh për Tanushën. <u>Tanusha</u> <u>E bukur</u> <u>e lumtur</u> <u>Vallëzonte</u> <u>këndonte</u> <u>luftonte</u> <u>Tanusha e bija e Krajlit</u> <u>Halili</u>
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).
Detyrat dhe puna e pavarur
Mësoni përmendsh pjesën e përshkrimit të Tanushës.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti poetik		Rezultati i të nxënësve të temës: Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Gjuha shqipe			
Fjalët kyçe: hordhi, beden, divan, bejte, dëlir, jerm, përçartje, martir, lehonë.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore Nxënësi/ja: - përshkruan zhvillimet e gjuhës shqipe ndër vite; - dallon qëndresën e shqiptarëve ndaj pushtuesit; - zbulon mesazhin që sjell ky tekst te ne.			

Kriteret e suksesit:

- Rikujton krijimet e autorit Ismail Kadare.
- Përshkruan një element dallues të poezisë kushtuar gjuhës.
- Analizon vargjet dhe dallon figurën letrare të metaforës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9 - Fleta të bardha, marker, tabela.


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Kllaster

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë “Ismail Kadare” dhe udhëzon nxënësit të shkruajnë një kllaster me mendimet e tyre për temën. Për shembull:



Pas përfundimit të kllasterit, mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë të njësisë së re mësimore “Gjuha shqipe” dhe shpjegon për nxënësit pjesën para leximit, si dhe figurën letrare të metaforës.

Ndërtimi i njohurive të reja: - Marrëdhënia-Pyetje-përgjigje - Citat-Koment

Në këtë fazë, mësuesi/ja lexon së pari poezinë e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit që ta lexojnë me rend (lexim artistik) me zë dhe, pas leximit, të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshqypjet/mbresat/ emocionet që zgjoi tek ata leximi i poezisë. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre të punës detyrat nga teksti shkollor.

Grupi I: Analizojmë poezinë, ushtrimet 1, 2, 3, 4

Grupi II: Interpretojmë poezinë, ushtrimet 5, 6, 7

Grupi III: Gjuha e poezisë, ushtrimet 8, 9, 10 dhe Reflektojmë rreth poezisë, ushtrimi 11.

Mësuesi/ja ndihmon grupet e nxënësve, nëse është e nevojshme.

Pastaj udhëzohen të lexojnë pjesën e njëjtë dhe të shkruajnë detyrën e udhëzuar nga mësuesi/ja.

Nxënësit do të zgjedhin strofën që u pëlqen dhe do të komentojnë zgjedhjen e tyre. Për shembull:

Strofa e pëlqyer	Komente
Kur panë se gjuhës S'i hodhën dot prangat, Lëshuan drejt saj Gjithfarë merimangash.	Nxënësit komentojnë zgjedhjen e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: **Pesëvargësh**

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen të shkruajnë një pesëvargësh për gjuhën.

Gjuha

E dashur e vlefshme

Shkruhet ruhet krijohet

Është pjesë e identitetit të njeriut

shqipe

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostifikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Të gjitha gjuhët pasurohen me fjalë të reja, që zakonisht krijohen nga fjalë ekzistuese. Por, pavarësisht se gjuha i ka fjalët e saj, në të ndërfiten edhe fjalë të huaja, të panevojshme. Përmendni disa prej tyre. Diskutoni në klasë rreth kësaj dukurie.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti poetik			Rezultati i të nxënit të temës: Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Njësia mësimore: Këndo ose vdis pa klithmë				
Fjalët kyçe: Bari, kosat e egra.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - përshkruan jetën dhe veprimtarinë e autorit; - dallon vargjet e përsëritura në poezi; - zbulon mesazhin që sjellë poezia.				
Kriteret e suksesit: - Rikujton krijimet e autorit Din Mehmeti. - Përshkruan një ritual pagan që gjendet në poezi. - Analizon vargjet dhe dallon figurat letrare.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9 - Fleta të bardha, marker (shënjeshtues), tabela.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.				
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh				

Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit:

Shpesh thuhet: “Heshtja është flori”. Si mendoni, a është kjo gjithmonë e vërtetë? Kur nuk duhet të zgjedhim të heshtim?

Nxënësit përgjigjen dhe diskutojnë me njëri-tjetrin duke i argumentuar mendimet e tyre.

Pas përfundimit të diskutimit, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësive të mësimore “Këndo ose vdis pa klithmë” dhe shpjegon për nxënësit pjesën “Para leximit” dhe për autorin.

Ndërtimi i njohurive të reja: Marrëdhënia Pyetje-përgjigje - Citat-Koment

Në këtë fazë, mësuesi/ja së pari lexon poezinë të zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit që ta lexojnë me rend (lexim artistik) me zë dhe, pas leximit, të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/ emocionet që zgjoi tek ata leximi i poezisë. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre të punës detyrat nga teksti shkollor.

Grupi I : Analizojmë poezinë, ushtrimet 1, 2, 3

Grupi II: Interpretojmë poezinë, ushtrimet 4, 5, 6, 7

Grupi III: Gjuha e poezisë, ushtrimet 8, 9, 10

Mësuesi/ja ndihmon grupet e nxënësve, nëse është e nevojshme.

Pastaj udhëzohen të lexojnë pjesën e njëjtë dhe të shkruajnë detyrën e udhëzuar nga mësuesi/ja.

Nxënësit/et do të zgjedhin strofën e pëlqyer dhe do të komentojnë zgjedhjen e tyre. Për shembull:

Strofa e pëlqyer	Komente
Bëhu i blertë si unë, më tha bari një natë këndo derisa të vallëzojnë yjet rreth diellit.	Nxënësit komentojnë zgjedhjen e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Ese të shkurtër

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen të shkruajnë një ese të shkurtër.

Realizoni një ese me temën: Kush zgjedh të heshtë, zgjedh të mbetet pa emër.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mësojeni përmendësh poezinë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti poetik.		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Sharlota			
Fjalët kyçe: roman në vargje, hebre, luftë, Sharlota, pikturë, jetë apo teatër?, vdekje			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon rrëfimtarin, vetën dhe kohën e rrëfimit; - dallon subjektin e pjesës që lexon; - nxjerr personazhet e romanit dhe disa veçori të tyre.			
Kriteret e suksesit: - diskuton për kohën, vendin, mjedisin dhe ngjarjet, duke dhënë detaje nga teksti; - sjell përvoja personazhesh të tjerë të ngjashme me ato të personazheve të romanit; - dallon mënyrën e rrëfimit në roman duke i dhënë ngjarjet në rend kronologjik ose kohor etj.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9 - Fleta të bardha, marker, tabela mbi Foenkinos dhe Charlotte Salomon, romani në vargje “Sharlota” e Foenkinos.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: stuhi mendimi, informacione shtesë.			
Mësuesi/ja njeh nxënësit me fjalën: Holokaust. Kërkon nga nxënësit që të flasin rreth kësaj fjale dhe emocionet që përcjell kjo fjalë. Shtrohen pyetjet: - Çfarë është Holokausti? – Ç’дини për të? - Ku u shtri e u përhap? - Çfarë përmasash mori?			

Ç'janë kampet e përqendrimit? - Si u sollën nazistët me hebrenjtë? - Përse vepruan ashtu? - Cila ishte ideologjia e tyre? – Po shtetet e tjera, si u sollën me hebrenjtë refugjatë? Po në Shqipëri, si u sollën me hebrenjtë? - A keni lexuar histori e ngjarje, ku personazhet kanë qenë pjesë e terrorit nazist?

Diskutohet me nxënësit rreth njohurive që kanë mbi Holokaustin dhe këto njohuri mund të plotësohen nga mësuesi/ja me anë të informacioneve shtese.

Holokausti është ngjarja me famëkeqe për shfarosjen e njerëzve në historinë e botës.

Hitleri në librin e tij “Lufta ime” shënon: “Raca gjermane është racë pasardhëse e racës ariane (popull që ka jetuar shumë vite më parë - qytetërim i zhdukur tanimë) dhe racë e pastër dhe si e tillë duhet ta sundojë botën... disa popuj duhet të zhduken nga faqja e dheut, hebrenjtë, romët dhe sllavët”.

Hitleri, gjatë Luftës së Dytë Botërore, kishte krijuar shumë burgje dhe kampe përqendrimi. Kampet kishin filluar të hapeshin që nga viti 1940. Ndër kampet më të njohura, ishin: Kampi Aushvic -Birkenau, Kampi i Aushvicit, i Dahaut, i Mat'hauzenit, i Belsenit, i Firesburgut.

Në këto vende, ishin mbledhur njerëz nga të gjitha vendet e pushtuara nga blloku nazi-fashist. Në këto kampe, u mbytën, u torturuan dhe u bënë eksperimente të gjalla në fushën mjekësore. Shumë njerëz për të mos parë skenat e tilla dhe për të mos përjetuar torturat, kryen vetëvrasje.

Terrori ndaj njerëzve në kampet e përqendrimit kishte ndërruar formën. Vrasjet me bomba, armë zjarri, pushkatimet, mbytjet me tortura... ishin bere te zakonshme. Nazistët donin t'i mbysnin njerëzit pa lënë gjurmë. Prandaj, filluan asgjësimin e tyre nëpërmjet helmimit masiv në dhomat me gaz në shumicën e kampeve të përqendrimit. Mbytja me gaz brenda një ditë, arrinte deri në 20.000 njerëz. Trupat e pajetë të njerëzve hidheshin në furra me temperatura të larta, për të zhdukur çdo gjurmë. Shumica e këtyre njerëzve ishin hebrenj.

Shqiptarët i mbrojtën aq shumë hebrenjtë, sa që i mbajtën edhe në familjet e tyre. Kjo ndodhi në shumë qytete të Shqipërisë, si: në Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Krujë, Shkup, Prishtinë, etj.

Në Belsen, Holandë, 15-vjeçarja me familjen e saj 4-anëtarëshe ishte e izoluar në bodrumin e një firme. Ajo kishte mbajtur ditar gjatë kohës. Ajo tregon torturat që ushtronin nazistët, rrethanat e kohës dhe mënyrën e jetesës në atë izolim. Ditari i saj u botua pas vdekjes nga i ati, i cili arriti të mbijetonte në kampin e përqendrimit: “Ditari i Ana Frankut”. Po për këtë temë flet edhe “Djali me pizhame”, i cili është bërë edhe film dhe nxënësit e njohin.

Ndërtimi i njohurive të reja: Leximi zinxhir, karrigia e autorit, prezantim.

Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e orës së mësimi “Sharlota”, një lloj i veçantë romani i shkruar në vargje.

Romani në vargje është një formë e ndërmjetme mes poezisë dhe prozës.

Lexohet teksti dhe sqarimet për romanin në vargje nga nxënësit, në forme zinxhiri.

Karakteristikat kryesore të romanit në vargje janë: prania e skenave intensive emocionale (përqendrimi në luhatjet emocionale të personazheve), përdorimi i formave poetike (vargje të lira, hapësira boshe, thurje të pazakonta të vargjeve), ndërtimi i veçantë i subjektit.

Një nxënës, pasi është përgatitur për jetën e autorit dhe ka marrë informacione për krijimtarinë e Foenkinos-it, luan rolin e atij. Nxënësit e klasës zhvillojnë pyetje (në formën e intervistës) që lidhen me krijimtarinë e jetën e tij dhe nxënësi i përgatitur përgjigjet. (Këtu mund të ndërhyjë edhe mësuesja për të plotësuar apo saktësuar nxënësin, nëse është e nevojshme).

David Foenkinos, është një nga shkrimtarët bashkëkohorë më të njohur në Francë. Ishte profesor kitare para se të bëhej shkrimtar. Tashmë, ai është autor i dhjetëra romaneve, të përkthyer në tridhjetë gjuhë të botës. Me romanin “Delikatesa” ai u bë një nga autorët më të shitur në Francë.

Në vitin 2014, me veprën “Sharlota”, Foenkinos, korri shumë sukses me lexuesit dhe me kritikën, duke fituar dy çmime letrare të rëndësishme. *Library Journal* shprehet: “Teksti zhvillohet si një psalm i shenjtë, një varg fjalish të shkurtër, të gjata jo më shumë se një rresht. Ky kufizim, e detyron autorin të mbajë njëfarë serioziteti, thekson tensionin, shmang shkarjet në sentimentalizma. Ky roman magjepsës, lexohet si të ishte një rrëfenjë e kaluar gojariht nga babai te biri, një rrëfenjë që nuk duhet harruar”.

Në këtë roman, Foenkinos i ka thurur lavde vajzës dhe gruas që mundohet të jetë vetvetja (Mësova t’i shkelja të gjitha shtigjet dhe kështu u bëra vetvetja.). Ajo përpiqet të mbijetojë, të jetojë me pasion e delikatesë. Autori sjell një vëzhgim të imtë të dhimbjeve të saj, duke na sjellë edhe realitete të kohës.

“Sharlota” u kthye në një fenomen letrar ndërkombëtar, duke fituar disa çmime letrare (*Renaudot* dhe *Goncourt des Lyceens*) dhe u bë një bestseller.

Edmond Tupe, përkthyes dhe autor shqiptar. Ka lindur në Tiranë në vitin 1947. Studimet i kreu në vendlindje, u diplomua për gjuhë e letërsi frënge në Universitetin e Sorbonës, Paris. Fillimisht pedagog në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, pastaj mësues në qytetin e Gramshit, më vonë, përkthyes në Tiranë. Autor tekstesh universitare, vëllimesh me poezi e prozë në shqip dhe frëngjisht, leksikograf, publicist e kritik përkthimesh, laureat çmimesh kombëtare e ndërkombëtare. Ka shqipëruar vepra të shkrimtarëve franceze: Proust, Tournier, Sartre, Giono, Maurois, Delerm, Plazy etj. Ka përkthyer në frëngjisht autorë shqiptarë si F. Kongoli, I. Kadare, D. Como, D. Culi.

Si autor, ai ka botuar disa tituj: “Mos ik, o ma” dhe “Kur dhimbja premt dashuri”.

Mësuesi/ja mund të plotësojë informacionet për Sharlotën dhe romanin në linkun: (<https://www.google.com/search?q=leben+oder+theater+salomon&source>).

Demonstrimi i rezultateve të arritura: punë me tekstin, analizë teksti.

Nxënësit kanë lexuar romanin dhe gjejnë momentin në të cilin përshkruhen ngjarjet e fragmentit të dhënë. Identifikojnë momentin jetësor kur Sharlota krijon veprën e saj “Jetë apo teatër”. (Ngjarja ndodh pasi një ushtar nazist e zbrit nga autobusi në Nicë dhe i shpëton jetën. Ajo shkon te doktor Moridis dhe ai e këshillon të pikturojë. Kur shkon në “La belle Aurore”, fillon të shkruajë e pikturojë gjithë jetën e saj).

Në formë zinxhiri ritregohet subjekti i romanit në vargje.

Subjekti i romanit në vargje “Sharlota”: Ky roman i veçantë rrëfen historinë e artistes Sharlotë Salomon, e lindur në prag të Luftës së Dytë Botërore në Berlin, në një familje hebraike dhe të traumatizuar nga disa tragjedi të brendshme.

Vetëvrasjet i ndiqnin pas dhe në çdo 13 vjet do të kishte një vetëvrasje. Përjeton që e vogël ndarjen nga e ëma po për shkak të vetëvrasjes, sepse ajo hidhet nga dritarja. Rritet nën kujdesin e babait dhe të njerksës, por shpesh edhe nën kujdesin e gjyshërve.

E dashuruar pas artit dhe vetë jetës, Sharlota rritet, edukohet dhe dashurohet marrëzisht në Gjermaninë e fillimit të nazizmit. Përkeqësimi i ndjeshëm i gjendjes në Gjermani, e shtyn atë drejt arratisjes pa dëshirën e saj, pa mbushur akoma moshën për pasaportë, në Francë, ku në vetminë më të thellë që përjeton, sidomos pas vdekjes së gjyshes, përjeton ethshëm kujtimin e dashurisë e të braktisjes dhe krijon një sërë veprash autobiografike (imazhe, fjalë dhe referenca muzikore), të cilat rrëfejnë gjithë historinë e jetës së saj.

Përndjekja e hebrenjve, mbërrin edhe në Francë. Me dorëzimin e Francës, vrasjet dhe vuajtjet filluan sërish për ta.

Sharlota jetonte në heshtje, pa shqetësuar njeri, në heshtje të plotë në “La belle Aurore”, por e keqja e ndjek edhe aty, vdekja e ndjek pas. Në një moment në Francë, e ndien se po afrohet fundi dhe pikturon duke pasqyruar gjithë jetën e saj.

Këto i fut në një valixhe dhe ia jep doktor G. Moridis, i cili duhej t'ia jepte zonjës Mur, bamirëses amerikane, që ndihmoi dhe e strehoi në Francë. Analizohet teksti, nisur nga ndërtimi i romanit. - Përse autori ka zgjedhur që ta shkruajë në këtë formë? (ngjarja është tronditëse, nuk të lë të qetësohesh. Autori kishte kohë që studionte jetën e saj, që mbledhte të dhëna dhe kur mësoi historinë, u trondit nga ngjarjet, u prek dhe këto emocione, donte t'i përcillte po kështu te lexuesi, siç i përjetoi ai vetë dhe jo thjesht një roman historik). Autori e bën veten pjesë të romanit, luan rolin e rrëfimtari, por edhe të personazheve që herë hyjnë e herë dalin nga romani dhe shprehet: “Nuk arrija dot të shkruaja dy fraza njëra pas tjetrës. Diçka më pengonte në çdo pikë. E pamundur të bëja përpara. Ishte një ndjesi fizike, një gulçim. E ndieja të nevojshme që të dilja me kryeradhë për të marrë frymë.” Gjatë studimit të tekstit, nxënësit kanë nxjerrë personazhet e romanit dhe një tipar dallues të tyre. Personazhet kryesore të romanit: Sharlota, personazhi kryesor; Alberti, i ati i Sharlotës; Frensiska, e ëma e Sharlotës; çifti Grynvald, gjyshërit e Sharlotës nga e ëma; Paula, njerka e Sharlotës; Alfredi, i dashuri i Sharlotës; Otili Muri, bamirësja amerikane që i strehoi në Francë; doktor Moridis, mjek që ndihmoi Sharlotën në Francë; Aleksandër Nagleri, refugjat austriak, i cili martohet me Sharlotën në Francë. Personazhe dytësore: Ludvig Bartningu, profesori që bëri të mundur futjen e saj në Akademinë e Arteve të Berlinit; Barbara, e vetmja shoqe e Sharlotës, ariane; Anxhelo Donati, politikan italian që ndihmoi hebrenjtë; prefekti Shenjo, zhduku listat administrative duke shpëtuar kështu shumë hebrenj. Personazh negativ: Alois Bruneti, vrasësi i tmerrshëm i çifutëve, më i tmerrshmi. Nxënësit plotësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit për të nxjerrë personazhet, duke treguar për rolin e tyre në ngjarje dhe në jetën e Sharlotës. “Holokausti. Në disa vende të Evropës, popullsia vendase, i dorëzonte hebrenjtë në duart e nazisteve. Por pati popuj që i fshihnin, strehonin dhe i mbronin hebrenjtë. Shembulli më i njohur, janë shqiptarët. Hebrenjtë në Shqipëri kaluan mirë dhe nuk përjetuan fatin tragjik të bashkëkombësve të tyre”. Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).
Detyrat dhe puna e pavarur
Gjeni figura të ndryshme letrare të përdorura nga autori dhe zbërtheni kuptimin e tyre.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti poetik.		Rezultati i të nxënit të temës: Njeh dhe krahason motivet në poezi e në prozë (meditative, patriotike, sociale, erotike);	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Charlota			
Fjalët kyçe: <i>Leben? oder Theater? – La Belle Aurore.</i>			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: – përshkruan një ngjarje nga Holokausti; – dallon përshkrimin autobiografik; – zbulon mesazhin që sjell ky tekst te ne.			
Kriteret e suksesit: – rikujton krijime të ndryshme gjatë kohës së sundimit të Adolf Hitlerit; – përshkruan një element dalluese të romanit në vargje; – analizon vargjet dhe dallon figurat letrare.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 9, fletë të bardha, marker (shënjes), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit: <i>A keni informacione për fjalën “holokaust”? Çfarë dini për Adolf Hitlerin?</i>			

Nxënësit tregojnë njohuritë e tyre lidhur me pyetjet dhe të gjithë diskutojnë për ngjarje të ndryshme të asaj kohe. Mësuesi/ja ndërhyr në bisedë duke plotësuar informacionet.

Pastaj shkruan titullin e njësisë mësimore në dërrasë të zezë “Sharlota” dhe shpjegon pjesën para leximit dhe për romanin në vargje.

Ndërtimi i njohurive të reja: - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje - Citat-Koment

Në këtë fazë, mësuesi/ja së pari lexon pjesën e zgjedhur në tekst “Sharlota”, ose mund të kërkojë nga nxënësit që ta lexojnë me rend (lexim artistik), me zë, dhe pas leximit, të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/emocionet që leximi i tekstit zgjoi tek ata. Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupet e tyre ushtrimet e dhëna në tekst.

Grupi I: Kuptojmë tekstin, ushtrimi 1

Grupi II: “Analizojmë tekstin”, ushtrimet 2, 3 dhe “Interpretojmë tekstin”, ushtrimet 4, 5, 6, 7.

Grupi III: “Gjuha e tekstit”, ushtrimet 8, 9, 10, 11, 12 dhe “Reflektojmë rreth tekstit”, ushtrimet 13, 14.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse është e nevojshme.

Pastaj udhëzohen të lexojnë pjesën e njëjtë dhe të shkruajnë detyrën e udhëzuar nga mësuesi/ja.

Nxënësit do të zgjedhin strofën apo citatin që u pëlqen dhe do të komentojnë zgjedhjen e tyre.

Për shembull:

Strofa e pëlqyer	Komente
Nëse ajo vetë do të marrë arratinë, nëse ajo vetë do të vdesë. Tani për tani, duhet me çdo kusht që puna e saj të ruhet. Të vihet në një vend të sigurt. Sharlota i fut pakot në një valixhe të madhe. I hedh një sy dhomës për herë të fundit.	Nxënësit komentojnë zgjedhjen e tyre.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: 3-2-1

Në këtë fazë, nxënësit reflektojnë rreth njohurive të mësuara duke treguar:

3) Tri arsye pse duhet ta lexojnë veprën “Sharlota”.

2) Dy tipare kryesore të veprës.

1) Një informacion që nuk e kanë ditur, por që i befasoi si fakt.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni dhe sillni në klasë libra të tjerë, të cilët rrëfejnë historinë e jetës së njerëzve realë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Është zgjedhja e mësuesit/es.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti dramatik		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Trashëgimia			
Fjalët kyçe: çakla, shtetizue, grishë, turr, nemë, i bie përfill, bie në qull, ledhet, parzëm, nuk më ban as të nxehtë, as të ftohtë, i lë hijen, pa i hyrë ferrë në këmbë, pajë, dhëlpën e lindun, i lëshuem zemre, hap kuvend, shi, fill e për pe, shej kohe, ta lamë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - njuh jetën dhe veprimtarinë e autorit; - dallon tekstin dramatik dhe llojet e saj; - vlerëson qëndrimin e personazheve në fragment. Kriteret e suksesit: - analizon ngjarjen në fragment; - përshkruan personazhin që e kishte fatin ta gjente arin; - interpretin në role fragmentin.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Në këtë fazë mësuesi/ja pyet nxënësit: A mbani në mend ndonjë dramë që e keni parë me prindërit apo me shokët dhe shoqet e klasës në teatër? Nxënësit tregojnë dramat që i kanë mbajtur në mend dhe përjetimet e tyre gjatë shikimit të dramës. Nxënësit nxiten nga mësuesi/ja të tregojnë për personazhet se si kanë interpretuar në skenë para publikut duke treguar edhe emocionet e tyre gjatë interpretimit. Pastaj mësuesi/ja shpjegon për Dramën.			

Drama		
Drama është një lloj i veçantë letrar që është më e afërt me tragjedinë sesa me komedinë, por ajo nuk synon domosdo një stil të madhërishëm, as përfundim tragjik, domethënë vdekjen e heroit, si zgjidhje të vetme (siç ndodh në tragjedi). Dramat zhvillojnë tension dramatik pa synuar maksimumin e përshkallëzimit negativ, duke ruajtur gjithsesi seriozitetin e duhur.		Heroi i dramës është një individ, i cili e ndien thellësisht vuajtjen dhe lufton me gjithë shpirt për të zgjidhur problemet e mëdha të jetës. Në kohët e hershme drama shkruhej në vargje, ndërsa në ditët e sotme drama shkruhet kryesisht në prozë. Drama mund të dëgjohet dhe shikohet kur vihet në skenë në teatër ose mund të lexohet si çdo vepër tjetër letrare.
Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim (Interpretim artistik) Marrëdhënia Pyetje-përgjigje Në këtë fazë mësuesi/ja shpjegon pjesën para mësimit dhe i ndan personazhet për lexim artistik. Pastaj mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë detyrat.		
Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1. Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3, 4. Grupi i tretë - Interpretojmë tekstin, detyrat 5, 6, 7, 8. Grupi i katërt - Gjuha e tekstit, detyrat 9, 10.		
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et nëse kanë nevojë në përgjigje. Ndërtimi i njohurive të reja: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit Sipas veprimtarisë rrjeti i diskutimit nxënësit do të reflektojnë rreth tekstit duke punuar ushtrimet 11 dhe 12 të rubrikës Reflektojmë rreth tekstit. Mendimet e nxënësve shkëmbehen në dyshe dhe pastaj klasa pozicionohet në dy grupe. Raportohen para klasës arsyet pro dhe kundër çështjes. Caktohet kufiri kohor për paraqitjen e argumenteve, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion nëse argumentet e grupit tjetër ju duken më bindëse.		
Po	Mendoni se brezat kanë përgjegjësi për pasardhësit?	Jo
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).		
Detyrat dhe puna e pavarur		
Ktheni pjesën e dytë të fragmentit në prozë, duke rrëfyer në vetën e tretë.		
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore		
Mësimdhënësit/et duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.		

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti dramatik		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Makbeth			
Fjalët kyçe: Parashikim, magjistrica, fati, pushteti.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - njih jetën dhe veprimtarinë e autorit; - dallon tekstin dramatik dhe llojet e tij; - vlerëson qëndrimin e personazheve në fragment. Kriteret e suksesit: - Analizon ngjarjen në fragment. - Përshkruan nxitjen e magjistriceve në këtë tragjedi. - Interpreton në role fragmentin.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker (shënjeshtër), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi-ja shkruan në tabelë “Uilliam Shekspir” dhe udhëzon nxënësit të tregojnë çfarë dinë për autorin. Nxënësit/et tregojnë për jetën e autorit dhe veprat e tij letrare. Kohë pas kohe, mësuesi/ja ndërhyr për të plotësuar mendimet e tyre. Pastaj mësuesi/ja shpjegon për autorin.			

Uilliam Shekspir

Uilliam Shekspir (1564-1616) është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Po ashtu edhe dramaturg, poet dhe aktor. Gjatë krijimtarisë së tij, Shekspiri shkroi 37 vepra, nga të cilat 13 tragjedi, 10 drama historike dhe 14 komedi. Pjesa tjetër e krijimtarisë përfshin 154 sonete, që konsiderohen si realizimi poetik më i çmueshëm i gjithë asaj periudhe, si dhe 2 poema të gjata.

Ndër veprat e tij më të bukura veçojmë tragjeditë: *Makbeth*, *Hamlet*, *Otello*, komeditë: *Shumë zhurmë për asgjë*, *Nata e dymbëdhjetë*, dramat historike: *Henri IV*, *Riçardi II* etj. Shekspiri e ngriti artin dramatik në majat më të larta të letërsisë botërore. Veprat e tij mbeten një pasuri e pashtershme për të gjitha kohërat dhe të admirueshme për çdo brez lexuesish.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim (Interpretim artistik) Marrëdhënia Pyetje-përgjigje
 Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon pjesën para mësimit dhe i ndan personazhet për lexim artistik. Pastaj mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë detyrat.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, ushtrimet 1, 2, 3, 4, 5, 6
Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, ushtrimet 7, 8, 9, 10
Grupi i tretë - Interpretojmë tekstin, ushtrimet 11,12
Grupi i katër - Gjuha e tekstit, ushtrimet 13,14

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse kanë mangësi apo paqartësi në përgjigje.

Ndërtimi i njohurive të reja: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit
 Sipas veprimtarisë “Rrjeti i diskutimit”, nxënësit do të reflektojnë rreth tekstit duke punuar ushtrimet 15 dhe 16 të rubrikës “Reflektojmë rreth tekstit”.

Mendimet e nxënësve shkëmbehen në dyshe. Më pas, klasa ndahet në dy grupe. Raportohen para klasës arsyet pro dhe kundër çështjes. Caktohet kufiri kohor për paraqitjen e argumenteve; nxënësit mund të ndryshojnë grupin, nëse argumentet e grupit tjetër iu duken më bindëse.

Po	Si mendoni, fatet tona janë të paracaktuara, apo e kemi ne në dorë atë që ndodh në jetën tonë?	Jo
-----------	--	-----------

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Analizoni subjektin dhe personazhet e një tragjedie tjetër të Shekspirit, ku vritet një mbret.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti dramatik		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Cili është ndryshimi midis tragjedisë dhe shfaqjes së saj në teatër?			
Fjalët kyçe: Parashikim, magjistrica, fati, pushteti.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:			
- dallon tragjedinë dhe shfaqjen e saj në teatër; - dallon punën e regjisorit për dukjen e personazheve në skenë; - krahason shfaqjen “ Makbeth”, por në tri shfaqje të ndryshme.			
Kriteret e suksesit:			
- Analizon ndryshimin mes tragjedisë dhe shfaqjes së saj në teatër. - Përshkruan punën e regjisorit gjatë realizimit të një shfaqjeje teatrale. - Krahason leximin e një tragjedie me shikimin e një shfaqje teatrale me përmbajtje të njëjtë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fleta të bardha, marker (shenjues), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Organizuesi grafik Në këtë fazë, mësuesi/ja zhvillon një bisedë me nxënësit në lidhje me shfaqjen dhe emocionet që përcolli tek ata. (Nxënësit, për detyrë shtëpie e kishin që të shikonin një shfaqje teatrale sipas dëshirës). Nxënësit do të përshkruajnë në bazë të organizuesit grafik.			

Përshkrimi i një shfaqjeje teatrale

Hyrja:	Zhvillimi:	Mbyllja:
Titulli, autori, regjisor, aktorët	Skenat, vendosja e ngjarjeve, konflikti,	Vlerësimi për shfaqjen, loja
Roli i aktorëve	Muzika, dekori, ndriçimi	Mesazh, ftesë, citim

Pas përfundimit të diskutimeve, mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë mësimore në dërrasën e zezë: Cili është ndryshimi midis tragjedisë dhe shfaqjes së saj në teatër? Pastaj u shpjegon nxënësve ndryshimet që vërehen kur lexojmë një tragjedi dhe kur e shikojmë atë si shfaqje në teatër. Për këtë ndryshim, puna më e madhe është e regjisorit. Në vijim, shpjegon pjesën “Realizimi i shfaqjes”.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon njësinë mësimore dhe udhëzon nxënësit që të lexojnë në heshtje dhe t’u përgjigjen pyetjeve të tekstit të rubrika “Studim teksti”, ushtrimet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10. Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës i lexojnë përgjigjet e tyre dhe të gjithë diskutojnë së bashku duke i mbrojtur mendimet e tyre me argumente.

Ndërtimi i njohurive të reja: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit

Sipas veprimtarisë “Rrjeti i diskutimit”, nxënësit do të reflektojnë rreth tekstit duke diskutuar me temën: Çfarë sjell ndryshimi i kontekstit kohor nga mesjeta në bashkëkohësi, i vënies në skenë të kësaj tragjedie?

Mendimet e nxënësve shkëmbehen në dyshe dhe pastaj klasa pozicionohet në dy grupe. Raportohen para klasës arsyet pro dhe kundër çështjes. Caktohet kufiri kohor për paraqitjen e argumenteve; nxënësit mund të ndryshojnë pozicion nëse argumentet e grupit tjetër iu duken më bindëse.

Diskutoni në klasë

Po

Çfarë sjell ndryshimi i kontekstit kohor nga mesjeta në bashkëkohësi, i vënies në skenë të kësaj tragjedie?

Jo

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Analizoni subjektin dhe personazhet e një tragjedie tjetër të Shekspirit, ku vritet një mbret.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës:IV	Klasa: IX
Tema: Teksti dramatik		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Shekspiri në teatër dhe Shekspiri në film			
Fjalët kyçe: filmi, shfaqja teatrale.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:			
- përshkruan një film dhe një shfaqje teatrale; - dallon punën e regjisorit për dukjen e personazheve në skenë dhe dukjen për realizimin e një filmi; - krahason personazhet në një shfaqje teatrale dhe në një film.			
Kriteret e suksesit:			
- Analizon ndryshimet mes një shfaqjeje teatrale dhe një filmi. - Përshkruan punën e regjisorit gjatë realizimit të një shfaqjeje teatrale dhe realizimit të një filmi. - Krahason një film me një shfaqje teatrale me përmbajtje të njëjtë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit: Cili i qëndron më shumë besnik letërsisë: filmi apo teatri? Përse?			

Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe vlerësohen për to.

Pas përfundimit të diskutimeve, mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë mësimore në dërrasën e zezë: “Shekspiri në teatër dhe Shekspiri në film”. U shpjegon nxënësve ndryshimet që vërehen kur shikojmë një film dhe kur shikojmë një shfaqje në teatër, e cila ka të njëjtën përmbajtje me filmin. Shpjegon po ashtu, pjesën “Për kalimin nga teksti në film”.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon njësinë mësimore dhe udhëzon nxënësit që të lexojnë në heshtje dhe t’u përgjigjen pyetjeve të tekstit te rubrika “Studim teksti”, ushtrimet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10.

Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës i lexojnë përgjigjet e tyre dhe të gjithë diskutojnë së bashku, duke i mbrojtur mendimet e veta me argumente.

Ndërtimi i njohurive të reja: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Rrjeti i diskutimit

Sipas veprimtarisë “Rrjeti i diskutimit”, nxënësit do të reflektojnë rreth tekstit duke iu përgjigjur pyetjes: **Si mendoni, a janë përherë me vend ndryshimet që i bëhen subjektit apo personazheve**

të një vepre letrare gjatë realizimit të saj kinematografik? Argumentoni përgjigjen.

Mendimet e nxënësve shkëmbehen në dyshe dhe pastaj klasa pozicionohet në dy grupe. Raportohen para klasës arsyet pro dhe kundër çështjes. Caktohet kufiri kohor për paraqitjen e argumenteve; nxënësit mund të ndryshojnë pozicion, nëse argumentet e grupit tjetër iu duken më bindëse.

Si mendoni, a janë përherë me vend ndryshimet që i bëhen subjektit apo personazheve të një vepre letrare gjatë realizimit të saj kinematografik?

Argumentoni përgjigjen.

Po

Jo

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shikoni një film dhe një shfaqje teatrale me përmbajtje të njëjtë . Më pas, përshkruani emocionet që përjetuat në secilin rast.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti rrëfyes		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Yllka Domi ose poezia e këputur përgjysmë			
Fjalët kyçe: lufta, poezia, parandjenjë, vrasje.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - njih biografinë e Yllka Domit; - dallon tekstin rrëfyes dhe llojet e tij; - vlerëson vargjet e poezisë së Yllkës.			
Kriteret e suksesit: - Analizon vargjet që tregojnë parandjenjën e Yllkës. - Përshkruan rrëfimin e mësuesit për Yllkën. - Krijon një shkrim (epitaf) për Yllkën.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan titullin e njësisë mësimore në tabelë “Yllka Domi ose poezia e këputur përgjysmë” dhe pyet nxënësit: Çfarë ju kujton ky emër? Nxënësit përgjigjen duke përshkruar informacionet që i kanë për Yllkën nga shkolla apo edhe nga familja. Pastaj mësuesi-ja shpjegon për nxënësit biografinë e Yllkës.			

Yllka Domi u lind në Gjakovë, më 18 nëntor të vitit 1982. Yllka ishte e bija e Afrim dhe Dashurije Domit. Ajo u lind në një familje qytetare me tradita patriotike. Gjyshi i saj, Kasim Domi, një atdhetar dhe veprimtar i madh, u dënua nga pushtuesit serbo-jugosllavë dhe vuajti dënimin në burgun më famëkeq, në Goli Otok. Babai i Yllkës, Afrimi, po ashtu u angazhua në veprimtari dhe në institucionet e Republikës së Kosovës për të dhënë kontributin e tij.

U dënua nga pushtuesit serbë dhe vuajti burgun në burgjet serbe. E ëma e Yllkës, Dashurija, i edukoi fëmijët e saj, Triumfin, Visarin e Yllkën, duke i ushqyer me dashuri dhe atdhedashuri, edhe pse në rrethana mjaft të vështira, sepse ishin kohë të egra dhe familja e tyre ishte vazhdimisht në shënjestër të pushtimit serb.

Yllka, si nxënëse e shkëlqyeshme e shkollës “Mazllom Këpuska” në Gjakovë, që herët u dallua për shkathtësitë e saj organizative, por edhe për talentin e rrallë që kishte për shkrimet dhe krijimtarinë letrare. Pra, shumë herët, ajo u mor me shkrime, me aktrim, madje ishte një valltare e mirë dhe me shtatin e saj dallohej nga bashkëmoshataret e saj.

Yllka angazhohej në të gjitha programet dhe manifestimet e shkollës, por ishte prezente edhe në organizimet e tjera kulturore që mbaheshin në qytet gjatë kohës së okupimit. Ajo lexonte poezitë e saj, por edhe recitonte bukur poezitë e shkrimtarëve të mëdhenj. Yllka Domi ka botuar shkrimet dhe poezitë e saj në revista të ndryshme. Me këto cilësi, Yllka vazhdoi edhe mësimet në gjimnazin “Hajdar Dushi”, ku përveç sukseseve në mësim, ajo udhëhoqi edhe grupin letrar.

Yllka rritej në një frymë atdhetare dhe po përballej gjithmonë me padrejtësitë që po i bëheshin kombit shqiptar. Prandaj, ajo ishte e interesuar gjithmonë që të informohej saktë se si po lëviznin gjërat. Kudo ishte aktive, në shkollë, në grupe humanitare, në ndihmë banorëve të zhvendosur, si dhe aty ku e kërkonte nevoja. Duke qenë e tillë, ra në kontakt me shumë të rinj e të reja, të cilët ishin kyçur në bërthamat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ka kryer kurse për ndihmë të të plagosurve në luftë dhe ka ushtruar përdorimin e armëve dhe pastrimin e tyre. Ajo ishte shumë e shkathtë dhe çdo përpjekje të saj e realizonte me sukses. Ashtu siç edhe kishte dëshirë, u radhit në Brigadën 137 Gjakova, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë ofensivës së Betejës së Çabratit, e cila po zhvillohej mes forcave të UÇK-së dhe ushtrisë serbe, më 7 maj 1999, u vra Yllka bashkë me disa bashkëluftëtarë. Yllka Domi u vra me snajper nga forcat serbe, në Çabrat, në ofensivën e 7.05.1999. Kriminelët serbë, për të fshehur gjurmët e krimit, trupin e Yllkës bashkë me trupat e tjerë të vrarë, i dërguan në një varrezë masive në Batajnicë (Serbi).

Pas identifikimit të eshtrave të Yllka Domit nga ekspertët e mjekësisë ligjore, trupi i saj u rivarros më 23.12.2003, në kodrën e Çabratit në Gjakovë. Yllka Domi është shpallur Dëshmore e Kombit.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lapsat në mes - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon tekstin rrëfyes dhe pjesën që do të mësojnë. Pastaj i udhëzon nxënësit të punojnë në grupet e tyre të punës. Nxënësit udhëzohen të lexojnë në heshtje pjesën dhe të mbajnë shënime. Pas përfundimit të detyrës, në secilin grup mësuesi/ja zgjedh një nxënës për të lexuar, duke i mbledhur të gjithë lapsat në mes të tavolinës së punës dhe lapsin që zgjedh, e drejton te nxënësi/ja që paraqitet, dhe ai/ajo nxënës lexon. Po kështu veprohet në secilin grup. Nxënësi/ja që lexon pjesën, pret nga nxënësit e tjerë të shtojnë informacione dhe të komentojnë së bashku pjesën.

Pastaj, mësuesi/ja udhëzon nxënësit të punojnë ushtrimet në tekst.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, ushtrimi 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, ushtrimet: 2, 3, 4.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, ushtrimet: 5, 6.

Grupi i katër - Reflektojmë rreth tekstit, ushtrimet: 7, 8, 9.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse kanë hamendje apo paqartësi në përgjigjet e tyre.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Pesëvargësh

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen të krijojnë një pesëvargësh. Për shembull:

Yllka

E bukur e lumtur

Shkruante parandiente luftonte

E dha jetën për liri

Dëshmore

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkoni dhe lexoni në klasë mbresa dhe kujtime të njerëzve që e kanë njohur Yllka Domin.

Identifikoni mesazhet që ata përcjellin dhe interpretoni rëndësinë e tyre. Krijoni një shkrim (epitaf për Yllkën).

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti rrëfyes		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Udhëtim në Paris			
Fjalët kyçe: pushtet, Zonja e Parë, pasuri, udhëtim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: • njeh biografinë e Mishelë Obamës; • dallon biografinë dhe autobiografinë; • vlerëson qëndrimin e prindërve të Mishelës. Kriteret e suksesit: • Analizon ngjarjen në tekst. • Përshkruan rrëfimin e Mishelit. • Krahason biografinë dhe autobiografinë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.			
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Gushëkuqi rrethor Në këtë fazë, mësuesi/ja udhëzon nxënësit (të ndarë në grupe) të përshkruajnë një personazh femër, që ka hyrë në histori për arritjet e saj, dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin për mendimet e tyre. Në secilin grup, nxënësit veprojnë njësoj dhe pastaj diskutojnë me të gjithë shokët e klasës për mendimet që kanë rreth temës. Më pas, mësuesi/ja shënon titullin e njësisë mësimore në dërrasën e zezë: “Udhëtimi në Paris” dhe shpjegon pjesën para mësimit.			

Kjo pjesë është shkëputur nga libri autobiografik i Mishelë Obamës “Becoming - Të bëhesh”, botuar në vitin 2018, në gjuhën angleze dhe në vitin 2019, në gjuhën shqipe. Kjo vepër na shoqëron në një udhëtim nga kuzhinat modeste, te sallat e ballos, nëpër çaste dhimbjesh therëse dhe provash qëndrueshmërie këmbëngulëse. Duke rrëfyer me ndershmëri dhe kurajë, Mishel Obama na vë përpara një sfidë: Cilët jemi në të vërtetë dhe çfarë dëshirojmë të bëhemi?

Fragmenti i mëposhtëm sjell kujtimet nga jeta në fillim të shkollës së mesme dhe nga një udhëtim me klasën në Paris.

Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënit me këmbime

Lexohet teksti “Udhëtimi në Paris”. Nxënësit marrin njohuri për Mishelë Obamën dhe për librin autobiografik “Becoming - Të bëhesh”, nga është shkëputur fragmenti të cilin lexuan.

Duke u mbështetur në pyetjet e rubrikës “Kuptojmë tekstin”, mësuesi/ja vazhdon diskutimin me tërë klasën. Pastaj, në klasë, formohen 4 grupe (5-6 nxënës) dhe secili grup punon ushtrimet që cakton mësuesi/ja.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, ushtrimi 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, ushtrimet: 2, 3, 4.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, ushtrimet: 5, 6, 7.

Grupi i katër - Reflektojmë rreth tekstit, ushtrimi 8.

Mësuesi/ja ndihmon grupet e nxënësve, nëse është e nevojshme.


Pasi grupet të kryejnë detyrat e caktuara, përfaqësuesit e grupeve argumentojnë përgjigjet e tyre. (Mësuesi/ja bën ndërhyrjet e duhura).

Duke u bazuar në rrjedhën e ngjarjeve në tekst, mësuesi/ja u shpjegon nxënësve: *Teksti “Udhëtimi në Paris” na mëson se asnjëherë nuk duhet të tërhiqemi dhe sforcohemi para vështirësive me të cilat mund të ballafaqohemi gjatë jetës. Dielli perëndon dhe lind çdo ditë. “Në lumturi, të gjitha harrohen”.*

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i Venit

Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen të plotësojnë Diagramin e Venit me të dhëna për biografinë dhe autobiografinë.



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).
Detyrat dhe puna e pavarur
Gjeni informacione rreth ish-Zonjës së Parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mishelë Obama. Shkruani vetëm ato informacione që ju bëjnë përshtypje dhe shpjegoni përse.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti rrëfyës		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare, si: poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Homeri i Shqipërisë			
Fjalët kyçe: Homeri, Gjergj Fishta, luftë, udhëtim, vlerësim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - njih biografinë e Justin Godart-it dhe të At Gjergj Fishtës; - dallon shkrimin në ditarin personal të Justin Godart-it; - vlerëson kontributin e At Gjergj Fishtës për Shqipërinë.			
Kriteret e suksesit: - Analizon tekstin dhe ditarin personal të Justin Godart-it. - Përshkruan dialogun mes At Gjergj Fishtës dhe Justin Godart-it. - Krijon një shkrim vlerësues për At Gjergj Fishtën.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, fletë të bardha, marker (shenjues), tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, Histori, Gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh

Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit: Çfarë dini për At Gjergj Fishtën?

Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe vlerësohen nga mësuesi/ja. Pastaj, mësuesi/ja shënon në tabelë titullin e njësisë mësimore: “Homeri i Shqipërisë” dhe shpjegon për At Gjergj Fishtën.

Gjergj Fishta lindi në fshatin e vogël Fishtë të Zadrimës, më 23 tetor 1871. Jetën e filloi si bari, por shumë shpejt, kur ishte veçse 6 vjeç, zgjuarsia e tij i bie në sy famullitarit të fshatit, i cili e dërgon Fishtën në Seminarin Françeskan të Shkodrës. Më 1880, kur hapet seminari në Troshan, ai vijon në këtë shkollë. Këtu, ai shfaq trillin poetik. Më 1886, dërgohet për studime në Bosnjë. Vitin e parë e kaloi në Guçjagorë, afër Travanikut. Mësimet filozofike i mori në Kuvendin e Sutidkës, ndërsa ato teologjike, në Kuvendin e Livnos. I formuar në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare, poeti ynë Gjergj Fishta është një nga vazhduesit më autentikë dhe të drejtpërdrejtë të saj, shprehës i idealeve atdhetare dhe demokratike në kushtet e reja që u krijuan në shekullin e njëzetë. Mënyrat e pasqyrimin të jetës në krijimtarinë e tij, janë vazhdim i natyrshëm i teknikës letrare të Rilindjes, ku mbizotërojnë romantizmi, realizmi dhe klasicizmi. Deri më 1899, Fishta shkruan me alfabetin shqip të françeskanëve. Në janar të atij viti, ai bëhet bashkëthemelues dhe pjesëtar aktiv i shoqërisë “Bashkimi”. Më 1902, emërohet drejtor i shkollës françeskane në Shkodër, gjer atëherë e drejtuar nga klerikë të huaj. Menjëherë, ai fut gjuhën shqipe si gjuhë mësimi në këtë shkollë. Arrin të botojë këngët e para të “Lahutës së Malësisë”, kryevepër e poezisë epike shqiptare, më 1904. Më 1907, boton përmbledhjen satirike “Anzat e Parnasit”; më 1909, përmbledhjen lirike “Pika voëset”; më 1913, “Mrizi i Zanave”. Më 1908, ai mori pjesë në Kongresin e Manastirit si përfaqësues i shoqërisë “Bashkimi”. U zgjodh Kryetar i Kongresit dhe drejtoi punën e Komisionit të Alfabetit. Në tetor 1913 themeloi revistën “Hylli i Dritës” dhe u bë drejtor i saj. Nga fillimi i prillit 1919 dhe gjatë vitit 1920, ishte sekretar i përgjithshëm i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Në dhjetor 1920, u zgjodh deputet i Shkodrës. Në prill 1921, në mbledhjen e parë të parlamentit shqiptar u zgjodh nënkryetar. Merr pjesë në Revolucionin e Qershorit 1924. Përndiqet pas rikthimit të Zogut në Shqipëri. Vitet 1925 e 1926 i kaloi në Itali. Të kësaj kohe janë edhe pjesa më e madhe e dramave, dramave lirike, tragjedive etj. Pas kthimit në Shqipëri, nisi etapa e fundit e krijimtarisë së Fishtës. Kësaj etape i vuri vulën përfundimi dhe botimi i plotë i “Lahutës së Malësisë” (1937). Për veprimtarinë poetike, arsimore, atdhetare e fetare, Gjergj Fishta mori nderime të ndryshme. Më 1931, Greqia i jep dekoratën “Foenix”. Më 1939, Italia e bën anëtar të Akademisë së saj. Vdiq në Shkodër, më 30 dhjetor të vitit 1940.

Pastaj, mësuesi/ja shpjegon pjesën “Para leximit” dhe për autorin Justin Godart.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje - Citat, Koment

Në këtë fazë, mësuesi/ja shpjegon tekstin dhe pjesën që do të mësojnë. Pastaj i udhëzon nxënësit të punojnë në grupet e tyre të punës. Nxënësit udhëzohen të lexojnë në heshtje dhe të përgjigjen në pyetjet e tekstit.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, ushtrimi 1 Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, ushtrimi 2 Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, ushtrimi 3 Grupi i katër - Reflektojmë rreth tekstit, ushtrimet: 4, 5, 6 Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse kanë nevojë.
Ndërtimi i njohurive të reja: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: 3-2-1 Në këtë fazë, nxënësit udhëzohen të tregojnë: *Tri arsye pse duhet të studiohet autori At Gjergj Fishta. *Dy tipare kryesore të krijimtarisë së tij. *Një informacion që nuk e kanë ditur më parë dhe që i befasoit si fakt.
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Ora quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (vlerësim diagnostikues dhe i vazhdueshëm gjatë orës).
Detyrat dhe puna e pavarur Shkruani një fletë ditari, në të cilën të përshkruani një takim që keni pasur me drejtorin e shkollës suaj ose me një përfaqësues të pushtetit vendor në lidhje me një çështje që ju shqetëson.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti rrëfyes		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e jolettrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Tung, babë!			
Fjalët kyçe: lojë, sëmundje, famë, Covid-19, letër personale.			

Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore**Nxënësi/ja:**

- zotëron dhe përdor gjuhën për qëllime të ndryshme komunikimi dhe kreativiteti;
- identifikon karakteristikat e një letre personale;
- dallon jetën dhe veprimtarinë e Françesko Totit;

Kriteret e suksesit:

- analizon karakteristikat e një letre personale;
- përshkruan jetën dhe veprimtarinë e ish-kapitenit të Romës Françesko Toti;
- krijon një letër personale dedikuar babait apo kujdestarit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:**Metodologjia për realizimin e njësive mësimore: Stuhi mendimesh**

Në këtë fazë mësuesi/ja pyet nxënësit: Çfarë dini për Françesko Totin?

Nxënësit përgjigjen në pyetje dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi/ja. Pastaj mësuesi/ja shpjegon pjesën para mësimi dhe letrën personale; si dhe shpjegon si informacion shtesë jetën dhe veprimtarinë e ish-kapitenit të Romës Françesko Toti.

Francesco Totti (i lindur më 27 shtator 1976) është një ish-futbollist profesionist italian, i cili luajti për Romën dhe kombëtaren italiane. Ai është etiketuar si Er Bimbo de Oro (Djaloshi i artë), L'Ottavo Re di Roma (Mbreti i tetë i Romës), Er Pupone (Fëmija i madh), Capitano (Kapiteni), dhe Gladiatore (Gladiator) nga mediat sportive italiane. Gjatë karrierës luajti kryesisht si mesfushor sulmues dhe sulmues i dytë, por gjithashtu mund të luante si sulmues i vetëm ose anësor. Aktualisht është drejtor sportiv te Roma.

Totti shpenzoi të gjithë karrierën e tij te Roma, duke fituar një titull të Serie A, dy tituj të Coppa Italia dhe dy Supercoppa Italiana. Aktualisht është golashënuesi i dytë i të gjitha kohërave në ligën italiane me 250 gola, dhe i gjashti në të gjitha garat italiane me 316 gola. Totti është golashënuesi dhe lojtari me më shumë ndeshje në historinë e klubit; ai gjithashtu mban rekordin për më shumë gola në Serie A me një klub, dhe gjithashtu është lojtari më i ri që ka qenë kapiten në historinë e Serie A. Një organizator krijues dhe sulmues, i njohur për vizionin, teknikën dhe aftësinë për të shënuar, Totti është konsideruar si një nga lojtarët italian më të mirë të të gjitha kohërave, një nga lojtarët më të talentuar të brezit të tij, dhe më i miri në historinë e Romës.[14] Totti ka fituar plot 11 çmime të Oscar del calcio nga Shoqata e Futbollistëve Italianë: pesë çmime Serie A Futbollisti Italian i vitit, dy çmime Serie A Futbollisti i vitit, dy çmime Serie A Goli i vitit, një çmim Serie A Golashënuesi më i mirë dhe një çmim Serie A Futbollisti i ri më i mirë i vitit.

Fitues i 2006 FIFA Kupës së Botës dhe finalist i UEFA Euro 2000 me Italinë, Totti u zgjodh në skuadrën më të mirë në të dyja turnetë; ai gjithashtu përfaqësoi vendin e tij në Kupën e Botës 2002 dhe Euro 2004. Ai ka fituar disa trofe personale ku më e rëndësishmja ishte Këpuca e Artë Evropiane në 2007 dhe Golden Foot (shqip: Këmba e Artë) në 2010. Ai ka qenë pjesë e skuadrës evropiane të sezonit tre herë. Në vitin 2004, ai u emërua në FIFA 100, një listë me 100 lojtarët më të mirë të historisë të përzgjedhur nga Pelé, si pjesë e festimeve njëqindvjeçare të FIFA-s.[15] Ai është njohur nga IFFHS si futbollisti më popullor i Evropës. Në nëntor 2014, Totti zgjeroi listën e rekordeve të tij, duke u bërë lojtari më i vjetër (38 vjeç e 59 ditë) që shënon në një ndeshje të UEFA Ligës së Kampionëve. Pas largimit nga sporti, në vitin 2017, Totti u nderua me çmimin Karriera e Lojtarit dhe UEFA President's Award.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim - Di-Dua të di-Mësova - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Tung babë” dhe shpjegon emocionin që sjell letra e Françeskos drejtuar babait që humbi jetën nga sëmundja Covid-19.

Pastaj udhëzon nxënësit të mbushin kolonat **Di** për informacionet që i kanë ditur më parë; **Dua të di** duhet të shkruajnë pyetje që u lindin pas leximit; **Mësova** e mbushin pas leximit të pjesës.

Di	Dua të di	Mësova
*	*	*
*	*	*
*	*	*
*	*	*

Pas përfundimit të detyrës, disa nxënës i lexojnë punimet e tyre. Pastaj, udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3, 4, 5.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 5, 6.

Grupi i katërt - Reflektojmë rreth tekstit, detyrat 7, 8.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, nëse kanë nevojë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrim i shkurtër

Në këtë fazë nxënësit udhëzohen të shkruajnë një shkrim të shkurtër me temën:

“Shkruani një letër personale për babanë tuaj apo kujdestarin.”

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruani një letër personale për babanë tuaj.

Shkruani një letër zyrtare për drejtorin e shkollës, në të cilën të shprehni një propozim konkret për lehtësimin e procesit mësimor gjatë kësaj periudhe.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Teksti rrëfyes		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Gjuha amtare, detyrim mbarëkombëtar			
Fjalët kyçe: intervistë, largim nga vendlindja, gjuha shqipe, kulturë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: • zotëron dhe përdor gjuhën për qëllime të ndryshme komunikimi dhe kreativiteti; • identifikon karakteristikat e një interviste; • dallon llojin e intervistës në tekst.			
Kriteret e suksesit: • analizon llojin e intervistës në tekst; • përshkruan jetën dhe veprimtarinë e mësuesit Vaxhid Sejdiu; • krijon një intervistë të lirë për ta realizuar në klasë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit: Çfarë rëndësie ka gjuha amtare për ju? Në secilën familje kemi anëtarë që ndodhen jashtë vendit. Familjarët tuaj a i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollën shqipe apo vetëm në shkollën që e kanë të detyruar (të huaj)? Nxënësit u përgjigjen pyetjes dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi/ja. Pastaj mësuesi/ja shpjegon pjesën para mësimit dhe jep informacione për themeluesin e një rrjeti të suksesshëm të shkollave shqipe në Zvicër.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim- Insert- Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Gjuha amtare, detyrim mbarëkombëtar” pastaj, shpjegon intervistën dhe karakteristikat e saj.

Në këtë fazë, mësuesi/ja së pari lexon intervistën e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend me zë dhe të përdorin shenjat e Insertit si: “V”-kur e di informacionin “-“ - kur nuk e ka të qartë ose dëshiron të dijë më shumë rreth informacionit dhe “?” -kur nuk e ka të qartë informacionin ose dëshiron të dijë më shumë rreth atij informacioni.(Gjatë leximit shënojnë shenjat në libër dhe pas leximit do të shënojnë në fletore në tabelë) e pas leximit të gjithë si klasë komentojnë së bashku për përshtypjet/mbresat/ emocionet që leximi i intervistës zgjoi tek ta.

“V”	“-“	“?”
*	*	*
*	*	*
*	*	*
*	*	*

Pas përfundimit të detyrës disa nxënës i lexojnë punimet e tyre dhe mësuesi/ja sqaron nëse ka ndonjë informacion që nuk e dinë apo është i paqartë. Pastaj udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3, 4, 5

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 6.

Grupi i katër – Reflektojmë rreth tekstit, detyrat 7, 8, 9

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse kanë nevojë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Karikatori i pistoletës

Në këtë fazë nxënësit udhëzohen të krijojnë dy rrathë në mes të klasës me karrige dhe të ulur ballë për ballë me njëri-tjetrin (krijohen dy rrathë nxënësit në mes kthehen nga nxënësit që janë në rrethin e dytë). Nxënësit e luajnë rolin e gazetarit/es dhe pyesin shokun-shoqen që e kanë afër me pyetje momentale të lira. Ndërkohë nxënësit ndërrojnë vendet (lëvizin nga një ulëse në tjetrën dhe mundësia është të pyesin më shumë nxënës).

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar(Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mendoni cilin personalitet do të dëshironit të intervistonit. Përgatitni pyetjet e intervistës për të dhe përpikuni ta kontaktoni për të marrë përgjigjet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekstet informuese-paraqitëse		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e jo letrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Bibliotekat më të bukura në botë			
Fjalët kyçe: biblioteka, libri, shkrimtar, lexim.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - përvetëson njohuritë kulturore e letrare në formimin gjuhësor; - formohet individualisht nëpërmjet leximit të teksteve letrare dhe jolettrare; - arrin të organizojë mendimet dhe të prezantojë me gojë.			
Kriteret e suksesit: - shkruan disa elemente karakteristike të një biblioteke; - diskuton për tekstet informuese; - krahason bibliotekën e Prishtinës me bibliotekat e mësuara në tekst.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:			

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:

Pjesa hyrëse: Përshkrim vizual

Në këtë fazë, Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Bibliotekat më të bukura në botë” dhe shpjegon pjesën para leximit dhe jep informacion për tekstet informuese paraqitëse.

Pastaj i nxit nxënësit për bisedë. Bibliotekat e mëposhtme janë konsideruar ndër më të bukurat në botë. Provoni të imagjinoni se çfarë ndjesie do të përjetoni brenda mureve të këtyre bibliotekave, teksa do të mbanit në duar një libër të mirë.

Pjesa kryesore: Ndërtimi i njohurive të reja - Diamanti 10

Në këtë fazë, Mësimdhënësi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën “Bibliotekat më të bukura në botë” në tekstet e tyre dhe të plotësojnë rubrikat me kuptimin e fragmenteve. Në vazhdim nxënësit listojnë edhe fjalët që nuk kanë kuptuar në tekst.

Biblioteka dhe Muzeu “The Morgan”,
Nju-Jork, SHBA.

Biblioteka e qytetit Shtutgart,
Gjermani.

Biblioteka e Manastirit Strahov,
Pragë, Çeki.

Biblioteka e abacisë
Admont, Austri.

Biblioteka Tianjin Binhai,
Kinë.

Biblioteka Publike e
Stokholmit, Suedi.

Biblioteka e Kolegjit
Trinity-Dublin, Irlandë.

Biblioteka e Aleksandrisë,
Egjypt.

Biblioteka Vasconcelos,
Meksikë.

Biblioteka e Universitetit të Artit
Tama, Japoni.

Pas përfundimit të detyrës, secili grup prezanton punimin e vet me një nxënës përfaqësues.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhënia pyetje-përgjigje

Pastaj udhëzohen të punojnë në grupet e tyre detyrat e ndara nga mësuesi/ja.

Grupi i parë: - Kuptojmë tekstin – detyrat: 1.

Grupi i dytë: - Analizojmë tekstin – detyrat: 2, 3, 4, 5.

Grupi i tretë: - Gjuha e tekstit – detyrat: 6



Grupi i katërt: - Interpretojmë tekstin – detyrat: 7, 8.

Mësimdhënësi/ja ndihmon nxënësit nëse është e nevojshme.

Pjesa përfundimtare: Pas reflektimit, nxënësit udhëzohen për Diagramin e Venit.

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë të veçantat dhe të përbashkëtat për zgjedhjen e tyre për krahasim të Bibliotekave.

1. Biblioteka e Prishtinës “Pjetër Bogdani” - Biblioteka e vendit tim
 2. Biblioteka The Morgan - Biblioteka Tianjin Binhai, Kinë



Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mblidhni informacione të tjera për bibliotekën që ju pëlqeu më shumë. Prezantojini ato në klasë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekstet informuese paraqitëse		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			

Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore: Veshjet popullore
Fjalët kyçe: kulturë, tradicionale, veshje, traditë, Ilirët,
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja: • zotëron dhe përdor gjuhën për qëllime të ndryshme komunikimi dhe kreativiteti; • identifikon karakteristikat e një veshje popullore; • dallon veshjet popullore në krahina të ndryshme. Kriteret e suksesit: • analizon tekstin informues në fragment; • përshkruan veshjen popullore të vendit ku jeton; • krahason veshjet popullore në krahina të ndryshme.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Në këtë fazë mësuesi/ja pyet nxënësit: <i>Çfarë rëndësie kanë veshjet popullore për vendin tuaj?</i> <i>A i mbani në shtëpi veshjet popullore të ruajtura me delikatesë?</i> <i>Nxënësit përgjigjen dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi/ja.</i> <i>Pastaj shpjegon pjesën para leximit.</i>
Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim - Ruaje fjalën e fundit për mua - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Veshjet popullore” pastaj, lexon pjesën e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend me zë dhe gjatë leximit të ndajnë pjesët e pëlqyera. Pas leximit udhëzohen që pjesët që i kanë zgjedhur t’i shkruajnë në fletore dhe të komentojnë pjesën. Pas përfundimit të detyrës nxënësi/ja që lexon pjesën e zgjedhur, fton një nxënës/se tjetër që ta komentojë pjesën që ka lexuar ajo, pastaj nxënësi që e ka lexuar pjesën e komenton sepse edhe e ka të përgatitur si pjesë të zgjedhur më parë. Njësoj veprohet edhe me nxënësit/et tjerë. Pastaj udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.
Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1. Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3, 4. Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 5, 6. Grupi i katër - Reflektojmë rreth tekstit, detyrat 7, 8, 9.
Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et nëse kanë nevojë. Ndërtimi i njohurive të reja: Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela T Në këtë fazë udhëzohen të shprehin mendimet e tyre për temën dhe të komentojnë mendimet e tyre si mendimet pozitive po ashtu, edhe negative. Si mendoni, pse veshja e një populli është trajtuar gjithmonë si elementi kryesor i kulturës shpirtërore e asaj materiale të një përkatësie etnike? E përkrahni këtë mendim?

Përgjigje pozitive	Tema (Pyetje)	Përgjigje negative
Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).		
Detyrat dhe puna e pavarur		
Kërkoni në revista, enciklopedi ose në internet, informacione rreth veshjeve popullore të krahinës suaj. Diskutoni në klasë rreth tyre.		
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore		
Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.		

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: – dallon nivele të ndryshme të artikulimit gjuhësor, nga zhvillimi i fjalisë së thjeshtë në fjali të përbërë dhe në paragraf.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin.			

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues.

IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kallëzuesi

Fjalët kyçe: kallëzues, folje, kryefjalë, kundrinor, gjymtyrë e domosdoshme.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- dallon dhe analizon kallëzuesin në fjali;
- dallon grupet e domosdoshme për foljen në fjali;
- ndryshon vendin e grupeve të fjalëve.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit. Gramatika 2, tabela e kallëzuesit, skeda me tekste të shkurtra.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Zhvillon komunikimin në çdolloj fushe.
- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS

GJATË ORËS MËSIMORE: *Punë në grup; Diskutim; Punë në dyshe*

Organizimi i orës së mësim:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Punë në grup*

Ndahet klasa në grupe me nga 4-5 nxënës dhe u kërkohet që në tekstin e dhënë në skedë të dallojnë:

a) kallëzuesit; b) gjymtyrët që lidhen me kallëzuesit; c) fjalinë më të vogël (për të përcaktuar gjymtyrët e domosdoshme të fjalisë)

Puna e secilit grup diskutohet duke i dhënë mundësinë secilit nxënës të jetë pjesëmarrës. Mësuesi/ja bën përmbledhjen e përfundimeve të nxjerra nga puna e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Diskutim*

Gjymtyrë kryesore e fjalisë

bërthamë organizuese e fjalisë



Lloji i foljes kallëzues përcakton funksionin dhe vlerën e grupeve të tjera në fjali.

- a. folje që kërkojnë kryefjalë dhe kundrinorë
- b. folje që kërkojnë vetë m kryefjalë
- c. folje që kërkojnë kryefjalë
KD, KZHD
- d. folje që s'kërkon as kryefjalë, as kundrinor

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë në dyshe*

1-Nënvizoni kallëzuesit e fjalive të pjesës së mëposhtme.

Nuk di të them sa të gjata m'u dukën këto pesë ditë. Kur i kujtoj, më duket sikur kanë zgjatur me vjet. Më kujtohet kur rrija e mbaja vesh të gjithë tingujt që mund të dëgjoheshin në shtëpi dhe që m'i zinte veshi... Pastaj gdhihej dita prapë, vinte dreka, mbrëmja, koha kur shokët e mi loznin dhe unë rrija dhe i shikoja nga dhoma ime.

3- Gjeni kallëzuesit dhe gruponi foljet sipas ndarjes në tabelën e mëposhtme.

Ne u ngritëm menjëherë, veshëm palltot tona, morëm valixhet dhe, pa nxjerrë fjalë prej goje, dolëm nga porta e madhe në rrugën e ftohtë. Diku larg gjëmte. Nga të dyja anët e rrugës, njerëzit na shikonin me çudi. Ne e ndjenim veten mjaft të vetmuar dhe, me sa dukej, po fillonin prapë ditët moderne, sepse heshtja po vazhdonte.

Folje që marrin (përveç rrethorëve):			
vetëm kryefjalë	kryefjalë dhe kundrinor	kryefjalë, kundrinor të drejtë dhe të zhdrejtë	as kryefjalë e as kundrinorë
u ngritë m	veshëm	shikonin	gjëmte
dolëm	morëm	ndjenim	
fillonin			
vazhdonte			
dukej			

4. Në fjalitë e mëposhtme, rrethoni grupet e domosdoshme për foljen dhe nënvizoni ato që nuk janë të domosdoshme.

- Nesër do të shkoj në kinema me shokët e mi.
- Kush trokiti në derë?
- Autobusi ndaloj në të dalë të qytetit.
- Rritja e temperaturave ndikoi në përhapjen e zjarreve.
- Macja flinte e qetë mbi divan.

5. Dalloni grupet e fjalëve dhe rishkruani fjalinë duke u ndryshuar vend atyre në fjali.

- Pa i hequr sytë nga dritarja, dëgjonte mendueshëm dhe i përhumur zhurmat e para të mëngjesit.
 - Mendueshëm dhe i përhumur, dëgjonte zhurmat e para të mëngjesit pa i hequr sytë nga dritarja.
- Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi i nxënësve:

Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh punën në grup, saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 6 - Hartoni një tekst të shkurtër me temë të lirë. Dalloni kallëzuesit dhe klasifikojini sipas numrit të gjymtyrëve që kërkojnë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon nivele të ndryshme të artikulimit gjuhësor, nga zhvillimi i fjalisë së thjeshtë në fjali të përbërë dhe në paragraf.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për mjedisin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Llojet e kallëzuesit: foljor dhe emëror			
Fjalët kyçe: llojet, kallëzues, foljor, emëror, klasifikim.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon dhe analizon kallëzuesin foljor; - dallon dhe analizon kallëzuesin emëror; - dallon grupet e domosdoshme për foljen në fjali; - ndryshon vendin e grupeve foljore dhe emëror.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libri i nxënësit. Gramatika 2, tabela e kallëzuesit, skeda me tekste të shkurtra			


Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Zhvillon komunikimin në çdo lloj fushe.
- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Punë në grup; Diskutim; Punë në dyshe***Organizimi i orës së mësim:****Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënës:** *punë në grup.*

Ndahet klasa në grupe me nga 4-5 nxënës dhe u kërkohet që në tekstin e dhënë në skedë të dallojnë: a) llojet e kallëzuesit; b) kallëzuesin foljor; c) kallëzuesin emëror.

Puna e secilit grup diskutohet duke i dhënë mundësinë secilit nxënës të jetë pjesëmarrës. Mësuesi bën përmbledhjen e përfundimeve të nxjerra nga puna e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Diskutim;*

Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë që tregon një veprim apo një gjendje të kryefjalës.

Kallëzuesi është emëror dhe foljor. Kallëzuesi foljor është i thjeshtë dhe i përbërë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *Punë në dyshe.***1- Klasifikoni kallëzuesit**

Çfarë po bën? Kam për të bërë shumë punë, por nuk di ç' duhet të bëj më parë. Fola me Anën. Ishte duke bërë prova për koncertin e radhës. Ajo është shumë e talentuar, por është në merak për nesër. Sikur të bëja pak pushim tani? Si thua?

2 - Provoni të ndryshoni rendin e gjymtyrëve në këtë fjali, duke dhënë pesë variante të ndryshme. A ndikon rendi në funksionin e tyre sintaksor? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Kallëzuesi foljor		Shembuj
i thjeshtë	Shprehet me forma foljore të ndryshme.	Kush po këndon? Sa bukur kënduakan! Kush ka për të kënduar tani? Na këndo një këngë! Kush është duke kënduar kështu?
i përbërë	Formohet nga dy folje ku e para tregon mënyrën e veprimit dhe e dyta vetë veprimin.	Fillim veprimi: Filloi të flasë. Vazhdim veprimi: Vazhdonte të fliste. Mbarim veprimi: Pushoi së foluri.
	Formohet nga dy folje ku e para tregon mënyrën e kryerjes së veprimit dhe e dyta vetë veprimin.	Domosdoshmëri: Duhet të flasim. Mundësi: Mund të flasim.

Ushtrimi 1.

Dalloni kallëzuesit dhe nënvizoni fjalët që varen prej tij.
Ardhja e pranverës i gëzon të gjithë.
Karakteret e forta nuk i përkul asgjë.
Kush është duke folur në telefon?
Ka për t'u kthyer prapë këtu.

Ushtrimi 2. Ktheni kallëzuesit e mësipërm në kallëzues të përbërë dhe formoni fjali me ta.

Ushtrimi 3. Analizoni funksionet e formave foljore të pashtjelluara. Nënvizoni fjalët që lidhen me to. S'ka për t'u nisur njeri, pa përfunduar dielli. Shkova në bibliotekë për të marrë një libër. Një të rënë zilja, të gjithë vërshuan në oborr. Ecte duke fishkëllyer.

Ushtrimi 4.

Dalloni funksionet e foljes jam. kallëzues këpujë

Kush është në shtëpi?

Unë nuk jam ti.

Duhet të jesh më i kuptueshëm.

Ç'është kjo? Na ishte njëherë...

Vlerësimi i nxënësve:

Bëhet vlerësim i vazhdueshëm gjatë gjithë orës për nxënësit, me shprehje dhe notë, duke pasur parasysh punën në grup, saktësinë dhe pjesëmarrjen në mësim.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 5 - Gjeni kallëzuesit dhe gjymtyrët që varen prej tyre. Thoni llojin e kallëzuesit.
E kishte pritur me padurim pragun e Vitit të Ri për të bërë këtë telefonatë, pa e ditur se kjo do ta brengoste më shumë nga ç'ishte i brengosur deri më tash. Disa herë deshi të ngrihej e të ikte, as që i duhej ajo e folur. Zëri i nënës iu duk i huaj, i panatyrshëm. Deshi ta pyeste, por...

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje; - shkruan paragrafë me fjali të bashkërenditura dhe të nënrenditura.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: - të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me bashkërenditje			
Fjalët kyçe: fjali e thjeshtë, fjali e përbërë, kallëzues, bashkërenditje, lidhëza, këpujore/shtuese, krahasimore - kundërshtuese, veçuese, përmbyllëse, skema.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon fjalinë e thjeshtë nga fjalia e përbërë; - përcakton llojet e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe i përdor drejt ato.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: libri i nxënësit, Gramatika 2, skeda.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.			

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE:** *Diskutim, punë në grup, punë e pavarur*

Organizimi i orës së mësimit:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: *Diskutim*

1. Dalloni fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra. Argumentoni përgjigjen.

	e thjeshtë	e përbërë
*Për të pasur shëndet të mirë, duhet të ushqehesh mirë.	√	
*Ushqehu mirë dhe ke për të pasur shëndet të mirë.	√	
*Që të kesh shëndet të mirë, duhet të ushqehesh mirë.	√	
*Mund të ushqehesh mirë, por mund të mos gëzosh shëndet të plotë.		√
*Për të pasur shëndet të plotë nuk mjafton vetëm të ushqyerit mirë.	√	

Ndërtimi i njohurive të reja: punë në grup

Lidhni fjalitë e mëposhtme me lidhëza bashkërenditëse dhe përcaktoni llojin e marrëdhënies që vendoset mes tyre.

Shtëpia ishte e braktisur dhe lulet në oborr ishin tharë. (këpujore/shtuese)

* Bie shumë shi, por do të shkoj në kinema. (krahasimore-kundërshtuese)

* Të dielën do të shkoj në stadium ose do ta shoh ndeshjen në shtëpi. (veçuese)

* Ishte mesi i gushtit, ndaj në oborrin e shkollës dëgjohej vetëm kënga e gjinkallave. (përmbyllëse)

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: punë e pavarur

3. Dalloni fjalitë me bashkërenditje dhe mjetet që lidhin pjesët mes tyre.

Fillimisht vrapova drejt saj /dhe e ndihmoval/ të ngrihej,/ por pastaj u ktheva për të parë/ ç'bënte Lila. Kishte zbritur nga trotuari /dhe po shkonte te Melina duke kaluar rrugën,/ por pa ua vënë veshin kamionëve /që kalonin njëri pas tjetrit. I shqova në sjellje, më tepër se në fytyrë, diçka /që më turbulloi/ e që sot e kësaj dite e kam të vështirë/ ta përcaktoj, /pasi,/ edhe pse shkonte përmes rrugës, e vogël e zezë, nervoze,/ edhe pse e bënte me vendosmërinë e saj të zakonshme,/ gjithsesi kishte ngecur si e ngrirë.

4. Ndërtoni skemën e fjalive të mëposhtme.

*Dikush trokiti në derë/, por askush nuk u përgjigj.

*Frynte erë/, binte shi/, gjëmonte/ e vetonte/, por në rrugë kishte ende shumë lëvizje.

*Këtë fundjavë do të shkoj me prindërit në mal, /ose do të takohemi me shokët në det.

Çdo ushtrim diskutohet në klasë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i nxënësve bëhet hap pas hapi gjatë gjithë etapave të orës mësimore.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Ushtrimi 5, sipas kërkesës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje; - shkruan paragrafë me fjali të bashkërenditura dhe të nënrenditura.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe te shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje			
Fjalët kyçe: fjali e përbërë me nënrenditje, marrëdhënie varësie, pjesë e varur ffilluese, rrethanore, përcaktore, skema e fjalisë.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - dallon fjalitë e përbëra me nënrenditje dhe i përdor drejt ato; - identifikon skemën e fjalive të përbëra.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit, Gramatika 2, skeda me fjali nënrenditëse			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.			


PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: Pyetja sjell pyetjen; Kllaster; Diskutim; Punë e pavarur

Organizimi i orës së mësimit:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit: Pyetja sjell pyetjen, Kllaster;

Hapi I. U drejtohen pyetjet nxënësve: Si është marrëdhënia ndërmjet pjesëve në fjalinë e përbërë me nënrenditje? Cilat janë llojet e FPN (fjali e përbërë me nënrenditje)? Si paraqitet skematikisht FPN?

Hapi II. Përgjigjet e nxënësve përmbledhen te kllasteri:




Hapi III. Përqendrohet vëmendja te FPN ftilluese. Rikujtohet informacioni i marrë në klasë të tetë.

Cilat janë mjetet lidhëse që shërbejnë për të lidhur pjesët e FPN ftilluese? Si është lidhja midis pjesës kryesore dhe pjesës së varur në këto fjali? Në varësi të rolit që luan pjesa e nënrenditur në lidhje me kallëzuesin e pjesës kryesore, si i klasifikojmë FPN ftilluese? Cili është rendi i pjesëve të kësaj fjalie?

Ndërtimi i njohurive të reja: Diskutim

Paraqiten në skemë përgjigjet e nxënësve




Shpjegohen modelet e skemave nga mësuesi duke bashkëpunuar me nxënësit në analizën e fjalive.

- Rikujtohen hapat që ndiqen për ndërtimin e skemës së fjalisë së përbërë:


- 1 - nënvizohen kallëzuesit;
- 2 - vendosen numrat mbi secilin kallëzues, që do t'i përgjigjet numrit të pjesës përkatëse;
- 3 - qarkohen mjetet lidhëse;
- 4 - ndahen pjesët (përcaktohen gjymtyrët që lidhen me secilin kallëzues)
- 5 - ndërtohet skema;
- 6 - emërtohen pjesët.

Nuk e dinim 1 /që ishte i huaj 2 /dhe /që jetonte vetëm 3. Çfarë nuk dinim? Që ishte i huaj **dhe** që jetonte vetëm.



që – 1. n. ftilluese
dhe – 1. b. shtuese/këpujore
ftilluese-kundrinore


Jo vetëm që nuk e dinim 1/, **por** as nuk na e merrte mendja 2/ **që ishte i huaj**. 3 Çfarë nuk dinim dhe nuk na e merrte mendja? Këtë gjë: *që ishte i huaj*.



– l. b. shtuese/këpujore
që – l. n. ffilluese

Ftilluese-kundrinore

Jo vetëm që nuk e dinim 1/, por as nuk na e merrte mendja 2/**që ishte i huaj** 3/ **dhe/ që jetonte vetëm**. 4




Jo vetëm...por- l. b. shtuese/
këpujore *që – l. n. ffilluese*
dhe – l. b. shtuese/këpujore

ftilluese-kundrinore

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: *punë e pavarur*

Nxënësit, sipas hapave, punojnë një fjali nga skedat e përgatitura, p.sh.:

Toni nuk arriti 1/ të rikthehej në majë 2/, **kurse** unë pata mundësi 3/ të luaja më tepër. 4



kundërshtuese kurse – l.b. kundërshtuese
ftilluese-kundrinore (të dyja)

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve bëhet hap pas hapi, gjatë gjithë etapave të orës mësimore, duke pasur parasysh pjesëmarrjen, saktësinë e njohurive të mëparshme dhe përdorimin e tyre për temën e re.

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

Gjej 5 fjali të përbëra nënrenditëse në faqen 141 dhe shkruaji në skeda.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje; - shkruan paragrafë me fjali të bashkërenditura dhe të nënrenditura.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIME - Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: - Komunikim verbal dhe joverbal. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me nënrenditje rrethore			
Fjalët kyçe: FPN rrethore, kohore, vendore, shkakore, qëllimore, mënyrore, krahasore, kushtore, lejore, rrjedhimore.			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja: - përcakton FPN rrethore dhe e përdor drejt atë; - dallon llojin e pjesës së nënrenditur rrethore, mbështetur dhe në mjetet lidhëse; - ndërton skemën e fjalive të përbëra me nënrenditje rrethore.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit, Gramatika 2, skeda me fjali të përbëra.			

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS
GJATË ORËS MËSIMORE: *Punë në grup; Diskutim; Punë individuale; Punë në çift*

Organizimi i orës së mësimi:

Model skede

Ndërtoni skemën e fjalive, duke punuar sipas hapave.

- Kur dielli ra pas malit, bariu i vogël drejtoi bagëtinë drejt fshatit.
- U ul të shkruante në kompjuter, ndonëse ishte i lodhur nga puna.

Hapi I. Nxënësit ndahen në grupe me nga 4 nxënës. Secilit grup i jepet një skedë me 2 fjali të përbëra që kanë pjesë të nënrenditura rrethanore. U kërkohet nxënësve të punojnë për t'i paraqitur skematikisht këto fjali, duke punuar sipas hapave të mësuara.

Hapi II. Secili grup prezanton punën e bërë. Diskutohet për secilin rast të PN rrethanore. Skemat e këtyre fjalive paraqiten edhe në tabelë. Nëse ndonjë nga skemat nuk është ndërtuar saktë, mësuesi ndërhyr për ta sqaruar e për ta ndërtuar saktë dhe në të njëjtën kohë mësuesi ngacmon kujtesën e nxënësve në lidhje me njohuritë për FPN rrethanore.

Hapi III. Nxënësit drejtohen në tekst për të punuar ushtrimet 1-4 në faqen 338.

Ushtrimi 1 - Punë individuale

Dalloni fjalitë e përbëra me pjesë të varur rrethanore dhe mjetet e tyre lidhëse.

Kur vrulli i zemërimit i ra,/ e frenoi prapë veten. Orari zyrtar s'po mbaronte që s'po mbaronte.
Megjithëse i dhembnin sytë,/ Ebu Qerimi tërhoqi disa fletë nga dosja e ëndrrave të papërpunuara/
dhe i vuri përpara. Kishte përshtypjen /se lodhej më shumë duke bërë /**sikur** lexonte,/ **sesa** po të lexonte vërtet. Zgjodhi ato fletë /**që** i kishin tekstet më të shkurtra/ **dhe**, pa e parë fare adresuesin, lexoi njëren prej tyre.

Ushtrimi 2 - Punë individuale

Përcaktoni llojin e fjalive të mëposhtme dhe nënvizoni mjetet lidhëse.

*Nëse bie shi,/ do të rri në shtëpi. (FPN kushtore)

*Kur bie shi,/ rri në shtëpi. (FPN kohore)

*Rri në shtëpi/ **sepse** po bie shi. (FPN shkakore)

*Ndonëse bie shi,/ nuk rri në shtëpi. (FPN lejore)

*Po bie shi,/ **ndaj** rrimë në shtëpi. (FPB përmbyllëse)

Ushtrimi 3 - Punë në çift

Shtoni nga dy pjesë të varura në pjesët e mëposhtme dhe përcaktoni llojin e tyre.

*Nuk më kujtohet/ se kush ma dhuroi librin (kryefjalore) / që kisha mbi tavolinë (përcaktore).

*Askush nuk foli / që të mos mërzhitej babai (qëllimore)/,sepse ishte lodhur shumë gjatë ditës. (shkakore)

*Ne i dërguam/ se ata nuk kishin qenë asnjëherë në fshat, (shkakore)/ ndonëse e dashuronin natyrën. (Lejore)

*Jashtë frynte erë /sa herë që nxihej andej (kohore) / nga dukej maja e Dajtit.(vendi)

Ushtrimi 4 - Punë në çift

Ndërtoni skemën për secilën nga fjalitë e ndërtuara në Ushtrimin 3.

Ushtrimet diskutohen me të gjithë nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve:
Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve bëhet hap pas hapi që në etapën e parë të puna në grup e deri në punimin e ushtrimeve.
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR
Ushtrimi 5, sipas kërkesës.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësi/ja bën vlerësim të vazhdueshëm.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Rubrika: Njohuri gjuhësore Tema mësimore: Sintaksë		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: - dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe nënrenditje; - shkruan paragrafë me fjali të bashkërenditura dhe të nënrenditura.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Komunikues efektiv II. Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik III. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribuues produktiv V. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë VI. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT – Debaton, analizon dhe argumenton për tema të ndryshme. Pasuron fjalorin. Zhvillon forma të veçanta të shkrimit, ese, auto/biografi, tregim, poezi, skeçe, prezantime, raporte etj. Zbaton rregulla gjuhësore e drejtshkrimore për të shprehur mendimet, qëllimet, ndjenjat për tema të caktuara në forma të ndryshme të shkrimit. Zhvillon shkrimin kreativ për veten dhe të tjerët. Shkruan për tema të caktuara. Përdor rregullat e shfaqjes, planifikon organizimin, prezanton dhe vlerëson punimet e ndryshme (materiale të publikuara, ngjarje, komente etj.), për paraqitje në medie. II. VLERAT DHE QËNDRIMET – Komunikon mirë. Merr pjesë në diskutim. Bashkëpunon. Respekton mendimin e të tjerëve. Zhvillon personalitetin dhe humanitetin. Motivohet për zhvillimin e shkathtësive. Zhvillon imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve. Përdor teknologjinë informative. Dëshmon vullnet dhe gatishmëri për punë individuale dhe në grupe. Bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme. Kritikon duke u mbështetur mbi argumente. Kujdeset për veten, për të tjerët dhe për ambientin. III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen te nxënësi/ja: të komunikuarit; të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit; të lexuarit; të kuptuarit; përdorimi i teknologjisë informative; aftësitë e të menduarit; të menduarit krijues. IV. Njohuritë dhe konceptet specifike të fushës: Komunikim verbal dhe joverbal. Llojet e fjalive sipas intonacionit. Gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta. Shenjat e pikësimit.			
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Njësia mësimore: Fjalitë e përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore			

Fjalët kyçe: FPN, përcaktore, përemrat lidhorë, ndajfolje lidhore, vendi i PN, skema e FPN përcaktore.

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

Nxënësi/ja:

- përcakton FPN përcaktore dhe e përdor drejt atë;
- identifikon funksionin e fjalës *që* në fjali të ndryshme;
- ndërton fjali të përbëra me pjesë të nënrenditur përcaktore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti i nxënësit, Gramatika 2, skeda me fjali të përbëra me nënrenditje.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE: *Stuhi mendimi, Kllaster, Diskutim, Punë në grup; Punë individuale*

Organizimi i orës së mësim:

Hapi I. Rikujtohen njohuritë për FPN përcaktore, të marra në klasën e tetë.

- Ç'dini për FPN përcaktore? Çfarë tregon PN përcaktore? Ku është vendi i kësaj PN në raport me PK? Cilat janë mjetet me të cilat lidhen pjesët e FPN përcaktore?

Hapi II. Konkretizohen përgjigjet me punimin e fjalisë: Dielli 2/ *i cili dukej si një disk i zjarhtë në kupë të qiellit*, 1/ *digjte* atë fillim gushti 2.

Hapi III.

Mjetet lidhëse

- P. lidhor: që, i cili
- Nd. lidhor: ku, nga

FPN
përcaktore


PN përcaktore tregon tipar, veçori të një gjymtyrë emërore të PK

Qëndron pas gjymtyrës që përcakton


Qëndron në mes dhe pas PK

Hapi IV. Punohen fjalitë për t'u njohur me skemat e FPN përcaktore.

A vjen nga Durrësi treni 1/ që ndaloj në stacionin 2/ që u hap së fundi? 3



Hante gjithçka 1/ që ishte e shijshme 2/ dhe/ që tretej lehtë 3.



ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekste udhëzuese			Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e jolettrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):				
I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.				
V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):				
I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit				
II. VLERAT DHE QËNDRIMET				
III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË				
IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Këshilla për të shmangur shqetësimin e panevojshëm përgjatë pasigurisë globale				
Fjalët kyçe: këshilla, shqetësim, siguri.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore				
Nxënësi/ja:				
• zotëron dhe përdor gjuhën për qëllime të ndryshme komunikimi dhe kreativiteti; • identifikon tekstin udhëzues; • dallon këshillat për t'i shmangur shqetësimet.				
Kriteret e suksesit:				
• analizon tekstin udhëzues në fragment; • përshkruan këshillat për të shmangur shqetësimet; • vlerëson këshillat si bazë për të parandaluar një depresion.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh				
Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit: Si veproni kur shpesh nga rutina e përditshme nervozoheni dhe ndiheni të pasigurt me ngjarjet që po ndodhin kohëve të fundit?				
Nxënësit/et përgjigjen në pyetje dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi/ja.				
Pastaj shpjegon pjesën para leximit.				

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim - Ditari dypjesësh - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Këshilla për të shmangur shqetësimin e panevojshëm përgjatë pasigurisë globale” pastaj, lexon pjesën e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend me zë dhe gjatë leximit të ndajnë këshillat e pëlqyera për t’i komentuar. Pas leximit udhëzohen t’i shkruajnë në fletore këshillat e zgjedhura dhe t’i komentojnë. Pastaj, disa nxënës i lexojnë këshillat e zgjedhura dhe komentojnë zgjedhjen e tyre. P.sh.:

Këshilla e pëlqyer	Komentimi
*	*
*	*

Pastaj udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1, 2.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 3, 4.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 5.

Grupi i katër – Reflektojmë rreth tekstit, detyrat 6, 7, 8.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et nëse kanë nevojë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela T

Në këtë fazë udhëzohen të shprehin mendimet e tyre për temën dhe të komentojnë mendimet e tyre si mendimet pozitive po ashtu, edhe negative.

Si mendoni, a janë të vlefshme për këdo këshillat e këtij teksti? Argumentoni mendimin tuaj.

Përgjigje pozitive

Tema
(Pyetje)

Përgjigje negative

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Zhvilloni një projekt me temë “Teknologjia ndihmon komunitetin”. Ndahuni në grupe dhe realizoni:

Grupi I – paraqitjen e programeve kompjuterike që lehtësojnë komunikimin në komunitet.

Grupi II – udhëzues për përdorimin e një prej programeve të tilla kompjuterike.

Grupi III – këshilla për të menaxhuar kohën gjatë përdorimit të njërit prej këtyre programeve kompjuterike.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekste udhëzuese		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Dieta e jetëgjatësisë			
Fjalët kyçe: këshilla, shqetësim, mbipeshë, edukatë, ushqim i shëndetshëm.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: • zotëron dhe përdor gjuhën për qëllime të ndryshme komunikimi dhe kreativiteti; • identifikon tekstin udhëzues; • dallon këshillat për ushqime të shëndetshme. Kriteret e suksesit: • analizon tekstin udhëzues në fragment; • përshkruan këshillat për t'i shmangur shqetësimet e mbipeshës; • vlerëson këshillat si bazë për të parandaluar mbipeshën.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh			
Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit: Cilat janë ushqimet e shëndetshme? A konsumoni ushqime të pashëndetshme që tani në kohët e fundit po emërtohen si “Mbeturina” edhe pse e dini që janë të dëmshme? Nxënësit/et përgjigjen dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi/ja. Pastaj shpjegon pjesën para leximit.			

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim - Ditari dypjesësh - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Dieta e jetëgjatësisë” pastaj, lexon pjesën e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend me zë dhe gjatë leximit të ndajnë këshillat e pëlqyera për t’i komentuar. Pas leximit udhëzohen t’i shkruajnë në fletore këshillat e zgjedhura dhe t’i komentojnë. Pastaj, disa nxënës i lexojnë këshillat e zgjedhura dhe komentojnë zgjedhjen e tyre. P.sh.:

Këshilla e pëlqyer	Komentimi
*	*
*	*

Pastaj udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3, 4.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 5, 6.

Grupi i katër - Reflektojmë rreth tekstit, detyrat 7, 8.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et nëse kanë nevojë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela T

Në këtë fazë udhëzohen të shprehin mendimet e tyre për temën dhe të komentojnë mendimet e tyre si mendimet pozitive po ashtu, edhe negative.

Mendoni se është e rëndësishme mënyra e gatimit të ushqimeve? Jepni opinionin.

Përgjigje pozitive

Tema
(Pyetje)

Përgjigje negative

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mendoni se është e rëndësishme mënyra e gatimit të ushqimeve? Jepni opinionin tuaj dhe më pas formuloni një recetë të shëndetshme për një nga vaktet e të ngrënit. Mendoni për ushtrimet fizike që kryeni zakonisht. Përzgjidhni njërin prej tyre dhe shkruani pesë udhëzime për realizimin e tij.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE				
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekstet argumentuese			Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore: Fjalimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut				
Fjalët kyçe: luftë, fjalim, oratori, bindje, paqe, argumentim, principatë.				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja:				
• zotëron dhe përdor gjuhën për qëllime të ndryshme komunikimi dhe kreativiteti; • identifikon veçoritë kryesore të këtij fragmenti; • dallon tiparet idetë dhe mesazhet e shprehura në të; • interpreton dhe diskuton rreth ideve të shprehura në tekst.				
Kriteret e suksesit:				
• analizon veçoritë kryesore në këtë fragment; • përshkruan një tipar, një mesazh dhe një ide të shprehur nga Skënderbeu në tekst; • vlerëson fjalimin e Skënderbeut duke përsëritur shprehjet e tij bindëse ndaj popullit.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:				
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh				
Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit:				
Çfarë dini për marrëdhëniet diplomatike të Skënderbeut?				
Me cilin vend kishte më shumë marrëdhënie?				
Çfarë tregon kjo për aftësitë e tij?				
Nxënësit/et përgjigjen dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi/ja dhe shënohen në tabelë.				
P.sh.:				

Skënderbeu diplomat

*Diplomaci me Venedikun
*Burrë shteti
*Dinak dhe i zgjuar

*Diplomacia e ruajti gjatë në pushtet
*Ishte i aftë për të drejtuar
*Diplomacinë e mbajti edhe me familjet

Pastaj mësuesi-ja shpjegon tekstin argumentues.

Ndërtimi i njohurive të reja: Grupet e ekspertëve

Në këtë fazë mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Fjalimi i Gjergj Kastriot Skënderbeut”, pastaj i ndan nxënësit në katër grupe punuese dhe udhëzohen të lexojnë pjesën dhe të shkruajnë në *flipchart* dhe si ekspert të asaj pjese do ta përgatisin në formë prezantimi në mënyrë më të mirë dhe më të qartë për të tjerët. Lexohet teksti dhe nxirren informacionet, vizatohet skema sipas nevojës dhe prezantohen në fund.

Prezantimi shkon sipas radhës së pjesëve të ndara.

1. Tematika e fjalimit.
2. Qëllimi i fjalimit.
3. Mesazhi që përcjellë Skënderbeu në popull.
4. Qëndrimi i Skënderbeut gjatë fjalimit.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Fjalori letrar-diplomatik Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, nxënësve u jepet për detyrë që të nxjerrin fjalët e reja dhe të shkruajnë përkufizimin e tyre, në formë të një fjalori të vogël letrar-diplomatik.

Pastaj udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3, 4.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 5, 6.

Grupi i katërt - Reflektojmë rreth tekstit, detyrat 7, 8.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et nëse kanë nevojë.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur


Kërkoni informacion në internet apo në libra historikë rreth figurës së heroit madhështor, Skënderbeut. Diskutoni në grup rreth vlerave të tij kombëtare.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekstet argumentuese		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e jolettrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Zbulimi i Hektorit			
Fjalët kyçe: luftë, tejzat, ekzemë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: • zotëron dhe përdor gjuhën për qëllime të ndryshme komunikimi dhe kreativiteti; • identifikon veçoritë kryesore të këtij fragmenti; • dallon tiparet idetë dhe mesazhet e shprehura në të; • interpreton dhe diskuton rreth ideve të shprehura në tekst.			
Kriteret e suksesit: • analizon veçoritë kryesore në këtë fragment; • përshkruan një tipar, një mesazh dhe një ide të shprehur nga Hektori; • vlerëson mendimin e popullit që trupin dhe fytyrën e kundërshtarit nuk duhet ta dëmtojme.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Stuhi mendimesh Në këtë fazë, mësuesi/ja pyet nxënësit/et: Çfarë dini për veprën “Iliada”? Cilat janë personazhet në vepër? Ku ishte pika e dobët e Akilit?			

Nxënësit/et përgjigjen dhe të gjitha mendimet respektohen nga mësuesi/ja dhe shënohen në tabelë. P.sh.:



Pastaj mësuesi/ja shpjegon tekstin argumentues.

Ndërtimi i njohurive të reja: Ruaje fjalën e fundit për mua - Marrëdhënia Pyetje-përgjigje

Në këtë fazë, mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e njësisë mësimore “Zbulimi i Hektorit” pastaj, lexon pjesën e zgjedhur në tekst ose mund të kërkojë nga nxënësit/et që ta lexojnë me rend me zë dhe gjatë leximit t’i ndajnë pjesët e pëlqyera. Pas leximit udhëzohen që pjesët që kanë zgjedhur t’i shkruajnë në fletore dhe të komentojnë pjesën. Pas përfundimit të detyrës, nxënësi/ja që lexon pjesën e zgjedhur fton një nxënës/se tjetër që ta komentojë pjesën që ka dëgjuar. Pastaj nxënësi që ka lexuar pjesën, komenton, sepse edhe e ka të përgatitur si pjesë të zgjedhur më parë. Njësoj veprohet edhe me nxënësit/et e tjerë.

Pastaj udhëzohen nga mësuesi/ja të punojnë në grupet e tyre punuese pyetjet e tekstit.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 4, 5.

Grupi i katër - Reflektojmë rreth tekstit, detyrat 6, 7, 8.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit/et nëse kanë nevojë.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Top tre

Në këtë fazë nxënësit/et udhëzohen të shkruajnë tri fjali që e përmbledhin tërë njësinë mësimore.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Lexoni vargjet e mëposhtme, të shkëputura nga “Iliada” e Homerit, kushtuar paraqitjes së Akilit dhe Hektorit. Shkruani një tekst të shkurtër në të cilin të krahasoni përshtypjet që ju lënë Hektori dhe Akili në të dyja tekstet (teksti i Kadaresë dhe teksti i Homerit).

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Shkruajmë një ese argumentuese (ora e parë)		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik, ese.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Shkruajmë ese argumentuese			
Fjalët kyçe: ese argumentuese, tema, hyrja, teza, argument, kundër-argumente, mbyllja			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - klasifikon tema për lloje të ndryshme esesh argumentuese; - analizon strukturën e esesë argumentuese; - rikujton njohuritë në lidhje me esenë dhe llojet e saj; - dallon tekstin letrar nga ai joletrar.			
Kriteret e suksesit: - shkruan një ese argumentuese, duke respektuar formën dhe përmbajtjen e saj; - shkruan pa gabime drejtshkrimore; - analizon esenë argumentuese nga ana gjuhësore; - shpjegon ndërtimin e një eseje argumentuese.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela, Libri Si të shkruajmë ese, CDE.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi, Tik.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			

Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore:**Ndërtimi i njohurive të reja : *Përvijim i të menduarit***

Keni dëgjuar për esenë argumentuese.

Cila është struktura e kësaj eseje?

Në sa paragrafë organizohet eseja argumentuese?

Nxënësit japin përgjigje.

Teksti argumentues

HYRJA - Shpjegon shkurtimisht temën, rëndësinë e saj dhe në të zakonisht gjendet teza e esesë.	Zakonisht, në të bëhet përmbledhja e argumenteve të dhëna gjatë zhvillimit. Asnjë informacion i ri nuk duhet të jepet në fund.
ZHVILLIMI - Autori zhvillon argumentet e tij dhe i mbështet ato me dëshmi të vlefshme dhe të besueshme. Argumentet mund të jenë logjike, statistikore ose faktike, varësisht nga tema e esesë.	Mjetet gjuhësore Përdorimi i vetës së parë njëjës. Kalimi nga veta e parë njëjës në vetën e parë shumës. Mbizotëron objektiviteti.
Qëllimi: të bindë lexuesin nëpërmjet fakteve dhe argumenteve bindëse.	Të argumentojnë se pikëpamjet e tij janë të sakta.
Kundërteza: Jepen pikëpamjet e kundërshtarëve, që rrëzohen nëpërmjet argumentit më të fortë të dhënë nga autori.	Koherenca dhe kohezioni

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i koduar Varianti 1

Ashtu si dashuria, libri nuk vdes kurrë

Ditë më parë, duke kaluar hutueshëm nga njëri kanal i televizorit në tjetrin, ndesha në një kanal ku po transmetohej njëfarë spoti i gjatë, apo lajmërimi për një program të ri. (Nuk e mbaj mend se cili televizion ishte saktësisht, dhe kjo pohon se sa i pambrojtur ideologjikisht është telespektatori krahasuar me lexuesin e gazetave, i cili e di me saktësi se kush po i flet.) Po u bënë reklamë mrekullive të CD-ROM-ve, disqeve që mund të na ofrojnë të njëjtlshmen e një enciklopedie të tërë, me ngjyra, tinguj dhe mundësisht me lidhje të menjëhershme nga argumenti në argument.

Meqenëse po krijoj njëfarë përvoja në këtë fushë, e pra e njoh argumentin, nuk po i kushtoja vëmendje të madhe.

Derisa, në njëfarë pike, dëgjova emrin tim: po thuhej se unë paskësja pohuar që këto disqe do të zëvendësojnë përfundimisht librat. Askush, veç në qoftë paranojak, s'mund të mëtojë që të tjerët të lexojnë gjithçka që ai shkruan, por të paktën mund të shpresojë që mos t'i vënë në gojë pikërisht të kundërtën, sidomos nëse po e përdorin, në mënyrë të paligjshme, për t'i bërë reklamë diçkaje. Në të vërtetë, po e përsëris fort e më fort se CD-ROM-i nuk mund ta zëvendësojë kurrë librin. Ka dy lloje librash, ata për t'u konsultuar dhe ata për t'u lexuar. Të parët (prototip është lista telefonike, por mund të shkohet deri te fjalorët dhe enciklopeditë) zënë shumë vend në shtëpi, janë të vështirë për t'u manovruar dhe janë të kushtueshëm. Këta mund të zëvendësohen nga disqet multimediale, kështu lirohet hapësirë në shtëpi dhe në biblioteka publike.

Ndërsa librat për t'u lexuar (që shkojnë nga "Komedia Hyjnore" te romani i verdhë më i vonë) nuk mund të zëvendësohen nga asnjë gjësend elektronik. Janë bërë për t'u mbajtur në dorë, edhe në shtrat, edhe në barkë, edhe atje ku nuk ka spina elektrike, edhe atje ku e kur çfarëdolloj baterie shkarkohet.

Në esenë argumentuese, autori mban një qëndrim për një çështje të cilën e mbështet me argumente. Qëndrimi i autorit shprehet nëpërmjet tezës, e cila nga ana gjuhësore shprehet me një fjali dëftore. Nga pikëpamja logjike, ndaj këtij qëndrimi të autorit, ka pikëpamje të ndryshme, që edhe mund të jenë në kundërshtim me të. Një mënyrë e mirë për të shndërruar idetë në tezë, është t'u përgjigjeni pyetjeve rreth çështjes nëpërmjet tezës.

Mësuesi udhëzon nxënësit në leximin e vëmendshëm të esesë duke koduar ato pjesë të tekstit që kanë të bëjnë me elementet përbërëse të përmbajtjes së esesë argumentuese.

Kujdes! Më poshtë janë kodet që nxënësit do të vendosin gjatë leximit të tekstit.

Hyrja – Autori tërheq vëmendjen lexuesit duke tërhequr situatën

Teza: CD-ROM-et nuk mund të zëvendësojnë librin.

Argumente:

Kundër-argumente

Mbyllja:

Varianti 2

Mësuesi/ja mund të përdorë një model eseje argumentuese që nuk është në tekst

Reklamat

Specialistët tregojnë se një ekonomi e shëndetshme varet nga një qarkullim i shëndetshëm i mallrave dhe i shërbimeve.

Kur njerëzit ndalojnë së bleri dhe së shituri, ekonomia fillon të bjerë. Njerëzit varfërohen dhe jeta kthehet në një luftë për mbijetese. Kushdo që dëshiron të shesë diçka, duhet t'u bëjë të ditur njerëzve se çfarë është ajo që kërkon të shesë dhe sa kushton. Një shitës duhet të tregojë mallra dhe t'i bindë njerëzit se ata kanë nevojë për to. Me fjalë të tjera, një shitës duhet të reklamojë. Kohët e fundit është bërë e modës që reklamat të kritikohen me idenë se ato zhvatin konsumatorin dhe ndotin zona të tëra me grumbuj hedhurinash. Një pjesë e reklamave shumëgjyreshe në revista të shkëlqyera, si dhe disa programe zbavitëse në televizion përçmohen jo vetëm se fyejnë inteligjencën e të rriturve, por edhe se dëmtojnë mendjet e fëmijëve dhe të rinjve (dhe kjo është me e keqja). Megjithatë, televizionet dhe revistat do të falimentonin pa reklamat, pasi ato kontribuojnë në një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre. Një tjetër përgjegjësi që i ngarkohet industrisë së reklamave, është se reklamimi i nxit njerëzit të blejnë gjëra që realisht nuk u duhen.

Një pohim ky, paksa, i pazakontë për një demokraci liberale që mbështetet në parimet e zgjedhjes së lirë. Kjo përgjegjësi krijon vizionin e një qytetari të pafuqishëm, që ndodhet në mes të një mekanizmi të "shpëlarjes" së trurit. Kërkoni po të doni, por kurrë nuk do të gjeni në regjistrat e gjyqeve një rast të vetëm të një qytetari të pafajshëm, që është detyruar nga reklamuesit apo reklamat, të blejë diçka që ai ose ajo nuk e ka dashur. Le t'i lëmë blerësit t'i hapin vetë sytë, por mos iu shmangni periudhës kur çmimet bien ndjeshëm vetëm se disa njerëz kanë mendime negative. Disa kritikë mendojnë se reklamat kontribuojnë në shtimin e ndotjes dhe po përshpejtojnë zhdukjen e materialeve të rralla nga planeti. Deri diku, kjo mund të jetë e vërtetë, por në këtë çështje ndikojnë edhe faktorë të tjerë, si: konsumatorët që i dëshirojnë këto mallra, prodhuesit që përfitojnë nga produktet e tyre, qeveria që ka nevojë për taksat që vijnë nga ekonomia e kështu me radhë. Shqyrtojeni me kujdes këtë listë dhe shikoni se ku ndodheni ju vetë.

Herën tjetër, kur të dëgjoni dikë të thotë se reklama ka një ndikim të pafavorshëm në ekonomi, risillni në mendje se ajo është katalizator në procesin e shitjes dhe të blerjes.

Teza: Reklama është katalizatori në procesin e shitjes dhe të blerjes.

Argumenti 1. Pa reklama, televizionet dhe revistat do të falimentonin, pasi ato kontribuojnë në një pjesë të madhe të të ardhurave të tyre.

Argumenti 2 Kërkoni po të doni, por kurrë nuk do të gjeni në regjistrat e gjyqeve një rast të vetëm të një qytetari të pafajshëm, që është detyruar nga reklamuesit apo reklammat, të blejë diçka që ai ose ajo nuk e ka dashur.

Kundërteza: Reklammat të kritikohen me idenë se ato zhvatin konsumatorin dhe ndotin zona të tëra me grumbuj hedhurinash.

Teknikat që përdor autori për të përfshirë lexuesin në problemin që trajton:

Teknikat: përdorimi i vetës II shumës, duke iu drejtuar drejtpërdrejt lexuesit/dëgjuesit;

- mbyllja mbetet e hapur, fton lexuesin të shtojë gjykimin e tij;
- përdorimi herë pas herë i një leksiku të shkujdesur, bisedor;
- toni sugjerues.

Karakteristikat e esesë argumentuese:

- hyrja është e shkurtër, prezantohet çështja;
 - fillon me kundërtezen dhe argumentet mbështetëse të saj (këndvështrimi I);
 - më pas ka argumente në mbështetje të tezës;
 - çdo argument kundra tezës shoqërohet me një argument pro asaj;
 - në paragrafin përmbyllës shfaqet qëndrimi i autorit, por njëkohësisht diskutimi lihet i hapur;
 - koherenca dhe kohezioni sigurohen përmes përshtatjes morfologjike të fjalëve, përmes përdorimit të një gjuhe të saktë, përmes mjeteve lidhëse (lidhëza, përemra lidhore, ndajfolje etj.).
- Burimi: AKP, Matura shtetërore 2015, Shkolla Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me shkrim

Udhëzohen nxënësit të punojnë për hartimin e një eseje argumentuese me temë: “Një vend kaq i afërt nga fëmijëria e largët”.

Kujdes! Udhëzohen nxënësit për:

- strukturën e esesë;
- argumentet bindëse që sjellin;
- pasurinë e detajeve;
- organizimin e paragrafëve;
- gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore;
- përdorimin e saktë të shenjave të pikësimit që përdoren brenda dhe në fund të fjalisë.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).


Detyrat dhe puna e pavarur

Jeta ime pa teknologji

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Shkruajmë një ese argumentuese (ora e dytë)		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik, ese.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Shkruajmë ese argumentuese			
Fjalët kyçe: ese argumentuese, tema, hyrja, teza, argument, kundër-argumente, mbyllja			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - klasifikon tema për lloje të ndryshme esesh argumentuese; - analizon strukturën e esesë argumentuese; - rikujton njohuritë në lidhje me esenë dhe llojet e saj; - dallon tekstin letrar nga ai joletrar.			
Kriteret e suksesit: - shkruan një ese argumentuese, duke respektuar formën dhe përmbajtjen e saj; - shkruan pa gabime drejtshkrimore; - analizon esenë argumentuese nga ana gjuhësore; - shpjegon ndërtimin e një eseje argumentuese.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela, Libri Si të shkruajmë ese, CDE.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi, Tik.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Ndërtimi i njohurive të reja: Kllaster			



Lexohet detyra e shtëpisë nga nxënës të ndryshëm. Diskutojmë së bashku.

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e pavarur individuale

Udhëzohen nxënësit që të shkruajnë një ese argumentuese.

Pavarësisht se klasa është ndarë në grupe për temën e esesë, puna është individuale për secilin nga anëtarët e grupit.

Grupi 1 Kur lexoj një libër, mbyll një portë dhe ngre një perandori.

Grupi 2 Libri prej letre është i lehtë, por forca e tij është aq e jashtëzakonshme, sa e ngre njeriun në majat e universit.

Grupi 3 Libri apo filmi?

Kujdes! Udhëzohen nxënësit për:

- strukturën e esesë;
- argumentet bindëse që sjellin;
- pasurinë e detajeve;
- organizimin e paragrafëve;
- gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore;
- përdorimin e saktë të shenjave të pikësimit që përdoren brenda dhe në fund të fjalisë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Mësuesi/ja përpaket që puna me shkrim e nxënësve të përfundojë brenda 30 minutave. Më pas lexohen disa nga punët e nxënësve dhe diskutohet rreth tyre.

Diskutimi përqendrohet në elementet përbërëse të esesë argumentuese teza, argumentet, kundërteza kundër-argumentet etj.

Nxënësit vlerësojnë shkrimet e shokëve jo vetëm nga përmbajtja, por edhe nga struktura, drejtshkrimi etj.

Mësuesi/ja mbledh fletoret e punës me shkrim për t'i vlerësuar me notë.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Vlerësohen nxënësit për strukturën e esesë, për analizën e elementeve të strukturës dhe të përmbajtjes.

Detyrat dhe puna e pavarur

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekste përshkruese		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e jolettrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Parku i Gërmisë			
Fjalët kyçe: Parku, lumi, lartësi, kodra, flora dhe fauna.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - ndërton një tekst mbi fjalë kyçe; - dallon e sqaron fjalët e reja të tekstit; - lexon paraprakisht informacionin, në mënyrë që të mos ketë vështirësi për të kuptuar.			
Kriteret e suksesit: - lidh informacionin që merr me përvojat e tij; - rilexon tekstin për të ngulitur në mendje detajet me të rëndësishme; - bashkëpunon me grupin për të zbërthyer tekstin sipas ndërtimit gjuhësor; - dallon elemente të tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: <i>Fjalë kyçe, shkrim me terma paraprakë.</i> Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën “Pikë turistike” dhe nxënësit/et japin emra vendesh në Kosovë ose Shqipëri që janë vende turistike. Kërkohet nga nxënësit/et që të sqarojnë shkurtimisht se cila është sipas tyre arsyeja që disa vende quhen pika turistike, çfarë i veçon dhe i dallon këto vende. (<i>Të veçanta i bën lashtësia, stili kulturor, natyra, bregdeti, gastronomia, stili arkitekturor, flora dhe fauna e tyre, traditat dhe zakonet etj.</i>). Mësuesi/ja shkruan në tabelë disa fjalë kyçe si: liqen, breg, plazh, sipërfaqe, fundi, peshq, Evropë, Shqipëri.			

Në formën e mendimit të lirë nxënësit shkruajnë një tekst ku duhet të përdorin fjalët e dhëna. Mësuesi/ja vendos kriterin për tekstin që duhet të krijojnë. Teksti duhet të jetë një tekst përshkruar. Nxënësit punojnë me udhëzimet e dhëna për të lidhur fjalët në një tekst përshkruar. Punimet e nxënësve dëgjohen dhe diskutohen para klasës duke nxjerrë elementet e përshkrimit.

Ndërtimi i njohurive të reja: *Punë e drejtuar, minileksion.*

Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e mësimit “Parku i Gërmisë” dhe drejton nxënësit të lexojnë në heshtje tekstin.

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale mbi të kuptuarit e tekstit dhe fjalët e reja të fjalorit.

Pas leximit të drejtuar mësuesi/ja ngre nxënësit për të sqaruar:

1- llojin e tekstit (*joletrar*);

2- për çfarë flet teksti (*jep informacione për Parkun e Gërmisë*);

3- qëllimi i tekstit (*të sjellë informacione*);

4- mënyra që përdor autori për të përcjellë informacionin (*teksti përshkruar*).

Sqarohet teksti përshkruar: *Teksti përshkruar ka si qëllim të përshkruajë duke paraqitur me detaje tiparet e një objekti, të një personi, të një kafshe, të një mjedisi, apo të një dukurie.*

Përshkrimi mund të jetë:

1- objektiv (në enciklopedi, në tekste shkencore, dokumente zyrtare etj.);

2- subjektiv (në ditarët, në letrat personale dhe në tekstet letrare).

Përshkrimi mbështetet në perceptimin shqisor: të shikuarit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit.

Në të jepen detaje dhe informacione të hollësishme të objekteve që përshkruhen.

Në tekstin përshkruar mbizotëron përdorimi i mbiemrave dhe fjalëve përshkruese. Në funksion të përshkrimit përdoren edhe ndajfolje, parafjalë, fraza që tregojnë pozicionin në hapësirë të objektit që përshkruhet.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: *Hulumtim, punim ushtrimesh, informacione shtesë.*

Nxënësit udhëzohen të hulumtojnë mbi tekstin duke iu rikthyer leximit për të dalluar elementet e përshkrimit. Duke lexuar e hulumtuar, nxënësit mbajnë shënim të dhënave që marrin nga teksti mbi Parkun e Gërmisë. Hulumtohet për disa minuta dhe lexohen shënimet. (*Në tekst jepen tri elemente të rëndësishme të parkut: pozicioni gjeografik, flora dhe fauna, lartësia mbidetare*).

Punohet me radhë me ushtrimet e tekstit në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve.

Grupi i parë - Kuptojmë tekstin, detyra 1.

Grupi i dytë - Analizojmë tekstin, detyrat 2, 3.

Grupi i tretë - Gjuha e tekstit, detyrat 4, 5.

Grupi i katër - Reflektojmë rreth tekstit, detyrat 6, 7.

Mësuesi/ja ndihmon nxënësit nëse kanë nevojë.

Në fund mësuesi/ja jep informacione shtesë për Parkun e Gërmisë.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Përshkruani në mënyrë subjektive Parkun e Gërmisë ose një park tjetër që ju ka lënë mbresa. Bazohuni në perceptimin shqisor për të realizuar një përshkrim të arrirë.

Vendosini shkrimin një titull dhe zgjidhni fotografi për ta shoqëruar atë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Tekste përshkruese		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit /Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Banesa tiranse			
Fjalët kyçe: tekst informues, banesë tiranase, përshkrim, Sali Shijaku			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - dallon tekstin letrar nga ai joletrar; - nxjerr veçoritë e tekstit përshkrues; - nxjerr përfundime pasi ka lexuar dhe ka kuptuar tekstin. Kriteret e suksesit: - mban shënime gjatë të lexuarit për të bërë ilustrime; - jep argumente që mbështesin interpretimin e tij; - dallon elementeve të tekstit, si: tema, paragrafi, hyrja, përfundimet.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Ndërtimi i njohurive të reja: fotomontazh, bisede e kombinuar me diskutim dhe argumentim, organizuesi grafik. Mësuesi/ja prezanton përpara nxënësve disa fotografi të ndërtesave të vjetra të qyteteve të ndryshme të vendit tonë. Gjatë shikimit të fotove, nxënësve u sqarohet qyteti dhe diskutohet mbi disa tipare që i dallojnë apo afrojnë nga njëra-tjetra.			

259

Mësuesi/ja lidh situatën me temën duke sqaruar se edhe me anë të fotografisë mund të komunikosh, por komunikimi më i plotë është ai përmes gjuhës së folur dhe të shkruar.

Rikujtohen njohuritë me anë të pyetjeve:

1- Çfarë kuptojmë me komunikim? (Komunikimi është nevojë e përditshme, por është edhe element argëtimi, element që forcon miqësitë, bashkëpunimet dhe lehtëson veprimtaritë e jetës sonë të përditshme).

2- Sa llojesh është ai? (gjuhësor dhe jo gjuhësor).

3- Po komunikimi gjuhësor si ndahet? (Komunikim me anë të gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar).

4- Cili komunikim është më i saktë? (gjuhësor, sepse me anë të gjuhës së folur e të shkruar mund të përcillen më mirë informacionet, mesazhet, mund të përshkruhen ndjenjat etj.).

Komunikimin e përdorim për qëllime të ndryshme dhe tekstet e krijuara për qëllime të ndryshme kanë dhe veçori të ndryshme.

Mësuesi/ja ndërton në tabelë një skicë për të nxjerrë disa lloje tekstesh.

Teksti	Veçoritë	Shembuj
Rrëfimtari	Rrëfen, tregon ngjarje, ka personazhe, ka një histori të trilluar a të vërtetë.	Tregim, roman, përrallë
Argumentues	Jep një opinion dhe e mbrohet me fakte bindëse.	Ligjërata, fjalime
Përshkrues	Përshkruan pamjen e personave, objekteve dhe vendeve.	Tekste artistike, guida, manuale.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Hulumtim, punë e drejtuar.

Mësuesi/ja njih nxënësit me temën e re, me tekstin përshkrues: “Banesa tiranase”. Lexohet pjesa dhe sqarohen fjalët e fjalorit.

U kërkohet nxënësve që të hulumtojnë mbi pjesën e dhënë për të gjetur elementet e tekstit përshkrues, të cilat i kanë marrë më parë. Rikujtohen njohuritë për ta pasur nxënësit më të thjeshtë.

Punohet disa minuta në heshtje për të studiuar tekstin dhe më pas ngrihen nxënësit me radhë për të gjetur detaje të tekstit përshkrues.

Mësuesja ndjek punën e nxënësve duke i drejtuar për të gjetur elementet e tekstit përshkrues.

1- Teksti përshkrues ka si qëllim të përshkruajë, duke paraqitur me detaje tiparet e një objekti, të një personi, të një kafeje, të një mjedisi, apo të një dukurie (E ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit XIX, ajo paraqet fazën më të zhvilluar të kësaj banese. Ajo ka planimetri katërkëndëshe të rregullt me dy kate).

2- Përshkrimi mbështetet në perceptimin shqisor: të shikuarit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit, të prekurit. (Dhoma e zjarrit, mjediset e ndenjjes dhe anekset e shërbimit).

3- Në të jepen detaje dhe informacione të hollësishme të objekteve që përshkruhen (nëpërmjet portave të mëdha dykanatëshe që janë pothuaj gjithmonë të mbuluara me çati të thjeshtë).

4- Në tekstin përshkrues mbizotëron përdorimi i mbiemrave dhe fjalëve përshkruese. Por, në funksion të përshkrimit përdoren edhe ndajfolje, parafjalë, fraza që tregojnë pozicionin në hapësirë të objektit që përshkruhet (katërkëndëshe, më të lashta, të mëdha, të mbuluara, gjithmonë).

5- Foljet e përdorura janë në kohën e tashme dhe të pakryer (janë, është).

Jepen disa detaje dhe informacione shkurt për piktorin Sali Shijaku. Një nga piktorët më të rëndësishëm në Shqipëri në shekullin XX. Lindi në Tiranë. Në Galerinë e Arteve ruhen rreth 92 vepra në pikturë, qeramike e vizatime.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin, puno/shkëmbe, punë individuale.

Punohet me ushtrimet për të zbërthyer të kuptuarit e tekstit.

Ushtrimi 1 - Banesa e Shijakasve daton në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. - x

Planimetria e saj është katërkëndëshe e rregullt me dy kate. - v

Bërthama e mjediseve përfaqëson saj është dhoma e zjarrit. - v

Banesat me vatrë zjarri kryesisht gjenden në zonën e Tiranës dhe në fshatrat përreth saj. - x

Në katin e parë janë ambientet e ndenjjes dhe anekset e shërbimit. - x

Në fillim të shekullit të njëzetë është bërë një rikonstrukcion i mjediseve, si dhe mbyllja e çardakut. - v

Këto lloj banesash hasen edhe në qytete të tjera të Shqipërisë. - x

Banesa e Shijakasve është shpallur monument kulture i kategorisë së parë në vitin 1973. - v

Banesat shqiptare dallohen për tipologjitë e tyre të larmishme e të pasura. - v

Ushtrimi 2 - Dhënësi – teksti; marrësi – lexuesi; kodi – gjuha shqipe; referenti – gjuha shqipe; kanali – shkrimi; Mesazhi - informacioni për ndërtesën tiranase dhe lashtësinë e saj.

Ushtrimi 3 - Objekti i përshkrimit - banesa tiranase; detajet – dy kate, katërkëndëshe, shkallë prej druri, mure qerpiçi, porta dykanatëshe; Shqisat – të shikuarit; Mënyra e organizimit të ideve – përshkrim në rend kohor.

Ushtrimi 4 - Do të punohet në grupe dyshe dhe nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin në saktësinë e ushtrimit.

Fazën më të zhvilluar: mbiemër i nyjshëm, femërore, njëjës, kallëzore, shkalla pohore.

Planimetri katërkëndëshe: mbiemër i panyjshëm, femërore, njëjës, kallëzore, shkalla pohore.

Ambientet ndihmëse: mbiemër i panyjshëm, femërore, shumës, emërore, pohore.

Llojet më të lashta: mbiemër i nyjshëm, femërore, shumës, emërore, krahasore.

Ushtrimi 5 – Shekullin - emër që tregon kohë; katërkëndëshe - mbiemër që tregon hapësirë; gjithmonë – ndajfolje që tregon kohë; fazën – emër, tregues kohor; përfaqëson – parafjalë, tregues hapësiror.

Ushtrimi 6 - Do të zhvillohet në mënyrë individuale dhe nxënësit do të përdorin stilin e individualitetin e tyre gjatë kthimit të tekstit në tekst përshkrues subjektiv. Mësuesi/ja ndjek dhe orienton nxënësit gjatë punës.

Ushtrimi 7 - (Po sepse është një tekst joletrar dhe qëllimi i tij është të sjellë një pamje të qartë të banesës tiranase, të sjellë informacion të saktë pa përfshirë opinionet dhe qëndrimet e autorit).

Ushtrimi 8 - Do të zhvillohet në formën e një diskutimi të lirë, duke qenë se nxënësit kanë njohuri për arkitekturën si pjesë e folklorit shqiptar.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Mblidhni informacion rreth arkitekturës së qytetit tuaj të pëlqyer dhe shfrytëzoheni atë për të krijuar një tekst përshkrues objektiv. Kujdesuni që të organizoni qartë mendimet tuaja.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Shkruajmë një ese përshkruese		Rezultati i të nxënit të temës: Nxënësi/ja: dallon elemente të teksteve të ndryshme letrare e joletrare si poezi, prozë, tekst dramatik; artikuj të gazetave apo revistave, tekstin biografik dhe autobiografik, ese.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 ,9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Shkruajmë ese përshkruese			
Fjalët kyçe: ese, ese përshkruese, përmbajtje, strukturë, paragraf, ide, detaje përshkruese			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - rikujton njohuritë në lidhje me esenë dhe llojet e saj; - dallon fjalitë përshkruese dhe mbiemrat në një tekst të dhënë; - krahason dy përshkrime objektive dhe subjektive; - dallon tekstin letrar nga ai joletrar.			
Kriteret e suksesit: - shkruan një ese përshkruese, duke respektuar formën dhe përmbajtjen e saj; - shkruan pa gabime drejtshkrimore; - vetëvlerëson krijimin e tij dhe punën e realizuar nga shokët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: “Gjuha shqipe 9”, Fleta të bardha, marker, tabela.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Edukatë qytetare, histori, gjeografi.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia për realizimin e njësisë mësimore: Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe U shpërndahen nxënësve disa modele të shkurtra esesh. Nxënësit, të ndarë në grupe, do të përcaktojnë llojin e esesë, qëllimin dhe tiparet e saj. Me pas, një përfaqësues i çdo grupi do të prezantojë punimin në tabelë. Vlerësohet puna e realizuar nga grupet (modele esesh argumentuese, krahasim kontrasti dhe ese përshkruese).			

Do të veçohet eseja përshkruese dhe nxënësit do të plotësojnë veçoritë e saj, duke shfrytëzuar edhe informacionin e paraqitur në tekst.

Ndërtimi i njohurive të reja:

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Lexim, Diskutim

Prezantohet tema e mësimi dhe lexohet teksti përshkrues: “Buzë liqenit të Janinës”. Gjatë leximit të pjesës udhëzohen nxënësit që të nënvizojnë mbiemrat. Mund të përcaktojnë edhe epitetet si figurë të përdorura.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve që lidhen me përmbajtjen e tekstit.

Perceptimi shqisor i të parit. Detaje që realizohen përmes mbiemrave të shumtë që janë përdorur.

Gjashtë remtarë të nxirë nga dielli... lopatat pezull.

Para barkës lundronte... të ndiqte turmën.

Nga ai krah ishulli... të pasanikëve të Janinës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur, Turi i galerisë

Përshkrimi i liqenit të Shkodrës është një përshkrim objektiv që mbështetet në fakte dhe të dhëna reale gjeografike, kurse përshkrimi i liqenit të Janinës është subjektiv, i parë nën këndvështrimin e një personazhi kaq madhështor si Ali Pasha. Gjuha në rastin e parë është asnjëse, me kuptim të drejtpërdrejtë, kurse në rastin e dytë është e figurshme.

Hapi I. Punë e pavarur: Nxënësit do të zgjedhin njërin nga temat e tekstit, për të hartuar një ese përshkruese, duke plotësuar më parë Organizuesin grafik, i cili do t'i orientojë për të realizuar sa më mirë punimin.

Hapi II. Turi i galerisë: Prezantimi i punimeve të realizuara nga nxënësit. Nxënësit do të vlerësojnë punën e realizuar nga ata vetë dhe nga shoku/shoqja. Gjatë vlerësimit do të kihen parasysh se sa janë zbatuar nga nxënësit rregullat e shkrimit të esesë përshkruese.

Vlerësimi i nxënësve: Nxënësit do të vlerësohen në bazë të angazhimit të tyre në procesin mësimor. Quhet e suksesshme atëherë kur kanë lexuar, shkruar dhe prezantuar (Vlerësim diagnostikues dhe të vazhdueshëm gjatë orës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë dhe letërsi shqipe	Shkalla e kurrikulës: IV	Klasa: IX
Tema: Projekte		Rezultati i të nxënit të temës: Fusha leksikore. Tërësia e fjalëve të një gjuhe quhet leksik. Leksiku është një sistem gjuhësor ku çdo fjalë ka vendin e vet dhe gjithmonë në lidhje me fjalët e tjera. Fusha leksikore është një bashkësi fjalësh që lidhen sipas kuptimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. Komunikues efektiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. II. Mendimtar kreativ 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. III. Nxënës i suksesshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. IV. Kontribuues produktiv 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8. V. Individ i shëndoshë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9. VI. Qytetar i përgjegjshëm 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT - Të dëgjuarit dhe të folurit/Të lexuarit/Të shkruarit II. VLERAT DHE QËNDRIMET III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË IV. NJOHURITË DHE KONCEPTET SPECIFIKE TË FUSHËS			
Njësia mësimore: Revista e shkollës (projekt ora e parë)			
Fjalët kyçe: revistë, shkrime, kronikë, intervistë, informacione, njoftime, lojëra, arti, kultura.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - bashkëbisedon lirshëm me shokët dhe shoqet duke dhënë mendimet dhe këndvështrimet e tij; - respekton mendimet dhe gjykimet e të tjerëve duke i dëgjuar me kujdes deri në fund; - ndan detyrat qetësisht gjatë diskutimeve në klasë, në mënyrë që të zhvillojnë një projekt së bashku. Kriteret e suksesit: - pasuron linjën e debatit me argumente duke respektuar etikën; - bashkëpunon në grupe rreth detyrës së dhënë; - jep kontributin e tij gjatë punës në grup sipas rolit që i caktohet.			
Burimet, mjetet e konkretizimit: Materiale të gatshme nga botime të ndryshme revistash, revista të botuara nga nxënësit.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, shkencat e natyrës, arte, teknologji.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: pyetje-përgjigje, situata reale, bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, fotomontazh, prezantim, turi i galerisë, konkurs.			
Organizimi i orës së mësimi			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Pyetje-përgjigje, situata reale.			

Në fillim të orës, mësuesi/ja ka përgatitur klasën për projektin me qëllim që të ketë gati materialet e duhura. Klasa duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të kenë të gjithë nxënësit pamje nga projektori. Për këtë orë mësimore janë të ftuar edhe mësues të tjerë nga shkolla, drejtorja e shkollës, nxënës nga senati dhe prindër të nxënësve.

Prezantimi mund të bëhet nga nxënës të përgatitur me një skenar të veçantë.

Lidhja me situatën nis me çështjen: “Ju jeni nxënës në klasën e nëntë dhe shumë shpejt do të largoheni nga kjo shkollë.

- Cilat janë gjërat që do të mbani mend? (shokët, shoqet, mësuesin/en kujdestare, rojën e shkollës etj.).

- Për çfarë do t’ju vijë me shumë keq? (për aktivitetet, shakatë në orët e mësimit)

- A do të donit të riktheheshit pas në kohë? (Po që të ishim më të vegjël e të mos na ngarkonin me kaq shumë detyra.)

- Çfarë do të ndryshonit apo do ta bënit ndryshe nëse do të kishit mundësi? (Do ta vazhdonim shkollën këtu, do të mësonim më shumë)

- Cilin apo çfarë do të donit ta merrnit me vete kur të largoheshit dhe përse? (Shokun, shoqen, bankën e fundit ku rrija rehat, mësuesin/en kujdestare etj.)

Diskutohet me radhë mbi përgjigjet e çiltra e të sinqerta të nxënësve dhe tregohen shkurtimisht dy situata që nxënësit duan të rikujtojnë nga koha e tyre shkollë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Bisedë e kombinuar me diskutim dhe argumentim, fotomontazh.

Mësuesi/ja shtron pyetjet:

- Ç’janë kujtimet? (Kujtimet janë ngjarjet dhe situatat apo personat që kanë qenë pjesë e jetës sonë dhe mbeten në kujtesën tonë, në mendimet tona).

- Përse shërbejnë ato? (Kujtimet na ndihmojnë që të zhvillojmë jetën normalisht, sepse në kujtime dhe kujtesë ruhet shumë informacion për jetën tonë, që nga personat që na rrethojnë deri te ngjarjet që na ndodhin gjatë gjithë jetës).

- Çfarë do të donit të mos harronit asnjëherë? (Kujtimet që dua të ruaj janë ato me familjen time, kujtimet e bukura me shoqërinë, kujtimet që lidhen me formimin tim si njeri).

- Cilat janë gjërat që na ndihmojnë të mbajmë mend dhe të kujtojmë? (Kujtimet ruhen në mendjen tonë, por rritja jonë, koha që kalon bën që ne të harrojmë shumë gjëra, për të kujtuar *më mirë na ndihmojnë fotografitë, tekstet e shkruara, video etj.*).

Diskutojmë me nxënësit rreth përgjigjeve të dhëna.

Për të vërtetuar këtë nxënësit kanë përgatitur një fotomontazh nga shkolla e tyre.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Prezantim, turi i galerisë, konkurs.

Për të kujtuar çaste nga jeta na ndihmon edhe media e shkruar. Pikërisht për të dokumentuar pjesë nga jeta shkollë, për të treguar ngjarje nga shkolla, mënyrën e arsimimit, aktivitete te ndryshme dhe vlerësimet e marra për të reklamuar punën e bërë në shkollë është zhvilluar edhe projekti për revistën e shkollës.

Grupet e punës kanë sjellë botimet dhe bëjnë prezantimin e revistës së tyre.

Secili grup ka krijuar edhe faqen *on-line* të revistës, e cila është hedhur në faqen e shkollës.

Në faqen e shkollës janë bërë pëlqime për revistën nga nxënësit e tjerë të shkollës.

Secili grup reklamon revistën dhe sqaron disa çështje si: vendosjen e titullit, llojin e revistës, tematikat që kanë zgjedhur, grupin e punës sipas rolit dhe kontributit të secilit nxënës, burimi i materialeve, ndihma nga te tjerët, redaktori, faqesja dhe kryetari i grupit.

Kryetari i secilit grup bën një përmbledhje të shkurtër të punës dhe nga një vlerësim për punën e bashkëpunimit të secilit nxënës.

Prezantimi shoqërohet me pamje gjatë zhvillimit të punës së projektit si edhe me pamje të revistës. Pasi mbarojnë me prezantimin secili kryetar u shpërndan të ftuarve nga një kopje të revistës dhe kopjen tjetër e vendos tek këndi i caktuar për turin e galerisë. Nxënësit zhvillojnë turin e galerisë për të parë botimet e njëri-tjetrit dhe japin mendime e vlerësime për punën e grupeve apo për punën e gazetarëve të vegjël. Në fund të orës, në formën e një konkursi të thjeshtë, shpallet revista më e mirë nga votimet <i>on-line</i> sipas pëlqimeve të nxënësve, por edhe nga juria e të ftuarve në klasë ndahen çmimet sipas mënyrës që kanë punuar. Juria vendos duke parë: Tematikat e përzgjedhura që trajtohen, drejtshkrimi i gjuhës në tekste, faqosjen dhe ilustrimet që shoqërojnë e sqarojnë materialin, mënyrën e reklamimit, faktet reale dhe informacionet e sakta, përfshirjen e të gjithë anëtarëve dhe shoqërimin apo jo me suplemente në gjuhë të huaj apo për një çështje të caktuar. Nxënësit përgëzohen për punën e bërë duke u bërë të ditur se me këtë projekt kanë bërë të përhershme shumë kujtime nga jeta shkollore.
Vlerësimi i nxënësve: Vlerësim me notë. Nxënësit do të vlerësohen për përzgjedhjen e materialeve, bashkëpunimin, saktësinë, mënyrën e reklamimit, dorëzimin në kohë të materialeve. Gjithashtu nxënësit do të bëjnë dhe vlerësim të njëri tjetrit me fjalë e shprehje.
Detyrat dhe puna e pavarur
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Mësimdhënësit duhet të japin komentet e tyre për secilën klasë për ecurinë e procesit mësimor.

Pyetjet rreth njohurive gjuhësore (I)

1. Qarko fjalët që janë shkruar saktë.
vajtjeardhjet, vazhdushëm, marathon, ndier, arsyje, lukrecia, llustër, nxierr, bambam, i paaftë.
2. Cilit stil gjuhësor i përket teksti i mësipërm “Zoti të dhashtë”?
a) Stilit shkencor-technik.
b) Stilit juridiko-administrativ.
c) Stilit politiko-shoqëror.
d) Stilit të letërsisë artistike.
3. Gjuha e përdorur në dialogun e paragrafit të parë i përket:
a) regjistrin të thjeshtë;
b) regjistrin të zakonshëm;
c) regjistrin të ngritur.
4. Kthe fjalinë e mëposhtme në ligjëratë të zhdrejtë.
- *A po më fal ndoj send, zojë? – pyeste me dorë në zemër lypësi.*

5. Gjej gabimet dhe rishkruaje saktë grupin e fjalëve.
Fjalët e zonjës së shtëpisë së lagjes së re.

6. Në paragrafin e fundit gjej:
a) një përemër pronor, veta e tretë: _____
b) një mbiemër të nyjshëm, gjinia femërore: _____
7. Shkruaj mënyrën e formimit të fjalëve të dhëna:
a) domethënie: _____
b) buzëqeshje: _____
8. Qarko fjalën e parme:
veprim, përditë, përpara, derës, domethënie, buzëqeshje, shpejto, mendim.
9. Gjej temën dhe mbaresën të fjalëve të dhëna:
a) veprimit: tema _____ mbaresa _____
b) hekurin : tema _____ mbaresa _____

10. Në fund, autori jep një këshillë. Cila është ajo? Kujt i drejtohet autori?

Argumento shkurt (me 5-6 fjali) se përse autori shprehet kështu.

Tabela e vlerësimit

Nota	1	2	3	4	5
Pikë	0-9	10-19	20-29	30-39	40- 50

Pyetjet rreth njohurive gjuhësore (II)

1. Qarko fjalinë e thjeshtë.
 - a) Duket sikur çdo gjë është në rregull.
 - b) Prit këtej e prit andej.
 - c) Ngutja kishte blerë dy metra basmë të bukur për të qepur një fustan.
 - d) Po vete të shikoj pak Durimin.

2. Emërto llojet e fjalive, nisur nga gjymtyra kryesore.

Qyqja, ç'bëra! _____

Të dy për të njëjtin hall. _____

E kontrolluan edhe një herë. _____

Mat shtatë herë dhe prit një herë! _____

3. Dallo në ushtrimin 2:
një fjali dëftore-thirrmore:

një fjali dëshirore:

një fjali nxitëse-thirrmore:

4. Shndërroji fjalitë e mëposhtme në thirrmore.
Duket sikur çdo gjë është në rregull.

Kush të ka mësuar të presësh kaq bukur, more Durim?

Po ky cepi këtu, sikur nuk ma mbush syrin.

5. Qarko fjalinë pavetore.
 - a) Atë mëngjes bënte ftohtë.
 - b) Në derë trokitën përsëri.
 - c) Ngutja shkoi te Durimi.
 - d) Shtriji këmbët sa ke jorganin.

6. Zëvendëso fjalitë e dhëna me fjali emërore.

Bora shkriu ngadalë, deri sa hyri marsi.

Natyra e bukur gumëzhinte nga zërat e fëmijëve.

Tabela e vlerësimit

Nota	1	2	3	4	5
Pikë	0-9	10-19	20-29	30-39	40- 50

REFERENCA

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
- Anita Woolfolk, *Psikologji edukimi*, CDE, Tiranë, 2011.
- Anton Pashku, *Në stuhi*, Prishtinë, 1957.
- Bardhyl Musai, *Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies*, Libri Universitarë”, Tiranë, 1998.
- Bardhyl Musai, *Modele për mësimdhënie të suksesshme*, Tiranë, Edualba, 2001.
- Bardhyl Musai, *Modele për mësimdhënie të suksesshme*, Tiranë, Edualba, 2001.
- Bardhyl Musai, *Psikologji Edukimi*, Tiranë, 1999.
- Bilal Xhaferri, *Krastakraus*, Bilal Xhaferri, Tiranë, 1993.
- Charles Temple, Alan Crawford, Wendy Saul, Samuel R. Mathews, James Makinster, *Strategji të mësimdhënies dhe të të nxëniet për klasat mendimtare*, Botim i projektit, Zhvillimi i të menduarit kritik gjatë të lexuarit dhe të shkruarit, CDE, Tiranë, 2006.
- D. Foenkinos, *Sharlota*, Tiranë, 2017.
- Epi i Gilgameshit* (përkthyer nga Anton N. Berisha).
- J.K. Rowling, *Harry Potter dhe dhoma e të fshehtave*, Dituria, Tiranë, 2012.
- John Boyne, *Djali me pizhame me vija*, Botart, 2014.
- Kasëm Trebeshina, *Fshati mbi shtatë kodrina*, Buzuku, Prishtinë, 2016.
- Kurrikula bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës, Prishtinë, 2016.
- Kurrikula lëndore /programi mësimor për lëndën *Gjuhë shqipe 9*, Prishtinë, 2020.
- M. Witcher, *Udhëtimi i gjatë i Geri Hopit*, Tiranë, 2018.
- Melinda Mula, *Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR*, Prishtinë, 2003, Druck Art.
- Michelle Robinson Obama, *Becoming - Të bëhesh*, Shtëpia Botuese Dudaj, Tiranë, 2019.
- Mitrush Kuteli, *Tregime të moçme shqiptare*, Mitrush Kuteli, 2012.
- Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR - Teknika dhe strategji për zhvillimin e mendimit kritik*, Druck Art, Prishtinë, 2003.
- Një yll i pashuar (mbresa, kujtime dhe krijime për Yllka Domin)*, Klubi Letrar “Gjon Nikoll Kazazi”, Gjakovë, 2002.
- R. L. Stevenson, Çështja e çuditshme e dr. *Xhekillit dhe e z. Haid*, 1896.
- Sterjo Spasse, *Të fala nga fshati*, Tiranë, 1967.
- Strategji të mësimdhënies dhe të të nxëniet për klasat mendimtarë, Grup autorësh, CDE, BK, Tiranë, 2006.
- Viktor Hygo, *Të mjerët*, Tiranë, 2012.
- Zhyl Verni, *Udhëtimi për në qendër të Tokës*, Omska, Tiranë, 2006.

(Katalogimi në botim (CIP
“Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani

37.016:811.18(075.2)

Libër për mësuesin : gjuhë shqipe 9 : për klasën e nëntë të
arsimit 9-vjeçar / Melihate Zeqiri ...[etj.]. - Prishtinë : Pegi,
2022. - 273 f. : ilustr. ; 28 cm.

Mësimdhënia -- Tekste për mësuesit

Gjuha shqipe -- Tekste për shkolla fillore

1. Zeqiri, Melihate 2. Roka, Dafina 3. Kursoni, Meleqe
4. Grajeçevci, Nafije

ISBN 978-9951-786-45-4

Aleph [000102510]